

# **TRAJTIM JURIDIKO-PENAL I TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT NË PROCESIN PENAL SHQIPTAR VËSHTRIM KRAHASUES ME VENDET E TJERA**

**Elena Xhina**

Dorëzuar  
Universitetit Europian të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve tëprogramit të Doktoratës në  
**Shkenca Juridike**, me profil **E Drejtë Publike**, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

Udhëheqës shkencor  
**Prof.Dr.Shefqet Muçi**

Numri i fjalëve: 69.991

Tiranë, tetor, 2016

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

© E drejta e autorit: Elena Xhina

Në përgjegjësinë time personale deklaroj se ky punim është shkruar prej meje sipas kërkesave, kushtedve dhe kritereve të Shkollës Doktorale të Universitetit Europian të Tiranës, nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar, plotësisht apo pjesërisht. Punimi është shkruar nga unë dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

## ABSTRAKTI

*Në procesin penal i pandehuri është një nga subjektet kryesore të së drejtës. Heqja e lirisë e vendos individin në një situatë jashtëzakonisht të cënueshme. Për këtë arsye, është e rëndësishme që heqja e lirisë të jetë sa më e kufizuar dhe të ndiqen procedura rigoroze, të përcaktuara në normat ndërkombëtare dhe në legjislacionin vendas. E drejta për të mos u privuar nga liria në mënyrë arbitrare, është një e drejtë themelore dhe është shprehur në të gjitha dokumentet kryesore për të drejtat e njeriut, si në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Paktin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj), Kartën Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve dhe Konventën Amerikane të të Drejtave të Njeriut. Liria personale, është e lidhur ngushtë me konceptin e dinjitetit njerëzor, dhe është një parakusht për të gëzuar liritë dhe të drejtat e tjera të njeriut. Në legjislacionin shqiptar, kryesisht në Kodin e Procedurës Penale, parashikohen një sërë dispozitash ligjore, të cilat garantojnë për të pandehurin një proces të rregullt ligjor. Nëpërmjet këtyre normave ligjore, i pandehuri vendoset në të njëjtat pozita me palën tjetër në proces, përkatësisht prokurori. E rëndësishme është zbatimi në praktikë i normave ligjore, që garantojnë të drejtat e të pandehurit në një proces penal. Është fakt se nuk ka një autoritet ligjor, që të monitorojë se sa realisht dhe efektivisht zbatohen këto dispozita ligjore në favor të të pandehurit. Në këtë rast monitorimi, do të ketë një ndikim të drejtpërdrejt në procesin penal dhe mund të shërbejë si mbrojtje nga keqadministrimi i drejtësisë. Teza e këtij studimi është: Trajtimi juridiko – penal i të drejtave të të pandehurit gjatë procesit penal. Respektimi i normave ligjore në favor të të pandehurit. Ky studim do të bazohet në një vëzhgim të detajuar, duke përdorur metodat shkencore përshkruese dhe krahasuese kërkimore, duke analizuar kuadrin ligjor shqiptar, përmirësimet e nevojshme që duhet të bëhen në të duke huazuar instrumenteve të suksesshme të vendeve të huaja.*

*Fjalë kyçe : i pandehuri, procesi penal, autoritetit monitorues, të drejtat e të pandehurit, kuadri ligjor*

## ***ABSTRACT***

*In criminal process the defendant is one of the main subjects of law. Deprivation of liberty places the individual in a situation extremely vulnerable. It is important that the deprivation of liberty to be more limited and strictly follow the procedure defined in international documents and national legislation. The right not to be deprived arbitrarily of their liberty is a fundamental right and is expressed in all documents for human rights. Personal freedom is closely related with the concept of human dignity and it is a prerequisite for enjoying freedom and other human rights. Albanian legislation, provides a number of legal provisions which guarantee the defendant a due process. Through these legal norms, the defendant is placed in the same position with the other party in the process, respectively the prosecutor. It is important implementation in practice of legal norms that guarantee the rights of the defendant in a criminal process. The fact is that there is no legal authority to monitor how realistically and effectively these provisions are enforced in favor of the defendants, and the courts. In this case, monitoring will have a direct impact on criminal process and can serve as protection from maladministration of justice. This study will be based on a detailed survey, using descriptive scientific research methods, analyzing the Albanian legal framework, improvements that need to be made in the borrowing of successful instruments from foreign countries.*

***Keywords:*** *the defendant, the criminal process, the monitoring authority, the rights of the defendant, the legal framework.*

## **DEDIKIMI**

*Dedikuar familjes sime, në veçanti Ornelës, Marlës dhe Elizës*

## **FALENDERIME**

*Si pjesë e një trupi, mbi dhé njerëzit janë,  
se brumn' e krijimit të njëjtë e kanë.....*

*(Saadi)*

Këto dy vargje të Saadit në dukje kaq të thjeshta, mbajnë një të vërtetë të madhe brenda tyre. Ne jemi të gjithë të barabartë, të tillë lindim dhe si të tillë duhet të jetojmë. Pikërisht, kjo e drejtë, e lashtë sa vetë jeta, ka qenë frymëzimi i këtij punimi, trajtimi i kësaj teme.

Falenderoj pa fund familjen time të madhe, që më dhanë kurajo e besim e veçanërisht Violën, që më mbështeti në çdo hap për përgatitjen e disertacionit. Prania e familjarëve të mi, ka qenë shumë e rëndësishme për mua dhe pa ta ky punim nuk do të ishte i njëjtë.

Një falenderim i veçantë shkon edhe për Udhëheqësin tim shkencor, Prof.Dr. Shefqet Muçi, i cili më ka mbështetur dhe më ka ndihmuar në realizimin e këtij punimi.

Jam e lumtur që zgjedhja ime për të kryer disertacionin rezultoi më e mira. Faleminderit stafit akademik të UET për profesionalizmin, dimensionin human dhe ndihmën e pakursyer që më kanë ofruar.

Falenderimi dhe mirënjohja shkon për të gjithë miqtë e mi që më kanë inkurajuar, mbështetur e këshilluar, në veçanti Mirandën dhe Bledin!

Dhe pa dyshim, mirënjohja më e thellë e falenderimi më special, shkon për tre vajzat e mia dhe bashkëshortin tim. Ne së bashku ia dolëm. Durimi dhe mirëkuptimi juaj, tregon se sa e madhe është dashuria jonë.

## PASQYRA E LËNDËS

Abstrakti.....	iii
Falenderime.....	vii
Lista e shkurtimeve.....	xii

## KAPITULLI I : HYRJE

1.1 Qëllimi i punimi.....	1
1.2 Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit.....	6
1.3 Aspektet strukturore dhe metodologjia e punimit.....	7

## KAPITULLI II : VËSHTRIM HISTORIK MBI POZITËN DHE TË DREJTAT E TË PANDEHURIT NË SHQIPËRI

<b>Hyrje .....</b>	<b>10</b>
2.1 Kuadri ligjor mbi të drejtat e të pandehurit në këndvështrim historik.....	11
2.1.1 E drejta zakonore shqiptare .....	11
2.1.2 Kuadri ligjor penal pas formimit të shtetit të parë shqiptar.....	13
2.2 Zhvillimet ligjore në kuadrin procedural penal për periudhën 1945-1990.....	17
2.2.1 Risitë ligjore pas vitit 1945 lidhur me të drejtat e të pandehurit në procesin penal.....	17
2.2.2 Kodi i Procedurës Penale të vitit 1953 .....	17
2.2.3 Kodi i Procedurës Penale të vitit 1979.....	19
2.2.4 Kodi i Procedurës Penale të vitit 1995.....	24

## KAPITULLI III : GARANCITË KUSHTETUESE TË TË DREJTAVE TË PANDEHURIT NË FAZËN E HETIMEVE

<b>Hyrje .....</b>	<b>29</b>
3.1 Caktimi i masave të sigurimit personal dhe marrja e një personi si të pandehur.....	32
3.2 Të drejtat themelore të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake, afirmuar në KEDrNj, Kushtetutë dhe K.Pr.Penale.....	39
3.2.1 E drejta e të pandehurit për të njohur akuzën në ngarkim të tij.....	40
3.2.2 E drejta e të pandehurit për të dhënë ose jo shpjegime në lidhje me akuzën në	

<i>ngarkim të tij</i> .....	44
3.2.3 <i>E drejta e mbrojtjes</i> .....	45
3.2.4 <i>E drejta e të pandehurit për të kërkuar marrjen e provave</i> .....	49
3.2.5 <i>E drejta e për t'u ndihmuar nga një përkthyes</i> .....	50
3.3 Të drejtat të tjera të të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake, si garanci për një proces të rregullt ligjor.....	52
3.3.1 <i>E drejta e të pandehurit për të kërkuar përjashtimin e prokurorit të çështjes penale apo oficerit të policisë gjyqësore</i> .....	52
3.3.2 <i>E drejta e kundërshtimit të vendimeve të prokurorit dhe veprimeve të oficerit të policisë gjyqësore</i> .....	53
3.3.3 <i>E drejta e të pandehurit për t'u njohur me të gjitha materialet e çështjes penale në përfundim të hetimit</i> .....	54
3.4 Raste të praktikës gjyqësore lidhur me shkeljen e të drejtave të të pandehurit fazën e hetimeve.....	57

## **KAPITULLI IV : GARANCITË KUSHTETUESE TË TË DREJTAVE TË PANDEHURIT NË FAZËN E GJYKIMIT**

<b>Hyrje</b> .....	<b>61</b>
4.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor, garanci e KEDrNj e afirmuar në Kushtetutë dhe K.Pr.Penale.....	62
4.2 Të drejtat themelore të të pandehurit në fazën e gjykimit të çështjes.....	64
4.2.1 <i>Prezumimi i pafajësisë</i> .....	65
4.2.2 <i>E drejta e mbrojtjes</i> .....	67
4.2.3 <i>E drejta për të marrë pjesë personalisht në gjykim</i> .....	68
4.2.4 <i>E drejta për të paraqitur prova dhe për të diskutuar mbi to</i> .....	69
4.2.5 <i>E drejta e mosinkriminimit të vetvetes dhe e drejta për të heshtur</i> .....	72
4.2.6 <i>Barazia e palëve në procesin gjyqësor</i> .....	73
4.3 Të drejtat të tjera të të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes penale, si garanci për një proces të rregullt ligjor.....	74
4.3.1 <i>E drejta e të pandehurit për t'iu drejtuar gjykatës për një akuzë penale</i> .....	74
4.3.2 <i>Përfundimi i procesit gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme</i> .....	76
4.3.3 <i>Seanca gjyqësore publike dhe shpallja e vendimeve gjyqësore</i> .....	78



4.4 Shqyrtimi i çështjes në Apel. Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit në ushtrimin e të drejtës së ankimit.....	80
4.5 Raste të praktikës gjyqësore lidhur me shkeljen e të drejtave të të pandehurit fazën e gjykimit të çështjes.....	82

## **KAPITULLI V: GJYKIMI NË MUNGESË DHE POZITA E TË PANDEHURIT**

5. Gjykimi në mungesë, nocioni në kuptimin juridik.....	90
5.1 Përcaktimi ligjor i të pandehurit “në mungesë” .....	91
5.2 Procedura ligjore e gjykimit në mungesë.....	93
5.3 Ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së dhënë në mungesë të pandehurit.....	106
5.4 Gjykimi në mungesë i të pandehurit dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut .....	115
5.5 Gjykimi në mungesë në këndvështrimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.....	117
5.5.1 Gjykimi në mungesë dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare.....	117
5.5.2 Mënyra e procedimit gjatë gjykimit në GJPN për personin e akuzuar.....	118

## **KAPITULLI VI : VËSHTRIM KRAHASUES I TË DREJTËS SONË PENALE ME ATË TË HUAJ NË KUADRIN E TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT**

<b>Hyrje.....</b>	<b>121</b>
6.1 Vështrim krahasues me të drejtën penale italiane.....	122
6.1.1 Gjyqtarët dhe gjykatat penale në Itali.....	123
6.2 Vështrim krahasues me të drejtën penale franceze.....	129
6.2.1 Pozita e të pandehurit gjatë hetimit në të drejtën penale franceze.....	130
6.2.2 Ndihma ligjore për të pandehurin në të drejtën penale franceze.....	132
6.2.3 Të drejtat e të pandehurit gjatë gjykimit në të drejtën penale franceze.....	134
6.3 Vështrim krahasues me të drejtën penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	136
6.3.1 Amendamenti i katërt.....	138
6.3.2 Amendamenti i pestë.....	139
6.3.3 Amendamenti i gjashtë.....	145
6.3.4 Amendamenti tetë.....	149
6.4 Vështrim krahasues me të drejtën penale të Republikës së Kosovës.....	151

<i>6.4.1 Kodi Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe parimet bazë të tij.....</i>	<i>151</i>
<i>6.4.2 Procesi penal hetimor në Republikën e Kosovës.....</i>	<i>153</i>

## **KAPITULLI VII : PROBLEMATIKAT NË RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PANDEHURIT NË PRAKTIKË**

7.1 Shkelja e të drejtave të të pandehurit si shkak i pavlefshmërisë së akteve procedural.....	158
7.2 Problematikat e hasura në praktikë në procesin e mbrojtjes së personit nën hetim.....	166

<b>KAPITULLI VIII – KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>168</b>
<b>LISTA E REFERENCAVE/ BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>175</b>

## **LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT**

BE	Bashkimi European
GjEDrNj	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
KEDrNj	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
K.C	Kodi Civil
O.K.B	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSCE	Organization for Security and Co-operation in Europe
RSh	Republika e Shqipërisë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
ECRI	European Commission against Racism and Intolerance
Art	Artikulli
RPSSH	Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë
Gj.K	Gjykata Kushtetuese
Nr.	Numër
Dt.	Datë
Fq.	Faqe

## **KAPITULLI I: HYRJE**

### **1.1. Qëllimi i punimit**

I pandehuri është subjekti kryesor i procesit penal. Në dispozitat e K.Pr.Penale, trajtohet gjerësisht figura e të pandehurit, si në aspektin juridik ashtu dhe atë penal. I pandehuri, në legjislacionin tonë penal, gëzon një sërë të drejtash krahas detyrimeve që ai duhet të përmbushë.

Pavarësisht faktit se në legjislacion janë përcaktuar shprehimisht të drejtat e të pandehurit në një proces penal, në praktikë ndeshen një sërë problematikash, përsa i përket respektimit të tyre.

Nga një vështrim i përgjithshëm i legjislacionit ndër vite, konstatohet se të drejtat e të pandehurit kanë evoluar dukshëm, por gjithnjë ka vend për përmirësim. Referuar ligjit procedural, i pandehuri ka të drejtë që ndaj tij të zhvillohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm, një disponim ky, i cili në sistemin komunist, shtetasit në cilësinë e të pandehurit, nuk e kanë gëzuar. Sot të pandehurit gëzojnë funksionin e mbrojtjes kushtetuese dhe si rrjedhojë, ata disponojnë barazinë e palëve në gjykim. Kjo barazi merr formë të plotë ligjore, me prezumimin e pafajësisë për të pandehurin.

Të drejtat dhe detyrimet e të pandehurit, zënë një vend të rëndësishëm në të Drejtën Penale materiale dhe atë Procedurale Penale. Ato materializohen në nenin 4,5,6,7 e në vijim të K.Pr.Penale. Por pikërisht këtu duhet të ngremë disa pyetje thelbësore: Këto të drejta, janë vetëm në teori apo gjejnë zbatim dhe në procedurën e përditshme hetimore e gjyqësore? Sa vërtet i garantohen të pandehurit, të drejtat që i njeh ligji nga zbatuesit në praktikë të legjislacionit? Sa i njohin të pandehurit të drejtat e tyre dhe a i bëhen të njohura, nga personat që kanë për detyrë t'ia bëjnë me dije atyre?

Pasqyrimi i veprimeve procedurale të kryera ndaj të pandehurit, në çdo fazë të hetimit apo gjykimit, është një nevojë ligjore e domosdoshme, së pari, për personat që janë të përfshirë në fenomenin e zbatimit dhe respektimit të këtyre të drejtave, (gjyqtarët dhe prokurorët, policia gjyqësore, psikologët, edukatorët, avokatët, etj.) dhe së dyti, për vetë doktrinën në këtë fushë. Për të qenë në nivelet e standarteve europiane, kërkohet të jetë prioritet, respektimi i integritetit dhe personalitetit të të pandehurit, duke i garantuar atij të drejtat që i njeh ligji procedural penal.

Në këtë kuadër, ka akte ndërkombëtare shumë të rëndësishme të tilla si: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa Amerikane e të Drejtave të Njeriut, të cilat kanë ndikuar në përfshirjen në legjislacionin tonë të brendshëm të dispozitave të posaçme, që lidhen me të drejtat e të pandehurëve dhe me mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

Një nga parimet bazë dhe themelore të shtetit të së drejtës, është respektimi i lirive dhe të drejtave të individit.

Mjaft studime me vlera ka pasur deri më tani, lidhur me të drejtat e të pandehurit në procesin penal. Nga vetë sistemi i drejtësisë, si Prokuroria apo Gjykata, mbrojtësit, si dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit, po monitorohen garancitë e të pandehurëve, për të gëzuar dhe njohur lirisht të drejtat e parashikuara në ligj. Këto përpjekje, si në fushën akademike ashtu dhe në praktikën e përditshme, kanë sjellë një ndjenjë përgjegjshmërie të funksionarëve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me të pandehurit ( policia gjyqësore, personeli i burgjeve etj. ).

Trajtimi i të drejtave të të pandehurit në procesin penal, kërkon që të njihet mirë konteksti i këtyre të drejtave dhe fusha e zbatimit të tyre.

Respektimi me rigorozitet i të drejtave të të pandehurit gjatë procesit penal, kërkon një vëmendje të veçantë në vendin tonë, në kohën kur legjislacioni penal dhe procedural penal, përpiqet të përqaset me normat ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë. Shoqëria shqiptare në stadin aktual të zhvillimit, e hapur ndaj shoqërive të tjera më të zhvilluara dhe fenomeneve që këto të fundit pasqyrojnë në të, ka filluar të ndërgjegjësohet lidhur me kategorinë e të drejtave dhe detyrimeve që të pandehurëve u përkasin.

Për realizimin e mbrojtjes të personit nën hetim, të dyshuar për një vepër penale apo të pandehurit në procesin penal, duhet të vihen në lëvizje instrumentat ligjore të parashikuar në ligj. Në shumë raste, këto instrumenta ligjor nuk respektohen, duke bërë që të shkelen të drejtat që i përkasin kësaj kategorie personash. Pikërisht, për këtë arsye kuadri ligjor i të drejtave të të pandehurëve, duhet të jenë specifik dhe efikas si dhe të gjej zbatim në praktikë.

Sistemi i drejtësisë shqiptare, nuk ka të përcaktuar se cilët nga aktorët që përfshihen në veprimet procedurale, duhet të monitorojë respektimin e të drejtave të personit nën hetim apo të pandehurit, t'a informojë atë për kategorinë e të drejtave që i përkasin si dhe të marrë masat e duhura për garancinë e respektimit të këtyre të drejtave.

Mospasja e një sistemi të tillë specifik, sjell një vazhdimësi problemesh, në drejtim të figurave që do të merren me trajtimin e këtyre problemeve të parashtruara. Mandej, problemi tjetër i madh që haset në praktikë, është mospasqyrimi me rigorozitet i veprimeve procedurale që kryhen me të pandehurin, në aktet përkatëse. Aktualisht, në vendin tonë, organet e Policisë, duke pasur attribute të organit të akuzës, në më të shumtën e rasteve, abuzojnë dukshëm me personat e arrestuar apo të ndaluar. Kjo konsiston në faktin se këta persona, nuk informohen për të drejtat e tyre, nuk informohen për shkaqet e ndalimit apo të arrestimit. Është fakt se personat e ndaluar apo të arrestuar, pyeten nga oficerët e policisë gjyqësore, disa herë për ngjarjen, pa mbajtur proces – verbal, deri sa ata të mbajnë pozita pohuese dhe në këtë moment, veprimi procedural pasqyrohet në proces – verbal. Pyetja e parë e këtyre personave, bëhet pa praninë e mbrojtësit dhe nuk i mundësohet takimi apo konsultimi me mbrojtësit, deri në momentin e kalimit të çështjes në prokurori dhe shqyrtimit të masës së sigurimit nga Gjykatat.

Të drejtat e të pandehurit po shihen dhe po zhvillohen si një degë e rëndësishme e së drejtës në përgjithësi. Bazat e parimeve të kësaj dege, që lidhen me respektimin e të drejtave të kësaj kategorie personash, e kanë bazën në shumë akte ndërkombëtare, që trajtojnë gjerësisht këto parime të së drejtës.

Për të dhënë kontribut në respektimin mirëfilli të këtyre të drejtave dhe në Shqipëri, trajtimi i problematikave në planin procedural dhe atë juridiko-penal, paraqet rëndësi e ka vend për lëvrim. Në trajtimin e kësaj teme dhe në funksion të këtij qëllimi, është e nevojshme që të trajtohet efikasiteti i instrumenteve mbrojtës në favor të të pandehurit dhe respektimi në praktikë i të drejtave të tyre. Që të realizohet ky trajtim në aspektin e respektimit të të drejtave, duhen parë të drejtat e të pandehurëve në planin e legjislacionit të brendshëm të shtetit shqiptar, i cili në këto vite ka ratifikuar e bërë pjesë të tij, akte ndërkombëtare që i trajtojnë gjerësisht këto të drejta.

Qëllimi i këtij studimi ka të bëjë me faktin se deri në çfarë shkalle legjislacioni ynë garanton mbrojtjen e këtyre të drejtave, duke pasur parasysh standartet ndërkombëtare dhe me identifikimin e dispozitave specifike në ligjet e brendshme, që i sigurojnë të pandehurëve mbrojtje. Nga kjo analizë, do të lindin ide për krijimin e një sistemi efikas të drejtësisë për të përmirësuar Kodin e Procedurës Penale, duke bërë dhe paralelizimin me Kushtetutën e RSh, si një garanci për zbatimin me përpikmëri në praktikë dhe për krijimin e një drejtësie efektive për këta të pandehur.

Tjetër qëllim i këtij studimi, do të jetë evidentimi se si janë përmirësuar ndër vite të drejtat e të pandehurit, duke filluar vëzhgimin historik në këtë drejtim, që nga e drejta zakonore shqiptare, dispozitat e Kodit Penal Otoman e deri në dispozitat e legjislacionit të sotëm procedural penal. Duke shfrytëzuar metodën e krahasimit, do të nxirren në pah përmirësimet e bëra dhe evolimin e këtyre të drejtave.

Studimi ka për synim të trajtojë terma të tillë si, dispozitat që trajtojnë të drejtat e të pandehurëve, monitorimin e respektimit të këtyre të drejtave, ndërgjegjësimi i subjekteve pjesëmarrëse në një procedim penal, për zbatimin me korrektësi të dispozitave në favor të të pandehurit, paralelizimi i K.Pr.Penale me Kushtetuten dhe Konventat Europiane, duke i studiuar në kompleksitet këto terma, për të arritur në një kuptim sa më të drejtë të termave juridiko-penal.

Qëllim i studimit është të përcaktohet qartë se sa realisht respektohen të drejtat e të pandehurit, të analizohen shkaqet që shpien në abuzim të pozitës së të pandehurit, duke paraqitur dhe raste konkrete të mohimit të të drejtave të tyre. Njohja e këtyre rasteve dhe vënia në dukje e tyre, do të bëjë të mundur zhvillimin mandej të një politike parandaluese efektive nga organet kompetente të shtetit, dhe për të gjetur zgjidhje praktike, lidhur me shkeljen e të drejtave të kësaj kategorie personash ( persona nën hetim, të pandehur ).

Në pjesën që do trajtojë dispozitat për të drejtat e të pandehurëve, studimi do të hedhë dritë mbi faktin se sa realisht vihen në jetë këto dispozita, sa i bëhen të ditura ato të pandehurit, sa i njohin personat nën hetim të drejtat që i garanton ligji dhe përdorimin e gjithë instrumentave mbrojtës në favor të të pandehurit. Duke analizuar të gjithë këto koncepte, do të merren në shqyrtim mendësi të ndryshme, lidhur me problematikat në këtë fushë dhe trajtimin juridiko-penal të tyre. Duke shqyrtuar vendin që zë në legjislacionin tonë të brendshëm, drejtësia në favor të të pandehurëve në dritën e akteve ndërkombëtare, studimi do të shqyrtojë masën në të cilën kjo drejtësi është efektive, problemet që hasen në praktikë dhe si mund të arrihet në një përmirësim të legjislacionit aktual.

Në punën time si Avokate, jam marrë kryesisht, me përfaqësimin e të pandehurëve në procesin penal, duke i ndjekur ata që në momentin e ndalimit të tyre apo arrestimit, deri në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale që janë dhënë. Duke qenë në kontakt me të pandehurit, që në fazat e para të procedimit penal, marrja pjesë në pyetjen e tyre, kryerja e veprimeve procedurale me ta, pjesëmarrja në gjykimin e çështjeve të të pandehurve deri në vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore, më kanë vënë përballë shumë sfidave lidhur

me trajtimin e tyre në pikëpamjen ligjore, por edhe njerëzore, dhe më kanë nxitur të shtrij kërkimin tim në këtë fushë, si në drejtim të akteve normative ndërkombëtare që kanë për objekt të drejtat e të pandehurëve, ashtu dhe në legjislacionin e brendshëm dhe të praktikës gjyqësore në këtë drejtim. E rëndësishme të kuptohet është, se një shtetas, kushdo qoftë, që ka marrë cilësinë e personit nën hetim ose të të pandehurit, nuk është thjesht një subjekt procedural që duhet të trajtohet flohtë nga sistemi i drejtësisë. Përkundrazi, figura e tij, duhet të shihet në kompleksitet, në mënyrë që atij t'i bëhen të njohura mjetet ligjore që i garanton ligji, si dhe duke respektuar të drejtat e tij gjatë kryerjes së veprimtarisë hetimore e gjyqësore. Për të realizuar këtë objektiv, hapa që duhet të ndiqen janë:

1. Të informohet i pandehuri për të drejtat që parashikohen në ligj dhe për mjetet juridike të mbrojtjes ligjore;
2. Të garantohet një mbrojtje efikase e të pandehurve, që nuk kanë mundësi të zgjedhin një mbrojtës dhe i caktohet një mbrojtës nga shteti;
3. Të pasqyrohen në akte ligjore të gjitha veprimet proceduriale të kryera ndaj të pandehurit, në çdo fazë të procesit penal;
4. Të monitorohet hap pas hapi respektimi i të drejtave të të pandehurit në procesin penal, për të garantuar këto të drejta, ruajtjen e dinjitetit të tyre gjatë marrjes në pyetje, shmangien e arbitraritetit si dhe respektimin barazisë së palëve;
5. Të merren gjithë masat e nevojshme nga institucionet përgjegjëse, për ta bërë drejtësinë efikase për çdo të pandehur.

Këto çështje më motivojnë që, së pari t'i përkushtohem hulumtimit lidhur me këto pesë pika të përmendura dhe së dyti, për të analizuar kontekstin e ligjit penal shqiptar, për gjendjen e drejtësisë për të pandehurit dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Për të drejtat e të pandehurit në procesin penal, janë dhënë mendime e janë bërë punime të vlefshme dhe vazhdojnë të bëhen. Duke pasur parasysh trajtime të tilla, ky studim do të përqëndrohet në trajtimin e elementeve të rinj dhe të ndërthurur me praktikën ekzistuese të organeve të drejtësisë në Shqipëri.

Për të bërë këtë studim, në një fushë që është punuar, do të përdoren burime si:

1. Aktet ndërkombëtare që veprojnë në drejtim të respektimit të drejtave të pandehurve, si Konventa, Deklarata, Rekomandime e akte të tjera të organizmave të ndryshme ndërkombëtare, si O. K. B, Këshilli i Evropës, etj. e të ratifikuara nga shteti shqiptar.



2. Legjislacioni shqiptar ndër vite, për pjesët që kanë trajtuar dispozitat për të drejtat e të pandehurëve.
3. Trajtimet e ndryshme juridiko-penale të autorëve të huaj, mbi integritetin e të pandehurëve dhe të drejtat e tyre.
4. Trajtime juridiko-penale të autorëve vendas, mbi respektimin e të drejtave të pandehurëve.
5. Raste të praktikës hetimore e gjyqësore në procedimet penale, që evidentojnë shkelje të të drejtave të të pandehurëve, duke nxjerrë në pah faktin, se sa zbatohen dispozitat ligjore në favor të personave që procedohen.
6. Burime të internetit.

## **1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit**

Në përjasje të legjislacionit procedural penal me aktet ndërkombëtare, që i kushtojnë një hapësirë të rëndësishme të drejtave të të pandehurit, ligjvënësit tanë kanë bërë përpjekje maksimale për të garantuar një proces ligjor sa më të drejtë dhe të paanshëm.

Nëpërmjet këtij studimi, do të shqyrtojmë hipotezën e ngritur, hipotezë e cila do të na shërbejë si pikënisje për të evidentuar problematikat që lidhen me temën për studim.

Për këtë studim, ka mjaft rëndësi jo vetëm parashtrimi teorik i kuadrit ligjor të procedurës penale dhe akteve ndërkombëtare, por dhe pasqyrimi i problematikave, unifikimit të praktikave gjyqësore, rasteve konkrete të shprehura me vendime gjyqësore, dhe gjetja e instrumenteve më të mirë për një proces sa më të rregullt ligjor. Të gjitha këto pjesë të strukturës së studimit, do t'i shërbejnë hipotezës së tij dhe dhënies së përgjigjeve për pyetjet e ngritura në të.

Hipoteza e këtij punimi kërkimor është:

- *Kuadri ligjor i të drejtës penale dhe procedurale penale shqiptare, përse i përket të drejtave të të pandehurëve, edhe pse në përgjithësi është i plotë dhe i bazuar në parimet e të së drejtës penale ndërkombëtare, nuk gjen zbatim në praktikë, pasi ndryshimet e herëpashershme në kuadrin ligjor penal e atë procedural penal, kanë ndërlikuar shumë procesin dhe kanë vështirësuar zbatimin e drejtësisë në praktikën gjyqësore.*

Me qëllim vërtetimit të kësaj hipoteze, në punim janë studiuar: mënyra se si ka evoluar në Shqipëri kuadri ligjor në drejtimin e të drejtave të të pandehurit, një vështrim krahasues me disa shtete të ndryshme të botës; vështrimi i legjislacionit nën dritën e akteve ndërkombëtare në këtë kuadër; problemet e hasura dhe pasqyrimi i tyre; raste të ndryshme të pasqyruara me praktika gjyqësore të vendit tonë dhe të huaja në këtë fushë.

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të studimit janë:

- Çfarë kuptohet efektivisht dhe praktikisht me termin "të drejta të të pandehurit" në të drejtën tonë penale ?
- Si kanë evoluar të drejtat e të pandehurit në procesin penal, në Shqipëri?
- Sa garantohet realisht të drejtat e të pandehurit nga subjektet e së drejtës në vendin tonë dhe a u bëhen të njohura të pandehurëve këto të drejta ?
- A është legjislacioni ynë procedural penal në harmoni me aktet ndërkombëtare?

### 1.3 Aspektet strukturore dhe metodologjia e punimit

Metodologjia e studimit do t'i përgjigjet arritjes së qëllimeve të këtij punimi. Në varësi të hipotezës apo pyetjeve që do të ngrihen në kapituj të veçantë të punimit, do të zbatohen edhe metodat e hulumtimit shkencor.

Në këtë studim do të përdoret **metoda e mbledhjes së të dhënave cilësore, analiza e të dhënave, metoda e analizës dokumentare, studimi i krahasuar dhe studimi i rastit.**

Punimi, i cili synon të trajtojë pikat e përmendura në seksionet më lart, do të jetë i ndarë në katër pjesë:

Në **pjesën e parë** të punimit, do të trajtohet sistemi ynë i së drejtës nga pikëpamja e të drejtave të personave nën hetim ( të pandehur ), në këndvështrim të faktorëve historike e sociale, duke nxjerrë në pah, përmiresimet e bëra në legjislacionin tonë penal në këtë drejtim, dhe se si lidhet respektimi i dispozitave referuese sa më lart me mbarëvajtjen e proceseve hetimore e gjyqësore.

Në këtë pjesë të parë, përveç trajtimit juridiko – penal të të drejtave të të pandehurëve, do të merren në shqyrtim problematikat e hasura në këtë kontekst dhe si është unifikuar praktika gjyqësore.

Në këtë pjesë, do të përdoret metoda e analizës dokumentare, nëpërmjet së cilës do të synohet të nxirren në dritë, elementet që vënen në pah ndryshimet në legjislacion, të cilat

kanë sjellë dhe përmirësimin e pozitës së të pandehurit në procesin penal, duke shfrytëzuar literaturën përkatëse të autorëve vendas, por duke bërë njëkohësisht krahasimin me aktet ndërkombëtare në këtë drejtim. Përveç kësaj, në funksion të kësaj metode të përdorur do të jetë dhe interpretimi i dispozitave ligjore, që hedhin dritë mbi përcaktimet juridiko-penale të këtij fenomeni. Nëpërmjet kësaj analize, do të synohet të bëhet e kuptueshme se përmirësimi i pozitës së të pandehurit, përbën pikënisjen për zhvillimin e mëpasshëm dhe një përmirësim të mëtejshëm të Kodit të Procedurës Penale, duke e bërë atë sa më bashkëkohor dhe efikas.

Në **pjesën e dytë** tëpunimit,do të gjejnë trajtim të veçantë të drejtat specifike të të pandehurit, mënyrën e interpretimit juridik të tyre, vendosjen e këtyre dispozitave në qendër të analizës së një procesi penal. Do të trajtohet mënyra se si lëvrohen këto të drejta nga subjektet që marrin pjesë në një proces penal, do të hulumtohet roli i veçantë që ka policia gjyqësore, prokurori, si subjekti i parë që bie në kontakt të drejtëpërdrejt me të pandehurin, ndërgjegjësimi i këtyre personave për të drejtat që i njej ligji, realizimin e një mbrojtjeje sa më efikase të të pandehurit dhe kur janë në pamundësi për të zgjedhur një mbrojtës, pasqyrimin e çdo veprimi konkret të kryer me të pandehurin në akte shkresore. Në këtë pjesë, do të analizohet edhe trajtimi juridiko-penal i të drejtave të të pandehurit nga legjislacioni aktual shqiptar në këtë fushë, parë në dritën e akteve ndërkombëtare.

Për të nxjerrë në pah këto problematika, do të përdoret metoda e mbledhjes së të dhënave cilësore, ku do të shfrytëzohen vendime të ndryshme gjyqësore të Gjykatave Shqiptare dhe të Huaja. Më pas, do të vazhdohet me analizën e të dhënave të mbledhura, me qëllim që të përshkruajmë,diskutojmë, vlerësojmë dhe të shpjegojmë përmbajtjen dhe karakteristikat e këtyre të dhënave.

Në **pjesën e tretë** të punimit, do të analizohet trajtimi juridiko-penal i të drejtave të të pandehurit, nga legjislacione të vendeve të ndryshme të botës. Për këtë qëllim, do të përdoret studimi krahasues funksional.

- Për të bërë sa më bindës studimin, në këtë pjesë, dhe për të arritur në përfundime konkrete e logjike për t'u pranuar, synoj të përdor metodën e kërkimit të studimit të rastit, duke përfshirë në studim raste konkrete nga praktika shqiptare e organeve të drejtësisë, mënyrën e trajtimit të tyre dhe respektimit të procedurave aktuale, deri në fazën e ekzekutimit të vendimit penal e më tej, të metat e këtij procesi. Duke u përpjekur të përgjithësoj fenomenin, do të përpiqem të jap një panoramë të

përgjithshme të realitetit shqiptar, në fushën e trajtimit të dukurisë së respektimit të së drejtës së të pandehurit. Përfundimet e marra nga reflektimi mbi literaturën, krahasimi mes legjislacionit të brendshëm e ndërkombëtar për kategorinë e të drejtave të të pandehurit në procesin penal, dhe raste nga praktika gjyqësore, do të shërbejnë, në funksion të idesë se legjislacioni shqiptar, përse i përket të drejtave të të pandehurëve, është në përputhje me aktet ndërkombëtare.

**Pjesa e katërt** e punimit lidhet me pasqyrimin e problematikave si dhe me përfundimet dhe rekomandimet, e cila do të përfshijë, në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe përfundimet e kapitujve paraardhës, kjo në funksion të hipotezës ngritur që në fillim të punimit. Hulumtimet dhe rekomandimet do të kenë për qëllim të përmirësojnë legjislacionin e brendshëm dhe ta harmonizojnë atë me praktikën ndërkombëtare.

Ky studim është mbështetur në një literaturë relativisht të gjerë, që përfshijnë burime parësore, burime dytësorë dhe burime të tjera.

Përveç akteve të së drejtës shqiptare, në studim janë përfshirë edhe akte nga e drejta e brendshme e disa shteteve të tjerë, si Franca, Italia, SHBA, Kosova, të cilët janë përdorur për t'i krahasuar me legjislacionin shqipëtar, në funksion të hipotezës dhe pyetjeve të studimit.

Është zgjedhur Franca dhe Italia, si shtete nga te cilat është huazuar Kodi Procedural Penal Shqiptar, me qëllim për të parë se si funksionon një legjislacion pothuajse i ngjashëm në vende të ndryshme.

Është zgjedhur Kosova, me qëllim që të bëhet krahasimi me një shtet në nivel pak a shumë të barabartë me Shqipërinë.

Nga ana tjetër, është zgjedhur SHBA, me një sistem të së drejtës penale krejt të ndryshëm nga ai shqiptar.

## **KAPITULLI II:VËSHTRIM HISTORIK MBI POZITËN DHE TË DREJTAT E TË PANDEHURIT NË SHQIPËRI**

### **HYRJE**

Procedimi penal lindi në një periudhë të caktuar historike, si një kërkesë dhe nevojë e shoqërisë për të luftuar kriminalitetin. Bashkë me procedimin penal, u shfaqën edhe subjektet kryesore të tij, pa të cilët ai nuk mund të kuptohet, dhe që janë prokurori dhe i pandehuri.

Funksionet që kryejnë dhe interesat që përfaqësojnë të dy këto subjekte, janë të kundërta, megjithatë është fakt tashmë seshteti nuk e zhvillon procedimin penal për të dëmtuar individin, por për të luftuar kriminalitetin. Duke qënë se i pandehuri është subjekt që ka lindur njëherësh me procedimin penal, edhe para prokurorit, si përfaqësues i interesave të shtetit, në qendër të procedimit penal, është i pandehuri, pa të cilin ky procedim nuk mund të kuptohet. Por, me evoluimin e shoqërisë, është formuar dhe është përsosur edhe pozita e të pandehurit, si subjekt i këtij procedimi. Në trajtimin që do t'i bëjmë më poshtë, ne do të sjellim evoluimin e pozitës së tij ndër vite dhe garancitë që kanë sjellë për të, ndryshimet në legjislacionin procedural penal shqiptar.

Ky trajtim do të fillojë me përcaktimin ligjor të pozitës së të pandehurit, në periudhat historike nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë dhe përkatësisht : Periudha e pushtimit osman; Mbretëria e Mbretit Zog; Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe Shqipëria si Republikë Parlamentare.Në vijim do të trajtojmë pozitën e të pandehurit në periudhat historike sa sipër, kuadrin ligjor që ka vepruar në këtë periudhe, përmirësimet e bëra kohë pas kohe dhe transformimet e shumta ligjore, që kanë shoqëruar këto periudha historike në këndvështrimin e pozitës së të pandehurit.

## 2.1 Kuadri ligjor mbi të drejtat e të pandehurit në këndvështrim historik

### 2.1.1 E drejta zakonore shqiptare

E drejta zakonore shqiptare është zhvilluar në shekullin IV. Kjo e drejtë, ka shërbyer si mjet i rëndësishëm në vetqeverisjen dhe bashkimin e popullit. Ajo ka sjellë mbijetesën dhe qëndresën ndaj ndikimeve të pushtuesve të ndryshëm.<sup>1</sup>

“Për të drejtën ilire nuk janë gjendur ende ligje apo akte të tjera të pushtetit shtetëror të shkruara e të sistemuara në kode ose në forma të tjera. Por sidoqoftë disa të dhëna fillestare ndonëse të zbehta na japin të kuptojmë se ajo ishte një pjesë e rëndësishme superstrukurale”<sup>2</sup>

Ilirët nuk e humbën orgjinalitetin e së drejtës së tyre as nën pushtimin romak. Ata zbatonin të drejtën e tyre zakonore, por se, kjo nuk ishte në kundërshtim me rendin publik romak.

“Burimet kryesore të së drejtës ilire ishin zakonet. Rëndësi kishin dhe aktet e ndryshme ligjore...në sistemin e së drejtës ilire vendim kryesor e zinte e drejta penale...për shkeljen e rregullave të ndryshme dhe kryerjen e krimeve të ndryshme, e drejta ilire kishte sanksionuar dënime të caktuara..Gjykatat ishin organet kryesore që merresin me dhënjen e drejtësisë...”<sup>3</sup>

Historia tregon mbijetesën e të drejtës zakonore. Edhe arbërit e ruajtën të drejtën e tyre zakonore, pavarësisht nga sundimi bizantin. Por se dhe për këtë kohë nuk ka të dhëna dokumentare dhe ato pak janë rastësore, të cilat janë më të plota nga shekulli XIV, të cilat pasqyrojnë institute të veçanta të së drejtës zakonore.

Në këtë drejtim, janë trajtuar si burime të drejtës zakonore shqiptare,<sup>4</sup> në studimet përkatëse, ato që janë studiuar e janë gjetur të dokumentuara e janë hulumtuar nga studiuesit.

“Burimet kryesore të së drejtës zakonore shqiptare të njohur deri tani janë: Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Maleve dhe Kanuni i Labërisë, si dhe kanune të tjerë lokale si ai i Bendës, Mirditës, Pukës, Hasit, etj.”<sup>5</sup>

Kanuni i Labërisë dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, paraqesin rëndësi të veçantë juridike, pasi nëto sanksionohen parimet themelore juridike të barazisë, të lirisë, ashtu siç ato pasqyrohen në të drejtën zakonore mbarëshqiptare.

“Studiues vendas dhe të huaj që janë marrë me të drejtën zakonore shqiptare apo me Institute të veçanta të saj janë përqëndruar kryesisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit, kjo edhe për faktin se Kanuni i Labërisë në përmbajtje të tij përputhet me të”<sup>6</sup>

<sup>1</sup>Luarasi,A. (2001) *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Tiranë:SHBLU, fq. 124

<sup>2</sup>Krisafi,K. (1979) *Shteti dhe e drejta në Iliri, Drejtësia Popullore*, Nr.1, Tiranë, fq. 87

<sup>3</sup>Po aty, fq.88

<sup>4</sup>Berhami,I. (2009) *Disa aspekte të përgjithshme të së drejtës zakonore shqiptare*, Tiranë: Buletin Shkencor : Seria e shkencave ekonomiko-juridike. - Nr. 3, f. 7 - 16.

<sup>5</sup>Elezi,I. (1998) *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, Tiranë: Albin, fq. 20

<sup>6</sup> Elezi,I. (2002) *Edrejta zakonore e labërisë*, Tiranë: Toena, fq.12

Kanune paraqesin interes për faktin se sjellin një korpus ligjor më vete, të pakodifikuar më parë.<sup>7</sup>

Më i njohur për kohëzgjatjen e tij, është kanuni i Lekë Dukagjinit, jo vetëm për shkakun e mbledhjes dhe njohjes së tij nga ana dokumentare, por dhe për faktin se, ai është zbatuar deri vonë dhe ka qenë “më i institucionalizuar”, në atë çfarë është gjetur e shkruar.

Duke i'u referuar Kanunit të Lekë Dukagjinit, elementët e normave të së drejtës, sanksionohen në këto dispozita :

Neni 142 : " Pleqt janë a të parët e vllaznive a Krenët e fiseve, zyra e të cillvet është e pshtetun në themel të tagrit kanûnor....Pa këta nuk mund të bahet ndo'i kanûn i ri e as kurrnji gjyqj a pleqni, qi do të pershijë a nji vllazni, a nji fis, a edhe nji katund e Flamur....Pleq thirren edhe burrat ma në za për urti e qi janë regjë ndër gjyqe e pleqni...Këta janë gjyqtarë nën be, të panashëm, krejt të pamvarëm, qi ushtrojnë drejtësinë për mprorjen e të gjitha tagrave të seicilit e të përbashkta e për dënimin e fajtorve. Gjyqi i bamë prej tyre ashti i njoftun prej kanunit mjaft qi të pleqnojnë mbas këtij..grueja nuk thirret në pleqni..."<sup>8</sup> .

Neni 152 : "Gjyqi mbi gjyqj" e Plak mbi Plak kanûja nuk bân."<sup>9</sup>

Neni 160 : " Në mos të pelqefët gjyqji, tek a'Sh.Pali...Në mos të pelqefët gjyqji, tek a'Gryka e Oroshit.. Dera e Gjomarkut themeli i kanûs..."<sup>10</sup>

Pleqnia, luante rolin e një organi të posaçëm gjyqësor, e cila i shqyrtonte rastet që u interesonin dy palëve ndërgjyqësore. Përbërjen e pleqnisë e përcaktonin palët. Procedura të cilën e zhvillonte pleqnia, i përgjigjet procedurës akuzuese. Hetimet në funksion të pleqnisë, i kryente një person i quajtur kapucar. Shqyrtimi gjyqësor bëhej me gojë, kontradiktor dhe i drejtpërdrejtë. Pleqnia, në fund jepte vendimin, të cilin e komunikonte dhe ai nuk mund të ankimohej.

Referuar këtij Kanuni, rezulton se janë respektuar disa parime bazë të procesit penal, si : Gjykimi i paanshëm dhe i pavarur, mos gjykimi dy herë për të njëjtin fakt, parimi i kontradiktoritetit. Por nga ana tjetër, konstatohet se personi i gjykuar ishte i detyruar të pranonte vendimin e pleqësisë dhe nuk mund ta ankimonte atë.

Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe kanunet e tjera provojnë se, shoqëria kishte kaluar në organizimin e saj mbi bazën e rregullave të insitucionalizuara, dhe në zona e ndryshme, ato ishin forma embrionale të organizimit të brenshëm shtetëror.Krerët e pleqtë me sundimin ekonomik e jashtëekonomik, krijuan lidhjet e tyre, qoftë edhe të tërthorta me strukturat

<sup>7</sup> Konomi ( Perolla),R. (2013) *Rendi etnojuridik nga statutet tek kanunet*, Tiranë :Kristalina - KH, fq.106

<sup>8</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K.Gjeçovi, përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova, fq. 138

<sup>9</sup> Po aty, fq. 148

<sup>10</sup> Po aty, fq. 150

publike osmane.<sup>11</sup> Për rrjedhojë, nga nevoja e bashkëpunimit shoqëror, ekonomik e politik, s'mund të realizohet një pavarësi totale nga e drejta osmane. "Megjithatë edhe në kushtet e kësaj autonomie, ka qenë i pashmangshëm ndikimi i së drejtës zyrtare osmane mbi të drejtën zakonore shqiptare".<sup>12</sup>

### **2.1.2 Kuadri ligjor penal pas formimit të shtetit të parë shqiptar**

Në kuadrin e reformave të Tanzimatit, në gjysmën e shekullit XIX, Porta e Lartë u përpoq të vërë në jetë politikën e saj për kufizimin e autonomisë së zonave që funksiononin mbi bazën zakonore shqiptare. Për këtë arsye, u miratua ligji i Xhibalit, mbi bazën e të cilit u krijua një komision, me cilësinë e një organi të lartë gjyqësor dhe administrativ. Por kjo orvatje për të institucionalizuar të drejtën zakonore, nëpërmjet veprimtarisë së organeve shtetërore nuk pati sukses.<sup>13</sup> Pas pushtimit osman, e drejta zakonore shqiptare nuk mbijetoi njëllë në të gjitha krahinat, madje ajo nuk pati të njëjtin tregues të fuqisë vepruese juridike. Në Shqipërinë Qëndrore, këto norma kanunore zbehen, madje, duke mos u pajtuar me marrëdhëniet e reja në zhvillim, disa prej tyre pushuan së ekzistuari.<sup>14</sup>

Me krijimin e shtetit të ri shqiptar nën drejtimin e Ismail Qemalit, në vitin 1912, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, u investua për organizimin e sistemit të ri juridik. Kuvendi i Vlorës deri në miratimin e ligjeve të reja, la në fuqi Kodin Penal Osman (të vitit 1858) me shtesat e ndryshimet e 27 majit të vitit 1909 dhe Kodin e Procedurës Penale (1879). Kuvendi i Vlorës më 10.05.1913 miratoi Kanunin e Zhurisë.

Ky kanun parashikoi një simbiozë të kërkesave të legjislacionit bashkëkohor të tipit kontinental dhe të drejtës së lashtë zakonore, pa institutet arkaike, që nuk pajtoheshin me marrëdhëniet e reja shoqërore dhe me qënien e një vendi sovran. Kanuni i Pleqsisë i vesh kanunet e zakoneve me një pekt të ri ku përfshihet edhe instituti i jurisë.<sup>15</sup>

Në këtë kanun parashikohej që anëtarët e zhurisë zgjidheshin nga njerëzit më të ndershëm, të ditur e të provuarit (nenet 1-4); në nenin 6 të tij parashikohej edhe e drejta e kërkesës për

---

<sup>11</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K.Gjeçovi, përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova, fq. 16

<sup>12</sup> Omari, L. (1990) *E drejta zakonore dhe e drejta zyrtare në Shqipëri, Drejtësia popullore*, Korrik-Shtator, Tiranë: SHBLU fq. 64

<sup>13</sup> Omari, L. (1990) *E drejta zakonore dhe e drejta zyrtare në Shqipëri, Drejtësia popullore*, Korrik-Shtator, Tiranë: SHBLU fq. 65

<sup>14</sup> Konomi (Perolla), R. (2013) *Rendi etnojuridik nga statutet tek kanunet*, Tiranë: Kristalina - KH, fq. 88

<sup>15</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K.Gjeçovi, përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova, fq. 41



përgjyqësor nga palët ndërgjyqësore të ndonjë anëtarit të zhurisë; gjykimi ishte publik (neni 13); në gjykim janë parashikuar si prova dëshmitë e çdo gjë tjetër (neni 14); e drejta e ankimit ndaj vendimit do të bëhej në gjykatën e diktimit (nenet 23-27).<sup>16</sup> Por, kjo procedurë e gjyqimit me juri për krimet e rënda, u zbatua vetëm një herë në Gjykatën e Elbasanit. Referuar nenit 9, Kanuni i Zhurisë i jepte të drejtën personit të gjykuar të zgjidhte një përfaqësues, dhe në pamundësi finaciare, do ti caktohej një përfaqësues me dëshirën e të gjykuarit nga gjykata<sup>17</sup>. Nga ana tjetër, personi i gjykuar, kur i fshihej hetimit, njoftohej nga gjykata për t'u paraqitur.

Sa sipër, rezulton se Kanuni i Zhurisë shënoi fillimet e zbatimit të politikës ligjore, për krijimin e elementeve të së drejtës penale e të procedurës penale, si dhe të organizimit gjyqësor me orientim perëndimor. Kanuni i Zhurisë dhe procedura e re gjyqësore e vendosur prej tij, ishte një ligj disi konfuz, por modern për kohën.<sup>18</sup> Mirëpo kjo veprimtari ligjëbërëse u ndërpre dhe kanunet nuk u zbatuan, për arsye se Qeveria e Ismail Qemalit dha dorëheqjen.

Mbi bazën e vendimeve të marra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 29 korrik 1913, në Shqipëri erdhi Princ Vidi, si princ për fronin shqiptar dhe më datë 10 prill 1914 hyri në fuqi "Statuti organik i Shqipërisë", i cili në një pjesë të tij kishte dhe mënyrën e organizimit gjyqësor të vendit; këshilli i pleqve, gjyqi i paqit, gjykata e shkallës së parë, gjyqi i apelit dhe Gjykata e Diktimit. Por edhe ky ligj, si të parët, mbeti i pazbatuar për shkak të Luftës së Parë Botërore, kur Shqipëria u bë shesh luftërash e pushtimesh të huaja.<sup>19</sup>

Duke qenë se vendi ishte në gjendje kaosi, zbatohej edhe e drejta zakonore penale, sidomos në zonat malore, po dhe ligjet e pushtuesve të huaj. Prandaj, për atë kohë sistemi i drejtësisë penale nuk ishte i përcaktuar.

Pas zhvillimit të Kongresit të Lushnjës në janar 1920, u miratua Statuti i Lushnjës, dhe pas zgjerimit të këtij statuti në vitin 1922, ai mori karakterin e një akti të plotë kushtetues, ku parashikoheshin për herë të parë të drejta e liri qytetare. Në nenin 16 të tij parashikohej

---

<sup>16</sup>Kanuni i Zhurisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

<sup>17</sup>Po aty, fq. 11

<sup>18</sup>Anastasi, A. (1998) *Institucionet Politike dhe e drejta Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë : Luarasi, fq.24

<sup>19</sup>Elezi, I. (2009) *Vështrim i shkurtër historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, Revistë Shkencore «Justiniani I», Tiranë: Albin, fq. 9

se:“Askush nuk mund të arrestohet, as të dërgohet në gjyq, veçse në rasat e parapame prej ligjës dhe në formën e caktuar prej saj”<sup>20</sup>.

Me dekretin e 11 janarit 1921, për sistemin gjyqësor shqiptar, u krijuan: 18 gjykata të pajtimit, 7 gjykata të shkallës së parë nëpër prefektura dhe një gjykatë e lartë (Diktimi) me qendër në Shkodër. Një vit më vonë, më 1922, Diktimi u vendos në Tiranë. Politika kriminale e shtetit shqiptar, gjeti pasqyrim edhe në programin e Qeverisë Demokratike të Fan S. Nolit (1924) për reformën ligjore.<sup>21</sup>

Pas largimit të Fan S.Nolit, me ardhjen në fuqi të Ahmet Zogut, u miratua “Statuti themeltar i Republikës së Shqipnjes” (1925) dhe, pas tre vjetësh, “Statuti Themeltar i Mbretnisë së Shqipnjes” (1928). Në këtë statut në kapitullin e III, në pjesën e pushtetit gjyqësor për gjyqet, parashikohet pavarësia e gjyqtarit (Art.118, 119, 120); e drejta e mbrojtjes, si dhe e mbrojtësit të caktuar kryesisht (Art.122, 128); gjykimi publik dhe shpallja e vendimit (Art.123, 124), detyrimi për dhënien e vendimit të arsyetuar (Art.125).<sup>22</sup>

Kodi Penal Shqiptar, i cili hyri në fuqi, më 01.6.1928, u hartua sipas modelit të kodit italian, dhe përmbante parime dhe institute demokratike, si: parimin e ligjshmërisë: “Nullum crimen, nulla poena sine lege”, parimin e fajësisë, të përgjegjësisë personale, të individualizimit të dënimit, sanksionet penale të tjera, ndarjen e veprave penale në delikte dhe kontravencione etj. Këto parime sanksionohen në nenin 1 dhe 2 te Kodit Penal të vitit 1928.

Neni 1: Askush nuk mund të ndëshkohet për një vepër që ligja nuk e ka paraparë ekspresisht si faj; gjith’ashtu nuk mund të dënohet me ndeshkime që nuk janë të caktueme në ligjë..”.

Neni 2: Askush nuk mund të ndëshkohet për nje vepër e cila nuk formonte faj mbas ligjës së kohës kur është bamun. Askush nuk mund të ndeshkohet për nje vepër, të cilën ligja e pasvumun nuk e ndeshkon; dhe, në qoftë se ka qënë i ndëshkuem, përmbarimi dhe efektet ligjore penale t’atij ndëshkimi mbeten të pa fuqishme. Në qoftë se midis ligjës së kohësë kur asht bamun faji dhe ligjavet të pas-vumuna ka ndryshim, aplikohet ajo ligjë, dispozitat e së ciles janë ma favorabël për të pandehunin.”<sup>23</sup>

Statuti Themeltar i Mbretërisë, u miratua nga Asamblea e dytë Konstituante më 01.12.1928, në të cilin u parashikua ndarja e pavarësia e pushteteve. Në kapitullin e III të tij, parashikoheshin parimet proceduriale, si ai i pavarësisë së gjykatës, bindjes së brendshme, gjykimit publik, mbrojtjes me avokat etj.. “Gjyqtarët në të dhanunin e

<sup>20</sup> Anastasi,A. ( 1998) *Institucionet Politike dhe E drejta Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë : Luarasi, fq.44

<sup>21</sup> Elezi,I. (2009) *Vështrim i shkurtër historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, Revistë Shkencore «Justiniani I», Tiranë: Albin, fq. 10

<sup>22</sup>Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare, fq 15-16

<sup>23</sup> Kodi Penal i vitit 1928, neni 1,2. Libri i Parë, Tiranë; Botim i Këshillit të Shtetit

vendimeve janë të pamvarun dhe udhëhiqen vetëm prej ligjës e ndërgjegjes tyne.. ”<sup>24</sup>. U njoh dhe parashikua, e drejta e mbrojtjes së detyrueshme me avokat, për krimet (deliktet) që parashikonin dënim me burgim mbi tre vjet, edhe nëse këtë nuk e kërkonte i pandehuri.

“Gjykimi i të pandehunit përpara gjykatave, mbi një delikt që sjell një ndëshkim kundra lirisë personale, maksimumi i të cilit kalon tre vjet, nuk mund të bahet veç se me asistencën e një avokati mbrojtës, t’emnuem prej të pandehunit vetë. Në rast se i pandehuni nuk emnon avokat mbrojtës, këtë e emnon gjykata simbas ligjës”<sup>25</sup>.

Po në këtë artikull,(dispozitë), parashikohej se kur pandehuri akuzohej për kryerjen e një krimi, që sipas ligjit material parashikonte dënim me burgim mbi tre vjet, pyetja e të pandehurit në çdo fazë, bëhej detyrimsht me prezencën dhe asistencën e avokatit të pandehurit. “Pyetja e të pandehunit në rastet kësodore në gjykata, hetuesi, mund të bahet me asistencën e avokatit mbrojtës t’emnuem prej të pandehunit”<sup>26</sup>

Merita të veçanta i përkasin ish-ministrit të Drejtësisë, Av. Stavri Vinjau, i cili me veprën e tij “E drejta konstitucionale” dhe programin e tij të qartë, për të realizuar reformat në drejtësi, në ligjet për drejtësinë penale, për të anuluar ligjet penale të së kaluarës dhe për t’i zëvendësuar ato me ligje të reja, dha një kontribut të çmuar në drejtësinë shqiptare. Gjithashtu rol të rëndësishëm, kanë luajtur edhe artikujt e Av. Agjah Libohovës “Për reformën ligjore” dhe “Për reformën në gjyqe”, i cili theksonte se ligjet në fuqi ishin të vjetruara dhe nuk u përshtateshin kushteve të reja sipas ligjeve perëndimore.<sup>27</sup>

Më 1 prill 1929, hyri në fuqi ligji “Për organizimin e Drejtësisë”, i cili në titullin II, për organizimin e gjykatave, përcaktonte sistemin gjyqësor që përbëhej nga: gjykata e paqit, gjykata e shkallës së parë, fillore e kolegjiale, dhe gjykata e Diktimit, civile e penale (neni 15); prokurori i shtetit dhe gjyqtarët hetues (neni 44 , 47).<sup>28</sup>

---

<sup>24</sup>Art 118 i Statusit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare

<sup>25</sup> Në Art 128 i Statusit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare parashikohej detyrimsht që për krimet, deliktet, mbrojtja e të pandehurit të bëhej me avokat

<sup>26</sup> Artikulli 128 paragrafi dytë i Statutit

<sup>27</sup>Elezi,I. (2009) *Vështrim i shkurtër historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, Revistë Shkencore «Justiniani I», Tiranë: Albin, fq. 10

<sup>28</sup>Ligji Nr.7, Fruer 1929 “*Mbi Organizimin e Drejtësisë*”, Tiranë: Ministria e Drejtësisë, (Mbretëria Shqiptare) , Përmban Dekretin e mbretit Ahmet Zogu për aprovimin dhe zbatimin e ligjit, Shtypshkroja Nikaj, fq.47-56

## 2.2 – Zhvillimet ligjore në kuadrin procedural penal për periudhën 1945-1990

### 2.2.1- Risitë ligjore pas vitit 1945 lidhur me të drejtat e te pandehurit në procesin penal

Gjatë luftës së dytë botërore, në drejtim të procedurës penale nuk pati kontribut të ri. Pas mbarimit të saj në kuadrin e formimit të një shteti të ri, u miratua Kushtetuta e vitit 1946, në të cilën elementët e një procesi gjyqësor i gjen të parashikuara në nenet:

Neni 22: "Dënimet nuk mund të caktohen dhe të jepen veçse në bazë të ligjës. Asnjëri nuk mund të dënohet pa u dëgjuar dhe pa u thirrur që të mbrohet sipas përshkrimeve të ligjës, përveç se kur vërtetohet ligjërisht mungesa e tij. Organet e administratës së shtetit, brenda kufijve të caktuara prej ligjës, mund të japin dënime dhe me burgosje për fajë të vogla të së drejtës komune. Asnjë shtetas nuk mund të nxirret jashtë shtetit ose të internohet brenda shtetit, veçse në raste të parashikuara me ligj. Republika Popullore e Shqipërisë mbron shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë shtetit".

Neni 82: "Gjykatat rregullisht gjykojnë në seancë publike. Të pandehurit i sigurohet e drejta e mbrojtjes."

Neni 84: "... Shtetasit që nuk dijnë shqip mund të përdorin gjuhën e tyre dhe të flasin me anë të një përkthenjësi".<sup>29</sup>

### 2.2.2 - Kodi i Procedurës Penale Shqiptare i vitit 1953

Kodi i Procedurës Penale i aprovuar më 30 mars të vitit 1953 dhe hyrë në fuqi më 1 qershor të po këtij viti, përbën një nga përpjekjet e shtetit shqiptar për të rregulluar legjislacionin e procedurës penale, që deri në atë kohë ishin rregulluar me akte ligjore të ndryshme. Në këtë kod gjejmë elementë të procesit të rregullt ligjor, të cilat i shohim në sanksionimin e disa parimeve themelore bazë të procedimit penal, siç janë: parimi i realizimit të drejtësisë penale (neni 1), parimi i ligjshmërisë (neni 2), parimi i mosdënimit dy herë për të njëtën vepër penale (neni 5), parimi i barazisë së palëve në procesin penal (neni 9), parimi i ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori (neni 10), parimi i së drejtës së mbrojtjes (neni 12), parimi i prezumimit të pafajësisë (neni 13), parimi i të drejtës së heshtjes (neni 69), etj. Më konkretisht, parimet më sipër, referohen në këto dispozita :

Neni 5: "Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëtin krim, për të cilin është gjykuar me vendim të formës së prerë, përveç kur vendimi priset me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ose kur vendoset rishikimi i çështjes për rrethana të zbuluara rishtas."

Neni 98: "Ndjekja penale nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjëndje të hetimit ose të gjykimit: ...9)kur me vendim të formës së prerë po ai i pandehur është gjykuar për të njëtin krim."

Neni 9: "... Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre dhe me anë të një përkthyesi kanë të drejtë të flasin dhe të marrin dënimin për provat dhe për zhvillimin e gjykimit."

Neni 12: "Në pajtim me Kushtetutën, të pandehurit i sigurohet e drejta e mbrojtjes. Mbrojtësi detyrohet të ndihmojë në realizimin e drejtësisë, duke sqaruar rrethanat që çfajsojnë të

<sup>29</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946

pandehurin ose lehtësojnë përgjegjësinë e tij. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i sigurohen të drejtat e tij procedurale dhe t'i ruhen interesat ligjore.”

Neni 55: “Si mbrojtës në çështje mund të marrin pjesë avokatët, bashkëshorti, gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, përfaqësuesit e autorizuar të institucioneve, ndërmarrjeve dhe organizatave”

Neni 13: “ I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk provohet fajësia e tij.”

Neni 69: “...I pandehuri nuk mund të detyrohet të flasë.”<sup>30</sup>

Në K.Pr.Penale të vitit 1953, janë konsideruar garanci procedurale të të pandehurit në të quajturin “zhvillimit demokratik të gjykimit”, prania e detyrueshme e të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes, marrja dijeni për aktakuzën, të drejta e të pandehurit në veprimet procedurale, të drejtën për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, prokurorit, ekspertëve.

Pa diskutuar këndvështrimin e analizës që bëhej nga ndikimi politik, elementët e një procesi të drejtë ligjor dhe garancitë procedurale të të pandehurit, për periudhën 1946-1990, në kohën që ka qenë në fuqi ky Kod, kanë qenë më e përqasur me atë çfarë ishte parashikuar në Kushtetutë dhe parimeve të një procesi të drejtë ligjor.

Këto parime udhëhoqën drejtësinë dhe vendimet gjyqësore të kohës. Lidhur me parimin e mbrojtjes, në një vendim të Gjykatës së Lartë të vitit 1979, citohet se :

“Dhënia e ndihmës juridike është e detyrueshme kur i pandehuri në kohën e kryerjes së krimit nuk ka mbushur moshën 16 vjeç. Gjykata duke mos caktuar një mbrojtës, ka shkelur rëndë kërkesën e pikës 1 të nenit 58 të K.P.Penale. dhe paragrafin e fundit të nenit 1 të dekretit Nr.4277, datë 20.06.1967 “Mbi krijimin e zyrave të ndihmës juridike” ku sipas këtyre dispozitave dhënia e ndihmës juridike në gjyq është e detyrueshme edhe për të miturit që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç.”<sup>31</sup>

Në një vendim të Gjykatës së Lartë, të vitit 1974, citohet se :

“ Kjo ndihmë juridike gjatë gjykimit është e detyrueshme për çështjet penale me persona të cilët për shkak të metash fizike ose psikike nuk janë në gjendje të kuptojnë ngjarjet. “ Neni 1 i dekretit Nr.4277, date 20.06.1967 “Mbi krijimin e zyrave të ndihmës juridike” parashikon të detyrueshme dhënien e ndihmës juridike për personat të cilët, për shkak të metash fizike ose psikike nuk janë në gjendje të kuptojnë ngjarjet .... I gjykuari në rastin konkret, ashtu sikundër ka rezultuar edhe nga akti i komisionit të ekspertëve psikiatër është i papërgjegjshëm, pasi është i sëmurë psikik ... Në rrethanë të mësipërme gjykata ka qenë e detyruar që t'i siguronte të gjykuesit mbrojtjen e parashikuar shprehimisht në ligj.”<sup>32</sup>

Referuar të drejtës së të pandehurit për tu njohur me akuzën, në vendimin e Gjykatës së Lartë, të vitit 1979, citohet se :

<sup>30</sup>Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953, ndryshuar me ligjin Nr. 1776, datë 03.12.1953 dhe me ligjin Nr. 2805, datë 04.12.1958, dhe ka qenë në fuqi deri në datë 01.04.1980 me hyrjen në fuqi të Kodit Procedurës Penale, miratuar me ligjin Nr 6069 datë 25.12.1979

<sup>31</sup> Vendim dt. 14.03.1979 i Gjykatës së Lartë, Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë, përmbledhje e viteve 1967, 1968, 1969 dhe 1970, fq. 155

<sup>32</sup> Vendim dt. 18.01.1974 i Gjykatës së Lartë, Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë, përmbledhje e viteve 1974, 1975, 1976 dhe 1977, fq. 215

“Nga materialet e çështjes nuk del që të gjykuarit t’i jetë komunikuar aktakuza...Kërkesat nenit 213 të KPP nuk janë diçka formale .Këto kërkesa kanë të bëjnë me një parim të rëndësishëm kushtetues e procedural, atë të mbrojtjes të të pandehurit.”<sup>33</sup>

Lidhur me caktimin e një përkthyesi për personat që nuk dine shqip, është një detyrë e gjykatës që buron nga e drejta e mbrojtjes së të pandehurit. Përsëri në një vendim të Gjykatës së Lartë, të vitit 1970, citohet se :

“Nga materialet e çështjes nuk rezulton që i gjykuari të jetë pyetur dëshiron nëse dëshiron ose jo përkthyes. Ky veprim i gjykatës vjen në kundërshtim me ligjin. Në bazë të neneve 9 e 73 të K.P.Penale, personat që nuk dinë gjuhë shqipe kanë të drejtë që të përdorin në gjyq gjuhën e tyre. Kjo garanci procedurale buron nga e drejta e mbrojtjes të të pandehurit.Caktimi ose jo i përkthyesit në gjykimin e çështjes nuk është e drejtë e gjykatës, por një detyrë e saj.”<sup>34</sup>

### **2.2.3 - Kodi i Procedurës Penale të vitit 1979**

Kodi i Procedurës Penale aprovuar me Ligjin Nr. 6069, datë 25.12.1979, hyrë në fuqi më datë 01.04.1980, cilësohet si akti më regresiv i legjislacionit procedural penal që ka ekzistuar në Shqipëri. Ndryshimet erdhën gradualisht, duke filluar që në vitet 1960 me ndryshimin e strukturës së organeve gjyqësore,<sup>35</sup> me heqjen e institutit të avokatisë duke e konsideruar “të dëmshme”, dhe që u parapri nga suprimimi i Ministrisë së Drejtësisë në vitin 1966. Më pas në vitin 1974, u shkëput Hetuesia nga Prokuroria,<sup>36</sup> duke i dhënë organeve të hetuesisë kompetenca më të gjëra<sup>37</sup> dhe duke i lënë prokurorit funksionin e kontrollit të zbatimit të ligjeve dhe “kontrollit mbi vetë gjykatën”. Të gjitha këto ndryshime deri në vitin 1979, krijuan premiset për daljen e K.Pr. Penale të vitit 1979 dhe pakësimin e garancive procedurale për të pandehurin, në minimum.

Fryma johumane dhe regresive e këtij Kodi, vihet re që në dispozitat e para të tij. Në to nuk gjejmë pasqyrim parimet themelore të procedimit penal, të cilatdo të përbënin bazën e një procedimi penal të drejtë e të rregullt ligjor, si: parimi i barazisë së palëve, i oralitetit, i prezumimit të pafajësisë etj. Këto parime u shfuqizuan, me arsyetimin se janë parime që dihen prej të gjithëve, dhe se e ngarkojnë legjislacionin procedural penal me formalizma. Ndërsa parimi i prezumimit të pafajësisë u konsiderua si një dogmë e vjetëruar, që nuk i

<sup>33</sup> Vendim dt. 02.08.1977 i Gjykatës së Lartë, Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë, përmbledhje e viteve 1974, 1975, 1976 dhe 1977, fq. 213

<sup>34</sup>Vendim dt. 22.09.1970 i Gjykatës së Lartë, Drejtësia Popullore Nr.6 e vitit 1970, fq. 62

<sup>35</sup> Ligji Nr. 4406, dt. 24.6.1968 “ *Për organizmin gjyqësor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatit e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986, fq. 1485

<sup>36</sup> Ligji Nr. 6298, dt. 27.3.1981 “ *Për Prokurorinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatit e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986, fq. 1500

<sup>37</sup> Ligji Nr. 6800, dt. 29.6.1983 “ *Për hetuesinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatit e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986, fq. 1508

përgjigjej realitetit objektiv, me karakter formal dhe deklarativ, i pakuptueshëm nga masat, dhe që në thelb çorienton organet e hetimit, prokurorisë dhe gjykatës në luftën kundër kriminalitetit. Heqja e këtij parimi, ndryshoi jo vetëm pozicionin procedural të të pandehurit, duke e ngarkuar atë me barrën e të provuarit të pafajësisë, por rëndoi dhe pozitën e tij, pasi organet e hetimit për marrjen e personit si të pandehur, nuk niseshin më nga parimi i prezumimit të pafajësisë, por me të dhënat e grumbulluara krijonin bindjen e plotë të fajësisë së tij, ashtu si dhe gjykata në dhënien e vendimit përfundimtar. Një garanci më pak për të pandehurin, përbënte dhe politizimi i legjislacionit procedural penal, duke cënuar dhe atë pavarësi minimale, që parashikonte ky kod për gjykatën në gjykimin e çështjes (neni 3,4).

Sipas këtij kodi, dhe konkretisht neni 7 i tij, ndjekja penale ushtrohej nga organet e hetuesisë dhe jo më nga prokurori, i cili përcaktohejtashmë si organ i kontrollit të zbatimit të ligjit nga gjykatat.<sup>38</sup> Hetuesia paraqitet si organ me varësi hierarkike të brendshme, dhe e pavarur nga prokurori. Këto ndryshime sollën rënien e nivelit profesional, dhe shtimin e shkeljeve të ligjit procedural gjatë hetimeve paraprake, duke u shkelur drejtpërdrejt të drejtat e të pandehurit.

Me ndryshimete mëvonshme në K.Pr.Penale të vitit 1980, ndihma juridike ishte e përcaktuar vetëm për të miturit dhe personat me të meta fizike, fakt i sanksionuar në nenin 10, pika 1 dhe paragrafi i fundit i tij, i cili citon : “gjykimi i të gjykuarit kur ai është nën moshën 18 vjeç bëhet detyrimisht me pjesëmarrjen e këshilltarit ligjor në pozitën e mbrojtësit.”<sup>39</sup>

Në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1979 (që hyri në fuqi në vitin 1980), nuk u parashikuan parimet kryesore të një procesi të rregullt ligjor si, prezumimi i pafajësisë, barazia e palëve në gjykim, etj. Ky Kod shpalli varësinë e gjykatës nga politika, i hoqi prokurorit funksionin e ndjekjes penale, mohoi mbrojtjen me avokat dhe rikonfirmoi të drejtën e prokurorit, për marrjen e masave të sigurimit e kontrollimeve, duke mos i njohur gjykatës, të drejtën e kontrollit dhe miratimit për veprimet procedurale më të rëndësishme të fazës së hetimit paraprak.<sup>40</sup>

---

<sup>38</sup> Kodi Procedurës Penale të RPSSH, neni 7, fq.6

<sup>39</sup> Vendim dt. 23.08.1980 i Gjykatës së Lartë, Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë, përmbledhje e viteve 1978, 1979, 1980, fq. 299

<sup>40</sup> Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I ( 2012 ) Procedura Penale, Tiranë : Morava, fq 14

Ndër të vetmet dispozita të këtij Kodi, ku parashikohen disa parime bazë të procesit të rregullt ligjor, mund të përmendim vetëm nenet 5,8 e 9 të tij.

Neni 5: "...Gjykata në gjykimin e çështjes penale është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit."

Neni 8: "...I pandehuri gëzon të drejtën e mbrojtjes gjatë gjithë procesit penal..."

Neni 9: "...Mbrojtës mund të jetë: këshilltari ligjor, bashkëshorti i të pandehurit, gjinia dhe krushqia e afërt e tij. Me vendim të gjykatës mbrojtjen e të pandehurit mund ta bëjnë edhe persona të tjerë."<sup>41</sup>

Me daljen e Kushtetutës së vitit 1976, u stabilizua ajo ç'ka ishte sanksionuar me ligjet e para saj, parimet e quajtuara "revolucionare", që gjetën shprehje në legjislacionin penal dhe sidomos atë procedural. Kjo Kushtetutë sanksionon se :

Neni 56: "Shteti garanton paprekshmërinë e personit. Asnjëri nuk mund të arrestohet pa vendim të gjykatës ose pa miratim të prokurorit. Në raste të veçanta, të parashikuara me ligj, organet kompetente mund të ndalojnë një person jo me shumë se tri ditë. Asnjëri nuk mund të dënohet penalisht pa vendim të gjykatës dhe për një vepër që nuk parashikohet nga ligji si krim. Asnjëri nuk mund të dënohet pa qenë i pranishëm në gjyq, përveçse kur vërtetohet ligjërisht mungesa e tij. Asnjëri nuk mund të internohet ose të dëbohet vecse në raste të veçanta të parashikuara me ligj." Neni 102: "Gjykatat gjykojnë çështjet penale e civile, si edhe çështje të tjera që me ligj janë lënë në kompetencën e tyre. Gjykimi bëhet me pjesëmarrjen e ndihmës gjyqtareve dhe me dyer të hapura, me përjashtim të rasteve kur me ligj është caktuar ndryshe. Gjatë gjykimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip, mund të përdorin gjuhën e tyre dhe të flasin me ndihmën e një përkthyesi. I pandehuri gëzon të drejtën e mbrojtjes."<sup>42</sup>

Në K.Pr.Penale të vitit 1979, konstatohet se dispozita lidhur me vendimin marrjes së personit si të pandehur, konkretisht formulimi i nenit 75, është i ndryshëm nga ai i parashikuar nga K.Pr.Penaletë vitit 1953. Nuk bëhet më fjalë për të dhëna të mjaftueshme, por për prova të mjaftueshme, duke e marrë të mirëqënë akuzën në lidhje me fajësinë e të pandehurit. Pra kërkohet që të dhënat në ngarkim të të pandehurit të kenë trajtën e konkretizuar të provave sipas ligjit.

Vendimi për marrjen e personit si të pandehur, merret nga gjyqtari i vetëm, hetuesi dhe sipas nenit 76, duhet ti komunikohet të pandehurit brenda 24 orëve ( jo 48 orëve siç parashikohet në K.Pr.P të 1953), për të siguruar të drejtën e tij të mbrojtjes. Por se si mund të realizohet kjo e drejtë, kur ky kod e kishte kufizuar në maksimumin të drejtën e mbrojtjes, rezulton qartë nga përmbajtja e nenit 9 të K.Pr.Penale, sipas të cilit: "Mbrojtës mund të jenë: këshilltari ligjor, bashkëshorti i të pandehurit, gjinia dhe krushqia e afërt e tij"<sup>43</sup>. Në këtë mënyrë parashikohet formalisht e drejta e mbrojtjes, kur është e qartë se ndihma juridike nuk mund të jepet nga personat e mesipërm, por vetëm nga mbrojtës të

<sup>41</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, neni 5,8,9 fq. 5-7

<sup>42</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976

<sup>43</sup> Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1979, neni 9



kualifikuar në fushën juridike, të cilët nuk përmenden në nenin 9. Bëhet përjashtim vetëm për këshilltarët ligjor, të cilët marrin pjesë si mbrojtës të të pandehurit, vetëm në rastet e parashikuara nga neni 10 i K.Pr.Penale. Në të gjitha raset e tjera, të pandehurit, si në fazën e hetimeve ashtu dhe në atë të gjykimit, nuk i sigurohej garancia minimale e mbrojtjes së të drejtave të tij nga një avokat.

Në këtë kod, nuk parashikohet as mënyra e njoftimit të akuzës të pandehurit, duke u suprimuar dispozitat që e parashikonin atë sipas K.Pr.Penale të vitit 1953. Gjithashtu lidhur me pyetjen e të pandehurit, neni 22, parashikonte se: “të pandehurit para pyetjes i njoftohet akuzat” si dhe përcakton mënyrën e pyetjes së të miturve nën 16 vjeç dhe detyrimisht në prani të një personi tjetër apo arsimtari.<sup>44</sup>Kjo ishte një garanci për të siguruar të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit të mitur.

Nga ana tjetër, të pandehurit i njiheje drejta të kërkojë përjashtimin e hetuesit, ç’ka parashikohej në nenin 74 të K.Pr.Penale, të ekspertit, ç’ka parashikohej në nenin 82 të tij, të njihej me materialet e çështjes në përfundim të hetimeve, neni 102 i Kodit, të ankohej kundër veprimeve të hetuesit, neni 107 i K.Pr.Penale, etj. Në fazën e hetimeve, ankimet i paraqiteshin përgjegjësit të sektorit të hetuesisë, dhe në organin më të lartë të hetuesisë.

Me dërgimin e çështjes në gjyq, të pandehurit i lindte drejta për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve që gjykojnë çështjen, e drejtë e parashikuar nga neni 110 i K.Pr.Penale.

Ky kod kërkonte si për hetuesin edhe për gjyqtarin, një plan për shqyrtimin e gjithanshëm të çështjes, ç’ka sanksionohej në nenin 62 dhe 125 të K.Pr.Penale, me qëllim shmangien nga gjykimi i përciptë i çështjes, që do të cënonte të drejtat e të pandehurit.

Në seancë gjyqësore, gjykata ishte e detyruar të siguronte njohjen e të pandehurit me aktakuzën si dhe t’i bëjë të ditur atij të drejtat në këtë fazë të gjykimit. Ajo ishte e detyruar gjithashtu, të marrë në shqyrtim kërkesat paraprake të tij në lidhje me marrjen e provave, referuar nenit 141 të K.Pr.Penale. Sipas nenit 136 të Kodit, gjykata duhej t’i shqyrtonte drejtpërdrejt në seancë në prani të të pandehurit këto prova, duke i dhënë të drejtën atij të japë shpjegime e të bëjë pyetje mbi çdo provë.<sup>45</sup> Në ndryshim nga neni 73 i K.Pr.Penale të vitit 1953, shqyrtimi i çështjes bëhet vetëm për akuzat për të cilat personi është marrë si i pandehur, ndërsa sipas nenit 153/2: “Gjykata vendos kthimin e çështjes hetuesisë për

---

<sup>44</sup> Kodi Procedurës Penale, i vitit 1979, neni 22, fq.12

<sup>45</sup>Kodi Procedurës Penale, neni 136, fq.68

plotësim hetimesh, kur gjatë hetimit janë shkelur rregullat procedurale që garantojnë të drejtat e të pandehurit.”<sup>46</sup>

Me përfundimin e gjykimit në shkallë të parë dhe dhënien e vendimit përfundimtar, të pandehurit i njihet gjithashtu e drejta e ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në Këshillin Gjyqësor të Gjykatës së Rrethit dhe në Gjykatën e Lartë, e drejtë e sanksionuar në nenin 162 të Kodit. Një risi e këtij Kodi, në ndryshim nga K.Pr.Penale të vitit 1953, ishte se në nenin 174 të tij kodi, parashikohej shprehimisht me titull të veçantë moskeqësimi i pozitës së të pandehurit: “Nuk lejohet ndryshimi i cilësimit të veprës penale me një nen që parashikon dënim më të rëndë, si dhe dhënia e një lloji ose mase dënimi më të rëndë”.<sup>47</sup>

Sa më sipër, ky nen i referohet rasteve të ankimit nga i pandehuri, ndërsa në paragrafin e dytë të tij parashikohet se, pozita e tij mund të rëndohet nga gjykata e shkallës së parë, në rast proteste nga prokurori apo ankim nga i dëmtuari akuzues.

Këto të drejta i janë njohur të pandehurit shprehimisht nga K.Pr.Penale i vitit 1979, megjithatë, është e kuptueshme se mundësitë e realizimit të tyre në praktikë ishin të papërfillshme, sepse në një proces penal ku ndjekja penale ushtrohet dhe nga vetë gjykata, kur gjykimi zhvillohet pa pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit si palë akuzuese, pa pjesëmarrjen e mbrojtësit të kualifikuar, duke i ngarkuar të pandehurit barrën për të provuar pafajsinë e tij, të gjitha këto e mbajnë procesin penal larg të qenit i barabartë, i drejtë, i rregullt e ligjor.

Kodit të Procedurës Penale të vitit 1979, i janë bërë ndryshime të pjesshme në vitet më vonë, sidomos me Ligjin Nr. 7386, datë 08.05.1990 dhe Ligjin Nr. 7541, datë 18.12.1991 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, ligje që parashikuan mbrojtjen me avokat, dhe shfuqizuan dispozitat e politizuara në Kodin ekzistues. Me dispozitat e reja, u shtuan elementë të rinj të procesit të rregullt ligjor, si prezumimi i pafajsisë. Duke vazhduar më pas, me Ligjin Nr.7717, datë 02.06.1993, që zbërtheu më tej dhe konkretizoi dispozitat e mëposhtme kushtetuese, të parashikuara në Ligjin Nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në Ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese". Këto ndryshime kanë sjellë ndryshime në dispozitat më poshtë :

---

<sup>46</sup> Kodi Procedurës Penale, neni 153/2, fq.76

<sup>47</sup> Kodi Procedurës Penale, neni 174, fq.86

Neni 6: “Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet si e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se sa ai që ka qenë i parashikuar në ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.”

Neni 7: “ Askush nuk mund të quhet fajtor përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Neni 8: “Gjatë procesit penal, askujt nuk mund t'i hiqet e drejta:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që bëhet;
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

d) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas me anë avokati kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

dh) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe personave të tjerë të cilët mund të sqarojnë faktet”.

Neni 9: “ Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pohojë fajësinë e tij.”

Neni 10: “ Pavlefshmëria e të dhënave të paligjshme. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.”

Neni 11: “Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u dëgjuar para se të dënohet.”

Neni 12: “Askush nuk mund të gjykohet ose të dënohet më shumë se njëherë për të njëjtën veprë penale, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë.”

Neni 13: “Kushdo ka të drejtë të apelojë një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë të krijuar me ligj.”<sup>48</sup>

#### **2.2.4 -Kodi i Procedurës Penale të vitit 1995**

Një ndryshim i rëndësishëm i legjislacionit shqiptar në vitet 1990, u pasqyrua dhe në legjislacionin procedural penal. Ky ndryshim erdhi si rezultat i ngjarjeve politike – sociale e juridike, me të cilat u përball shteti shqiptar këtë periudhë. Pikërisht këto ngjarje, i dhanë fund një sistemi tërësisht të dështuar dhe shërbyen si pikënisje e përpjekjeve për ta shndërruar Shqipërinë, në një shtet të vërtetë European. Kërkesë primare në përpjekjet e mësipërme, u shtrua ndryshimi i legjislacionit, me qëllim zëvendësimin e parimeve, koncepteve e praktikave antidemokratike, me idetë dhe frymën e një legjislacioni bashkëkohor. Legjislacioni procedural penal, si pjesë e pandarë e tij, u përfshi në këto ndryshime, si dhe u përshtat jo vetëm me ndryshimet historike të vendit tonë, duke u zhveshur nga politizimet e së kaluarës, por edhe me konventat e marrëveshjet ndërkombëtare, duke u bërë këto të fundit pjesë e këtij legjislacioni. Në këto rrethana, u miratua K.Pr.Penale me Ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, i cili hyri në fuqi më 1 Gusht

---

<sup>48</sup>Ligji Nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.5, Prill 1993

1995.<sup>49</sup> Ky kod përbën një aspekt të rëndësishëm të reformës legislative në fushën e drejtësisë. Në themel të kodit të ri, qëndrojnë parimet dhe normat themelore të procedimit penal, të pranuar botërisht nga konventat ndërkombëtare dhe nga legjislacioni procedural i shteteve demokratike. Për t'iu përshtatur sa më mirë një legjislacioni bashkëkohor e demokratik, K.Pr.Penale ka qënë vazhdimisht objekt i ndryshimeve deri në vitin 2002. Dispozitat Kushtetuese dhe ndryshimet e bëra në kodin e mëparshëm, shërbyen si bazë për hartimin e kodit të ri të procedurës penale dhe orientimit të procedimit penal drejt sistemit akuzator.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme që solli ky kod, përmendim:

**Së pari** : legjislacioni procedural penal shqiptar, para viteve 1990, përfaqësonte “variantin më regresiv të sistemit inkuizitor,” i cili parimet kryesore të procesit penal si: parimin e të drejtës së mbrojtjes, të prezumimit të pafajësisë, të barazisë së palëve i suprimoi, ndërsa të drejtat e të pandehurit kufizoheshin në maksimum, duke i mohuar atij dhe të drejtën kryesore,atë të mbrojtjes me avokat. Këto parime i sanksionoi K.Pr.Penale i vitit 1995, të cilat përshkojnë të gjithë legjislacionin procedural penal dhe qëndrojnë në themel të tij.

**Së dyti**, pozicioni dhe roli i subjekteve të procedimit penal, ndryshoi tërësisht thuhet nga sistemi i mëparshëm, i cili e përfshinte gjykatën në palën akuzuese, duke i atribuar në disa raste dhe të drejtën e ushtrimit të ndjekjes penale, ndërsa në gjykim vetë prokurori nuk konsiderohej palë, dhe i njihej e drejta për të ushtruar kontroll mbi Gjykatën. Ndërsa sot, kodi i ri ka përcaktuar qartësisht rolin, pozicionin dhe funksionin e secilit prej subjekteve të procedimit penal, duke ndaluar shprehimisht përzierjen e këtyre funksioneve. Të gjitha këto ndryshime, sollën nevojën e braktisjes së sistemit inkuizitor, dhe orientimin drejt atij akuzator. Hapat e parë që ndihmuan drejt këtij kalimi ishin:

Miratimi i Ligjit “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, Nr.7541,dt.18/12/1991, i cili përcaktoi të drejtat dhe detyrat e avokatit, duke garantuar realisht të drejtën e mbrojtjes me avokat.<sup>50</sup>

Miratimi i Ligjit Nr.7574, dt.24/06/1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile.”<sup>51</sup>Ky ligj solli ndryshimin e sistemit gjyqësor dhe

---

<sup>49</sup>Ligji Nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 5, Prill 1995, f.159; 186 nene.

<sup>50</sup> Ligji Nr.7541, datë 18.12.1991”Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Gazetën Zyrtare Nr.10, Dhjetor 1991, f.452; 27 nene

krijimin e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatave të Apelit, përcaktoi mënyrën e funksionimit të këtyre gjykatave në përputhje me standartet ndërkombëtare. Prokuroria u njoh si organ i ndjekjes penale, i'u njoh e drejta për të drejtuar e kontrolluar hetimet.

“Dispozitat Kushtetuese për organizimin e drejtësisë”, të miratuara me Ligjin Nr.7561.dt.29/04/1992.<sup>52</sup>

Dispozitat Kushtetuese për “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” të miratuara me ligjin Nr.7692, dt.31/03/1993. Zbatimi i këtij ligji solli ndryshime rrënjësore në K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e kryerjes së veprimeve procedurale që prekin këto liri e të drejta si: kufizimi i lirisë, kontrollet e sekuestrimet. U përcaktuan në mënyrë të plotë, të drejtat e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. U njoh kontrolli i gjykatës në caktimin e masave të sigurimit, në kryerjen e kontrolleve e sekuestrimeve, si dhe u caktua afati i paraqitjes së të ndaluarit para një gjyqtari dhe e drejta e të arrestuarit për t’u ankuar në gjykatë.

Të gjitha këto ndryshime në legjislacionin procedural penal, vunë në themel të kodit të ri të procedurës penale sistemin akuzator, por duke ruajtur edhe disa elementë të sistemit inkuizitor, lidhur me të drejtat e palëve dhe funksionet e Gjykatës. Ky sistem shpall e garanton realisht, parimin e barazisë së palëve në proces, të prezumimit të pafajësisë, të kontradiktorialitetit, parime këto, që qëndrojnë në themel dhe paraprijnë Kodin e ri të Procedurës Penale. Ky sistem i njeh dhe i garanton të pandehurit të drejta reale për t’u mbrojtur nga akuza. Referuar dispozitave të K.Pr.Penale, që në fazën e hetimeve paraprake, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, marrin pjesë aktivisht në grumbullimin e fakteve dhe njihen me materialet e organit që proçedon. Prova formohet në seancë gjyqësore, administrohet në debatin gjyqësor ku roli i palëve është vendimtar. Roli i gjykatës konsiston në atë të një arbitri, me funksionin kryesor të dhënies së drejtësisë, por është pranuar dhe iniciativa e saj në gjykim, duke marrë prova kryesisht në raste të domosdoshme. Kodi i ri i Procedurës Penale, duke zgjedhur këtë sistem, garanton të drejtat e individit në procesin penal dhe siguron në mënyrë të përsosur një procedim penal të drejtë, të barabartë, e të rregullt ligjor. Në Kodin e ri të Procedurës Penale të vitit 1995, gjejnë vend parimet kryesore Kushtetuese të parashikuara qartë në pjesën e përgjithshme të tij.

---

<sup>51</sup> Ligji Nr.7574, datë 24.6.1992 ”Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.3, Korrik 1992, f.147; 24 nene.

<sup>52</sup> Ligji Nr.7561,dt.29/04/1992“Dispozitat Kushtetuese për organizimin e drejtësisë”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.5, Prill 1993

Këto dispozita, janë një përafrim dhe përfaqje nga të gjitha aktet e mëparshme, drejt elementëve të procesit të drejtë ligjor në Shqipëri, deri në momentin e aprovimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 1998, në të cilën u sanksionuan të drejtat e palëve në një proces të rregullt gjyqësor, në të gjithë elementët e tyre.

Në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1995, në nenin 3 të tij, sanksionohet se : “Gjykata është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit. Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore”.

Në nenin 4, sanksionohet se : “ I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”.

Në nenin 6 sanksionohet se : “I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore”.

Ndërsa në nenin 7 sanksionohet se : “ Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtën vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente”.

Në nenin 8, sanksionohet se : “Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit”.<sup>53</sup>

Nga ana tjetër, në Kushtetutë sanksionohet se :

Neni 29: ”Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.”

Neni 30: “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.”

Neni 31: “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

- a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

---

<sup>53</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.”

Neni 32:“ Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.”

Neni 33:”Kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 34: Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohej sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Neni 42:“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 43:“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.”<sup>54</sup>

Më tej, në Kushtetutë sanksionohet se :

Neni 3 : “Gjykata është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit. Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore”.

Neni 4 : “ I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”.

Neni 6 : “I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore”.

Neni 7 : “ Askush nuk mund të gjykohej rishtas për të njëjtën vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente”.

Neni 8 : “Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit”.<sup>55</sup>

Në Kodin aktual të Procedurës Penale, gjejnë shprehje të gjitha parimet kryesore që përbëjnë elementët e një procesi të drejtë ligjor, si në aspektin ndërkombëtar, duke i'u referuar KEDNJ, ashtu edhe në aspektin kombëtar, referuar Kushtetutës. Kodi është hartuar në pajtim me standardet ndërkombëtare. Ai ka më shumë karakteristikat e një sistemi procedural akuzator. Në veçanti i është dhënë rëndësi debatit gjyqësor, i cili drejtohet nga gjykata, por roli i palëve është vendimtar, pasi ata paraqesin prova, dhe debatojnë për vlerën e provës.

<sup>54</sup>Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007 si dhe Ligjin Nr. 9904, datë 21.4.2008 (Kushtetuta)

<sup>55</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995

## KAPITULLI III : GARANCITË KUSHTETUESE TË TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT NË FAZËN E HETIMEVE

### HYRJE

Me të drejta të të pandehurit, do të kuptojmë tërësinë e kuadrit ligjor, i cili përmban parimet themelore, që garantojnë një proces të rregullt ligjor.

Legjislacioni procedural penal në vetvete, përbëhet nga tëresia e gjithë rregullave procedurale që normojnë e rregullojnë gjithë procesin penal, duke vendosur një ekuilibër sa më të drejtë midis mbrojtës së interesave të shoqërisë, duke luftuar me efektivitet kriminalitetin, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, zhvillimin e një procesi penal duke respektuar e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Çmohet se raporti midis të pandehurit dhe organeve të drejtësisë mund të ndahet në dy etapa, në varësi të fazës së procedimit penal, konkretisht në **hetim** dhe në **gjykim**.

I pandehuri ka një sërë të drejtash në secilën prej fazave të mësipërme. Kështu, ai ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave, të japë shpjegime, të mbrohet me avokat, të paiset apo njihet me aktet në ngarkim të tij, etj. Për secilën nga të drejtat i pandehuri mund të paraqesë kërkesa, me qëllim për të mundësuar plotësimin e tyre. Por ndryshimi i raportit ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit, në dy fazat e mësipërme të procesit, qëndron në organin që disponon në lidhje me të drejtat e të pandehurit. Në gjykim lidhur me kërkesat e të pandehurit, vlerëson dhe vendos Gjykata. Prokurori është palë e barabartë në gjykim, të cilit i njihet e drejta, që të paraqesë para gjykatës, vetëm vlerësimet në lidhje me kërkesat e bëra.<sup>56</sup> Disponimi i qëndron gjykatës, e cila është e paanshme dhe në marrëdhënie të njëjtë me secilën nga palët në debat. Për këtë arsye, në gjykim procesi është ndërtuar mbi bazën e konceptit akuzator, duke garantuar plotësisht të drejtat e të pandehurit. Ndërkohë gjatë hetimit paraprak, lidhur me provat, faktet, kërkesat apo pretendimet e të pandehurit, vendos prokurori. Vetë natyra e funksionit të prokurorit, krijon një pozicion të kundërt me të pandehurin. Prokurori është i ngarkuar të hetojë veprën penale, pra të zbulojë autorin, të përcaktojë provat dhe vendndodhjen e tyre, të kërkojë dhe mundësojë administrimin e tyre, qoftë edhe kundër vullnetit të subjekteve të tjera procedurale. Në hetim, prokurori vepron mbi bazën e një dyshimi dhe jo bindje për autorin e veprës penale, për faktin e konsumimit

---

<sup>56</sup> Cicchini, D.M (2012) *Tried Convicted: How Police Prosecutors and Judges destroy our constitutional rights*, Maryland: Rowman & Littlefield Publishers, fq.23



prej tij të veprës penale, pasi bindja krijohet në përfundim të hetimeve paraprake. Prokurori vepron duke ndërhyrë edhe në të drejtat themelore të individit, nëpërmjet përgjimit të bisedave, kontrollit personal apo të banesës, sekuestrimit të objekteve në pronësi të autorit, këqyrjes së vendeve etj...*(pa u ndalur në rolin e gjykatës mbi këto veprime)*.

Karakteristikat e mësipërme, e vendosin prokurorin në një pozicion përballjeje me të pandehurin. Pavarësisht nga ky fakt, prokurori është i detyruar të shprehet për të gjitha kërkesat e autorit të veprës<sup>57</sup>. Në këtë mënyrë, për prokurorin krijohet një pozicion i dyzuar, pasi në një anë ai duhet të grumbullojë provat dhe të provojë akuzën, në anën tjetër duhet të çmojë dhe disponojë mbi kërkesat e të akuzuarit, për të garantuar të drejtat e tij. Këto rrethana, vendosin para përfaqësuesit të akuzës një përgjegjësi të dyfishtë. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori ngrihet në një nivel që përqaset me atë të gjyqtarit. Për pasojë, ai duhet të vendosë me objektivitet dhe në respektim të plotë të kriterëve ligjore, pavarësisht se vendimet e tij mund të ndikojnë në lehtësimin e autorit apo shmangien e tij nga përgjegjësia përkatëse. Prokurori në hetim, veç rolit si përfaqësues i akuzës, është njëkohësisht edhe garant i të drejtave të të pandehurit.

Nëse gjatë hetimeve paraprake, prokurori nuk do të sigurojë respektimin e të drejtave të pandehurit, veprimet e tij dhe të policisë gjyqësore do të karakterizohen nga pavlefshmëri absolute, relative apo papërdorshmëri, të cilat do të shfrytëzohen në gjykim, për të dëmtuar akuzën. Për këtë arsye, garantimi i të drejtave procedurale të të pandehurit, përbën një detyrim, plotësimi i të cilit veç mbrojtjes së interesave të këtij të fundit, realizon edhe ecurinë normale të procesit penal.

Duhet theksuar se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të pandehurit, shtrihen edhe për personin nën hetim (neni 34/4 i K.Pr.Penale). Për pasojë prokurori duhet të kushtojë vëmendje të njëjtë respektimit të tyre, pavarësisht nëse i dyshuari për veprën penale ka marre apo jo cilësinë e të pandehurit.

Rëndësinë më të madhe, respektimi e zbatimi i këtyre të drejtave, e merr për personin ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, “të pandehurin”. Duke patur një pozitë specifike, i pandehuri krahasuar me subjektet e tjera procedurale, është subjekt i kufizimeve të të drejtave dhe lirive të tij.

---

<sup>57</sup> Ligji Nr.8737, datë 12.2.2001, ndryshuar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese Nr. 25, datë 13.02.2002, ndryshuar me ligjin Nr. 9102, datë 10.07.2003, ndryshuar me ligjin Nr. 10051, datë 29.12.2008, i azhurnuar “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Është e vërtetë se organi i ndjekjes penale ka attribute, që personit të marrë të pandehur t'i cënojë apo kufizojë një sërë të drejtash, për shkak të gjendjes së veçantë të tij. Por kjo, kurrsesi nuk duhet kuptuar dhe barazuar me faktin se pushteti penal ndaj tij është i pakufizuar. Në të kundërtën, do të shkelej haptazi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, sikurse dhe e drejta universale që gëzon individi në një shoqëri njerëzore. Një pushtet i tillë nuk ekziston, jo vetëm kur personi është në fazën e hetimit si i pandehur, por edhe atëherë kur ai është deklaruar fajtor me vendim gjyqsor të formës së prerë për një vepër penale dhe është duke e vuajtur këtë dënim. Cilësimi dhe qenia e një personi si “i pandehur”, në çfarëdo lloji mase sigurimi të zgjedhur dhe të vlerësuar ndaj tij, është në realitet një dukuri e përkohshme, për aq sa lejojnë parametrat ligjorë. Duke qenë e tillë, kurrsesi nuk mundet që e përkohshmja të dominojë mbi të përhershmen, domethënë, mbi atë që individi ndodhet jashtë qënies së tij si i pandehur. Pra, edhe për këtë arsye, nuk ndodhemi para një pushteti të pakufizuar të organit të akuzës ndaj personit të marrë në përgjegjësi penale.<sup>58</sup> Për vendosjen e këtyre kufizimeve, si Kushtetuta ashtu edhe K.Pr.Penale, kanë parashikuar organet kompetente, gjykatën dhe prokurorinë. Nga ana tjetër, për të shmangur çdo abuzim apo arbitraritet në lidhje me ushtrimin e këtyre tagrave, janë parashikuar edhe garancitë procedurale të të pandehurit, respektimi i të cilave, përbën detyrim ligjor për këto organe dhe i siguron të pandehurit, realizimin e të drejtave të tij gjatë gjithë procesit penal. Ndodhur në këto kushte, garantimi i të drejtave të pandehurit, merr po atë rëndësi si edhe tagrat që i janë atribuar organit procedues apo gjykatës.

Procesi i rregullt ligjor, kërkon nga organet e procedimit, respektimin e të drejtave të të pandehurit, që nga momenti kur ai cilësohet “i pandehur”, njoftohet për vendimin e marrjes së tij si i pandehur, e deri në përfundim të gjykimit (përfshirë apelimet), kur vendimi i pafajësisë, pushimit apo dënimit merr formë të prerë. Në këtë kuptim, procesi i rregullt ligjor, përfshin të gjitha garancitë procedurale penale të të pandehurit, që nga faza e hetimit të çështjes penale deri në përfundim të fazës së gjykimit të kësaj çështje, kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë.<sup>59</sup>

---

<sup>58</sup> Dhrami, J. (2010) *Raportet e prokurorit me të pandehurin dhe të dëmtuarin akuzues*, Tiranë: Jeta juridike, Shkolla e Magjistraturës, fq.70-71-72

<sup>59</sup> Siegel, J.L. & Worrall, L.J. (2014) *Essentials of Criminal Justice*, Stamford, USA: Library of Congress, pg.82

Të drejtat e të pandehurit që burojnë nga “e drejta për një proces të rregullt ligjor”<sup>60</sup>, do t’i trajtojmë nën këndvështrimin e:

1. Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

2. Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

3. Kodit të Procedurës Penale

Është zgjedhur kjo renditje dhe mënyrë trajtimi, duke patur parasysh se është KEDrNj, ajo që përcakton jo vetëm konceptin e “procesit të rregullt ligjor”, por edhe standartin minimum të të drejtave dhe lirive që e përbëjnë atë. Konventa është më tepër se një instrument ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, pasi ajo kodifikon disa të drejta themelore, të cilat duhet të gjejnë pasqyrim në çdo legjislacion të brendshëm.<sup>61</sup>

Ndërsa Kushtetuta duke u bazuar mbi dispozitat e Konventës, jo vetëm i afirmon ato, por shkon më tej drejt përsosjes, zgjerimit dhe garantimit të këtyre të drejtave. Dhe si përfundim, do të gjejmë zbërthimin dhe konkretizimin e të drejtave, për një proces të rregullt ligjor në K.Pr.Penale, duke trajtuar hollësisht dispozitat që parashikojnë të drejtat e të pandehurit në marrëdhëniet procedurale që krijohen midis tij dhe subjekteve të tjera.

### **3.1 Caktimi i masave të sigurimit personal dhe marrja e një personi si të pandehur**

Caktimi i masave të sigurimit dhe marrja e personit si të pandehur, janë veprime procedurale, të cilat jo vetëm nuk mund të njësohen, por as nuk e kushtëzojnë njëri-tjetrin. Kjo për arsye se, pavarësisht nga kufizimi i të drejtave dhe lirisë së personit ndaj të cilit ndërmerren këto veprime procedurale, dallimi i tyre kryesor qëndron në qëllimin dhe funksionin që ato kryejnë.

**Së pari**, masat e sigurimit, caktohen nga gjykata duke u ndryshuar rrënjësisht praktika shumëvjeçare e caktimit të masave të sigurimit nga prokurori, e cila është bërë shkak për shkeljen e rëndë të lirive dhe të drejtave të personave të proceduar. Ky ndryshim, erdhi si rezultat i përshtatjes së K.Pr.Penale me normat ndërkombëtare të sanksionuara nga KEDrNj. Marrja e personit si i pandehur, është kompetencë ekskluzive kushtetuese dhe

---

<sup>60</sup> E drejta për proces të rregullt është një ndër të drejtat më të gjëra që parashikohet në instrumentet ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë garantohet nga neni 6 dhe Protokollin Nr.7 i KEDNJ

<sup>61</sup>Muçi, Sh. (2012), *E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Tiranë : Botimet Dudaj

ligjore e prokurorit, i cili është organi i vetëm që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 148 i Kushtetutës dhe neni 24 i K.Pr.P).<sup>62</sup>

**Së dyti**, masat e sigurimit, kanë si qëllim të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale, të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.

Ndërsa marrja e personit si i pandehur, ndjek si qëllim vënien para përgjegjësisë penale, të çdo personi që ka kryer një vepër penale, të parashikuar nga K.Penal dhe procedimin e tij sipas kërkesave të ligjit.

Duke u nisur nga qëllimi që ndjekin këto veprime procedurale, është e kuptueshme se masat e sigurimit, synojnë të plotësojnë nevojat e sigurimit ndaj personit në procedim, ndaj dhe interesat e hetimit të plotë e në kushte normale të çështjes, kërkojnë caktimin e tyre para marrjes së personit, si autor i mundshëm i veprës penale, me cilësinë e të pandehurit.

Në praktikën gjyqësore të mëparshme, dallimi midis këtyre dy veprimeve procedurale është paraqitur i vështirë për t'u kuptuar e për më tepër zbatimimi i tyre është bërë në mënyra të ndryshme. Problemi i shtruar për zgjidhje në këtë rast është:

A duhet domosdoshmërisht që marrja e personit si i pandehur t'i paraprijë caktimit të masës së sigurimit personal nga gjykata ndaj këtij personi?

Le të sjellim më parë dy raste të praktikës, e më pas të zgjidhim dhe argumentojmë problemin e mësipërm.

Me vendimin Nr.21, dt.14.05.2001, Gjykata e Apelit mori në shqyrtim çështjen penale me të pandehur A.T. dhe B.K., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga neni 237 e 238, 25 i K.P, me objekt:Shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës për caktimin e masave të sigurimit personal arrest në shtëpi (neni 232/d) për të arrestuarin B.K. dhe arrest me burg (neni 232/dh) për të arrestuarin tjetër A.T, duke vendosur shfuqizimin e këtij vendimi me arsyetimin:

“Prokuroria e Rrethit Durrës, i ka kërkuar Gjykatës së rrethit të caktojë ndaj shtetasve A.T. dhe B.K. si masë sigurimi personal atë të arrestit “në burg”, ndërkohë që dilte e vërtetuar se asnjëri prej këtyre shtetasve nuk ishte marrë më parë në përgjegjësi penale për veprat për të cilat organi i Prokurorisë mendonte të kishte dyshime të arsyeshme se ishin kryer prej tyre.

Gjykata e Rrethit duke shkelur rëndë kërkesat ligjore, në kundërshtim me nenet 228, 229,230 të K.Pr.P., ka caktuar ndaj të pandehurve A.T. dhe B.K. masa të sigurimit personal, ndërkohë që ata nuk ishin vënë në dijeni për akuzat që iu ishin bërë dhe nuk ishin marrë në përgjegjësi

<sup>62</sup> Islami, H.,Hoxha, A.&Panda, I.(2007), *Procedura Penale*, Tiranë:Botimet Morava

penale për veprat që dyshoheshin. Në këto rrethana, duke qënë se shtetasit A.T. dhe B.K. nuk rezultojnë të jenë marrë të pandehur nga organi i hetimit, edhe masat e sigurimit të kërkuara dhe të caktuara nga gjykata, janë bërë në kundërshtim me kërkesat procedurale e ligjore, ndaj dhe ky vendim duhet të shfuqizohet.”<sup>63</sup>

Duke iu referuar këtij rasti, argumentat e mësipërm nuk mund të përbëjnë shkak për prishjen e vendimit gjyqësor për këto arsye:

Së pari, duhet të kemi parasysh dhe veçojmë kushtet ligjore që janë të domosdoshme për t’u plotësuar për marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit, dhe kushtet e kriteret ligjore që duhet të përmbushen për caktimin e masave të sigurimit personal.

Po t’i referohemi nenit 5/3 të K.E.Dr.Nj, nenit 27/2(c) të Kushtetutës dhe neneve 228, 229, të K.Pr.Penale, del qartë se kushtet e përgjithshme ligjore për caktimin e masave të sigurimit janë :

1. Dytshmimi i arsyeshëm i bazuar në prova,
2. Ekzistenca e veprës penale,
3. Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale,
4. Ekzistenca e një prej kushteve të parashikuara në nenin 27/2 (c) të Kushtetutës dhe nenin 228/3 të K.Pr.P.:
  - a) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;
  - b) largimi i të pandehurit ose rreziku që ai të largohet;
  - c) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të tij, të mund të kryejë krime të rënda, ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Të tre kushtet e mësipërme dhe një prej pikave të kushtit të katërt, duhet të ekzistojnë dhe vërtetohen njëkohësisht e bashkarisht në çdo rast konkret, si dhe të argumentohen në aktin që cakton masën e sigurimit personal.<sup>64</sup>Krahas këtyre kushteve, duhet të respektohen edhe kriteret ligjore të parashikuara në nenin 229 të K.Pr.P si dhe kriteret e veçanta të parashikuara në nenin 230 të K.Pr.P në rastin e caktimit të masës së arrestit në burg.

Me plotësimin e kërkesave të mësipërme ligjore, organi i prokurorisë ka të drejtën, të kërkojë dhe gjykata detyrimin ligjor të vendosë, caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personit për të cilin kërkohet ajo.

<sup>63</sup> Vendim Nr. 21, dt. 14.5.2001 i Gjykatës së Apelit Durrës

<sup>64</sup> Vendime të GJEDrNj, Kurt kundër Turqisë, gjykimi i 28 Majit 1998, paragrafi 123

Ndërsa, për marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit, siç kemi trajtuar edhe më sipër, duhet të përmbushen akoma kërkesa të tjera dhe të një cilësie shumë më të lartë. Kështu, nëse për caktimin e masës së sigurimit kërkohet “një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”, si standarti kryesor i kufizimit apo heqjes së lirisë së personit, për marrjen e një personi si i pandehur, organi i procedimit nuk mund të bazohet në të dhëna minimale për kryerjen e veprës penale. Në këtë rast, shkalla e dyshimit të arsyeshëm është më e lartë dhe ka një bazë më të gjerë provash, të cilat në tërësinë e tyre domosdoshmërisht duhet të vërtetohen (neni 34 i K.Pr.P):

- 1) Kryerjen e veprës penale;
- 2) Individualizimin e kryerjes së saj nga një person i caktuar;
- 3) Administrimi i të dhënave të mjaftueshme (provave) të cilat krijojnë bindjen tek organi i procedimit, se autori i kryerjes së veprës penale është pikërisht personi që do të merret si i pandehur dhe jo një tjetër.<sup>65</sup>

Kjo bindje është e kushtëzuar nga gjendja e hetimeve, rrjedhë e së cilës është ajo, dhe nuk mund të barazohet me “dyshimin e arsyeshëm”<sup>66</sup> për caktimin e masës së sigurimit, sepse edhe sasia dhe cilësia e provave që kërkohen për secilin rast është e ndryshme, ashtu siç kërkohen të një shkalle dhe të një cilësie më të lartë edhe kushtet e tjera ligjore që kemi trajtuar për marrjen e personit me cilësinë e të pandehurit.<sup>67</sup>

Duhet theksuar gjithashtu, se ekzistenca e veprës penale dhe të provuarit e fajësisë së të pandehurit në kryerjen e saj, janë elementët kryesorë që krijojnë bazën e mjaftueshme, për të vendosur një person të caktuar para përgjegjësisë penale, dhe janë gjithmonë rrjedhë e hetimeve në një proces penal të caktuar. Në këtë aspekt, nuk mund të merret një person në përgjegjësi penale dhe t’i komunikohet akuza konkrete, pa u kryer hetimet e nevojshme, ndaj dhe caktimi i masave të sigurimit, presupozon plotësimin e nevojave të hetimit, në mënyrë që ato të vazhdojnë normalisht dhe të mos pengohen nga personi ndaj të cilit merret kjo masë.

Nga sa më sipër, rezulton se një person i caktuar, mund të merret i pandehur edhe pa qënë nevoja e caktimit të masave të sigurimit ndaj tij, dhe kjo del edhe nga vetë dispozitat e

---

<sup>65</sup> Në Kurt kundër Turqisë Gjykata Evropiane u shpreh se çdo heqje lirie nuk duhet të vihet në zbatim vetëm duke qënë në pajtim me rregullat substantive dhe procedurale të ligjit vendas, por duhet edhe t’i përmbahet qëllimit kryesor të Nenit 5, përkatësisht mbrojtjes së individit kundrejt arbitrarizmi

<sup>66</sup> Puzelt kundër Republikës Çeke, 25 Prill 2000

<sup>67</sup> Shih gjithashtu Engel dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulta, 8 Qershor 1976

K.Pr.Penale. Por, kur ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e masave të sigurimit ndaj tij, kjo nuk ka përse të jetë detyrues dhe paraprile nga vendimi i marrjes së tij si i pandehur, sepse marrja në mënyrë të nxituar, pa u zhvilluar hetimet e nevojshme, e një personi të caktuar me cilësinë e të pandehurit, nuk është vetëm shkelje e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, por është edhe një veprim i padobishëm edhe për vetë ecurinë e hetimeve, duke ndikuar negativisht në shpejtësinë e zbulimit të veprës penale dhe të autorit të saj. Për më tepër, në dispozitat e K.Pr.Penale, nuk parashikohet shprehimisht detyrimi i marrjes së personit si i pandehur para caktimit të masës së sigurimit ndaj tij. Përkundrazi po t'i referohemi nenit 5/2 të Konventës dhe nenit 28/1 të Kushtetutës, në këto dispozita parashikohet shprehimisht:

“Kushdo të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet...”<sup>68</sup>

Nga interpretimi i kësaj dispozite, del se heqja apo kufizimi i lirisë, i paraprin marrjes së personit si i pandehur, dhe në kuptim të dispozitës së mësipërme “vënia e tij në dijeni për shkaqet e masës së sigurimit dhe për çdo akuzë që mund t'i bëhet” dhe që justifikon ligjërisht ndalimin apo arrestimin, ka si qëllim t'i krijojë personit të ndaluar apo arrestuar, mundësinë e mbrojtjes apo të kundërshtimit ndaj kësaj mase, dhe nuk kërkon domosdoshmërisht marrjen e tij si të pandehur.

Me interes për t'u trajtuar, paraqiten edhe dy veprime të tjera procedurale, që janë arrestimi në flagrancë (neni 251,252 i K.Pr.Penale) dhe ndalimi i të dyshuarit për një krim (neni 253 i K.Pr.Penale). Të dy këto veprime procedurale, si dhe marrja e personit të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për një krim, me cilësinë e të pandehurit, në praktikën gjyqësore, janë konsideruar pazgjidhshmërisht të lidhura ngushtë midis tyre.<sup>69</sup>

Referuar nenit 255/1 të K.Pr.Penale, citohet se :

“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim, i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit, se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklaratë, dhe se në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai të thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim, si dhe i bëjnë të ditur të drejtat që ai ka për të zgjedhur mbrojtës, duke e njoftuar menjëherë atë.”<sup>70</sup>

<sup>68</sup>Cicchini,D.M&J.D,Kushner,B.A (2010) *But they didn't read me my rights:Myths, Oddities and Lies about our legal System, Problems with the Police*, New York : Prometheus Books, fq. 61-76

<sup>69</sup> Chemerinsky,E&,Levenson,L.L. (2015) *Criminal Procedure.Case and statutory supplement, Chapter 12*, New York: Wolters Kluwer,fq. 97-104

<sup>70</sup> Neni 255/1 K.Pr.Penale të R.Sh

Ky njoftim apo informacion, nuk është i njëjtë me njoftimin e akuzës që i bëhet të pandehurit sipas nenit 34 të K.Pr.Penale, sepse në rastin e parë, njoftimi bëhet nga oficeri apo agjenti i policisë gjyqësore që kryen arrestimin në flagrancë apo ndalimin, njoftim i cili ka për qëllim t'i bëjë të ditur, personit të arrestuar apo ndaluar, shkakun e arrestimit apo të ndalimit si dhe të drejtat kryesore që i njeh atij ligji që nga ai moment. Ndërsa në rastin e dytë, njoftimi bëhet si rregull nga prokurori, dhe me autorizim të tij nga oficeri i policisë gjyqësore, për më tepër, ky njoftim bëhet nëpërmjet një akti të shkruar, "vendim" në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme, d.m.th shkaqet ligjore dhe faktike për marrjen e këtij personi si të pandehur.

Duke shpjeguar këtë dallim, Gjykata Europiane e të Drejtave të njeriut ka theksuar se, në rastin e arrestimit dhe ndalimit nga policia, "informacioni" i dhënë të arrestuarit apo të ndaluarit nuk ka nevojë të jetë po aq i hollësishëm sa ai i parashikuar nga neni 6/3 i KEDrNj. Ky i fundit, parashikon të drejtën e të pandehurit, që të "informohet për natyrën dhe për shkakun e akuzës që bëhet kundër tij" (çështja Van Den Leer kundër Vendeve të Ulta, viti 1990).<sup>71</sup>

Neni 5/2 i Konventës, përmban mbrojtjen elementare, që një person i arrestuar duhet të dijë përse po privohet nga liria e tij, me qëllim që ai jetë në gjendje, nëse e sheh të arsyeshme, të ankohet në gjykatë për të kundërshtuar ligjshmërinë e këtij privimi, në përputhje me nenin 5/4 të Konventës.

Nga ky dallim, është e qartë se për arrestimin në flagrancë dhe ndalimin e të dyshuarit për një krim, nuk kërkohet paraprakisht njoftimi i akuzës apo marrja e personit të arrestuar apo të ndaluar si i pandehur dhe, si rregull arrestimi dhe ndalimi kryhen para këtij njoftimi, i cili mund të bëhet në fillim, në mes apo në përfundim të hetimeve paraprake, atëherë kur ekzistojnë "të dhëna të mjaftueshme" në ngarkim të këtij personi,

Ky problem i rëndësishëm që është shtruar në praktikën gjyqësore, është trajtuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues Nr.3, dt.27.09.2002, sipas të cilit: "Për ndalimin apo arrestimin në flagrancë nga organi i akuzës, si dhe për caktimin e masave të sigurimit personal nga gjykata, marrja më parë e personit me cilësinë e të pandehurit nuk është e detyrueshme".<sup>72</sup>

---

<sup>71</sup>Van Den Leer kundër Vendeve të Ulta, gjykimi i 21 Shkurt 1990

<sup>72</sup> Vendim Nr.3, dt. 27.9.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të R.Sh



Në trajtimin e këtij problemi, Kolegjet e Bashkuara i janë referuar KEDrNj, Kushtetutës dhe K.Pr.Penale, duke sjellë argumentat e mëposhtme:

“Në përshtatje me nenin 5/2 të Konventës, në Kushtetutë dhe në K.Pr.P. janë përcaktuar rregulla të hollësishme për njoftimin e akuzës dhe marrjen në pyetje të të arrestuarit apo të ndaluarit. Në nenin 28 të Kushtetutës thuhet se: “kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet”.<sup>73</sup>

Kjo e drejtë parashikohet në nenin 256 të K.Pr.Penale, sipas të cilit i arrestuari ose i ndaluar, merret në pyetje në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht, duke u njoftuar për faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, si dhe duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij.<sup>74</sup>

Nga përmbajtja e nenit 34 të K.Pr.Penale, personi e merr cilësinë e të pandehurit vetëm atëherë kur ai njoftohet me akt të shkruar në formën e vendimit, nga prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar prej tij. Njoftimi i akuzës, me akt të shkruar, si veprim procedural, nënkupton përfundimin paraprak të arritur nga organi i prokurorisë, se vepra penale është kryer dhe se autori i saj është personi të cilit i bëhet ky njoftim. Prokurori, marrjen e personit me cilësinë e të pandehurit nëpërmjet njoftimit të akuzës me akt të shkruar, mund ta realizojë në cdo fazë të procedimit penal, përfshirë këtu edhe kohën përpara se personit t’i hiqet liria. Marrja në pyetje nga prokurori, e personit të arrestuar apo ndaluar sipas nenit 256 të K.Pr.P, nuk do të thotë se ai përmes këtij veprimi ka marrë cilësinë e të pandehurit, sepse ky veprim nuk është i njëjtë me atë të parashikuar në nenin 34 të këtij kodi. Pasqyrimi i veprimeve të kryera nga prokurori sipas nenit 256 të K.Pr.P, bëhet me procesverbal (neni 315 i K.Pr.P). Ndaj duke kryer këto veprime, prokurori, personit të cilit i është hequr liria, nuk i ka dhënë cilësinë e të pandehurit, pasi prej tij nuk është përpiluar akt i veçantë “vendim”, siç kërkon neni 34/1 i K.Pr.Penale.<sup>75</sup>

Neni 256 i K.Pr.P, nuk e urdhëron prokurorin që në këtë fazë të procedimit, të realizojë të drejtën ligjore për të marrë personin me cilësinë e të pandehurit. Njoftimi i personit të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë nga prokurori, me shkaqet dhe kushtet për të cilat është bërë ndalimi apo arrestimi në flagrancë i tij, si dhe njoftimi me të dhënat që disponohen se ai është autor i një vepre penale, bëhet në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

---

<sup>73</sup> Neni 28 i Kushtetutës së R.Sh

<sup>74</sup> Neni 256 i K.Pr.Penale të R.Sh

<sup>75</sup> Neni 34/1, 256 e 314 të K.Pr.Penale

Caktimi i masës së sigurimit nuk lidhet me njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit. Masat e sigurimit si rregull caktohen përpara se të bëhet njoftimi i akuzës, dhe kanë si qëllim, plotësimin e nevojave të sigurimit ndaj personit në procedim. Vetëm pas zbatimit të tyre, bëhet njoftimi i akuzës dhe vazhdohet me marrjen në pyetje.

Përdorimi i fjalës “i pandehur” kur flitet për të drejtat e të arrestuarit, lidhet me faktin që ai mund të jetë edhe i tillë, por jo se pa qenë i tillë ndaj tij nuk mund të caktohet masë sigurimi.<sup>76</sup>

Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve, por ky status mund të merret edhe më përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit, por këtë veprim ai e kryen vetëm pasi të ketë siguruar të dhënat e mjaftueshme dhe bindjen e arsyeshme se shtetasi i dyshuar ka konsumuar elementë të veprës penale për të cilën akuzohet (neni 34/1 i K.Pr.P). Ajo që vlen të theksohet dhe të vihet më shumë në dukje, është përcaktimi i përmbajtjes së akuzës që duhet të njoftohet dhe dhënia e mundësisë personit të akuzuar për t’u mbrojtur.<sup>77</sup>

Nga kjo rrjedh përfundimi logjik, se organi procedues mund ta bëjë njoftimin e akuzës si përpara pyetjes së personit nën hetim, ashtu edhe përpara marrjes së personit në cilësinë e të pandehurit dhe pyetjes së tij.

Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se, masat e sigurimit mund të caktohen edhe pa u marrë personi më parë si i pandehur, me kusht që të jetë vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet dhe për të drejtat e tij (neni 31 i Kushtetutës).

Nga sa më sipër, bazuar në analizën e dispozitave kushtetuese e ligjore, në argumentat e përdorur nga Kolegjet e Bashkuara si dhe në arsyetimin që kam paraqitur më sipër, mendoj se kjo është zgjidhja e drejtë e këtij problemi.

### **3.2 Të drejtat themelore të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake, afirmuar në KEDrNj, Kushtetutë dhe K.Pr.Penale**

E drejta jonë penale gjen pasqyrimin e saj në K.Pr.Penale dhe në Kushtetutën e R.Sh.<sup>78</sup> Parimet bazë të saj afirmohen dhe në KEDrNj. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim merr

---

<sup>76</sup> Allen, J.R. & Stunz, J.W., (2015) *Comprehensive Criminal Procedure*, New York: Wolters Kluwer, fq. 269-275

<sup>77</sup> Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I. (2003), *Komentari i Kodit të Procedurës Penale të RSh*, Tiranë: Botimet Morava

<sup>78</sup> Dobjani, E. (2008), *Parimi i sigurisë juridike*, Në: Jeta juridike Nr.4, Dhjetor 2008, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, fq. 74 – 85

figura procedurale e “të pandehurit“, parimet themelore të së drejtës që lidhen me pozitën e tij dhe procesin penal.

I pandehuri e merr këtë cilësi gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe është pikërisht kjo fazë e cila merr rëndësi të vecantë në respektimin e të drejtave procedurale, pasi nga marrja e cilësisë “i pandehur “ ndaj këtij subjekti më pas fillojnë e rrjedhin një sërë pasojash ligjore. K.E.Dr.Nj. në nenin 6/3 të saj parashikon një varg të drejtash të cilat i pandehuri i gëzon që nga momenti kur ai merr cilësinë “i pandehur”, dhe kjo rezulton e qartë nga interpretimi i termit “i akuzuar” i përdorur në Konventë.<sup>79</sup> Që nga ky moment, krijohet figura procedurale e të pandehurit dhe vendosen përballë njëri-tjetrit si palë të barbarta, i pandehuri dhe prokurori, me të drejta të njohura nga Kushtetuta dhe K.Pr.Penale. Prokurori, si subjekti procedural që ngre dhe përfaqëson akuzën në gjyq, dhe nga ana tjetër “i pandehuri”, personi ndaj të cilit ngrihet kjo akuzë. Kjo marrëdhënie procedurale mes këtyre dy subjekteve të procedimit, shoqërohet me disa garanci për të pandehurin, të trajtuara në vijim.

### ***3.2.1 E drejta e të pandehurit për të njohur akuzën në ngarkim të tij***

Në nenin 6/3 (a) të K.E.Dr.Nj. sanksionohet se:

“Çdo i akuzuar, ka të drejtë pikërisht që: a-të informohet brenda një afati sa më të shkurter, në një gjuhë që ai e kupton, dhe në mënyrë të hollësishme për natyrën dhe shkakun e akuzës që bëhet kundër tij”.<sup>80</sup>

Në vendimet e saj, Gjykata Europiane ka vënë në dukje se koncepti i akuzës duhet trajtuar brenda kuptimit që i jep Konventa, sipas së cilës akuza mund të përkufizohet si njoftimi zyrtar dhënë një individit nga autoriteti kompetent, për pretendimin se ai ka kryer një vepër penale dhe që ndryshon në mënyrë substanciale pozitën e tij. Që nga ky moment, personit të akuzuar i lind e drejta për të kërkuar “një proces të rregullt ligjor”. Kjo nënkupton, detyrimin e organit procedues për respektimin e kërkesave të nenit 6 të Konventës, sepse nga ky moment fillon të llogaritet “afati i shkurtër” i njoftimit të akuzës. Gjykata Europiane ka theksuar se, ky njoftim duhet bërë me shkrim si dhe të përmbajë bazën faktike dhe ligjore të kësaj akuze, e shprehur kjo në gjuhën që kupton i pandehuri, sepse në të kundërt ai do të vihej në disavantazh dhe nuk do të mund të përgatiste mbrojtjen ndaj kësaj akuze.

Nëse i referohemi nenit 31/a të Kushtetutës kemi pothuajse të njëjtin formulim:

<sup>79</sup>Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore dhe të protokolleve të saj shtesë, ratifikuar me Ligjin Nr. 8137, dt. 31.7.1996, Botim i QPZ

<sup>80</sup>Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6/3 (a), Përmbledhje e akteve ndërkombëtare për Drejtësinë, Botim i QPZ

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a-të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij”<sup>81</sup>

Nëpërmjet kësaj dispozite, Kushtetuta i zgjeron më tej garancitë e të pandehurit, duke parashikuar si detyrim për organin procedues dhe njohjen e të pandehurit me të drejtat e tij në këtë fazë të procedimit, që nga momenti i njoftimit të akuzës.

Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, ky detyrim parashikohet për organin procedues në nenin 38 të K.Pr.Penale, sipas të cilit: “organi procedues i shpjegon të pandehurit faktin që i atribuohet, e njëh me provat në ngarkim të tij ...”<sup>82</sup>Kjo e drejtë e të pandehurit, përbën një detyrim kushtetues për organin procedues, sepse vetëm duke ditur akuzën në ngarkim të tij, i pandehuri mund të sqarojë pozitën e tij rreth fajësisë apo pafajësisë, si dhe të mund të mbrohet ndaj saj. Gjithashtu, siç përmendëm më lart, organi procedues është i detyruar në bazë të Kushtetutës, t’a vërë në dijeni të pandehurin dhe t’i shpjegojë të drejtat që ai gëzon në këtë fazë të procedimit.

Në nenin 34 të K.Pr.Penale, parashikohet që akti i akuzës, i njoftohet të pandehurit. Ky veprim duhet të behet në prani të mbrojtësit (nëse kërkohet), detyrim i cili rrjedh nga e njëjta dispozite. Në të kundërt njoftimi i aktit të akuzës, në reference të nenit 128/c të K.Pr.P, është absolutisht i pavlefshëm. Njoftimi i akuzës të pandehurit, është vlerësuar si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin Nr.27 dt.11.12.2006, ku shprehet:

“Nuk qëndrojnë pretendimet e kërkuesit për moskomunikimin e akuzës dhe për mosqenien e tij apo të mbrojtësit në dijeni të zhvillimit të procesit ligjor në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën e apelit. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore rezulton se mbrojtësi i caktuar prej kërkuesit ka qenë i pranishëm në të gjitha veprimet procedurale si në fazën e hetimit ashtu edhe në atë të gjykimit”<sup>83</sup>.

Të njëjtin vlerësim ka bërë Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 21, datë 24.07.2006, ku shprehet:

“Gjykata Kushtetuese çmon se në rrethanat kur kërkuesi është gjykuar e dënuar në mungesë, pa u vënë në dijeni personalisht në lidhje me akuzat dhe procesin në ngarkim të tij, i duhet garantuar edhe të pasur një gjykim në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”<sup>84</sup>.

<sup>81</sup> Kushtetuta e RSH-së, neni 31/a

<sup>82</sup>Kodi Procedurës Penale, neni 38

<sup>83</sup> Vendim Nr. 27, dt. 11.12.2006 i Gj.K, përmbledhje vendimesh të Gj.K, Botimet Ilar, Tiranë

<sup>84</sup> Vendim Nr. 21, dt. 24.07.2006 i Gj.K, përmbledhje vendimesh të Gj.K, Botimet Ilar, Tiranë

Sa më lart, komunikimi i akuzës së pandehurit, konfirmohet edhe një herë si pjesë e procesit të rregullt ligjor, në kuadër të nenit 6 te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mungesa e komunikimit të akuzës, shkakton pavlefshmëri absolute te ndjekjes penale dhe gjykimit, e për pasojë edhe prishjen e tyre. Lidhur me komunikimin e akuzës, si pjesë e të drejtave të garantuara në nenin 6 të KEDrNJ, është shprehur edhe Gjykata e Strasburgut në çështjen “Berhani kundër Shqipërisë”, e cila ka përcaktuar sa vijon:

“Aplikanti u ankua në bazë të Nenit 6/ 3 (a), (b) dhe (c) se: nuk ishte informuar për akuzat nga prokuroria; nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për t’u vetëmbrojtur; dhe nuk kishte pasur mundësi të caktonte avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij sepse nuk ishte informuar për procedimin penal”<sup>85</sup>.

Në rastin Berhani, Gjykata e Strasburgut ka konstatuar shkelje të të drejtave të mësipërme e për pasojë ka penalizuar shtetin shqiptar.

Në vendimin unifikues Nr.7 dt. 14.10.2011, Gjykata e Lartë shprehet:

“Masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, meqenëse, në rrethanat e çështjes objekt i këtij gjykimi, rezulton se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për caktimin e tyre të parashikuara nga ligji procedural penal”<sup>86</sup>.

Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues, se në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të “rrezikut”, pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit), vënia në rrezik e procesit të provuarit nga ana e të pandehurit. Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit, që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës. Ky përfundim ka në kuadër të tij, garantimine procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi, të parashikuar nga Kushtetuta, e që pikërisht justifikon, parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit. Në këtë mënyrë, edhe kërkesa e prokurorit për caktim mase sigurimi gjatë fazës së gjykimit, është e bazuar në ligj. Por për organin e

<sup>85</sup> Berhani kundër Shqipërisë, gjykuar më 27 Maj 2010

<sup>86</sup> Vendim unifikues Nr.7 dt. 14.10.2011 i Gj.Lartë

akuzës ashtu si dhe për Gjykatën, ekziston detyrimi për të argumentuar vënien në rrezik të procesit të të provuarit nga ana e të pandehurit. Caktimi apo jo i masës së sigurimit, është atribut i gjykatës, rrethanë kjo e cila garanton plotësisht të dyshuarin për veprën penale. Por duke qenë se prokurori, është pala që inicion procesin, detyrimi për të bërë vlerësimin paraprak të kushteve dhe kriterëve ligjore, i përket pikërisht këtij subjekti. Masa e sigurimit ndaj personit të dyshuar si autor i veprës penale, mund të caktohet edhe në mungesë të këtij subjekti<sup>87</sup>. Lidhur me këtë mënyrë të vendosjes së masës, Gjykata e Lartë ka disponuar në vendimin unifikues Nr.4 dt. 24.06.2009, ku ndër të tjera shprehet si vijon:

“Kjo procedurë që ndiqet për caktimin e masës së sigurimit nuk bazohet në parimin e kontradiktorialitetit dhe nuk garantohen të drejtat themelore që ka personi ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit për tu dëgjuar, për t’u mbrojtur vete ose me avokat, për të ngritur pretendime dhe paraqitur prova, pasi në vetvete kjo procedurë e caktimit të masës së sigurimit nuk është një gjykim i mirëfilltë me elementët që ai ka të përcaktuar sipas Kodit të Procedurës Penale, për shkak se, nevojat e sigurimit, këtë fazë të procedimit e konsiderojnë sekret dhe nuk e detyrojnë as prokurorin dhe as gjykatën të njoftojnë të pandehurin dhe mbrojtësin e tij lidhur me këtë veprim procedural. Ky rregullim ligjor është logjik, sepse në themel do të garantojë që një person që dyshohet të ketë kryer një veprë penale, të mos kryejë një veprë tjetër, të mos verë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, apo t’i largohet dhe shmanget procedimit penal. Këto janë dhe shkaqet që prokurori, edhe pse nuk kemi një gjykim me palë, duhet t’ia parashtrijë dhe provojë gjykatës se ekzistojnë së bashku ose veçmas kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase të sigurimit personal. Është e vërtetë se në rastin e caktimit të masës së sigurimit personal jo si përjashtim, pra jo në kushtet e flagrancës, kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës nuk i njoftohen personit ndaj të cilit kërkohet apo vendoset caktimi i një mase sigurimi. Këto janë veprime sekrete, të cilat për shkak se masa duhet të ekzekutohet dhe për shkak se marrja dijeni përpara ekzekutimit nga personi ndaj të cilit është caktuar një masë mund ta bënte të pamundur ekzekutimin e saj, nuk kërkojnë njoftimin paraprak të personit. Jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar që të drejtat, personi ndaj të cilit është caktuar një masë sigurimi në këto kushte, mund t’i mbrojë gjatë gjykimit të vlefësimit të masës nga gjykata brenda tre dite nga ekzekutimi i saj”<sup>88</sup>.

Me vendimin e mësipërm, është trajtuar mungesa e detyrimit të prokurorit, për të njoftuar personin e dyshuar me kërkesën e bërë ndaj tij për caktim mase sigurimi. Marrja dijeni për rrethanat në ngarkim të të dyshuarit nuk i mohohet këtij subjekti, por vetëm shtyhet në kohë, për shkak të ruajtjes së sekretit të hetimit dhe garantimit të procedimit penal. Gjykata e Lartë në vendimin unifikues Nr.1 të datës 08.01.2009, është shprehur:

“ Në çështjen objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në interpretim të drejtë të ligjit, gjykatat pikës 6 te nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancinë e lidhur me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre. Po kështu, shqyrtimi i kërkesës dhe pretendimeve janë bërë në seance gjyqësore  
Me të drejtë gjykatat kanë pranuar pretendimin e kërkuesit dhe vlerësuar si shkelje të ligjit procedural nga ana e prokurorisë, mosrespektimin e afatit dhe mos dërgimin e informacionit të

<sup>87</sup>Vendimi Unifikues Nr.4.dt. 24.06.2009 i Gjykatës së Lartë

<sup>88</sup> Vendim Unifikues Nr.4, dt. 24.6.2009 i Gjykatës së Lartë

prokurorit mbi gjendjen e procedimit në lidhje me kërkuesin. Me tej, me të drejte gjykatat kanë çmuar riparimin e menjëhershëm të kësaj shkeljeje, duke urdhëruar prokurorin të paraqesë në seancë informacionin me shkrim dhe kopjet e akteve përkatëse, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuesit për t'i krijuar mundësinë të parashtrojë qëndrimin e kërkesat. Me të drejtë gjykatat kanë krijuar në këtë mënyrë kushtet për lejimin e zhvillimin e debatit mes palëve mbi materialin e paraqitur. Pasi kanë çmuar dhe analizuar në vendimin e tyre nëse mbi bazën e informacionit ka apo jo vend për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit, me të drejtë gjykatat kanë çmuar se është vendi për rrëzimin e kërkesës, mes të tjerave duke arsyetuar edhe se vetëm mosrespektimi i detyrimit për informim, apo dërgimi me vonesë i tij, nuk sjellin vetvetiu revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit”.<sup>89</sup>

Pra gjykata ka unifikuar praktikën, duke u shprehur se mungesa e informacionit të prokurorit para gjykatës, dy muaj pas ekzekutimit të masës, nuk përbën kusht të mjaftueshëm për ta zëvendësuar atë. Informacioni është i rëndësishëm, pasi vë në dijeni gjyqtarin e hetimeve paraprake lidhur me hetimet dhe nevojën e vazhdimit të masës së sigurimit me arrest. Në varësi të këtij akti, mund të procedohet edhe me zëvendësimin apo revokimin e masës së sigurimit. Para prokurorit, shtrohet detyrimi që kur rezulton e nevojshme, të kërkojë zëvendësimin madje edhe revokimin e masës së sigurimit. Nëse në hetim, konstatohet që rreziku i ikjes, përsëritjes së krimit apo marrjes së provës, nuk vazhdon të ekzistojë, organi i akuzës duhet të iniciojë procedurat përkatëse mbi masën e sigurimit.

### ***3.2.2 E drejta e të pandehurit për të dhënë ose jo shpjegime në lidhje me akuzën në ngarkim të tij***

Këtë të drejtë e pandehuri e realizon gjithmonë pas njoftimit të akuzës, dhe kur organi procedues realizon pyetjen e tij. Sipas nenit 38/3 të K.Pr.Penale, “para se të ketë filluar pyetja, të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet”.<sup>90</sup>Gjithashtu, kjo është një e drejtë e të pandehurit dhe nëse i pandehuri do të japë ose jo shpjegime rreth akuzës, këtë ai e zgjedh vetë, pasi kjo është një e drejtë dhe jo detyrim për të. Kjo dispozitë e K.Pr.Penale pajtohet plotësisht me nenin 32/1 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes, dhe as të pohojë fajësinë e tij”.<sup>91</sup>

Për ta konkretizuar këtë dispozitë kushtetuese, në nenin 38/2 të K.Pr.Penale sanksionohet se: “ndalohet kategorikisht përdorimi i dhunës psikike apo fizike ndaj të pandehurit për të

<sup>89</sup> Gjykata e Lartë, Vendimi Unifikues Nr.1, dt 08.01.2009

<sup>90</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 38/3

<sup>91</sup> Kushtetuta e RSh-së, neni 32/1

marrë shpjegimet e tij”.<sup>92</sup> Në referim të dispozitave ligjore të cilat ndalojnë përdorimin e dhunës ndaj të pandehurit gjatë fazës së marrjes në pyetje, tashmë nga punonjësit e policisë apo oficerët e policisë gjyqësore, pasi i pandehuri apo i akuzuari japin shpjegime, ata plotësojnë një deklaratë në kushtet e anonimatit të plotë, ku deklarohen nëse ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike apo psikologjike gjatë marrjes në pyetje.

Veç faktit se, marrja në pyetje e të pandehurit apo shtetasit nën hetim duhet të bëhet në kushtet e lirisë së plotë të fjalës së individit dhe vullnetit të lire, ky veprim hetimor merr rëndësi të veçantë, pasi thëniet e të pandehurit shërbejnë si provë në gjykim, kjo në respektim të nenit 150 të K.Pr.Penale. Është kusht që deklaratimet e subjekteve sa sipër, të merren sipas rregullave procedurale penale dhe vlerësohen nga gjykata, në raport me provat e tjera të administruara prej saj gjatë gjykimit të çështjes penale.

### **3.2.3 E drejta e mbrojtjes**

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në epoken e globalizimit kanë marrë një rëndësi të veçantë dhe kanë një shtrirje universale. Për ligjërimin, garantimin e këtyre të drejtave, në një proces penal, ka një rol të veçantë mbrojtësi. Ai afirmohet si mbartës i këtyre të drejtave, duke garantuar një proces të drejtë ligjor .<sup>93</sup>

Mbrojtja ligjore në procesin penal, është specifike si për nga vetë natyra e çështjeve penale, ashtu dhe nga roli që merr avokati në këto çështje. E drejta e mbrojtjes, është një nga garancitë e një procesi të rregullt ligjor, pasi siguron barazinë e palëve në proces dhe siguron zbatimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykim. Kjo e drejtë gjen pasqyrim si në KEDrNj, Kushtetutë dhe K.Pr.Penale. Në nenin 6/3 të K.E.Dr.Nj, sanksionohet shprehimisht se:

- “Çdo i akuzuar ka të drejtë:.....
- b) t’i jepen koha dhe lehtësitë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c) të mbrohet vetë, ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë”<sup>94</sup>

Pothuajse i njëjti formulim është pranuar edhe nga Kushtetuta në nenin 31/b, ç të saj sipas të cilit:

<sup>92</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 38/2

<sup>93</sup>Marini (Mariani),A. (2012) *Një sistem formimi për avokatët shqiptarë*, Tiranë: Revista Avokatia 8, botim i Dhomësë Kombëtare të Avokatisë Shqiptare

<sup>94</sup>KEDrNj, neni 6/3



“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:.....

- b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- c) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme;”<sup>95</sup>

Siç del nga dispozita e mësipërme, kjo e drejtë thelbësore e të pandehurit gjatë gjithë procesit penal, jo vetëm është sanksionuar nga Kushtetuta jonë, por dhe është zgjeruar me garanci të tjera që do t’i shtjellojmë më poshtë. Në thelb të kësaj të drejte qëndron ideja se, çdo i akuzuar ka të drejtë të mbrojë vetveten dhe, pavarësisht nëse ka apo jo mbrojtës, atij duhet t’i krijohen mundësitë për të realizuar mbrojtjen e tij. Kjo e drejtë me rëndësi kushtetuese, ka qenë e kufizuar dhe krejt formale në legjislacionin procedural penal të para viteve 1990. Sot, funksioni procedural i mbrojtjes, i shpallur e garantuar nga Kushtetuta, është sanksionuar dhe konkretizuar në dispozitat e K.Pr.Penale, në normat që parashikojnë veprimet konkrete të subjekteve të procedimit, marrëdhëniet procedurale midis tyre, gjatë gjithë fazave të procesit penal.

Kjo garanci lind për të pandehurin, në momentin kur shfaqet funksioni i ndjekjes penale, në fazën e hetimit të çështjes penale, sepse që nga ky moment shkojnë paralelisht gjatë gjithë procesit penal, funksioni i akuzës dhe funksioni i mbrojtjes ndaj kësaj akuze. Funksioni i mbrojtjes, konsiston në tërësinë e veprimeve procedurale, që synojnë të kundërshtojnë pretendimet e organit të ndjekjes penale, të rrëzojnë ose lehtësojnë akuzën, ndaj dhe si një funksion procedural, mbrojtja përfshin si element të domosdoshëm, veprimtarinë e mbrojtësit, si përfaqësues i interesave të ligjshme të të pandehurit. Kjo e drejtë e këtij të fundit, për të realizuar mbrojtjen e tij nëpërmjet ndihmës së një personi të kualifikuar në këtë fushë, jo vetëm e orienton të pandehurin mbi mjetet procedurale që duhen përdorur, por përbën edhe një garanci të rëndësishme, për të qenë në mbrojtje të drejtave dhe e interesave të tij sa më efektive, siç e kërkon edhe Konventa e Kushtetuta.

Si një parim themelor i procedimit penal, në nenin 6 të K.Pr.Penale, parashikohet se:“I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë, ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme, i sigurohet mbrojtja falas me avokat.”<sup>96</sup>

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, është e qartë se mbrojtja, si një veprimtari procedurale e vetë të pandehurit, është një e drejtë e tij që ai e disponon. Në këtë kuptim, sipas Kushtetutës dhe K.Pr.Penale, i pandehuri “mund” por nuk detyrohet të mbrohet. Ai

<sup>95</sup>Kushtetuta e RSh-së, neni 31/b

<sup>96</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 6

nuk mund të detyrohet të ushtrojë të drejtat e tij, por është detyrë e organit procedues ta njohë të pandehurin me këto të drejta. Vetëm përjashtimisht, në kreun V të K.Pr.Penale, ku parashikohen dispozitat në lidhje me mbrojtësin e të pandehurit, në nenin 49/2 të tij thuhet se: “ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme për të pandehurin nën moshën 18 vjeç apo me të meta fizike a psikike”.<sup>97</sup>

Në pajtim të plotë me Konventën dhe Kushtetutën, në nenin 49/1 të K.Pr.P, të pandehurit, i cili nuk ka zgjedhur mbrojtës, por që kërkon të ndihmohet nga një i tillë, i caktohet një mbrojtës kryesisht nga organi procedues, në mënyrë që të realizojë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tij. Konventa dhe Kushtetuta, kanë vendosur mbi shtetin, detyrimin që t’i sigurojë të pandehurit mbrojtje ligjore falas, nëse ai nuk ka mjetet e mjaftueshme financiare për të marrë një avokat. Kushtetuta, në formulimin që i ka bërë kësaj të drejte, e ka tejkalar Konventën, sepse lejon caktimin e avokatit në çdo rast të pamundësisë financiare, kurse Konventa e kushtëzon me ekzistencën e interesave të drejtësisë.

Në fazën e hetimeve paraprake, është prokurori që i siguron të drejtën e mbrojtjes të pandehurit nëpërmjet një mbrojtësi të caktuar kryesisht sipas nenit 49/1 dhe 49/7 Kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen, paguhet nga shteti.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin Nr.31, dt.14.07. 1998, lidhur me pretendimin e palës kërkuese, se mbrojtja e të pandehurit nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, nuk mund të jetë efiçente për shkak se “shteti është palë kundërshtarë” në procesin penal, thekson se:

“Avokati, qoftë si detyrim ligjor, qoftë për shkak të etikës profesionale, e ka për detyrë të përdorë me ndërgjegje të plotë të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe aftësitë e tij profesionale për mbrojtjen e të pandehurit, njëlloj si në rastin kur zgjidhet prej vetë të pandehurit, ashtu edhe kur caktohet nga organi procedues”.<sup>98</sup>

Mbrojtësi në procesin penal, ka një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Mbrojtësi është një aktor i domosdoshëm në procesin e dhënies së drejtësisë. Personi nën hetim ose i pandehuri, nëpërmjet një mbrojtësi garanton respektimin e të drejtave që i njeh ligji dhe i jep besimin e zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor. Avokati për realizimin sa më efikas të mbrojtjes së të pandehurit, përdor të gjithë instrumentat ligjor që parashikohen në ligj.

---

<sup>97</sup> Kodi Procedurës Penale, neni 49/1

<sup>98</sup> Vendime të Gjykatës Kushtetuese të RSH 1997-1999, Botime Edlor, Tiranë

Nga sa më sipër, e drejta për të patur mbrojtës duhet të sigurohet edhe në mënyrë efektive, prandaj organi procedues nuk duhet të mjaftohet vetëm me caktimin e mbrojtësit, por edhe të ndërhyjë që ai të përmbushë detyrimet e tij. Sigurisht që detyra e mbrojtësit është të veprojë në interesin më të lartë të klientit të tij, në rastin tonë të të pandehurit, por gjithnjë në respektim të ligjit. Procesi i rregullt ligjor, merr përparësi dhe të gjithë aktorët që marrin pjesë në zhvillimin e këtij procesi, duhet të përdorin çdo instrument ligjor që i shërben atij. Mbrojtësit duhet t'i krijojnë të gjitha kushtet dhe mundësitë për realizimin e mbrojtjes. Kështu ai duhet të njihet me parë me gjithë aktet e dosjes hetimore apo gjyqësore, për aq kohë sa nuk dëmtohet procesi i hetimit apo gjykimit. Mbrojtësi duhet të njihet me çdo veprim procedural që ka lidhje me të mbrojturin prej tij. Mbrojtësit duhet t'i sigurohet takimi dhe komunikimi i lirë me të mbrojturin prej tij, të drejta ligjore këto që gjejnë vend gjerësisht në legjisllacionin tonë.<sup>99</sup>

Sipas K.Pr.Penale, i pandehuri ka të drejtën të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës, e parashikuar kjo në nenin 48/1 të tij. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij.

Në nenin 54/1 të K.Pr.Penale, parashikohet mbrojtja e disa të pandehurve nga një mbrojtës i përbashkët, por me kusht që mes të pandehurve të mos ketë papajtueshmëri interesash.

Ashtu siç e parashikon Kushtetuta, në nenin 31/ç të saj, e drejta e komunikimit privatisht midis të pandehurit e mbrojtësit të tij, është sanksionuar edhe nga K.Pr.Penale, në nenin 50/2 të tij. Për më tepër kjo e drejtë është zgjeruar duke u parashikuar si detyrim ligjor i organit procedues: “Njoftimi paraprakisht i mbrojtësit të të pandehurit, për të qënë i pranishëm në kryerjen e veprimeve hetimore ku kërkohet prania e të pandehurit.”<sup>100</sup> Ky detyrim ligjor parashikohet edhe në nenin 309 dhe 310 të K.Pr.Penale, dispozita që sanksionojnë se mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të jetë i pranishëm në qyrrje, në kontrollet, në sekuestrimet e kryera nga organi procedues, në bazë të dispozitave të K.Pr.Penale. Sipas K.Pr.Penale, mbrojtësi konsiderohet palë në procesin penal dhe gëzon të gjitha të drejtat procedurale që ky legjisllacion parashikon për to. Për të ndaluar çdo ndërhyrje arbitrare në ushtrimin e rregullt të detyrës nga ana e mbrojtësit dhe për të garantuar të drejtat e të pandehurit, K.Pr.Penale parashikon një sërë garancish për mbrojtësin në nenin 52 të tij.

---

<sup>99</sup>Komiteti Shqiptar i Helsinkit.(2006), *Raporti i të Drejtave të Njeriut në Shqipëri (1997 – 2003)*, Tiranë

<sup>100</sup> K.Pr.Penale, neni 50/2 i tij

### **3.2.4 E drejta e të pandehurit për të kërkuar marrjen e provave**

Një nga të drejtat që sanksionon parimin e barazisë së palëve gjatë procesit penal, është e drejta e të pandehurit për të kërkuar marrjen e provave. Kjo e drejtë gjen afirmimin e saj në KEDrNj, Kushtetutë dhe K.Pr.Penale. Referuar K.E.Dr.Nj., kjo e drejtë sanksionohet në nenin 6/3 (d) të saj, e cila përcakton se:

“ Çdo i akuzuar ka të drejtë që:  
.....d) të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve që e shfajësojnë në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës”<sup>101</sup>

Ndërsa Kushtetuta e sanksionon këtë të drejtë në nenin 31/d të saj, i cili përcakton se:

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:  
.....d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve, dhe të personave të tjerë të cilët mund të sqarojnë faktet;”<sup>102</sup>

Gjykata Europiane ka theksuar se një të akuzuari, sipas qëllimit të dispozitës së Konventës, duhet t’i jepet mundësia e përshtatshme dhe e duhur, për të kundërshtuar dhe për të marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, megjithatë kjo Gjykatë e ka trajtuar këtë të drejtë të të pandehurit, si një kërkesë që lidhet ngushtësisht me procedurën para gjykatës.

Duhet të theksojmë se, në formulimin e nenit 6/3 (d) të Konventës cilësohet edhe parimi i barazisë së palëve në procesin penal, sepse Konventa kërkon që t’i jepen të pandehurit mundësi të njëjta me ato të akuzës në thirrjen e pyetjes e dëshmitarëve. Ndërsa po t’i referohemi Kushtetutës sonë, ajo nuk ka bërë dallim mes dëshmitarëve të akuzës apo mbrojtjes, por lejon thirrjen e çdo dëshmitari që mund të sqarojë faktet objekt procedimi. Kjo e drejtë e të pandehurit është edhe kërkesa e fundit e nenit 31 të Kushtetutës, si një e drejtë substanciale e të pandehurit në procesin penal, cënimi i së cilës e kthen këtë të fundit në një proces të parregullt ligjor.

Sipas K.Pr.Penale, gjatë fazës së hetimit të çështjes penale, pasi i pandehuri e ka marrë këtë cilësi pra i është komunikuar akuza, i njihet e drejta të sqarojë pozitën e tij. Me këtë kuptojmë të drejtën e tij, për të kërkuar kryerjen e atyre veprimeve proceduriale, që kanë për qëllim të rrëzojnë akuzën ndaj tij, të lehtësojnë përgjegjësinë penale të tij apo të vërtetojnë pafajësinë e tij. Me fjalë të tjera, K.Pr.P, nëpërmjet kësaj të drejte, i garanton të pandehurit realizimin efektiv të së drejtës së tij të mbrojtjes në procesin penal dhe

<sup>101</sup> *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut*, neni 6/3, Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare.(2010), botim i Qendrës Publikimeve Zyrtare, Qershor

<sup>102</sup> Kushtetuta e RSh-së, neni 31/d

veçanërisht në fazën e hetimeve paraprake ku, “lufta midis këtyre dy subjekteve proceduriale”, prokurorit dhe të pandehurit është e ashpër për zbulimin e të vërtetës dhe vënies para përgjegjësisë penale të fajtorit. Për shkaqet e mësipërme, kur i pandehuri mendon se për sqarimin e pozitës së tij është e nevojshme thirrja dhe pyetja me cilësinë e dëshmitarit të një apo disa personave, që kanë dijeni lidhur me faktet konkrete të çështjes, ai ka të drejtë t’i kërkojë organit të procedimit thirrjen dhe pyetjen e këtyre personave si dëshmitarë për këto fakte. Gjithashtu ai ka të drejtë të kërkojë nga organi procedues, kryerjen e veprimeve të tjera hetimore si p.sh. eksperimenteve, ekspertimit etj<sup>103</sup>. Kështu në nenin 179/2 të K.Pr.Penale, citohet se:

“vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim si dhe të parashtrijë pyetje për ekspertin.”<sup>104</sup>

Në këtë kuptim, i pandehuri gëzon të drejtën që t’i paraqesë organit procedues kërkesën për marrjen e provave që kanë lidhje me çështjen, dhe që çmohet prej tij se kanë rëndësi për sqarimin e pozitës së tij. Çdo kërkesë të të pandehurit, organi procedues ka detyrimin kushtetues t’i japë zgjidhje ligjore, duke marrë vendimin përkatës për pranimin ose jo të saj, si dhe duke ia njoftuar atë të pandehurit. Në këtë mënyrë, ky i fundit mund të realizojë të drejtën e tij të ankimit.

### **3.2.5 E drejta e për t’u ndihmuar nga një përkthyes**

Në vazhden e të drejtave të pandehurit, merr në raste të veçanta vlerë të rëndësishme, e drejta për t’u ndihmuar nga një përkthyes, dhe këto janë rastet kur i pandehuri është shtetas i huaj. Kjo e drejtë gjen pasqyrimin e saj, në KEDrNj, Kushtetutë dhe K.Pr.Penale. Referuar nenit 6/3 (e) të Konventës, sanksionohet se :

“Çdo i akuzuar ka të drejtë:....e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në gjyq;”<sup>105</sup>

Ndërsa në Kushtetutë kjo e drejtë, ka këtë përmbajtje në nenin 31/c të saj: “Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;”<sup>106</sup>

<sup>103</sup> Summers, J.S. (2007) *Fair trials: the European Criminal Procedural Tradition and the European court of Human Rights (Criminal law)-The Rights of the defence* -, North America: Hart Publishing, pg. 61-82

<sup>104</sup> K.Pr.Penale, neni 179/2 i tij

<sup>105</sup> KEDrNj, neni 6/3(e)

<sup>106</sup> Kushtetuta e RSh-së, neni 31/c

Referuar K.Pr.Penale, në përshtatje me dispozitat e mësipërme në nenin 8/2 të tij sanksionon: “Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe me anën e përkthyesit kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit”.<sup>107</sup>

Në çështjen Kamasinski kundër Austrisë, Gjykata Europiane theksoi se:

“E drejta e shpallur në nenin 6/3 (c) të Konventës, për ndihmën falas të një përkthyesi, gjen zbatim jo vetëm për deklaratat gojore të bëra në seancë gjyqësore, por edhe për materialet dokumentare dhe procedurat paragjyqësore”.<sup>108</sup>

K.Pr.P e trajton këtë të drejtë në një seksion të veçantë (neni 123-127), megjithatë duhet të theksojmë se: Ndihma e përkthyesit duhet të sigurohet gjatë gjithë procesit penal, sepse në disa raste të caktuara, përkthimi siguron realizimin me efektivitet të së drejtës për t’u informuar mbi akuzën. E drejta për t’u ndihmuar nga një përkthyes, sipas dispozitave të K.Pr.P përbën një detyrim primar për organin procedues dhe ka rëndësi thelbësore për procesin penal, por s’mund të njësohet me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit. E thënë ndryshe, nuk mund të refuzohet caktimi i një përkthyesi, me arsyetimin se i akuzuari merr dijeni për veprimet proceduriale nëpërmjet mbrojtësit të tij, edhe nëse gjyqtari, prokurori, oficeri i policisë gjyqësore apo pjesëmarrësit e tjerë në procedim e njohin gjuhën që flet i akuzuari (neni 123/3). Si Konventa ashtu dhe Kushtetuta përdorin termin “falas”, që do të thotë se edhe kur i pandehuri deklarohej fajtor, shpenzimet e bëra për përkthimin i mbeten shtetit që nga fillimi i çështjes e deri në përfundimin e saj. E drejta për t’u ndihmuar nga një përkthyes, si çdo e drejtë tjetër e të pandehurit, kërkon nga organi procedues, sigurimin e kësaj të drejte në mënyrë efektive. Autoriteti procedues, nuk mund të mjaftohet vetëm me caktimin e përkthyesit, por duhet që të kontrollojë dhe verifikojë herë pas here përmbushjen e këtij detyrimi në mënyrë profesionale nga përkthyesi. Ndaj dhe në K.Pr.P. janë parashikuar ndalimet për ushtrimin e detyrës së përkthyesit në nenin 124 si dhe përgjegjësia e tij për përkthim të rremë, neni 126 dhe neni 308 K.Pr.Penale.

Trajtuam pesë kërkesat specifike për procesin penal dhe veçanërisht për fazën e hetimeve paraprake të parashikuara nga Konventa dhe Kushtetuta si dhe të konkretizuara në K.Pr.P. Këto kërkesa përbëjnë dhe standartin minimum të të drejtave themelore të të pandehurit që

---

<sup>107</sup>Kodi Procedurës Penale, neni 8/2

<sup>108</sup>Kamasinski kundër Austrisë, 9783/82, 19 Dhjetor 1989

në fillimet e procesit penal, dhe sidomos përbëjnë një detyrim të padiskutueshëm për organet e procedimit të shteteve anëtare që kanë ratifikuar Konventën.

### **3.3. Të drejtat të tjera të të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake, si garanci për një proces të rregullt ligjor**

Legjislacioni penal përveç të drejtave të përmendura më lart, garanton dhe i njeh të pandehurit në procesin penal edhe një sërë të drejtash të tjera, të cilat plotësojnë kornizën e një procesi të drejtë, të rregullt e të paanshëm. Pa ekzistencën e këtyre dispozitave ligjore, të cilat rregullojnë pozitën ligjore të të pandehurit dhe respektojnë parimet bazë të së drejtës penale, nuk mund të themi se kemi një sistem që garanton drejtësi dhe shpall ligjshmëri. Kuadri ligjor i cili referon të drejtat e të pandehurit në fazën e hetimit nuk do të ishte i plotë, nëse nuk do të përfshinte në tërësinë e tij të drejtat që vijonë :

#### ***3.3.1 E drejta e të pandehurit për të kërkuar përjashtimin e prokurorit të çështjes penale apo oficerit të policisë gjyqësore***

Për të siguruar hetimin me objektivitet të çështjes penale dhe shmangien e çdo veprimi arbitrar të personit të ngarkuar nga ligji (prokurorit) për kryerjen e veprimeve hetimore, K.Pr.P, e ka parashikuar këtë të drejtë të të pandehurit në nenet 26 dhe 27 të tij. Të drejtën e përjashtimit, i pandehuri mund ta kërkojë vetëm kur ekzistojnë shkaqet e përligjura të parashikuara nga nenet 16 dhe 17 të K.Pr.P.<sup>109</sup> si p.sh.: interesi në zgjidhjen e çështjes; pjesëmarrja në të njëjtën çështje si dëshmitar, ekspert; kur ka dyshime në paanësinë e tij etj. Kur prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore, për një arsye apo tjetër, është i interesuar për mënyrën e përfundimit të çështjes, pra kur konstaton një nga shkaqet ligjore për përjashtimin e tij nga procedimi, duhet të paraqesë vetë kërkesë tek prokurori më i lartë, për të kërkuar dorëheqjen e tij nga hetimi i kësaj çështje penale. Ky është një kusht i dosmosdoshëm për të patur hetime objektive, ndaj dhe ligjvënësi i ka krijuar mundësinë ligjore të pandehurit, ta ushtrojë këtë të drejtë në rastet kur prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore, nuk kërkojnë heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale. Këtë të drejtë i pandehuri e ushtron në çdo kohë, pa asnjë kufizim, mjafton që çështja të jetë në fazën e hetimeve paraprake. Kërkesën e përjashtimit, i pandehuri ia paraqet drejtuesit të prokurorisë, i cili pasi e shqyrton, i njofton vendimin e argumentuar në mënyrë që t'i jepet mundësia e kundërshtimit tek Prokurori i Përgjithshëm .

---

<sup>109</sup>Nenet 16 dhe 17 të K.Pr.Penale, parashikojnë rastet standart në të cilat mund të kërkohej përjashtimi i prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore

### ***3.3.2 E drejta e kundërshtimit të vendimeve të prokurorit dhe veprimeve të oficerit të policisë gjyqësore***

Në vazhden e të drejtave të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, një vend të rëndësishëm zë dhe e drejta e të pandehurit për të kundërshtuar vendimet e prokurorit apo veprimet e oficerit të policisë gjyqësore. Kjo e drejtë sanksionohet në nenin 278/1 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “gjatë hetimeve paraprak, për rastet e parashikuara ngaligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private vendos gjykata”.<sup>110</sup> Nëpërmjet kësaj dispozite, legjislacioni ynë procedural penal i ka atribuar gjykatës, kompetencën për të vendosur mbi kërkesat e palëve gjatë kësaj faze, duke patur parasysh rolin e arbitrit dhe funksionin e zgjidhjes së çështjes me paanësi prej saj, për të shmangur çdo vendim apo veprim të njëanshëm të prokurorit të çështjes, nëpërmjet kontrollit të ushtruar prej saj kur palët e kërkojnë. Kontrolli i gjykatës mbi hetimet paraprake është një garanci për respektimin e lirive dhe të drejtave të individit në këtë fazë të procedimit. Ky kontroll ushtrohet nga i njëjti gjyqtar i caktuar për çdo rast konkret, dhe jo nga një gjyqtar i ngarkuar vetëm me këtë detyrë siç parashikohet në disa legjislacione proceduriale të vendeve të tjera, i cili quhet “gjyqtar për hetimet”.<sup>111</sup>

Dispozita e mësipërme, i jep të drejtë të pandehurit të bëjë ankim kundër vendimeve të prokurorit që shkelin apo çënojnë të drejtat e tij. Ky ankim paraqitet në gjykatë, për rastet e parashikuara shprehimisht në ligj, siç janë: ankimi kundër vendimit për vlerësimin e sekuestros nga prokurori, neni 301/2 K.Pr.P, ankimi kundër vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve neni 325/1 K.Pr.P, etj. Për të gjitha rastet e tjera, kur veprimet e prokurorit shkelin të drejtat e të pandehurit ky i fundit ankimin e paraqet tek prokurori më i lartë, ndërsa veprimet e oficerit të policisë gjyqësore ankimohen tek prokurori i çështjes, i cili i ka deleguar këto veprime. Ankimi i paraqitur kundër veprimeve të prokurorit të çështjes dhe oficerit të policisë gjyqësore, ndryshon nga kërkesa për përjashtimin e tyre, sepse qëllimi i ankimit, është rivendosja e një të drejte të të pandehurit, e cila sipas tij i është mohuar, por nuk passjell detyrimisht përjashtimin e tyre. K.Pr.Penale nuk i ka përcaktuar shprehimisht rastet e shkeljes së këtyre të drejtave, por mjafton që me veprimet proceduriale që kryen prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore, të çënojnë apo t'i mohojnë

---

<sup>110</sup>Kodi Procedurës Penale, neni 278/1

<sup>111</sup> Bergman, P. & Berman, S. (2015) *The criminal law Handbook, know your rights, survive the system (Fundamental trial rights of the defense)*, USA, pg. 351-374



të pandehurit një prej të drejtave të tij të parashikuara nga ky kod, dhe ky i fundit ka të drejtën e ankimit ndaj këtyre veprimeve. K.Pr.Penale nuk shprehet për formën dhe mënyrën se si duhet ndërtuar ankesa, megjithatë, mjafton që i pandehuri në ankesë të argumentojë shkeljen e së drejtës së tij. Pavarësisht nga niveli i dobët i argumentimit, apo forma verbale e ankimit, organi kompetent është i detyruar ta shqyrtojë atë. Ankimi i të pandehurit mund të jetë për shkak të refuzimit të pyetjes së një dëshmitari, të refuzimit për marrjen e një prove materiale, për mënyrën e marrjes në pyetje të të pandehurit etj. Organi kompetent të cilit i është paraqitur ankesa, është i detyruar ta shqyrtojë atë, dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendosë pranimin ose jo të saj duke i njoftuar këtë vendim të pandehurit.

### ***3.3.3 E drejta e të pandehurit për t'u njohur me të gjitha materialet e çështjes penale në përfundim të hetimit***

I pandehuri gjatë fazës së hetimeve paraprake, pamvarësisht rolit të tij aktiv në hetim, si mbledhja e provave, dhënia e deklarimeve apo të drejta të tjera procedurale që i'a garanton ligji, ai nuk ka të drejtë të njihet me të gjitha aktet hetimore deri në përfundim të hetimit. Pikërisht kjo e drejtë e të pandehurit, është sanksionuar në nenin 327 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “Prokurori pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë”.<sup>112</sup>

Nga dispozita e mësipërme rezulton se, me përfundimin e hetimeve, çdo veprim i mëtejshëm procedural apo qoftë edhe kalimi i çështjes në fazën e gjykimit, kushtëzohen nga një detyrim ligjor i vendosur për prokurorin e çështjes dhe që është “e drejta e të pandehurit për t'u njohur me materialet e çështjes”.Pasi ka arritur në mendimin përfundimtar se provat e grumbulluara nga hetimi i çështjes penale, provojnë kryerjen e veprës penale nga i pandehuri, prokurori vendos përfundimin e hetimeve dhe është i detyruar ligjërisht të kryejë këto veprime procedurale :

1. Njofton të pandehurin se hetimet kanë përfunduar dhe se të dhënat e mbledhura janë të mjaftueshme për dërgimin e çështjes në gjyq.
2. I shpjegon të pandehurit se ka të drejtë të njihet me materialin hetimor dhe të shqyrtojë gjithë zhvillimin e çështjes.

---

<sup>112</sup>Kodi Procedurës Penale, neni 327

3. E njeh të pandehurin me të drejtën për të parashtruar kërkesat që ai mund të ketë lidhur me plotësimin e hetimeve, pasi të ketë shqyrtuar materialin hetimor.
4. I krijon mundësinë të pandehurit për të patur në dispozicion gjithë materialin hetimor dhe kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e tij.
5. Mban procesverbal për kërkesat e të pandehurit.
6. Jep vendim për refuzimin e kërkesave të të pandehurit kur nuk i gjen të drejta ato, ose plotëson hetimet sipas kërkesës së tij.
7. Përpilon relacionin përkatës dhe vendos sipas rastit pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë.

Është fakt se, kryerja e veprimeve të mësipërme nga prokurori përbën një detyrim ligjor të tij dhe njëkohësisht një të drejtë thelbësore për të pandehurin, sepse vetëm njohja e plotë me çdo material në ngarkim të tij, i mundëson atij sigurimin e një mbrojtjeje reale dhe efektive. Kjo njohje nuk ka kufizim në kohë, ajo mund të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme për të pandehurin për tu njohur plotësisht me materialin hetimor, me kusht që këtë të drejtë të mos e shpërdorojë. Në të kundërt, organi procedues ka të drejtë që, në përshtatje me nivelin intelektual të të pandehurit dhe me volumin e dosjes, t'i caktojë një afat të mjaftueshëm për shqyrtimin e materialit të çështjes. Në rast se i pandehuri nuk është në gjendje të kuptojë materialet e çështjes, prokurori është i detyruar t'i vijë në ndihmë atij për sqarimin e tyre. Njohja e materialit të çështjes penale në përfundim të hetimit, nuk bëhet vetëm për ato materiale me të cilat i pandehuri nuk është njohur më parë, por për të gjithë materialin, pavarësisht nëse ai është njohur ose jo më parë. E theksojmë këtë, sepse në praktikën hetimore ka patur raste kur prokurori me justifikimin “për të mos humbur kohë, se i pandehuri për një pjesë të materialit hetimor është njohur më parë” ( siç janë procesverbalet e pyetjes së tij, ballafaqimet e tij me dëshmitarë të ndryshëm ), nuk i ka vënë në dispozicion të pandehurit edhe këto materiale, ose është mjaftuar me njohjen e tij në mënyrë formale. Është e kuptueshme që një praktikë e tillë është e gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Pavarësisht se për të pandehurin këto materiale janë të njohura më parë ( siç mund të jenë thëniet e tij ), ai i njeh këto materiale të shkëputura nga njëra-tjetra, prandaj dhe mund të mos jetë në gjendje të asimilojë përmbajtjen e tyre e të bëjë lidhjen me materialet e tjera, po të kemi parasysh këtu edhe shkallën e nivelit intelektual të tij, kjo lidhje bëhet më e vështirë. Në rastet kur në një çështje penale janë disa të pandehur ka lindur pyetja : Nëse këta persona duhet të njihen

vetëm me materialet në ngarkim të tyre apo me të gjithë materialin e çështjes, d.m.th edhe me materialet në ngarkim të të pandehurve të tjerë? Në këto raste, i pandehuri duhet të njihet me atë material që e ngarkon atë me përgjegjesi penale, dhe jo me materialin hetimor të të pandehurve të tjerë, kur nuk ka lidhje me të. E themi këtë, se qëllimi i njohjes me materialin në ngarkim të tij, është për t'i dhënë atij mundësinë të realizojë të drejtën e mbrojtjes, ndaj ky i pandehur nuk ka pse të njihet me materiale hetimore që nuk e ngarkojnë atë penalisht.<sup>113</sup> Me vënien në dispozicion të materialit hetimor të pandehurit për njohje, kanë përfunduar të gjitha veprimet hetimore të prokurorit ndaj të pandehurit për të vërtetuar fajësinë e tij. Që nga ky moment prokurori nuk ka të drejtë të ndërmarrë asnjë veprim hetimor tjetër ndaj të pandehurit dhe as ta pyesë atë rreth fajësisë së tij gjatë njohjes me këtë material, sepse veprime të tilla nuk gjejnë mbështetje në K.Pr.Penale. Nëse prokurorit do ti lindë nevoja e sqarimit domosdoshmërisht të një fakti të caktuar që ka lidhje me çështjen, është e detyrueshme që i pandehuri të vihet në dijeni për këtë, me kush që pas sqarimit të këtij fakti, i pandehuri të njihet tërësisht me materialet e çështjes penale. Pasi është njohur me materialet e çështjes i pandehuri ka të drejtë të kërkojë dhe plotësimin e hetimeve nëpërmjet kryerjes së veprimeve të tjera hetimore (eksperimente, marrje e dokumentave në instanca të ndryshme, thirrje dëshmitarësh ), kur ai mendon se janë të nevojshme për të sqaruar pozitën e tij. Këto kërkesa i pandehuri ia njofton prokurorit, i cili i shënon në procesverbalin e përfundimit të hetimeve. Prokurori është i detyruar ta marrë në shqyrtim kërkesën e të pandehurit dhe të vendosë plotësimin e hetimeve ose refuzimin e kërkesës, duke e argumentuar atë si dhe duke vënë në dijeni të pandehurin. Të drejtën e njohjes me materialet hetimore në përfundim të hetimit, i pandehuri e realizon vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij, ç'ka sanksionohet në nenin 327 K.Pr.Penale. Kur i pandehuri nuk është gjetur, është fshehur apo arratisur dhe ndaj tij është nxjerrë nga prokurori vendimi i mosgjetjes, njohja me fashikullin e hetimit paraprak, realizohet nga mbrojtësi i tij i zgjedhur dhe kur nuk ka të tillë, nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga organi procedues.

---

<sup>113</sup> River, Ch. (2015) *Criminal law procedure. A background on the elements of crimes and the rights of defendants*, USA: CreateSpace Independent Publishing

### **3.4 Raste të praktikës gjyqësore lidhur me shkeljen e të drejtave të të pandehurit fazën e hetimeve paraprake**

Respektimi i të drejtave të pandehurit në çdo fazë të hetimit, mbart rëndësi të veçantë dhe garanton atë që ne shpesh e përkufizojmë « drejtësi ». Nëse këto garanci ligjore të të pandehurit nuk do të udhëheqin procesin ligjor, si pasojë do të sillnin cënimin e procesit dhe më tej të vendimeve penale. Më poshtë po ju paraqesim disa raste të praktikës gjyqësore, ku mosrespektimi i të drejtave të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, ka sjellë prishjen e vendimeve penale.

#### **Rasti I**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr.310, dt.21.11.2000 ka vendosur kthimin e akteve organit të Prokurorisë Shkodër me arsyetimin se :

“Gjykata çmon se kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet në seancë gjyqësore pasi është akt absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 128/c të K.Pr.P, për shkak të mosrespektimit të kërkesave të nenit 331/3 të K.Pr.P në lidhje me njoftimin e kërkesës për gjykim të pandehurit, duke mos i realizuar të pandehurit garancitë kushtetuese që i njeh neni 31/a,ç; neni 32/2 dhe neni 33 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ».<sup>114</sup>

#### **Rasti II**

Gjykata e Lartë me vendimin Nr.416 dt.13.06.2001 ka konstatuar shkelje të së drejtës së të pandehurit në procesin penal dhe ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Korçë me arsyetimin se:

“Si akuza fillestare ashtu edhe vendimi i mëvonshëm për ndryshimin e saj nuk i janë njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij dhe Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit nuk e kanë evidentuar një fakt të tillë, ndaj dhe kjo shkelje e dispozitave procedurale {neni 34,128/c i K.Pr.P} i bën vendimet e tyre absolutisht të pavlefshme. »<sup>115</sup>

#### **Rasti III**

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.102, dt.18.04.2002 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me arsyetimin se:

“nga materialet e dosjes rezulton se, nga data e atribuimit të veprës penale shtetasve Sh.Sh., I.N. dhe H.M. (prill ‘98) e deri në dërgimin e çështjes për gjykim (mars 2000), ka kaluar një periudhë kohe tej afatit 3 muajor të përcaktuar në nenin 323/1 të K.Pr.P. Në dosjen hetimore ndodhet vetëm vendimi datë 9.04.1999 për zgajtjen e afatit hetimor.

Në bazë të n.324/2 të K.Pr.P, prokurori mund të zgjasë afatin e hetimeve paraprake, por jo pasi të jetë plotësuar afati tre muajor i parashikuar në nenin 323/1 të këtij kodi, siç ka vepruar në

---

<sup>114</sup>Vendim gjyqësor Nr.310, dt. 21.11.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>115</sup>[www.gjykataelartë.gov.al](http://www.gjykataelartë.gov.al)

rastin konkret që ka marrë vendimin për zgjatjen e afatit hetimor rreth 8 muaj pas plotësimit të afatit tre mujor. Në rastin konkret, të gjitha veprimet dhe aktet procedurale të kryera pas kalimit të afatit tre mujor nga organi i akuzës, që i përkasin tre të pandehurve të mësipërm, janë absolutisht të pavlefshme, nuk kanë asnjë vlerë procedurale dhe për rrjedhojë nuk mund të përdoren (neni 128 i K.Pr.P.). Akte të tilla janë kërkesa për gjykim datë 14.03.2000, vendimi i dërgimit të çështjes për gjykim datë 14.03.2000, vendimet për njoftimin e akuzës të pandehurve.

Sa më lart, edhe veprimet e aktet e tjera procedurale të kryera e të hartuara nga gjykata, janë absolutisht të pavlefshme, pasi mbështeten në aktet e sipër përmendura që nuk kanë vlerë procedurale (n.131 i K.Pr.P.).

Meqënëse pavlefshmëria e këtyre akteve nuk mund të riparohet nga Gjykata e Apelit, Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet prishur dhe çështja duhet të dërgohet për rigjykim pranë po kësaj gjykate me një tjetër trup gjykues.<sup>116</sup>

#### **Rasti IV**

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.258, dt.21.10.2002 vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me arsyetimin se:

“Gjatë hetimeve paraprake nuk janë zbatuar drejt procedurat e mungesës lidhur me të pandehurin A.A., dhe nuk janë kryer të gjitha procedurat e kërkimit të parashikuara nga neni 140-142 të K.Pr.P.

Në kundërshtim me kërkesat ligjore, avokati i të pandehurit është pyetur si deklarues dhe deklarimet e tij kanë shërbyer si provë për t’u marrë nga prokurori “vendimi i mosgjetyes” së të pandehurit. Të gjithë të pandehurve sipas nenit 34/1 të K.Pr.Penale i’u është komunikuar akuza e Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit me qëllim përfitimi, e parashikuar nga neni 198/2 i K.Penal dhe, në pyetjen e tyre nga prokurori kanë dhënë shpjegime për këtë akuzë. Por, në kërkesën për gjykim dhe në vendimin e gjykatës, të pandehurit janë akuzuar e dënuar edhe për nenin 25 të K.Penal, si vepër penale e kryer në bashkëpunim. Si rrjedhim, të pandehurit janë dënuar edhe për një akuzë të re për të cilën nuk janë marrë të pandehur dhe nuk kanë dhënë shpjegime mbi mënyrën e bashkëpunimit. Në këto rrethana, vendimi i gjykatës është bazuar në akte absolutisht të pavlefshme dhe si i tillë ai është i pavlefshëm ».<sup>117</sup>

Nga sa më sipër, del qartë se shkelja e të drejtave të të pandehurit për t’u vënë në dijeni mbi ndryshimin e akuzës dhe mosrespektimi i rregullave në lidhje me njoftimin e të pandehurit kanë çuar në pavlefshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ato bazohen në akte absolutisht të pavlefshme, të marra në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale.

<sup>116</sup>Vendimi gjyqësor penal Nr.102, dt.18.04.2002 i Gj.Ap.Durrës

<sup>117</sup> Vendim gjyqësor penal, Nr. 258, dt. 21.10.2002 i Gj.Ap.Durrës

## Rasti V

Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr.4, dt. 7.02.2001, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se:

“Kërkuesi A.A. me vendimin e Gjykatës së Rrethit Elbasan, është deklaruar fajtor për veprat penale të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të K.Penal, dhe është dënuar përfundimisht me 24 vjet burgim.

Mbi ankimin e të gjykuarit, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, çështjen, mbi bazën e rekursit të paraqitur nga i gjykuari, e ka shqyrtuar në Dhomën e Këshillimit dhe ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se: “Rekursi nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale dhe se vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan dhe ajo e Apelit Durrës janë të drejta dhe të bazuara në ligj”.<sup>118</sup>

Nga gjykimi i kësaj çështje në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese konstatoi se në të tria shkallët e gjykimit, nga gjykatat e zakonshme vërehen shkelje proceduriale të cilat e bëjnë procesin të parregullt. Shkelje antikushtetuese janë bërë që në fazën e hetimit. Gjatë hetimit nuk është komunikuar akuza menjëherë e hollësisht, pasi organi i hetimit nuk ka caktuar mbrojtës që t’i komunikonte akuzën e të pandehurit i cili ishte në mungesë, duke shkelur kështu nenin 31/ç të Kushtetutës.

I pandehuri nuk është njohur me të gjitha materialet e çështjes në ngarkim të tij nga prokurori para se çështja të kalonte për gjykim. Kështu, gjashtë deklaratimet e personave që kanë dijeni për çështjen, nuk ishin në dosjen hetimore, kur prokurori njohu të pandehurin me materialet e çështjes. Këto prova janë paraqitur vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë pas disa seancave, me kërkesë të gjykatës. Në këtë vështrim është shkelur e drejta e mbrojtjes e të gjykuarve.

Konstatohet gjithashtu se, nga dt.27.07.1998 që është regjistruar çështja e të gjykuarit në organet e hetimit dhe deri në datën 1.02.1999 që është caktuar mbrojtësi, janë bërë një sërë veprimesh proceduriale pa praninë e mbrojtësit, ç’ka përbën shkelje të garancisë për realizimin në kohë të mbrojtjes (neni 31/b i Kushtetutës). Dosja hetimore ka kaluar për gjykim në datën 5.02.1999, d.m.th. 4 ditë pas pjesëmarrjes së mbrojtësit, ç’ka ka sjellë pamundësinë objektive në hetuesi për të realizuar mbrojtje efikase në kohë.

Nga materialet e çështjes nxirret konkluzioni se, Gjykata e Shkallës së Parë që e ka deklaruar fajtor të pandehurin, e ka marrë të mirëqënë akuzën, duke cënuar parimin e

---

<sup>118</sup>Vendime të Gjykatës Kushtetuese të RSh

prezumimit të pafajësisë (neni 6/2 i Konventës E.Dr.Nj dhe neni 4 i K.Pr.Penale.) Në këto dispozita parashikohet se, “çdo person i akuzuar për një shkelje të ligjit, prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”. Cënimi i këtij parimi të rëndësishëm procedural nga ana e gjykatës, tregon se nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor që shprehet qartë në qëndrimin e mbajtur nga gjykata ndaj alibisë së pretenduar nga i pandehuri, sipas të cilit, në kohën e krimit ndodhej në Greqi.

Gjykata Kushtetuese konkludon se, shkeljet procedurale të lejuara nga organi i akuzës dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë që ka deklaruar fajësinë e të pandehurit, nuk i ka korrigjuar as Gjykata e Apelit dhe as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Apelit, jo vetëm që nuk i ka konstatuar shkeljet e mësipërme, por ajo vetë ka bërë shkelje të rëndë procedurale, pasi nuk e ka siguruar paraqitjen e të pandehurit në gjykim, kur ai ka kërkuar me insistim të thirrej për t'u dëgjuar në atë Gjykatë.

Gjykata Kushtetuese përfundimisht konkludon se, gjykatat e të tria shkallëve kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës, e për rrjedhojë duhet të shfuqizohen.

Në vendimin e mësipërm Gjykata Kushtetuese ka konstatuar shkeljen e të drejtave të të pandehurit në fazën e hetimeve, që kanë të bëjnë me komunikimin e akuzës dhe caktimin e mbrojtësit kryesisht nga prokurori kur ai procedohet në mungesë, si dhe mosnjohjen e plotë të tij me të gjitha materialet në ngarkim të tij. Gjithashtu, në fazën e gjykimit, është konstatuar shkelje e parimit të prezumimit të pafajësisë nga gjykata e shkallës së parë në gjykimin e çështjes si dhe e mosrealizimit të thirrjes së të pandehurit për të qënë i pranishëm në gjykim nga Gjykata e Apelit. Të gjitha këto shkelje, janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si cënim i të drejtës kushtetuese të mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor.

## KAPITULLI IV : GARANCITË KUSHTETUESE TË TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT GJATË PROCESIT PENAL NË FAZËN E GJYKIMIT

### HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, burimi i parë dhe themelor i të drejtave në Shqipëri, ligji me fuqi më të lartë në hierarkinë e akteve ligjore në vendin tonë, në pjesën e dytë të saj sanksionon “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Në nenin 15 të saj, Kushtetuta shpall se:

“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit Juridik”. Ndërsa në nenin 42 sanksionon se: “Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj, nuk mund të çenohen pa një proces të rregullt ligjor”. “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj”.<sup>119</sup>

Këto dispozita kushtetuese dhe të tjerat në vazhdim të saj, përbëjnë katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të afirmuara këto në Kushtetutë, dhe kanë si qëllim të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, për shkak të vetë supremacisë që gëzon Kushtetuta në hierarkinë e ligjeve. Në këtë aspekt, si ligji themelor i shtetit, Kushtetuta garanton “paprekshmërinë e personit”, që do të thotë se individi jo vetëm i gëzon këto të drejta, por shteti merr përsipër detyrimin për t’i siguruar ato realisht. Ndaj edhe Kushtetuta e kushtëzon cënimin apo kufizimin e këtyre të drejtave, vetëm nëpërmjet “një procesi të rregullt ligjor.” Ky term në vetvete nënkupton një të drejtë “gjigande” që përfshin disa të drejta të tjera kushtetuese e ligjore, mbi bazën e të cilave krijohet dhe kushtëzohet vetë ekzistenca e “procesit të rregullt ligjor”. Të tillë janë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, si gjykimi i drejtë, publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, neni 30, prezumimi i pafajësisë, neni 31, garancitë e procesit penal, neni 32, e drejta e mosinkriminimit, neni 33, e drejta për t’u dëgjuar, neni 34, e drejta për ankim ndaj vendimit gjyqësor.

Nëpërmjet garancive të mësipërme, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka afirmuar standartet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë

---

<sup>119</sup>Kushtetuta RSh, neni 15, 42



të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e cila, në bazë të Kushtetutës, është bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, ç'ka parashikohet në nenin 17/2 të Kushtetutës.

#### **4.1 E drejta për një proces të rregullt ligjor, garanci e KEDNj e afirmuar në Kushtetutë dhe K.Pr.Penale**

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, ka gjetur pasqyrim dhe përshtatje të plotë në dispozitat kushtetuese për të pandehurin dhe udhëheq normat e së drejtës, përse i përket parimit universal të mbrojtjes së të drejtave të tij. Në nenin 6 të saj kjo Konventë sanksionon: “ të drejtën për një proces të rregullt ligjor” me dispozitën :

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për konfliktet dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuzë të natyrës penale të drejtuar kundër tij”.<sup>120</sup>

Pra vihet re se e drejta për një proces të rregullt ligjor është afirmuar edhe nga Kushtetuta në nenin 42/2 të saj. E drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikohet në nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut me këtë formulim:

“Çdokush ka të drejtë të barabartë të dëgjohet, drejtësisht e publikisht, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në mënyrë që të merret një vendim mbi të drejtat dhe detyrimet e tij apo dhe mbi akuzat penale të ngritura ndaj tij”.<sup>121</sup>

K.E.Dr.Nj., Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetuta, e sanksionojnë këtë të drejtë dhe i japin asaj një kuptim mjaft të gjerë. Referuar termit “proces i rregullt ligjor”, do të nënkuptojmë faktin se çdo person gëzon të drejtën e një procesi të rregullt ligjor. Nëse të drejtat e tij të parashikuara në Konventë dhe Kushtetutë janë cënuar, dhe ai është subjekt në një proces, atëherë atij i lind e drejta për të kërkuar një proces të rregullt ligjor. Në nenin 1 të Konventës sanksionohet se: “Palët e larta kontraktuese i sigurojnë çdo personi që ndodhet nën juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin i të kësaj Konvente”.<sup>122</sup>

Kjo përbën dhe fushën e zbatimit të nenit 6/1 të Konventës dhe nenin 42/2 të Kushtetutës. Të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këtë kontekst, do ta përkufizojmë si : “E drejta e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor, është tërësia e të drejtave apo garancive procedurale që i njihen atij gjatë procesit penal nga Konventa dhe Kushtetuta, të

---

<sup>120</sup> KEDrNj, neni 6

<sup>121</sup> Neni 10 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

<sup>122</sup> KEDrNj, neni 1

konkretizuara këto nga Kodi i Procedurës Penale”, përkufizim ky që rrjedh nga këto akte ligjore. Këto garanci, për të pandehurin do të ishin krejt formale, nëse nuk do të ekzistonte një sistem kontrolli i garantimit dhe zbatimit të këtyre të drejtave. Mekanizmat garantues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë:

1) Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat janë të detyruara të shqyrtojnë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt, të çdo akuze penale të ngritur ndaj një personi të caktuar, duke i garantuar atij të drejtat proceduriale që parashikon Konventa, Kushtetuta dhe K.Pr.P. për të, dhe që të marra së bashku, përbëjnë “të drejtën e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor”. Mundësitë ligjore për ta garantuar me efektivitet këtë të drejtë, janë më të mëdha, po të kemi parasysh se ekziston një sistem gjyqësor tri shkallësh, që i njeh Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë të drejtën për të korigjuar apo prishur vendimet e gjykatave më të ulta, nëse konstatojnë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

2) Gjykata Kushtetuese, e cila vepron si shkallë e katërt gjykimi, në bazë të nenit 131(f) të Kushtetures së Rsh., “kur vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve”, vetëm kur plotësohen këto dy kushte:

- a- Të jenë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor;
- b- të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.<sup>123</sup>

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim është mjaft e gjërë dhe e rëndësishme, sepse çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese jo vetëm bën interpretimin kushtetues dhe zgjidh përfundimisht ankesat e individëve në këtë drejtim, por prodhon efekte “erga omnes” për të gjithë dhe për rrjedhojë ka efektet e forcës së ligjit.

3) Gjykata Europiane, e cila është edhe “ruajtësja e zbatimit të Konvetës nga shtetet anëtare”, dhe juridiksioni i së cilës është i detyrueshëm për Shqipërinë që nga momenti i ratifikimit të kësaj Konvente.

Nga sa më sipër Konventa dhe Kushtetuta, jo vetëm parashikojnë një varg të drejtash për të pandehurin, por edhe marrin përsipër nëpërmjet mekanizmave të lartëpërmendur, të sigurojnë zbatimin e tyre.

---

<sup>123</sup> Kushtetuta Rsh., neni 131

Në përshtatje të plotë me Konventën dhe Kushtetutën, K.Pr.P ka zbërthyer dhe konkretizuar këto të drejta, duke i përsosur më tej garancitë e ofruara prej tyre për të pandehurin. Në këtë kuadër, K.Pr.Penale në nenin 1 të tij merr përsipër: “të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve në zbatim të Kushtetutës, duke siguruar një procedim të drejtë, të barabartë, e të rregullt ligjor.” Ndërsa në nenin 2 të tij, K.Pr.P kërkon:

“respektimin e normave proceduriale nga subjektet e procedimit penal, organet shtetërore dhe vetë shtetasit”, në mënyrë që të realizohen me efektivitet të drejtat e “te pandehurit” në procesin penal, të sanksionuara këto në K.Pr.Penale.<sup>124</sup>

Ekziston një pajtueshmëri e plotë e legjislacionit procedural penal me Konventën dhe Kushtetutën, pasi në themel të tij dhe të kërkesës për një proces të rregullt ligjor, qëndrojnë parimet dhe standartet ndëkombëtare bashkëkohore, për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Parime të tilla janë: parimi i pavarësisë së gjykatave (neni 3), parimi i prezumimit të pafajësisë (neni 4), parimi i mbrojtjes (neni 6), parimi i barazisë së palëve (neni 1 i K.Pr.P.) etj.

#### **4.2 Të drejtat themelore të të pandehurit në fazën e gjykimit të çështjes**

Me kalimin e çështjes në gjyq, i pandehuri merr cilësinë e pjesëmarrësit themelor, “të palës” në procesin gjyqësor. Që nga ky moment, në çdo veprim procedural që do të kryejë gjykata, si dhe në marrëdhëniet procedurale të krijuara midis saj, prokurorit dhe të pandehurit si palë në këtë proces, ka detyrimin ligjor që buron nga Konventa, Kushtetuta dhe K.Pr.P, për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës dhe 42 të Kushtetutës.

Neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, përcakton kërkesat themelore që ndërtojnë procesin e rregullt ligjor dhe që lidhen veçanërisht me organin që realizon dhënien e drejtësisë, “Gjykatën”, si dhe procedurën gjyqësore të shqyrtimit të çështjes prej saj. Sipas Nenit 6/1 të Konventës:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze penale të drejtuar kundër tij”<sup>125</sup>

Referuar nenit 42/2 të Kushtetutës, citohet se :

---

<sup>124</sup> K.Pr.Penale, neni 1,2 i tij

<sup>125</sup> KEDrNj, neni 1

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”.<sup>126</sup>

Të dyja këto dispozita, sanksionojnë elementet që duhet të përmbajë procesi i rregullt ligjor dhe që në fakt, përbejnë garanci apo të drejta për të pandehurin në këtë fazë procedurale të gjykimin, duke i garantuar gjykimin dhe zgjidhjen e çështjes, konform kërkesave të mësipërme, realizimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Garancitë e mësipërme konsistojnë në:

#### **4.2.1 Presumimi i pafajësisë**

Në nenin 6/2 të Konventës thuhet se: “Çdo person i akuzuar për një shkelje të ligjit, prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”.<sup>127</sup> Ky nen zbatohet për të gjithë personat “e akuzuar për një vepër penale”, dhe është i vlefshëm për të gjithë procesin penal, duke filluar nga momenti kur një person merr cilësinë e “të akuzuarit” apo të pandehurit. Parimi i prezumimit të pafajësisë, është një parim shumë i rëndësishëm për procesin penal dhe mishëron parimin themelor të shtetit të së drejtës.

Në vendimet e saj, Gjykata Europiane ka theksuar se ky parim është i detyrueshëm për t`u zbatuar jo vetëm nga gjykata, por edhe nga autoritetet e tjera publike. Gjykata ka arritur në këtë përfundim në gjykimin e çështjes *Allenet de Ribemont kundër Francës*, ku shprehet se:

“Në kohën e konferencës së shtypit në 29 dhjetor 1976, z.Allenet de Ribemont sapo ishte arrestuar nga policia dhe megjithëse nuk ishte akuzuar ende për ndihmë dhe mbështetje në vrasje me paramendim, arrestimi dhe ndalimi i tij në ruajtje në polici, përbënte pjesë të hetimeve gjyqësore të filluara disa ditë më parë nga një gjyqtar hetues në Paris, duke e cilësuar atë si një person “të akuzuar për një vepër penale” brenda kuptimit të n.6/2 të Konventës. Gjykata vëren se në rastin në fjalë, disa nga oficerët e lartë të policisë franceze e përmendin z.Allenet de Ribemont pa ndonjë rezervë, si një ndër nxitësit e një vrasjeje dhe bashkëfajtor në atë vrasje. Kjo përbënte haptazi shpallje të fajësisë së ankuesit që: së pari, e shtynte publikun të besonte se ai ishte fajtor dhe së dyti, paragjykonte vlerësimin e fakteve nga autoriteti kompetent. Ndaj si përfundim, ka patur shkelje të nenit 6/2 të Konventës. »<sup>128</sup>

Në interpretimin që i ka bërë Gjykata Europiane parimit të prezumimit të pafajësisë ka përcaktuar dhe qëllimet që ndjek ky parim të cilat janë:

- 1) Të mos nxitet opinioni publik dhe të mos i injektohen atij bindje të caktuara, të cilat, në një moment të mëvonshëm mund të kthehen në presion për gjykatën, dhe të influencojnë tek ajo.

<sup>126</sup> Kushtetuta e RSH., neni 42.2

<sup>127</sup> KEDrNj, neni 6/2

<sup>128</sup> *Allenet de Ribemont kundër Francës*, dt.10.02.1995, fq.16-17

2) Të mos paragjykohet personaliteti i një personi i cili mund të shpallet i pafajshëm, dhe kjo mund të dëmtojë interesat e tij në të ardhmen. Nga ana tjetër të mos çenohet as autoriteti dhe prestigji i vetë gjykatës, që ligjërisht mund ta shpallë këtë person të pafajshëm.

Në këtë drejtim Kushtetuta e R.Sh. ka avancuar më tej se Konventa, pasi shprehjen e diskutueshme “të provohet ligjërisht” e ka parashikuar në kuptimin “të provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë”<sup>129</sup>. Kjo shprehje ka në themel interpretimin që ka patur parasysh Gjykata Europiane, sepse si Kushtetuta ashtu dhe K.Pr.P., i atribuojnë gjykatës kompetencën ligjore për të vendosur përfundimisht me vendim gjyqësor, mbi fajësinë apo pafajësinë e një personi të akuzuar për një veprë penale. Ky parim i rëndësishëm është sanksionuar edhe në nenin 4 të K.Pr.Penale, duke i’u shtuar formulimit të nenit 30 të Kushtetutës, paragrafi me këtë përmbajtje: “Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”.

Parimi i prezumimit të pafajësisë, është parimi themelor i procedimit penal dhe lidhet ngushtësisht me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit dhe vetë pozitën e tij procedurale. Mbi këtë parim mbështeten gjithë dispozitat e K.Pr.Penale, të cilat përcaktojnë rregullat për marrjen dhe çmarrjen e provave, si nga organi i prokurorisë ashtu edhe nga gjykata. Respektimi i këtij parimi kërkohet që në fazën fillestare të procedimit penal, në atë të hetimeve paraprake, kur organi i prokurorisë merr vendim për marrjen e personit si të pandehur, mbi bazën e të dhënave që janë të mjaftueshme për të treguar fajësinë e tij dhe jo për ta cilësuar atë përfundimisht fajtor.

Gjykata në fazën e gjykimit të çështjes, vendosë për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, gjithmonë duke patur parasysh se, prezumimi i pafajësisë kërkon që, për të dhënë vendim dënimi, të ketë prova të padyshimta fajësie. Kjo do të thotë se barra e të provuarit të fajësisë, i takon organit të akuzës dhe, nëse i pandehuri nuk është në gjendje të kundërshtojë akuzën, kjo nuk provon fajësinë e tij. Edhe refuzimi i të pandehurit të flasë, nuk është shkak për ta quajtur fajtor. Ky qëndrim është mbajtur dhe nga Gjykata Europiane nëçështjen John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.08.02.1996.<sup>130</sup>

---

<sup>129</sup> Kushtetuta e Rsh., neni 30

<sup>130</sup> John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.08.02.1996. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate, nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e

Fajësia e të pandehurit në kryerjen e një vepre penale, nuk mund të bazohet në hamendje e supozime. Kur provat janë të dyshimta ose kur pas hetimit gjyqësor të gjithanshëm, versioni i akuzës nuk është i vetmi version që përjashton çdo version tjetër, i pandehuri nuk mund të deklarohet fajtor. Gjykata jep vendim dënimi, vetëm kur ekzistojnë prova të cilat vërtetojnë plotësisht akuzën dhe rrëzojnë prezumimin e pafajësisë së të pandehurit dhe jo kur mungojnë provat për të vërtetuar pafajësinë e tij. Ky parim ka fuqi edhe gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të dytë, sepse vetëm kur vendimi i fajësisë merr formë të prerë, i pandehuri konsiderohet fajtor. Me vendim të formës së prerë në këtë rast, kuptohet vendimi i Gjykatës së Apelit, ku përfundon procedimi i rregullt ligjor dhe fillon zbatimi i vendimit (në rastet kur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ankimohet në Gjykatën e Apelit). Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i këtij parimi në praktikë, është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit në të gjitha fazat e procedimit.

#### ***4.2.2 E drejta e mbrojtjes***

Si një kërkesë themelore e procesit të rregullt ligjor, i pandehuri e gëzon këtë të drejtë (sic kemi trajtuar më sipër) që nga momenti kur merr cilësinë si i tillë, e deri në përfundimin e gjithë procedurave gjyqësore, duke përfshirë edhe apelimet.

Të drejtën e mbrojtjes e kemi trajtuar në pjesën e temës që shtjellon të drejtat e të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake, por ajo që duam të theksojmë në lidhje me fazën e gjykimit, është se K.Pr.P ka parashikuar një sërë dispozitash, që përbëjnë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i “zhvillimit të gjykimit në praninë e të pandehurit në seancë gjyqësore”(nenet 350-352). Këto dispozita përcaktojnë rastet e gjykimit në mungesë të të pandehurit, pasi ky gjykim përbën një kufizim të së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit për shkaqet e përligjura të parashikuara nga ky kod. Megjithatë thelbi i së drejtës së mbrojtjes, i garanohet të pandehurit që gjykohet në mungesë, dhe konsiston në praninë e detyrueshme në seancë gjyqësore të mbrojtjesit të tij, qoftë ky i zgjedhur prej vetë të pandehurit apo i caktuar kryesisht nga gjykata. Konkretisht, në rastet kur i pandehuri nuk paraqitet në

---

prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal; mjafton të ekzistojë një arsyetim i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja.

seancën gjyqësore, pa patur shkaqe të ligjshme (neni 351), ka dhënë pëlqimin që shqyrtimi gjyqësor të bëhet në mungesë të tij, largohet nga salla e gjykimit, apo i fshihet gjykimit (neni 352), dhe në secilin prej këtyre rasteve i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, gjykata është e detyruar t'i caktojë atij mbrojtës kryesisht, për të garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave procedurale të tij.

Edhe Kushtetuta në nenin 33/1 të saj sanksionon se “kushdo ka të drejtë të dëgjohej para se të gjykohej”, por edhe nga kjo e drejtë kushtetuese ka një përjashtim që i referohet personave të cilët i fshihen drejtësisë (neni 32/2).<sup>131</sup>

#### ***4.2.3 E drejta për të marrë pjesë personalisht në gjykim***

Kjo e drejtë është sanksionuar nga Kushtetuta në nenin 33/1 të saj, megjithatë sipas nenit 32/2 “nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë”, rast në të cilin vetë Kushtetuta parashikon një kufizim të së drejtës për tu dëgjuar.

Ndërsa, K.Pr.Penale, për konkretizimin e dispozitave të mësipërme, në nenin 344 të tij thekson të drejtën e të pandehurit për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore. Për realizimin e kësaj të drejte, në nenet 132-143 janë përcaktuar rregullat për njoftimin e tij. Vetëm pasi të jenë zbatuar rigorozisht këto rregulla, mund të thuhet se i pandehuri ka marrë dijeni për ditën e gjykimit dhe, nëse nuk paraqitet, ka hequr dorë nga kjo e drejtë. Në rast të mosrespektimit të rregullave mbi njoftimin e të pandehurit, nuk mund të bëhet gjykim në mungesë të tij, sepse ky gjykim do të ishte haptazi i padrejtë. Kjo për shkak se, i pandehuri jo vetëm nuk do të kishte mundësi të parashtronte pretendimet e tij, por do të humbiste dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar për të cilin nuk do të kishte dijeni. Zhvillimi i gjykimit në mungesë në respektim të neneve 344, 349, 350, 351, 352 të K.Pr.Penale, nuk e shkel të drejtën e të pandehurit për të marrë pjesë personalisht në gjykim, si në rastin kur i pandehuri largohet nga salla e gjyqit dhe nuk ka pranuar të ketë mbrojtës (neni 344/4), ashtu dhe kur ai nuk paraqitet në seancë, ndonëse ka marrë njoftim dhe nuk ekzistojnë shkaqe të përligjura për mosparaqitjen e tij (neni 351), apo provohet se i pandehuri i fshihet gjykimit (neni 352/4). Në këto raste zhvillohet gjykim në mungesë të të pandehurit dhe ai përfaqësohet nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, apo në rast se nuk ka zgjedhur të tillë, nga mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata.

---

<sup>131</sup>Kushtetuta Rsh., neni 32/2

Gjykata Kushtetuese është shprehur me vendimin Nr.31 date 14.07.1998 se gjykimi në mungesë, nuk është antikushtetues dhe nuk e cënon të drejtën për një proces të rregullt ligjor me arsyetimin se:

“Garancitë procedurale penale që parashikon neni 8 i Ligjit Kushtetues mund të realizohen si nga i pandehuri ashtu edhe nga mbrojtësi i tij. Ky i fundit ka të drejtat që i ligji i njej të pandehurit (neni 50). Caktimi i mbrojtësit për të pandehurin e pagjetur bëhet nga organi procedues jo në mënyrë të pakushtëzuar, por vetëm pasi ky organ ti ketë konsumuar të gjitha obligimet që i ngarkon ligji për gjetjen e të pandehurit”.<sup>132</sup>

E drejta për të marrë pjesë personalisht në gjykim, është e rëndësishme për të gjitha shkallët e gjykimit. Këtë e ka theksuar Gjykata Europiane në gjykimin e një sërë çështjesh penale. Ajo ka konstatuar se gjykimi në mungesë në tërësinë e tij, nuk i cënon të drejtat e të pandehurit dhe nuk është në kundërshtim me Konventën. Por Gjykata Europiane ka rekomanduar që të zbatohen me rigorozitet hapat që parashikon ligji dhe që, gjykimi në mungesë të jetë vetëm përjashtimi dhe jo rregulli.

#### ***4.2.4 E drejta për të paraqitur prova dhe për të diskutuar mbi to***

Kjo e drejtë përbën thelbin e procesit kundërshtar dhe kjo rezulton nga kuptimi i përgjithshëm i një procesi të drejtë gjyqësor. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se palët nuk gëzojnë të drejtën që çdo provë e tyre të pranohet dhe të debatohet në gjykim, sepse gjykata nuk mund të pranojë apriori provat që ka lejuar me vendim. Palët gëzojnë të drejtën t’ia paraqesin provat gjykatës, gëzojnë të drejtën për të debatuar mbi këto prova dhe është gjykata ajo që do të vendosë në fund me arsyetim, nëse do ti pranojë ose jo këto prova.<sup>133</sup> Gjithashtu palëve duhet t’u sigurohet paraqitja, në fund të gjykimit, e konkluzioneve përfundimtare dhe analizës së provave të marra, madje duhet t’u jepet kohë për t’u përgatitur për këto, nëse e kërkojnë. Gjykata duhet të sigurohet që vetë palët të kenë mundësi të japin shpjegimet e tyre, edhe kur ato janë të përfaqësuara nga mbrojtësi.

Shtrojmë pyetjen: A e parashikon K.Pr.P këtë të drejtë dhe në standartin që e kërkon Konventa ?

Në nenin 356/2 të K.Pr.P parashikohet e drejta e të pandehurit dhe e mbrojtësit të tij, për të treguar faktet që synojnë të provojnë dhe të kërkojnë marrjen e provave. Këtë të drejtë i pandehuri e realizon pasi gjykata ka deklaruar hapjen e shqyrtimit gjyqësor ( neni 355 ) dhe i fton palët (prokurorin e të pandehurin ) të paraqesin kërkesat e tyre, në lidhje me marrjen

<sup>132</sup> Vendime të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 31, dt. 14.7.1998, Botime Edlor, Tiranë 2000

<sup>133</sup> Engel dhe të tjerët kundër Hollandës, 08.06.1976



e provave. Në bazë të nenit 357, gjykata pasi dëgjon palët jep vendim për provat që do të merren dhe shkakun e refuzimit për të tjerat.<sup>134</sup>Shohim se K.Pr.P është në përshtatje të plotë me kërkesat e Konventës, e cila parashikon garancitë minimale që duhet t'i sigurohen në një proces gjyqësor të pandehurit, kufi nën të cilin, shtetet anëtare nuk mund të zbresin.

Kodi ynë i Procedurës Penale, jo vetëm e parashikon këtë të drejtë por dhe e ka zgjeruar atë me garanci të tjera, për ta bërë sa më efektive realizimin e saj nga palët. Kështu në nenin 357/2 të K.Pr.P., parashikohet se palët mund të kërkojnë marrjen e provave edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, por vetëm kur argumentojnë se nuk kanë patur mundësi për t'i kërkuar ato më përpara. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të provave, për të realizuar më mirë parimin e kontradiktoritetit, në nenin 358 të K.Pr.Penale, theksohet e drejta e të pandehurit për të bërë deklarime në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor. Kryetari i seancës, e njeh të pandehurin me këtë të drejtë dhe e sqaron se këto deklarime, mund ti bëjë sa herë e çmon të nevojshme, në lidhje me deponimet e dëshmitarëve, shpjegimet e ekspertëve, si dhe për çdo provë që administrohet gjatë gjykimit. Megjithatë, kjo e drejtë është e kufizuar nga përmbajtja e deklarimeve, të cilat duhet të jenë brenda objektit të akuzës. Në rast të kundërt, të pandehurit i hiqet e drejta e fjalës kur ai nuk i përmbahet objektit të akuzës, pasi është lajmëruar më parë nga kryetari i seancës.

Qoftë nga kuptimi i përgjithshëm i procesit të drejtë, qoftë nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane, është pranuar se provat në gjykim duhet të merren në mënyrën e parashikuar nga ligji dhe, se nuk mund të përdoren provat që nuk janë marrë në këtë mënyrë. Kushtetuta e ka parashikuar në mënyrë të veçantë këtë detyrim: “Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme”<sup>135</sup>.

Gjykata Europiane ka theksuar se pranueshmëria e provave dhe veçanërisht e dëshmive, është në radhë të parë çështje që rregullohet nga legjislacionit kombëtar dhe si rregull i përgjithshëm u takon gjykatave të zakonshme të vlerësojnë dëshmitë e bëra para tyre.<sup>136</sup> Nisur nga ky fakt, detyra e gjykatës më të lartë nuk është të marrë vendim nëse deklaratat e dëshmitarëve janë pranuar siç duhet si provë, por më tepër të vërtetojë nëse procesi në tërësi, përfshirë mënyrën në të cilën merren dëshmitë, është i drejtë.<sup>137</sup>

---

<sup>134</sup> K.Pr.Penale, neni 357 i tij

<sup>135</sup> Kushtetuta e RSh, neni 32/2

<sup>136</sup> Van Mechelen dhe të tjerë kundër Hollandës, dt.23.04.1997

<sup>137</sup> Vendimi Nr.156 dt. 25.5.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Gjykata Europiane në çështjen e Krcmar dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, analizon se një palë në procesin gjyqësor, duhet të ketë mundësinë për t'u njohur me provat e paraqitura gjykatës, si dhe me mundësinë për të komentuar mbi ekzistencën e tyre, përmbajtjen dhe vërtetësinë në mënyrën e duhur dhe brenda një kohe të përshtatshme.<sup>138</sup>

Kodi i Procedurës Penale, ka parashikuar gjithashtu mënyrën dhe radhën e marrjes së provave në nenet 359-371 të tij. Ndërsa në nenin 380 të K.Pr.Penale, theksohet se: “Gjykata e bazon vendimin e saj vetëm në provat e marra dhe të verifikuara në shqyrtimin gjyqësor”<sup>139</sup>. Në titullin e katërt të Kodit të Procedurës Penale, është përcaktuar kuptimi i provës (neni 149), objekti i provave (neni 150), llojet e tyre si dhe mjetet e kërkimit të provës. Çdo e dhënë tjetër e marrë në kundërshtim me nenet e këtij Kodi, nuk përbën provë dhe nuk mund të përdoret si e tillë në gjykim.

Çështja “Lika dhe Laska kundër Shqipërisë”, është ndër çështjet e para penale që është dërguar dhe shqyrtuar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, për shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. GjEDrNj me vendimin e datës 20 prill 2010, konstatoi shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mënyrën arbitrare të marrjes dhe të vlerësimit të provës vendimtare të fajësisë së aplikantëve, paraqitjes për njohje dhe dëshmime okulare. Gjykata në arsyetimin e saj shprehet se :

“...Është një aspekt themelor i së drejtës për një gjyq të drejtë që procedimet penale, përfshi elementë të tillë të procedimeve që lidhen me procedurën të kenë barazinë e mjeteve në dispozicion të akuzës dhe mbrojtjes...”<sup>140</sup>

GjEDrNj e vazhdon arsyetimin e saj, duke konkluduar që e drejta për një gjyq kundërshtues, nënkupton në parim të drejtën e palëve që në një proces penal, të njihen dhe të komentojnë të gjitha aktet e paraqitura me cilësinë e provës<sup>141</sup>.

#### ***4.2.5 E drejta e mosinkriminimit të vetvetes dhe e drejta për të heshtur***

Megjithëse këto dy të drejta nuk përmenden shprehimisht në tekstin e Konventës, nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata Europiane i ka cilësuar ato si standarte

<sup>138</sup>Krcmar dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, dt. 03.03. 2000

<sup>139</sup> K.Pr.Penale, neni 380 i tij

<sup>140</sup> Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, Aplikim Nr. 123451/04 dhe 17605/04, dt. 20 prill 2010, Vendime të GjEDrNj

<sup>141</sup> Gjonaj(Saliu),E. (2014) *Rigjykimi i çështjes në zbatim të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut*, Tiranë: Revista Avokatia 8, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare

ndërkombëtare që ndodhen në themel të nocionit të një procedure të paanshme, sipas nenit 6 të Konventës.

E drejta e mosinkriminimit të vetvetes, veçanërisht presupozon që prokuroria për vërtetimin e akuzës ndaj të pandehurit, të mos mbështetet në dëshmi të siguruara nëpërmjet metodave të kërcënimit ose shtypjes në kundërshtim me vullnetin e të pandehurit. Dhe së dyti, kjo e drejtë ka të bëjë me respektimin e vullnetit të një personi të akuzuar për të heshtur.<sup>142</sup>

Këto të drejta janë njohur dhe nga Kushtetuta në nenin 32/1 të saj: “Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.”<sup>143</sup>

Garancitë që ofron shprehimisht kjo dispozitë kushtetuese janë : Të akuzuarit nuk mund t’i vijë asnjë pasojë nga fakti që ai nuk e pohon fajësinë e tij, sepse ky fakt nuk mund të përdoret në dhënien e vendimit nga gjykata dhe as të kombinohet me provat e marra prej saj ; Asnjë person nuk mund të akuzohet për dëshmi të rreme apo refuzim për të dëshmuar, nëse nuk ka treguar fajësinë e një të afërmi të tij. Çdo i akuzuar ka të drejtë të heqë dorë nga e drejta për të heshtur, por pohimet e tij mbi veprën penale të kryer, apo shpjegimet e tij duhet të vlerësohen në tërësi me provat e tjera (neni 152 K.Pr.P). Nga sa sipër, rezulton se një person nuk mund të deklarohet fajtor e të dënohet vetëm mbi bazën e pohimit të vetë atij. Heshtja e të pandehurit nuk mund të përdoret si provë e vetme apo kryesore, por mund të përdoret si provë e zakonshme në tërësinë e provave të tjera që formojnë bindjen e brendshme të gjyqtarit. Në bazë të Kodit të Procedurës Penale, në përshtatje me Konventën dhe Kushtetutën, këto të drejta i pandehuri i gëzon që nga momenti kur ai merr cilësinë si i tillë, derisa vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, qoftë ky vendim pushimi, pafajësie apo dënimi (neni 38/3). Pra, edhe gjatë fazës së gjykimit të pandehurit i njihet kjo e drejtë dhe në bazë të nenit 353 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të të pandehurit, kur nuk është paraqitur apo është deklaruar në mungesë, nëse prania e tij është e domosdoshme për marrjen e një prove , por jo për pyetjen e tij.<sup>144</sup>

Sipas Kodit të Procedurës Penale, thëniet e të pandehurit përbëjnë një ndër llojet e provave në procesin penal, por neni 166 thekson se i pandehuri pyetet vetëm kur :

- 1) e kërkon një gjë të tillë,

---

<sup>142</sup> Samaha, J. (2014), *Criminal Procedure (self – incrimination)*, Stamford: Library of Congress, pg. 284-315

<sup>143</sup> Kushtetuta e RSh, neni 32/1

<sup>144</sup> Kodi Procedurës Penale, neni 353 i tij

2) jep pëlqim kur kërkohet pyetja e tij .<sup>145</sup>

Në çdo rast, para se të fillojë pyetja e tyre, gjykata e njej të pandehurin me të drejtën për të mos u përgjigjur (të drejtën e heshtjes, neni 167/4).

#### **4.2.6 Barazia e palëve në procesin gjyqësor**

Ky është një ndër parimet kryesore që karakterizon procesin e drejtë dhe në thelb do të thotë që, të dyja palëve në gjykim t'u jepen mundësi e mjete të barabarta ligjore për të paraqitur çështjen, në mënyrë që asnjëra palë të mos vihet në disavantazh në raport me palën tjetër.

Gjykata Europiane e ka theksuar rëndësinë e madhe që merr ky parim në vendimet e dhëna prej saj, në të cilat shprehet se barazia e palëve kërkon që të dyja palët të vihen në kushte të barabarta, t'u ofrohen të njëjtat mundësi për dhënien e shpjegimeve para gjykatës dhe për të kërkuar marrjen prej saj të provave që disponojnë, të kenë po të njëjtat mundësi për t'u njohur me provat e njëra-tjetrës dhe që gjykata t'i vlerësojë këto prova në tërësinë e tyre, pa paragjykuar asnjërën prej tyre. Vënia në disavantazh e njëjës palë në raport me tjetrën, passjell dhe shkeljen e këtij parimi.

Kodi ynë i Procedurës Penale në gjithë dispozitat e tij, veçanërisht ato të gjykimit, i siguron të pandehurit të drejtën e barazisë së armëve.<sup>146</sup> Konkretisht, për çdo veprim procedural që kryen gjykata dhe ligji parashikon praninë e të dyja palëve, ajo është e detyruar t'i njoftojë si prokurorin edhe të pandehurin (neni 33/2), t'u japë mundësi të njëjta për t'u njohur me fashikullin e shqyrtimit gjyqësor (neni 335), të paraqesin kërkesa paraprake (neni 354), të kërkojnë marrjen e provave (neni 356), të parashitrojnë secila prej tyre konkluzionet përfundimtare (neni 378). Në lidhje me këtë të fundit, për vetë pozitën specifike që ka i pandehuri në procesin penal si dhe duke qenë se Kodi i Procedurës Penale, ka parashikuar prokurorin si subjektin që inicion shqyrtimin gjyqësor me akuzën e ngritur ndaj tij, për të balancuar të drejtat e tyre në procesin gjyqësor, të pandehurit i njihet e drejta e fjalës së fundit (neni 378/4).

Parimi i barazisë së palëve merr më shumë rëndësi, kur palë apo i interesuar drejtpërsëdrejti në përfundimin e çështjes është shteti. Kjo për shkak se shteti mund të përdorë mekanizma

<sup>145</sup> Kodi Procedurës Penale, neni 166 i tij

<sup>146</sup> Muçi, Sh. (2007), *E drejta penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Tiranë: Botimet Dudaj

që i disponon vetëm ai. Konkretisht, ligjet e Parlamentit mund të çenojnë këtë parim. Përmendim këtu Ligjin Nr. 8175, datë 23.12.1996. “Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, i cili për veprat penale të parashikuara nga nenet 5, 7-10, 12-14/2, 15-23/1, 24, 28-34, 37-40 caktonte dënime penale fikse. Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr. 13, datë 29.05.1997, vendosi të shpallë të papajtueshëm me Kushtetutën nenet e mësipërm të këtij ligji me arsyetimin se:

“parashikimi i sanksioneve fikse në normat e Ligjit Nr. 8175, bie ndesh me një sërë parimesh të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal, sidomos me mënyrën e caktimit të dënimit, me rrethanat lehtësuese e rënduese, të cilat kur konkurojnë vlejnë pa përjashtim për çdo vepër penale. Në këtë rast, sanksionet fikse eliminojnë mbrojtjen, përsa i përket përcaktimit të shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer e të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cinguar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë. Si rrjedhojë, dënimet fikse çenojnë të drejtat themelore të njeriut, të garantuara me parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë dhe si të tilla duhet të shfuqizohen.”<sup>147</sup>

### **4.3 Të drejtat të tjera të të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes penale, si garanci për një proces të rregullt ligjor**

#### ***4.3.1 E drejta e të pandehurit për t’iu drejtuar gjykatës për një akuzë penale***

Kjo e drejtë në interpretim të nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nënkupton të drejtën e aksesit në gjykatë që ka çdo person, ndaj të cilit është ngritur një akuzë penale, me qëllim që kjo gjykatë të jetë i vetmi organ, i cili do të vendosë për bazueshmërinë ose jo në ligj të kësaj akuze. Gjithashtu Gjykata Europiane lidhur me këtë të drejtë ka theksuar se, e drejta e aksesit në një gjykatë nuk duhet vetëm të ekzistojë, por të jetë edhe e efektshme. Kështu, mospagimi nga shteti i një avokati të pandehurit, i cili e dëshiron por nuk ka mjete financiare për ta shpërblyer atë, është konsideruar nga Gjykata Europiane si shkelje e nenit 6/1 të Konventës. Përveç kësaj Gjykata Europiane e të drejtave të njeriut ka përcaktuar edhe nocionin e termit “gjykatë”. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane, një gjykatë karakterizohet në kuptimin material të termit nga funksioni i saj gjyqësor, d.m.th çështjet që shqyrton brenda kompetencave të saj në bazë të shtetit të së drejtës dhe sipas procedurave të kryera në mënyrë të paracaktuar. Ajo duhet të përmbushë këto kërkesa:

- 1) Pavarësinë nga pushtetet e tjera, veçanërisht nga ekzekutivi,

---

<sup>147</sup>Vendim Nr. 13, datë 29.05.1997 i Gjykatës Kushtetuese të RSh, Botimet Edlor, Tiranë

- 2) Paanësinë nga palët në çështje,
- 3) Koha e qëndrimit të anëtarëve të saj në detyrë,
- 4) Garancitë e ofruara nga procedurat e saj.

Kushtetuta jonë përveç sanksionimit të “nje gjykate të pavarur dhe të paanëshme”, në nenin 42/2 të saj, në përshtatje me përcaktimet e nenit 6/1 të Konventës, në nenin 135 të saj përcakton organet që ushtrojnë pushtetin gjyqësor (Gjykatat e shkallës së parë, Gjykatat e Apelit, Gjykata e Lartë) dhe krijimine tyre vetëm nëpërmjet ligjit. Gjithashtu ajo përcakton procedurën e emërimit, të shkarkimit, kohën e qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve, e cila nuk mund të kufizohet.

Në bazë të nenit 145/1 të Kushtetutës: “gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”, ndërsa në nenin 144 parashikohet se: “gjykatat kanë buxhet të veçantë të cilin e administrojnë vetë”, duke mënjanuar kështu ndërhyrjen e ekzekutivit.<sup>148</sup>

Garantimi i trajtimit financiar të gjyqtarëve (neni 138), përvokueshmeria e tyre, papajtueshmeria e detyrës së gjyqtarit me çdo veprimtari tjetër shtetërore dhe imuniteti nga proçesi penal, të gjitha këto garanci të parashikuara nga Kushtetuta për Gjyqësorin, i sigurojnë atij pavarësinë nga pushtetet e tjara dhe paanësinë në gjykimin e çështjeve, sipas kërkesave të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut për konceptin e gjykatës.

Nga ana tjetër, në përputhje të plotë me Konventën dhe Kushtetutën, K.Pr.P në nenin 11 të tij përcakton “Gjykatën” si organin e vetëm që realizon dhënien e drejtësisë, duke e përforcuar më tej këtë përcaktim: “Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një vepre penale pa vendim të gjykatës”.<sup>149</sup>

K.Pr.Penale ka përcaktuar rregulla të hollësishtme për të siguruar paanësinë e gjykatës në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Kështu në nenet 15,16,17 të K.Pr.P janë parashikuar shkaqet që përjashtojnë gjyqtarin nga gjykimi i çështjes siç janë: interesi në procedim, dhënia e këshillave mbi objektin e procedimit, shfaqje e njëanshmërisë etj.

Të gjitha dispozitat e mësipërme, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e të pandehurit për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit (neni 18), realizojnë dhe garantojnë të drejtën kryesore të të pandehurit për shqyrtimin e akuzës në ngarkim të tij nga një Gjykatë e pavarur dhe e paanëshme, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>148</sup> Kushtetuta e R.Sh, neni 144 e 145 i saj

<sup>149</sup> K.Pr.Penale, neni 11 i tij

### 4.3.2 Përfundimi i procesit gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme

Neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut thekson: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...”<sup>150</sup>

Kjo është një tjetër kërkesë e rëndësishme e nenit 6/1 të Konventës, në funksion të një procesi të drejtë. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor nuk mund të jetë e pakufishme, sidomos kur bëhet fjalë për një proces penal që është i shoqëruar edhe me kufizimin e të drejtave dhe lirive të të pandehurit.<sup>151</sup> Ndaj Gjykata Europiane në vendimet e saj ka theksuar se ka një moment të caktuar në çdo proces gjyqësor, kur fillon të llogaritet “koha e arsyeshme” brenda së cilës duhet të ketë përfunduar ai.<sup>152</sup> Në lidhje me procesin penal, koha e arsyeshme e përmendur në nenin 6/1 të konventës, fillon të ecë që në çastin kur një person është “akuzuar”, d.m.th është marrë i pandehur (çështja Deweer dt. 27.02.1980). Në lidhje me përfundimin e “kohës së arsyeshme” në procesin penal, afati i caktuar nga neni 6/1 i konventës, përfshin tërë procesin në fjalë, apelimet, akuzat e reja dhe çdo procedurë tjetër, derisa të merret një vendim përfundimtar, i formës së prerë e i paankimueshëm.<sup>153</sup>

Kriteret për përcaktimin e kohës së arsyeshme janë:

- a) rrethanat e veçanta të rastit konkret,
- b) kompleksiteti i problemeve faktike ose ligjore të ngritura në çështje,
- c) sjellja e të pandehurit dhe e autoriteteve kompetente.

Edhe Kushtetuta në nenin 42/2 të saj, ka vendosur detyrimin kushtetues për organin procedues, që akuzat e ngritura ndaj një personi, të shqyrtohen dhe të vendoset për bazueshmërinë ose jo të tyre, “brenda një afati të arsyeshëm”. Ky detyrim i organit procedues, përbën një të drejtë kushtetuese për të pandehurin. K.Pr.Penale në përshtatje me nenin 6/1 të Konventës dhe nenin 42/2 të Kushtetutës, ka parashikuar “afatin e arsyeshëm”

---

<sup>150</sup> KEDrNJ, neni 6

<sup>151</sup> Nuala Mole and Catharina Harby, *The right to a fair trial [E drejta për një proces të drejtë gjyqësor]* (Udhëzuesi nr. 3 i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, 2006), faqe 24.

<sup>152</sup> Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, GjEDrNj, 23 tetor 2007, paragrafi 66, 67 dhe 77. Në rastin Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, GjEDrNj-ja fajësoi Shtetin për mosdhënien e një vendimi të formës së prerë dhe për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, duke deklaruar se duhet të kishte qenë detyrë e gjykatave shqiptare të identifikonin procedurat gjyqësore të lidhura me këtë çështje, dhe aty ku ta gjykonin të nevojshme, t’i bashkonin, t’i pezullonin ose të refuzonin hapjen e mëtejshme të procedurave të reja gjyqësore për të njëjtën çështje. Sipas kësaj Gjykate, një menaxhim më i mirë i procedurave gjyqësore të lidhura me këtë çështje, të zhvilluara paralelisht, do të kishte kontribuar pozitivisht për një sqarim të shpejtë të titullit të palës ankuese. Gjykata vëzhgoi se sistemi ligjor shqiptar nuk kishte siguruar një zgjidhje të veçantë, që mund të përdorej nga palët ankuese për të korrigjuar kohën e tejzgjatur të procedurave gjyqësore.

<sup>153</sup> Deweer kundër Belgjikës, GjEDrNj, 27 shkurt 1980, paragrafi 46. Gjykata europiane referon se gjykimi konsiderohet i përfunduar pas marrjes së një vendimi të formës së prerë

të hetimeve paraprake, i cili fillon jo nga data e marrjes së personit si i pandehur, por nga data në të cilën, emri i personit të cilit i është atribuar vepra penale, është shënuar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale. Brenda tre muajve nga kjo datë, prokurori duhet të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq, pushimin ose pezullimin e saj. Procedura për zgjatjen e këtij afati, parashikohet në nenin 324 të K.Pr.P, por gjithsesi, kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Në këtë aspekt, K.Pr.Penale, “standartin minimal” të kërkuar nga Konventa për fillimin e kohës së arsyeshme që nga momenti kur një person akuzohet, e ka siguruar më tej, duke konsideruar si çast fillimi, atë të datës në të cilën emri i një personi të caktuar shënohet në rregjistrin e njoftimit të veprave penale. Në këtë mënyrë, garantohet respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të personit të cilit i atribuohet vepra penale, të cilat që nga ky moment mund të jenë objekt i kufizimeve nga organi procedues.

Ndërsa kur çështja kalon në gjykim, K.Pr.Penale, nuk ka parashikuar shprehimisht një afat kohor të caktuar për përfundimin e saj, duke patur parasysh rrethanat e veçanta që mund të paraqiten për çdo çështje konkrete. Megjithatë, duke iu referuar dispozitave të tij, në nenin 342 parashikohet se “gjykimi duhet të zhvillohet i pandërprerë, dhe vetëm për arsye të veçanta, shqyrtimi gjyqësor mund të ndërpritet deri në 15 ditë.”<sup>154</sup>

Zbatimi i rregullit të “gjyimit të pandërprerë”, është kërkesë e respektimit të detyrimit kushtetues për shqyrtimin e çështjes penale brenda një afati të arsyeshëm, me qëllim përfundimin e procedimit në afate optimale, dhe garantimin e kësaj të drejte të pandehurit.

#### ***4.3.3 Seanca gjyqësore publike dhe shpallja e vendimeve gjyqësore***

Kërkesat përfundimtare për një proces gjyqësor të drejtë, kanë të bëjnë me natyrën publike të seancës gjyqësore dhe të shpalljes së vendimeve gjyqësore. Karakteri publik i procesit për organet gjyqësore i parashikuar në nenin 6/1 të K.E.Dr.Nj është i rëndësishëm për dy arsye:

**Së pari**, mbron pjesëmarrësit në gjykim, veçanërisht të pandehurin nga ndonjë padrejtësi e fshehtë jashtë kontrollit të publikut.

**Së dyti**, përbën një nga mjetet me anën e të cilit mund të ruhet besimi tek gjykatat.

Gjykata Europiane thekson se publiciteti i seancës gjyqësore kontribuon në arritjen e synimit të nenit 6/1 të Konventës, d.m.th në një gjykim të drejtë. Gjithashtu Gjykata Europiane në çështjen Axen kunder Republikës Federale të Gjermanisë, thekson se :

---

<sup>154</sup> K.Pr.Penale, neni 342 i tij



” karakteri i hapur i procedimeve përpara organeve gjyqësore që i referohet Nenit 6/1 mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikqyrje publike. Duke e bërë të dukshëm ushtrimin e drejtësisë, publiciteti kontribuon në përmbushjen e synimit të Nenit 6/1, për një proces të drejtë gjyqësor, garantimi i të cilit përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, brenda kuptimit të Konventës”.<sup>155</sup>

Edhe Kushtetuta në nenin 42/2 të saj, sanksionon të drejtën e një gjykimi publik, si parim themelor i procesit gjyqësor. Ndërsa në Kodin e Procedurës Penale, publiciteti i seancës parashikohet në nenin 339/1, sipas të cilit mosrespektimi i këtij detyrimi kushtetues e ligjor passjell pavlefshmërinë e saj.

Gjykata Europiane ka theksuar se, të gjitha shtetet anëtare të K.E, duhet t’i përmbahen këtij parimi të publicitetit të gjykimit, megjithatë sistemet legislative të tyre dhe praktikat gjyqësore, përcaktojnë fushën dhe mënyrën e zbatimit të tij, përsa i përket mbajtjes së seancave dhe shpalljes së gjykimeve. Kjo do të thotë që, pavarësisht nga rastet e parashikuara nga këto shtete për gjykimin jopublik, ky përbën vetëm një përjashtim dhe që vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të shpallet publikisht. Kushtetuta e sanksionon këtë detyrim për gjykatat në nenin 146/2 të saj, sipas të cilit: “vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”.<sup>156</sup>

Në nenin 6 të Konventës parashikohen rastet kur prania në sallën e gjykimit mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut.

Edhe në K.Pr.P, në nenin 399 sanksionohet se : “seanca gjyqësore është publike përndryshe quhet e pavlefshme”.<sup>157</sup> Rastet e përjashtimit nga parimi i përgjithshëm i publicitetit të gjykimit, janë parashikuar në nenin 340 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit:

“Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me dyer të mbyllura kur :

- a- publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror;
- b- nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;
- c- për mbrojtjen e sigurisë së dëshmitarëve ose të pandehurve;
- d- kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve”.<sup>158</sup>

Gjykata Europiane është shprehur se : “ shtetet kanë liri në zgjedhjen e formës me anën e së cilës vendimi do të bëhet publik”.<sup>159</sup> Në këtë kuptim, mosshpallja në seancë por depozitimi

---

<sup>155</sup>Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, 8.12.1983, paragrafi 25

<sup>156</sup> Kushtetuta e RSh, neni 146/2

<sup>157</sup> K.Pr.Penale, neni 399

<sup>158</sup> K.Pr.Penale, neni 340

<sup>159</sup>Sutter kundër Zvicrës datë 22.02.1984, fq. 14-15

në sekretari i vendimit të Gjykatës, duke patur kushdo të drejtë për të marrë kopje, nuk përbën shkelje të nenit 6/1 të Konventës.

Detyrimi i Gjykatës për shpalljen e vendimeve gjyqësor në seancë, pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor, është parashikuar në nenin 384 të Kodit të Procedurës Penale. Këto kritere ligjore njihen dhe përgjithësisht zbatohen drejt. Por gjendja aktuale e ndërtesave të Gjykatave të Shkallës së Parë, nuk krijon kushtet e nevojshme për një gjykim publik e solemn. Ka pak salla të përshtatshme për gjykim, ndaj shpeshherë gjyqet zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, në të cilat mund të qëndrojnë vetëm gjyqtarët dhe palët. Kështu në fakt gjykimi bëhet i mbyllur edhe pse deklarohet i hapur për publikun.

Duhet të theksojmë se, “e drejta për një proces të rregullt ligjor” që përmbledh kërkesat e nenit 6/1 të Konventës, si elementë të domosdoshëm të këtij procesi, ka një kuptim të gjërë dhe nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin atë administrativ dhe disiplinor. I njëjti interpretim vlen edhe për nenin 42 të Kushtetutës, i cili është në përshtatje të plotë me përcaktimet e nenit 6/1 të Konventës. Sa më sipër, kemi dhënë kuptimin e “të drejtës për një proces të rregullt ligjor”, duke u fokusuar vetëm tek procesi gjyqësor dhe konkretisht në procesin penal. Dhe kjo, për të veçuar garancitë procedurale që parashikohen për të pandehurin (neni 6/1 i Konventës) dhe mënyrën e përshtatjes dhe garantimit të tyre nga Kushtetuta dhe K.Pr.Penale.

Ndërsa, nëse i referohemi nenit 6/2 të Konventës, në përmbajtjen e tij ai sanksionon kërkesa specifike vetëm në lidhje me procesin penal. Këto kërkesa përbëjnë edhe të drejtat themelore të të pandehurit në procesin penal, të cilat i kemi trajtuar më sipër, dhe që përcaktojnë “standartin minimal” të garancive të tij në këtë proces, duke e detyruar çdo shtet anëtar në njohjen dhe respektimin e tyre nga legjislativi i brendshëm.

#### **4.4 Shqyrtimi i çështjes në Apel. Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit në ushtrimin e të drejtës së Apelit**

Me kalimin e çështjes në Apel, të pandehurit i njihet dhe edrejta të kërkojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Referuar nenit 427 të K.Pr.P:

“Kur një palë kërkon rimarrjen e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata n.q.s. çmon se një gjë e tillë është e nevojshme, vendos përsëritjen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në Shkallë të Parë, sepse nuk ka marrë dijeni, ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore”.<sup>160</sup>

Referuar nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 2 të protokollit 7 të K.E.D.Nj, rezulton se personi i deklaruar fajtor për një vepër penale, ka të drejtë të paraqesë ankim në një gjykatë më të lartë, në kushtet që parashikon ligji. Kushtet që përcakton ligji, sipas të drejtës sonë janë të parashikuara në Titullin VIII të K.Pr.P, i cili rregullon ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, mënyrën, procedurën si dhe kufijtë e shqyrtimit të tyre. Ndër të tjera, ligjvënësi ka parashikuar një garanci procedurale të rëndësishme për të pandehurin, duke i garantuar atij të drejtën e një apeli ndaj vendimit gjyqësor, pa patur rrezikun e rëndimit të pozitës së tij në ushtrimin e kësaj të drejte. Kështu, në nenin 425/2, 3 të K.Pr.Penale, sanksionohet se:

“kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t’i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar, ndërsa kur apelues është edhe prokurori, ose vetëm ky i fundit, Gjykata e Apelit mund t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose të rrisë masën e dënimit...”<sup>161</sup>

Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata e Apelit kur shqyrton çështjen vetëm mbi ankimin e të pandehurit, në asnjë rast nuk mund të rëndojë pozitën e tij si për masën e dënimit, ashtu edhe për cilësimin juridik nga një vepër më e lehtë në një vepër penale më të rëndë.

Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, zbatohet në konsekuencë e njëlloj, kur janë kushtet, në të dy shkallët e gjykimit, si në Apel edhe në Gjykatën e Lartë. Nëse prokurori, si organ përfaqësues i akuzës në emër të shtetit, e ka humbur mundësinë për ta rënduar pozitën e të pandehurit në Apel, për shkak se çështja atje ka shkuar vetëm mbi bazën e ankimit të të pandehurit, ai e ka humbur këtë mundësi përgjithmonë dhe nuk mund ta rifitojë atë më vonë nëpërmjet ushtrimit të rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Në këndvështrimin e zbatimit të parimit të mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit në procesin penal, pjesë e të cilit është edhe e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit dhe garancia e mosrëndimit të padrejtë të pozitës së të pandehurit në këtë gjykatë (kur mungon ankimi nga prokurori), për të njëjtin vendim të gjykatës së Apelit nuk mund të aplikohen dy standarte vlerësimi:

---

<sup>160</sup> Neni 427 K.Pr.Penale

<sup>161</sup> Neni 425/2,3 K.Pr.Penale

1) vendimi të konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj, sepse është dhënë konform një parimi të rëndësishëm kushtetues e ligjor, të vendosur në favor të të pandehurit dhe njëkohësisht,

2) ky vendim të mos konsiderohet i drejtë, nëse prokurori e çon çështjen në fjalë në Gjykatën e Lartë.

Si Gjykata e Lartë në shqyrtimin e rekursit të prokurorit kundër vendimit të Apelit, ashtu dhe gjykatat e tjera në eventualitet të rigjyqimit të çështjes në zbatim të urdhërimeve të Gjykatës së Lartë, në analizë të fundit, nuk mund të japin ndaj të pandehurit një lloj apo masë dënimi më të lartë se ai (ajo) që ka dhënë fillimisht Gjykata e Shkallës së Parë.

Të gjitha korrigjimet e shkeljeve ligjore të mëparshme, kanë vlerë vetëm për gjykimet e tjera, me qëllim që, shkelje të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen. Në të kundërt, nëse do të korrigohej shkelja në çështjen konkrete, do të dhunohej parimi kushtetues i mbrojtjes së të pandehurit në procesin penal. Është kjo arsyeja që në raste të tilla, balanca anon nga mbrojtja e interesave të individit në dëm të interesit publik.

Nga analiza e dy zgjidhjeve të mësipërme, mendoj se vetë K.Pr.Penale, e ka parashikuar shprehimisht kur gjen aplikim parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.<sup>162</sup> Kështu duke iu referuar nenit 425 të K.Pr.Penale, është dispozita e vetme e cila përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe vendos detyrimin e saj për të respektuar këtë parim, kur apelues është vetëm i pandehuri. Ndërsa po t'i referohemi nenit 434 të K.Pr.Penale, që përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, një kufizim i tillë nuk parashikohet për këtë gjykatë. Përveç kësaj, siç argumentojnë edhe Kolegjet e Bashkuara, Gjykata e Apelit e shqyrton çështjen nga pikëpamja e faktit dhe e ligjit, ndërsa Gjykata e Lartë nga pikëpamja vetëm e ligjit, nëse është zbatuar siç duhet ai apo jo. Është pikërisht ky funksion i Gjykatës së Lartë, e cila e vë atë para detyrimit ligjor të konstatojë shkeljet e ligjit nëpërmjet rekursit të prokurorit, të cilit K.Pr.Penale nuk ia ka kufizuar këtë të drejtë (neni 407, 408 të K.Pr.P.) dhe t'i korrigjojë ato në një nga mënyrat e parashikuara në nenin 441 të K.Pr.Penale.

Si neni 43 i Kushtetutës, ashtu edhe neni 2 i protokollit 7 të K.E.Dr.Nj, kërkojnë që të pandehurit t'i jepet mundësia e ankimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, dhe kjo kërkesë kushtetuese gjen pasqyrim në nenin 410 të

---

<sup>162</sup> K.Pr.Penale, neni 425/3 i tij

K.Pr.Penale dhe për më tepër garantohet nga parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (neni 425/3). Por mendoj se dispozitat e mësipërme nuk legjitimojnë një vendim gjyqësor në kundërshtim me ligjin të konstatuar nga Gjykata e Lartë, për t'i garantuar të pandehurit mosrëndimin e pozitës së tij, kur vendimi gjyqësor ankimohet në shkallën e tretë të gjykimit, pavarësisht nga subjekti që ushtron të drejtën e rekursit (prokurori apo i pandehuri).

#### **4.5 Raste të praktikës gjyqësore lidhur me shkeljen e të drejtave të të pandehurit fazën e gjykimit të çështjes**

##### **Rasti I**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. 343, dt.16.05.2002 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se :

“Nga materialet e çështjes rezulton se midis të pandehurve A.T dhe L.B, të akuzuar për veprat penale të parashikuara në nenet 76,22,25 e 278/2 të K.P, ka patur mospërputhje interesash, çka del nga deklaratimet e tyre në disfavor të njëri-tjetrit. Rezulton se të dy të pandehurit janë mbrojtur në gjykimin në shkallë të parë nga i njëjti mbrojtës M.Zh. Në këto rrethana, ka qënë e domosdoshme që nga ana e gjykatës së shkallës së parë të konstatohej kjo mospërputhje interesash dhe të bëheshin zëvendësimet e nevojshme të mbrojtësve, për t’iu garantuar kështu të pandehurve një mbrojtje të drejtë dhe ligjore. Duke mos u bërë kjo, gjykimi është kryer në kundërshtim me dispozitat proceduriale penale {neni 54} që lidhen me pjesëmarrjen në gjykim të mbrojtësit. Për pasojë, në bazë të nenit 128/c të K.Pr.P, aktet e këtij gjykimi janë absolutisht të pavlefshme për shkak të kësaj shkelje të rëndë proceduriale, sepse është cënuar e drejta e mbrojtjes së të pandehurve.”<sup>163</sup>

Gjykata, ka konsideruar shkelje të së drejtës së mbrojtjes, edhe rastin kur i pandehuri deklaroi se kërkon të mbrohet me avokat për shkak të pamundësisë financiare, duke mos nënkuptuar këtu se nuk e dëshiron atë dhe gjykata nuk ia ka siguruar mbrojtësin.

##### **Rasti II**

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. 88, dt.28.02.2001 ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Bulqizë me arsyetimin se :

“të pandehurës në seancën gjyqësore, nuk i është siguruar avokat. Nga procesverbali i seancës nuk del nëse e pandehura e ka refuzuar avokatin, ndërkohë që e ka patur atë gjatë hetimeve. Gjykata ishte e detyruar ta pyeste të pandehurën nëse dëshironte apo jo të mbrohej me avokat dhe, nëse refuzonte mbrojtësin për shkak se ajo nuk e paguante dot t’ia caktonte kryesisht gjykata {neni 49/1 i K.Pr.P}. Por edhe fakti që e pandehura akuzohet për një vepër penale të

<sup>163</sup>Vendim Nr. 343, dt.16.05.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

rëndë {neni 78,278/2 i K.P} dhe se niveli i saj kulturor është i ulët, bën që gjykata detyrohej t'i caktonte një mbrojtës kryesisht, në mënyrë që e pandehura të realizonte të drejtën e saj të mbrojtjes".<sup>164</sup>

Gjykata Kushtetuese ka konsideruar shkelje të së drejtës kushtetuese të mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor, mosnjohimin e të pandehurit nga Gjykata e Apelit sipas kërkesave të nenit 426, si dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij pa i caktuar mbrojtës.

### **Rasti III**

Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr.3 dt.29.01.2001 vendosi shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se:

“Kërkuesi L.L është gjykuar në mungesë në gjykatën e Faktit, duke iu caktuar kryesisht një mbrojtës.

Nga Gjykata e Apelit, ku është shqyrtuar apeli i prokurorit që kërkonte ndryshimin e vendimit duke caktuar një dënim më të rëndë, edhe pse kërkuesi ishte përsëri në mungesë, nuk është marrë asnjë masë për të realizuar mbrojtjen e tij të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës. Gjykata e Apelit në radhë të parë nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 426/1 I K.Pr.P lidhur me njoftimet, dhe nga ana tjetër, ajo s'ka marrë asnjë masë për t'i caktuar një mbrojtës kërkuesit që vazhdonte të gjykohej në mungesë. Kjo do të garantonte një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave të tij dhe do të siguronte një proces të rregullt ligjor. Vec kësaj, kjo gjykatë, ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e ka bërë nëpërmjet shqyrtimit në themel, duke i rivlerësuar provat e administruara nga gjykata dhe duke arritur në konkluzione krejt të kundërta, pa u zbatuar parimi i kontradiktoritetit.

Edhe pse kjo shkelje është rilevuar në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal nuk e ka kaluar çështjen në gjykim, me arsyetimin e mungesës së shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.P. Mungesa e mbrojtjes në rastin konkret, është shkelje e parimeve esenciale të procesit penal, gjë që e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues.”<sup>165</sup>

(Në kapitullin në vijim do trajtohet hollësisht pavlefshmëria e vendimeve gjyqësore, si pasojë e shkeljeve të të drejtave të të pandehurit, veçanërisht të së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykim, për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimeve).

### **Rasti IV**

Me vendimin Nr.9, dt.22.02.2001 Gjykata Kushtetuese ka theksuar se:

“E drejta e të pandehurit për të zgjedhur mbrojtësin e tij është njëkohësisht edhe një detyrim për gjykatën për ta respektuar këtë të drejtë. Është e vërtetë që gjykata e rrethit gjyqësor në rigjykim i ka caktuar mbrojtës të pandehurit dhe i ka dhënë kohë atij të përgatitet, por kjo nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se gjykata ka përmbushur detyrimet e saj kushtetuese e ligjore për realizimin e të drejtës së mbrojtjes së të pandehurit. Është detyrë e Gjykatës së shkallës së parë dhe e Gjykatës së Apelit të kryejnë të gjitha veprimet proceduriale

<sup>164</sup> Vendim Nr. 88, dt.28.02.2001 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>165</sup> Vendim Nr.3 dt.29.01.2001 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Mihal Duri e Re, Tiranë

për njoftimin e të pandehurit dhe, vetëm kur ky i fundit nuk paraqitet, t'i caktojnë mbrojtës kryesisht. Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk ka caktuar as mbrojtës kryesisht, por ka dëgjuar vetëm prokurorin, duke mosrespektuar parimet e rëndësishme të mbrojtjes dhe të kontradiktoritetit në gjykim”.<sup>166</sup>

Nëpërmjet vendimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese kërkon nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm jo vetëm sigurimin e të drejtës së mbrojtjes të pandehurit, por garantimin e kësaj të drejte, duke zbatuar me korrektësi dispozitat e K.Pr.P, në mënyrë që kjo e drejtë të mos jetë “formale”, kur i pandehuri gjykohet në mungesë.

Gjykata Kushtetuese ka konsideruar shkelje të së drejtës së mbrojtjes edhe shqyrtimin dhe dhënien e zgjidhjes nga Dhoma e Këshillimit të Gjykatës së Lartë, të shkaqeve ligjore të paraqitura në rekurs nga i pandehuri.

## **Rasti V**

Me vendimin Nr.24, dt.24.04.2001, Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin e vendimit Nr.322 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se:

“Avokati i të pandehurit B.G ka ushtruar rekurs pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë Kukës dh Gjykatës së Apelit Shkodër. Rekursi përmban shkaqe që lidhen me cilësimin e gabuar ligjor të veprës penale, me shkeljen e normave procedurale gjatë gjykimit, të cilat kanë ndikuar në mohimin e të drejtës së mbrojtjes së të pandehurit.

Në vendimin e Kolegjit Penal, megjithëse pranohet se kërkuesi ka pretenduar si shkak për prishjen e vendimit, cilësimin e gabuar ligjor të veprës penale nga gjykatat, në dispozitiv është vendosur mospranimi i rekursit. Gjithashtu, asyetime i përdorur në vendimin objekt shqyrtimi se: “gjykatat në marrjen e vendimit kanë zbatuar drejt ligjin penal dhe normat e tjera juridike”, përbën një konkluzion përfundimtar të shqyrtimit të çështjes në themel, në të cilin ka arritur Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit, por që nuk mund të përputhet me kuptimin ligjor që ligjvënësi ka formuluar për mospranimin e rekursit.

Shqyrtimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit është krejt i ndryshëm nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore. Detyrë e Dhomës së Këshillimit është të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë të tilla që të përputhen me kërkesat e nenit 432 të K.Pr.P. Mjafton ekzistenca e këtyre shkaqeve ligjore, por pa i hyrë vlerësimi të tyre në fakt, që çështja të kalohet në seancë gjyqësore.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese ka arritur në konkluzionin se, moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që shqyrtimi dhe dhënia zgjidhje shkaqeve ligjore të parashtruara në rekurs, nuk i përket Dhomës së Këshillimit, i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar nëpërmjet avokatit të tij, duke mos u garantuar njëkohësisht zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës”.<sup>167</sup>

---

<sup>166</sup>Vendim Nr.9, dt.22.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Mihal Duri e Re, Tiranë

<sup>167</sup> Vendim Nr.24, dt.24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Mihal Duri e Re, Tiranë

## Rasti VI

Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr.33, dt.24.05.2000 ka shfuqizuar vendimin Nr. 282 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se :

“Nga gjykimi i kësaj çështje rezultoi se nuk vërtetohet që t’i jetë komunikuar kërkesit rekursi i prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka gjykuar dhe e ka deklaruar fajtor të pandehurin në mungesë dhe pa pjesëmarrjen e mbrojtësit. Në këtë rast kjo gjykatë ka shkelur nenin 31/c të Kushtetutës, duke i mohuar të pandehurit të drejtën e mbrojtjes, pra është bërë një proces i parregullt ligjor në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës. Në rrethanat e lartë përmendura, konkludohet se Kolegji Penal nuk ka pasur parasysh edhe nenin 31/1 të Kushtetutës ku sanksionohet se : “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet”. Ky parim parashikohet edhe në nenin 6 të Konventës. Në këtë çështje del se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, e për rrjedhojë vendimi i atakuar i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet si antikushtetues”.<sup>168</sup>

Gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të ndodhi që fakti të dalë ndryshe nga ç’është paraqitur në kërkesën për gjykim, ose që të evidentohet kryerja e një vepre tjetër nga i pandehuri, e cila ka lidhje me me atë që gjykohet. Në këtë rast ndodhemi para “Akuzave të reja” të parashikuara në nenet 372-377 të K.Pr.P. Në të gjitha këto raste, gjykata është e detyruar në bazë të nenit 376, t’i bëjë të ditur të pandehurit se ka të drejtën për të kërkuar një afat për mbrojtjen, i cili s’mund të jetë më tepër se 10 ditë. Në këtë mënyrë, K.Pr.Penale, jo vetëm i njeh të drejtën e mbrojtjes të pandehurit, por në pajtim të plotë me kërkesat e nenit 6/3 të Konventës dhe të nenin 31 të Kushtetutës, e siguron këtë të drejtë në mënyrë efektive.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri gëzon të drejtën që gjykata të shprehet me vendim në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.

Gjykata Europiane ka theksuar se është shumë e rëndësishme për të drejtën, për një proces të rregullt ligjor, dhënia e një vendimi përfundimtar për një çështje të caktuar, si dhe arsyetimi i këtij vendimi.

Kjo kërkesë parashikohet dhe në nenin 142/1 të Kushtetutës. Gjithashtu edhe në K.Pr.Penale, në nenin 382, kërkohet arsyetimi i vendimit gjyqësor, i cili duhet të mbështet vetëm në provat e administruara në seancë gjyqësore dhe në ligjin penal. Gjithashtu, ai duhet të përmbajë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale dhe detyrimisht nënshkrimin e anëtarëve të trupit gjykues, mungesa e të cilit sjell pavlefshmërinë e vendimit.

Edhe në rastet e gjykimeve me dyer të mbyllura, neni 384 i K.Pr.Penale, sanksionon detyrimin e gjykatës për shpalljen e vendimit gjyqësor.

---

<sup>168</sup> Vendim Nr.33, dt.24.05.2000 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Mihal Duri e Re, Tiranë



Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr.28, dt.19.3.1999, vendosi shfuqizimin si antikushtetues të vendimit Nr.250 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë vetëm përsa i përket të pandehurit S.R. me arsyetimin se:

“Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin Nr.412, ka deklaruar fajtor kërkuesin S.R. për veprat penale të Apelit Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bërë rekurs vetëm njëri prej të gjykuarve të tjerë, E.C. dhe kërkuesi, duke e paraqitur atë sipas rregullave në kryesekretarinë e Gjykatës së Apelit brenda afatit ligjor. Në rekurs janë ngritur një sërë problemesh me karakter ligjor, duke u pretenduar për pafajësi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, e ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e të pandehurit E.C. Në senacë gjyqësore ka marrë pjesë edhe avokati i kërkuesit, i cili pasi ka pretenduar se ka bërë rekurs brenda afatit ligjor, i ka dorëzuar një kopje të tij Kolegjit Penal.

Edhe pse u vu përballë një fakti të tillë, Kolegji Penal ka vazhduar shqyrtimin e çështjes mbi bazën e rekursit të E.C., duke dëgjuar njëkohësisht edhe pretendimet e mbrojtësit të kërkuesit. Në përfundim Kolegji vendosi t’I japë pafajësi E.C., ndërsa kërkuesit t’I ulë masën e dënimit nga 15 vjet në 10 vjet heqje lirie, me të vetmin arsyetim “se merr parasysh rolin e tij si bashkëpunëtor në krim”.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se, procesi gjyqësor i zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përsa i përket kërkuesit S.R. është i parregullt e për pasojë ai duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

Së pari, është shkelur e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor, si një e drejtë kushtetuese (n.43 i Kushtetutës). Dëgjimin nga ana e Kolegjit Penal vetëm të mbrojtësit të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese, nuk e konsideron si realizim në të gjithë gjerësinë e vet të së drejtës kushtetuese të ankimit.

Po t’i referohesh përmbajtjes së vendimit dhe mungesës totale në të, të argumentave për rrëzimin e pretendimeve të S.R., arrihet plotësisht në konkluzionin se edhe dëgjimi i mbrojtësit ka qënë tërësisht formal, gjë që përbën cënim të së drejtës së mbrojtjes. Ulja që i ka bërë Kolegji Penal masës së dënimit, nuk do të thotë se në këtë gjykim janë analizuar pretendimet e ngritura nga i pandehuri. Përkundrazi ndryshimi i kësaj pjese të vendimit është diktuar nga nevoja për të harmonizuar masën e dënimit me shkallën e fajësisë së tij në kryerjen e krimit, e cila, siç pranon Kolegji, ka qënë më e vogël në krahasim me atë të dy të pandehurve të tjerë.

Së dyti, në këtë proces, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur një detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës: “vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara”.

Në vendimin nr.250 të Kolegjit Penal, jo vetëm që nuk bëhet fjalë për rekursin e S.R., por nga përmbajtja e tij nuk del se çfarë ka pretenduar ai në rekurs, dhe më kryesorja, nuk përmendet fare çfarë ka pranuar e rrëzuar gjykata.

Për më tepër, ndërsa kërkuesi si në rekurs ashtu edhe në fjalën e mbrojtjes ka pretenduar pafajësi, në vendim, në mënyrë krejt spontane, në një paragraf të vetëm argumentohet vetëm ulja e dënimit.

Në këto rrethana, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përsa i përket të pandehurit S.R., duhet të shpallet antikushtetues si rezultat i një procesi jo të rregullt gjyqësor”.<sup>169</sup>

## Rasti VII

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë me vendim Nr.568, dt.23.10.2002 mori në shqyrtim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit N.M. me akuzën e mashtrimit (n.143 K.P.) dhe vendosi prishjen e vendimit nr.44 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me arsyetimin:

<sup>169</sup>Vendim Nr.28, dt.19.03.1999 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Edlor, Tiranë

“ Vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë në kundërshtim me ligjin e për këtë shkak ai duhet te priset. I pandehuri N.M. është gjykuar në mungesë nga Gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë për veprën penale të parashikuar nga n.143 i K.P.

Ky vendim, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila e ka shqyrtuar çështjen pas pesë vjetësh, për shkak se i pandehuri N.M. është proçeduar në mungesë. I pandehuri ka bërë kërkesë për t’u rivendosur në afat për të bërë ankim pasi nuk kishte marrë dijeni për vendimin e gjykatës së shkallës së parë që e kishte deklaruar fajtor. Kjo gjykatë me vendimin nr.20, ka pranuar kërkesën e rivendosjes në afat.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se, në gjykimin në Apel janë lejuar shkelje të dispozitave të K.Pr.P, e konkretisht të n.427/4 të tij. Sipas kësaj dispozite, “kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni për të, Gjykata e Apelit duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor”. Ky përcaktim i ligjit ka patur për qëllim që, personi i cili akuzohet për një vepër penale, të jetë në gjendje që të mbrojë interesat e tij në procesin penal nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

Fakti që gjykimi në shkallë të parë, është bërë në mungesë të të pandehurit dhe kjo jo për faj të tij, i jep të drejtën sipas dispozitave të K.Pr.P., jo vetëm që të rivendoset në afat për të bërë ankim, por edhe të marrë pjesë në gjykimin tërësisht të çështjes nga gjykata më e lartë, e cila duhet ta ribëjë të plotë atë, nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit është një gjykatë që gjykon çështjen në fakt dhe në ligj. Kolegji Penal çmon se n.427/4 i K.Pr.P është detyrues për Gjykatën e Apelit e cila, në rastet e rivendosjes në afat për të bërë ankim për shkaqet që kjo dispozitë parashikon, në gjykimin e çështjes, duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor për t’i dhënë mundësi të pandehurit të aplikojë të gjitha mjetet ligjore në mbrojtje të të drejtave të tij. Duke qënë se në rastin në fjalë gjykata nuk e ka bërë një gjë të tillë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë arriti në përfundimin se gjykimi në Apel është bërë në kundërshtim me ligjin e për pasojë nuk ka siguruar një proces të rregullt ligjor”.<sup>170</sup>

Nga argumentimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë, është e kuptueshme se shkelja e kësaj të drejte për të pandehurin, gjatë gjyimit në Apel, cënon procesin e rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutësi dhe neni 6 dhe neni 2 i protokollit Nr.7 të KEDrNj.

## **Rasti VIII**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr.779, dt.30.08.1998, ka deklaruar fajtor kërkuesin Q.M. për veprën penale të “Vjedhjes “ dhe në bazë të nenit 134 dhe nenit 48/ç të K.P. e ka dënuar me 13 muaj burgim. Po me këtë vendim është dënuar edhe vëllai i kërkuesit, P.M., me 10 vjet burgim për veprat penale të parashikuara nga nenet 140 e 278/2 të K.P.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim vetëm i gjykuari Q.M. Gjykata e Apelit me vendimin Nr.336 dt.17.11.1998 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit, me vërejtjen që, ndryshimi i akuzës për kërkuesin Q.M, nga bashkëpunëtor në vjedhje me armë, sipas nenit 140 të K.P. në vjedhje të pasurisë sipas nenit 134 të K.P, është bërë në kundërshtim me provat. Vetë Gjykata e Apelit, duke zbatuar nenin 425/3 të K.Pr.P. nuk

---

<sup>170</sup>Vendim Nr.568, dt.23.10.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

mund t'i caktonte kërkuesit një dënim më të rëndë, sepse do të cënonte "parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit".

Kundër vendimeve të Gjykatës së Rrethit dhe të Gjykatës së Apelit, ka ushtruar rekurs prokurori pranë Prokurorisë së Apelit të Tiranës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.120, dt.3.03.1999, ka lënë në fuqi vendimin Nr.336 të Gjykatës së Apelit për të gjykuarin P.M dhe e ka ndryshuar atë për të gjykuarin tjetër Q.M, për cilësimin ligjor nga vjedhje e pasurisë sipas nenit 134 të K.P, në vjedhje me armë sipas neneve 140 dhe 25 të K.P. duke e dënuar nga 13 muaj në 12 vjet burgim.

Gjykata Kushtetuese e vënë në lëvizje nga i gjykuari Q.M, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, e ka rrëzuar kërkesën e tij për prishjen e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr.96, dt.27.07.2001, me këtë arsyetim:

"Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk e cënon parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit dhe nuk ka të bëjë me të drejta të fituara. Sipas nenit 43 të Kushtetutës: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë". Është e vërtetë që me ankimin atij nuk mund t'i rëndohet pozita, por ky parim shërben si garanci kur mjetin e ankimit e ka përdorur i pandehuri, dhe nuk mund të shërbejë si i tillë kur mjetin e ankimit e ka përdorur prokurori. Ky i fundit, në zbatim të parimeve kushtetuese, përfaqëson akuzën dhe i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjeve. Prandaj, për rastet e shkeljeve ligjore nga gjykatat, të konkretizuara në një vendim të paligjshëm, Prokuroria nuk mund të qëndrojë indiferente. Ajo ka detyrimin të ushtrojë të gjitha mjetet procedurale për zbatimin e drejtë të ligjit. Atë që nuk mund ta bënte në rastin konkret Gjykata e Apelit për shkak të kufizimit procedural (neni 425/3), e realizoi Gjykata e Lartë, e cila sipas nenit 432 të K.Pr.P, pranon rekursin kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Apeleve e të rretheve dhe vendos për çështjet ligjore sipas nenit 434 e 441 të K.Pr.P."<sup>171</sup>

Nëpërmjet vendimit të mësipërm, del qartë se Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e drejtë të nenit 425/2,3 të K.Pr.P, duke iu referuar të drejtave e detyrimeve kushtetuese që i atribuon Kushtetuta prokurorit dhe, duke theksuar se i pandehuri e gëzon të drejtën e mosrëndimit të pozitës së tij, kur është i vetmi subjekt që apelon vendimin e gjykatës në Gjykatën e Apelit, dhe se ky parim është detyrues për Gjykatën e Apelit dhe jo për Gjykatën e Lartë.

## **Rasti IX**

Në të njëjtin përfundim ka arritur edhe Gjykata e Lartë lidhur me parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.

---

<sup>171</sup>Vendim Nr.96 dt.27.07.2001 i Gjykatës Kushtetuese, Botim i Mihal Duri e Re, Tiranë

Kështu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues Nr.2, dt.19.04.2001, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kur ankimi në Gjykatën e Apelit është bërë vetëm nga i pandehuri, ndërsa në Gjykatën e Lartë ajo vjen me ankim të të dy palëve ose vetëm të prokurorit, theksojnë se:

“Në kuptim të nenit 432 të K.Pr.P, rekursi aplikohet vetëm për shkaqe ligjore, ndaj shkelja e ligjit nga gjykatat më të ulëta në dhënien e vendimit, i jep juridiksion Gjykatës së Lartë të shqyrtojë dhe çënojë vendimet e tyre.

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë lidhen vetëm me shkaqet ligjore të ngritura apo të konstatuara, që e bëjnë vendimin e ankimuar të kundërligjshëm në dallim nga gjykimi në Apel, ku kufijtë e shqyrtimit të çështjes në atë gjykatë lidhen edhe me subjektin që ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Fakti që prokurori nuk ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, nuk i mohon atij të drejtën të ushtrojë rekursin në Gjykatën e Lartë. Në rast të kundërt, ligji duhej të shprehej në mënyrë eksplicite lidhur me humbjen e kësaj të drejte.

Konstatimi i paligjshmërisë së vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, edhe kur është në disfavor të të pandehurit nuk lidhet me rëndimin e pozitës së tij, kur shkakua për prishjen e vendimit është aplikimi i gabuar i ligjit që passjell pavlefshmëri të vendimit të ankimuar”.<sup>172</sup>

Por ky vendim i Gjykatës së Lartë, është shoqëruar edhe me një mendim pakice që kundërshton zgjidhjen e arritur nga kjo gjykatë për problemin e mësipërm, me arsyetimin se pavarsisht nga terminologjia e përdorur në ligj, si apeli në Gjykatën e Apelit, edhe rekursi në Gjykatën e Lartë, janë mjete ankimi që i njihen të pandehurit për t’i ushtruar sipas disponibilitetit të të tij, dhe që i garantojnë atij pamundësinë e rëndimit të pozitës nga një gjykatë më e lartë, nëse kundër vendimit nuk i ka ushtruar këto mjete ankimi edhe përfaqësuesi i akuzës.

---

<sup>172</sup>Vendim unifikues Nr.2, dt.19.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

## KAPITULLI V : GJYKIMI PENAL NË MUNGESË DHE POZITA E TË PANDEHURIT

### *5. Gjykimi në mungesë, nocioni ne kuptimin juridik*

“Gjykimi në mungesë” nënkupton situatën kur një person i akuzuar për një vepër penale, nuk është i pranishëm fizikisht gjatë hetimit dhe gjykimit të provave, fakteve në ngarkim të tij. Kur themi “hetimit dhe gjykimit” të provave, kemi parasysh jo vetëm mungesën e personit fizikisht në hetimin që bën organi i akuzës, por dhe gjatë hetimit gjyqsor që bën gjykata, të provave të të gjitha llojeve të lejuara dhe marra sipas ligjit, të cilat fajësojnë ose shfajësojnë personin e akuzuar. Mungesa fizike e personit të akuzuar është një gjëndje mjaft e diskutuar në gjykim. Askush më mirë se vetë i pandehuri nuk mund të mbrojë veten e tij, si në rastin e replikës së drejtpërdrejtë me akuzën, ashtu edhe në rastin e zgjedhjes së mbrojtësit të tij, që do ta ndihmojë atë me një ndihmë të specializuar profesionale, për të zhvilluar një proces sa më të drejtë në mbrojtje të interesave ligjore të të akuzuarit. Instituti i gjykimit në mungesë të të pandehurit, është pranuar nga e drejta jonë, në favor të interesit publik. Gjykimi në mungesë, është sanksionuar me Kodin e Procedurës Penale në vitin 1995 dhe më pas në vitin 1998, usanksionua edhe në Kushtetutë, por nga ana tjetër janë bërë përpjekje për të siguruar standardet minimum të të drejtave individuale në procesin penal, pa i mohuar të pandehurit një proces të rregullt ligjor. Legjislatori ka marrë përsipër që të riparojë dëmin e shkaktuar nga personi, që akuzohet ndaj të tjerëve, duke e marrë atë në përgjegjësi penale, por në të njëjtën kohë, të garantojë edhe personin që akuzohet për një procedim të drejtë. Kështu synohet të garantohet e drejta e personit për t’u njohur me provat dhe faktet kundër tij, për të pyetur dëshmitarë dhe ekspertë gjatë gjykimit, për të paraqitur edhe ai prova etj. Por si mund të ushtrojë personi gjithë këto të drejta në mbrojtje të interesave të tij, kur ai nuk është i pranishëm në gjykim ose aq më keq kur ai nuk ka asnjë dijeni për procesin ndaj tij. Mungesa fizike e një personi nën akuzë mund të jetë për shkaqe të ndryshme, duke filluar që nga padijenja se ndaj tij ka një akuzë dhe një procedim penal, deri tek fshehja e personit me dashje direkte, pasi ka frikë nga dënimi, ose mosdashja me dëshirë e vullnet për të marrë pjesë në gjykimin ndaj tij. Pikërisht për këtë arsye, procedura e gjykimit në mungesë të të pandehurit, ka ndezur debate, si ndërmjet juristëve të doktrinës gjatë përkufizimit se kush konsiderohet “mungesë”, ashtu edhe ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, në përballjen ligjore në proceset gjyqsore, gjatë praktikës së

gjykimit të çështjeve të ndryshme, jo vetëm sipas legjislacionit të brendshëm por edhe në atë të shteteve europiane<sup>173</sup>.

### **5.1 Përcaktimi ligjor i termit “ i pandehur në mungesë”**

Mungesa e të pandehurit konsiderohet si e vullnetshme, kur ai i fshihet drejtësisë dhe largohet për të mos u përballur me të, por mund të jetë dhe e pavullnetshme për arsye se ai nuk ka pasur dijeni se ndaj tij është ngritur një akuzë dhe po zhvillohet një procedim, ose ai nuk ka mundur të jetë prezent në gjykim për pamundësi të tjera, që nuk lidhen me vullnetin e tij. Në nenin 33 të Kushtetutës, është parashikuar se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.”<sup>174</sup> Në analizë të këtij përcaktimi ligjor, arrijmë në përfundimin se, pjesëmarrja dhe prezenca e të pandehurit në gjykim përbën një të drejtë për të dhe jo një detyrim. Për rrjedhojë, vetëm kur vërtetohet se i pandehuri i fshihet drejtësisë apo nuk dëshiron të shfrytëzojë të drejtën e tij për të qënë i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, ai mund të gjykohet në mungesë. Nisur edhe nga parashikimet e legjislacionit tonë të brendshëm, Kodi i Procedurës Penale, parashikon disa raste kur i pandehuri me vullnetin e tij të lirë, heq dorë vullnetarisht nga e drejta për të qënë i pranishëm në gjykim. Kështu në nenin 352 të K.Pr.Penale, parashikohet se gjykimi në mungesë, mund të vazhdojë kur i pandehuri kërkon ose jep pëlqimin që shqyrtimi gjyqësor të bëhet në mungesë të tij, ose duke qënë i burgosur, refuzon të marrë pjesë, përfaqësohet nga mbrojtësi.<sup>175</sup> Kur i pandehuri, i cili pasi është paraqitur, largohet vetë nga salla, konsiderohet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi, kur provohet që i pandehuri fshihet. Përsa i përket parashikimeve të kësajdispozite, është e qartë në rastin e shprehjes së vullnetit nga i pandehuri për mospjesëmarrje, por ajo që e bën të diskutueshme është pika “4” e dispozitës, që parashikon një vullnet të pandehurit të diskutueshëm, përsa i përket provueshmërisë së tij. Pra si provohet se i pandehuri po fshihet nga drejtësia, sepse mund të konfundohet kjo “fshetje” me “mospasjen dijeni”. Detyrimi për ta provuar heqjen dorë, nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim me vullnet të plotë të të pandehurit, e ka prokurori i çështjes në gjykimin që zhvillohet. Kështu, në rastet kur personi është i arrestuar, prokurori i çështjes duhet ti paraqesë gjykatës një dokument të

---

<sup>173</sup> Puto, A., Kondi, Th., Zaka, T. & Kalo, P., Kumbaro, M. (2001) *Për një rend publik Europian*, Vëllimi I, Tiranë: Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, fq. 647.

<sup>174</sup> Kushtetuta e Rsh, neni 33 i saj

<sup>175</sup> K.Pr.Penale, neni 352 i tij

vërtetuar nga drejtuesi i institucionit, ku ndodhet personi, në formën e një deklaratë ku shpreh vullnetin e mospjesëmarrjes. Po kështu është prokurori që duhet të vërtetojë me prova të pakundërshtueshme dhe tej çdo dyshimi, që i pandehuri fshihet sepse i ka shpëtuar një arrestimi në flagrancë, ose u ka ikur punonjësve të policisë që e kishin ndaluar, etj. Njëkohësisht Kodi i Procedurës Penale parashikon edhe gjykimin në mungesë të të pandehurit që nuk paraqitet në gjyq pa pasur shkaqe të ligjshme<sup>176</sup>. Në këtë rast, pasi janë kryer gjithë veprimet e nevojshme procedurale për njoftimin e të pandehurit, prezumohet se i pandehuri ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në hetim apo gjykim, pasi nuk ka paraqitur shkaqe që të justifikojnë mungesën e tij. Në të drejtën tonë, mjafton që të jenë përmbushur kriteret ligjore procedurale për njoftimin e të pandehurit, që të prezumohet se i pandehuri ka marrë dijeni në mënyrë efektive gjë që çon në prezumimin se mungesa është e vullnetshme<sup>177</sup>.

Në legjislationin tonë penal parashikohet mënyra e njoftimit të të pandehurit kur është i lirë, i burgosur dhe kur nuk gjëndet.<sup>178</sup> Ajo që ka rëndësi për një proces penal, në mënyrë që të përcaktohet drejt gjendja juridike e mungesës së vullnetshme apo të pavullnetshme, është pikërisht njoftimi i personit që nuk gjëndet. Si hap i parë, urdhërohet gjetja e personit nga policia gjyqsore nëpërmjet kërkimit të tij. Personi shpallet në kërkim brënda dhe jashtë vëndit nëpërmjet interpolit. Nëse kërkimi nuk jep rezultat, atëherë nxirret vendimi i mosgjetyes dhe i caktohet një mbrojtës kryesisht të pandehurit. Këtu lind problematika që ka kjo procedurë njoftimi dhe ligji, pasi lind pyetja: A konsiderohet i njoftuar personi, i cili nuk gjëndet duke njoftuar avokatin mbrojtës të caktuar nga gjykata kryesisht, të cilin i pandehuri as e njih dhe as ka dijeni për caktimin e tij si mbrojtës? Respektimi i të drejtave të garantuara nga neni 6 i Konventës Europiane i të Drejtave të Njeriut, nuk arrin të realizohet kur i pandehuri është në mungesë, pra kur ai nuk paraqitet në gjykim. I gjithë instituti i gjykimit në mungesë, silllet rreth problemit se kur mund të konsiderohet që i pandehuri është njoftuar në mënyrë efektive, e për akuzat dhe kur mund të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim.<sup>179</sup> Në Kodin e Procedurës Penale janë parashikuar një sërë garancish ligjore, me qëllim që të pandehurit që është në mungesë t'i garantohet një proces i rregullt ligjor. Ka mjaft raste, në të cilat shkak për prishjen e

---

<sup>176</sup>Neni 351 i K.Pr.Penale

<sup>177</sup>Paskali,F.(2001) *Gjykimi në mungesë i të pandehurit*,Tiranë :Tribuna Juridike, Nr.30, fq.20

<sup>178</sup> Islami,H.&Hoxha,A., Panda I.( 2007) *Komentari i Procedurës Penale*, Tiranë: Botimet Morava,fq.193

<sup>179</sup> Cordero,F. (1995) *Procedura Penale*,Terca Edizione, Milano: Giuffrè, fq.308

vendimit të një gjykate, bëhet mosrespektimi i kërkesave ligjore për njoftimin apo për deklarimin e mungesës<sup>180</sup>.

Gjykata Europiane kërkon më tepër siguri për njoftimin efektiv apo dorëheqjene shprehur të të pandehurit.<sup>181</sup> Gjykata në rastin kur i pandehuri nuk paraqitet, është e detyruar të hetojë shkaqet e mungesës së tij dhe kur rezulton se njoftimi nuk është bërë, nuk ka qenë i rregullt apo është i dyshimtëurdhëron shtyrjen e seancës dhe përsëritjen e njoftimit (nenet 349 dhe 350/4 i K.Pr.Penale).

Është fakt se të pandehurit i rikrijohet mundësia për të bërë ankim edhe atëherë kur nuk ka pasur parregullsi me njoftimet<sup>182</sup>. Kështu i pandehuri i gjykuar dhe i dënuar në mungesë që rishfaqet (vullnetarisht apo sepsekapet) rivihet në afat për të bërë ankim me përjashtim të rastit kur “ ai megjithëse ka marrë dijeninë mënyrë efektive për procedimin ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij për tu paraqitur”.

## **5.2. Procedura ligjore e gjykimit në mungesë**

Me marrjen e vendimit të dërgimit të çështjes për gjyq, përpilimit të kërkesës për gjykim, përgatitjes së fashikullit të gjykimit dhe depozitimit të akteve në gjykatë, përfundon faza e hetimeve paraprake të procedimit penal dhe fillon faza e gjykimit. Faza e gjykimit konsiston në tre momente; në veprimet përgatitore para shqyrtimit gjyqësor, në momentin e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe në momentin e veprimeve gjyqësore të mëtejshme që pasojnë shqyrtimin gjyqësor. Veprimet përgatitore para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor fillojnë me momentin kur në sekretarinë e gjykatës paraqitet fashikulli i gjykimit nga ana e prokurorit dhe vijojnë deri në momentin kur kryetari i seancës çel seancën gjyqësore në praninë e palëve, të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit. Në nenet 333-338 të K.Pr.Penale, janë parashikuar veprimet përgatitore që paraprijnë fillimin e gjykimit të çështjes penale. Veprimet përgatitore, fillojnë me shqyrtimin e fashikullit të gjykimit nga gjyqtari i vetëm, apo sipas rastit nga kryetari i trupit gjykues, në mënyrë për të verifikuar

---

<sup>180</sup> Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.410, datë 18.04.2007

<sup>181</sup> GjEDrNj Sejdivic kundër Italisë, Në këtë gjykim GJEDNJ-ja ka shkuar edhe më tej, duke vërejtur se: “Dhunimi i nenit 6 të KEDNJ-së ka ardhur si pasojë e keqfunksionimit të legjislacionit dhe procedurave të brendshme, shkaktuar nga mungesa e një mekanizmi efektiv që të bënte të mundur realizimin e të drejtës së personave të dënuar në mungesë, të cilët edhe të painformuar në mënyrë efektive për gjykimin në ngarkim të tyre, edhe që nuk kishin hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta për t’u mbrojtur, për të përfituar që një gjykatë tjetër të shprehet përsëri në lidhje me akuzat”( citim i Gjykatës së Lartë).

<sup>182</sup> Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, vendim i Dhomës së Madhe, Nr.56581/00, datë 01.03.2006, fq.60



nëse fashikulli i gjykimit është ndërtuar sipas parashikimeve të nenit 332 të K.Pr.Penale. Brënda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës për gjykim, gjyqtari i ngarkuar me gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore, datë e cila i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, palëve private apo përfaqësuesve të tyre, të paktën dhjetë para datës të caktuar për gjykim<sup>183</sup>. Do të ishte i mundurnjë gjykimi më të shpejtë dhe do të bënte të mundur eliminimin e stërzgjatjes dhe zvarritjes të gjykimeve penale, sidomos me ato gjykime me shumë të pandehur ku mungesa qoftë dhe vetëm e mbrojtësit të njërit prej të pandehurve do të shkaktonte shtyrjen e gjykimit për të gjithë të pandehurit, nëse bëhej saktësimi që në seancën përgatitore i procedurave; nëse i pandehuri do të mbrohet nga një mbrojtës, nëse mbrojtësi është njohur me aktet e çështjes dhe është gati të bëjë mbrojtjen; caktimi i mbrojtësve zëvendësues sipas rastit nga i pandehuri ose kryesisht nga gjykata, në mënyrë që mbrojtësit zëvendësues të ishin të njohur që në fillim me aktet e dosjes dhe në rast të mungesës së mbrojtësve të parë të merrnin pjesë në gjykim si mbrojtës të të pandehurit pa qënë e nevojshme ndërprerja dhe shtyrja e shqyrtimit gjyqësor. I pandehuri që është prezent fizikisht merr pjesë në seancë si person i lirë edhe kur është i paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur duhet që të merren masa për të parandaluar rrëzikun e ikjes apo rrezikun e dhunës. Në rast se i pandehuri gjatë gjykimit, me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës gjyqësore, edhe pse i është tërhequr më parë vëmendja lidhur me këtë fakt, ai largohet nga salla me urdhër të kryetarit. Në këtë rast, pavarësisht se ai nuk merr pjesë në vazhdimin e gjykimit konsiderohet se është i pranishëm dhe përfaqësohet nga mbrojtësi i tij. Gjykimi nuk pengohet edhe nëse i pandehuri i larguar nuk ka pranuar që të ketë mbrojtës. Në këtë rast caktohet një mbrojtës kryesisht nga gjykata dhe vazhdon gjykimi<sup>184</sup>. Veprimet e kryera në seancë gjyqësore, kërkesat e bërë nga prokurori, konkluzionet e prokurorit, të palëve private, mbrojtësve apo përfaqësuesve të palëve private, përshkruhen në proces verbalin e seancës gjyqësore i cili mbahet nga sekretari i seancës dhe përfshihet në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. Palët kanë të drejtë që gjatë shqyrtimit gjyqësor, të kërkojnë që të shënohen në proces verbal deklarimet apo argumentimet e tyre për të cilat kanë interes. Po kështu, memoriet me shkrim të paraqitura nga palët në procesin gjyqësor, kërkesat me shkrim, konkluzionet e tyre, i bashkohen proces verbalit të seancës gjyqësore. Bashkimi i këtyre akteve proces verbalit të seancës

---

<sup>183</sup> Në nenin 340/1 të K.Pr.Penale janë parashikuar rastet e zhvillimit gjyqësor me dyer të mbyllura

<sup>184</sup> Neni 344 i K.Pr.Penale

gjqësore bëhet me vendim të ndërmjetëm të gjykatës, vendim i cili edhe ky pasqyrohet në proces verbalin e seances gjyqësore. Veprimet paraprake fillojnë me çeljen e seancës së parë gjyqësore, ku përshkruhet vendi, data, dhe ora e seancës, kryetari verifikon fillimisht paraqitjen e palëve. Fillimisht verifikohet nëse janë kryer njoftimet e nevojshme, nëse ato janë kryer në formën e kërkuar nga ligji, dhe më pas nëse palët janë paraqitur. Në rast se palët janë paraqitur, pavarësisht parregullshmërisë së njoftimeve, vijon më tej seancë gjyqësore. Nëse i pandehuri, i dëmtuari akuzues apo personi ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për gjykim, nuk kanë marrë njoftimin apo njoftimi është i dyshimtë, gjykata me kërkesën e palëve apo kryesisht urdhëron përsëritjen e njoftimit, në mënyrë që palët e mësipërme të marrin dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës gjyqësore. Kjo procedurë ndiqet jo vetëm në seancën e parë gjyqësore, por edhe në vijimësi të zhvillimit të gjykimit. Kur i pandehuri i lirë apo i paraburgosur, nuk paraqitet në seancë ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për tu paraqitur, gjykata pasi dëgjon palët, deklaron mungesën e tij. Në këtë rast i pandehuri përfaqësohet nga mbrojtësi i tij<sup>185</sup>. Rasti më i zakonshëm i zbatimit të kësaj dispozite, është rasti kur provohet plotësisht se i pandehuri ka marrë dijeni, duke marrë njoftimin përkatës për t'u paraqitur në ditën dhe orën e caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, por nuk është paraqitur. Gjykata me vendim të saj të ndërmjetëm, vendos që të deklarojë mungesën e të pandehurit dhe gjykimi vazhdon në mungesë të tij duke u përfaqësuar i pandehuri nga mbrojtësi. Nëse i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, atëherë gjykimi vazhdon duke i caktuar gjykata të pandehurit një mbrojtës kryesisht. Megjithatë, jo në të gjitha rastet situata mundet të jetë kaq e thjeshtë. Marrin në konsideratë rastin kur i pandehuri është hetuar në mungesë, rezulton i larguar, nuk dihet adresa apo vëndndodhja e tij, apo rastin kur ndaj të pandehurit mundet të jetë marrë një masë sigurimi “arrest në burg”, por që kjo masë sigurimi nuk është ekzekutuar pasi i pandehuri i fshihet drejtësisë. Në të gjitha këto raste të mundshme, gjykata duhet të respektojë me përpikmëri rregullat procedurale për kryerjen e njoftimit të të pandehurit, të parashikuara nga nenet 140-143 të K.Pr.Penale. Në rast se njoftimi i të pandehurit, nuk mund të bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit, atëherë njoftimi bëhet në banesën tij ose në vëndin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të pandehurin ose një fqinji të tij, ose një personi që punon me të pandehurin. Nëse personat e mësipërm

---

<sup>185</sup> Neni 351/1 i K.Pr.Penale.

mungojnë, janë të papërshtatshëm apo refuzojnë që të marrin aktin, atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vënde të tjera<sup>186</sup>. Në rast se përsëri nuk është bërë e mundur njoftimi i të pandehurit, kryhet procedura e njoftimit me shpallje, ku akti njoftimit depozitohet në qendrën administrative të lagjes apo të fshatit ku i pandehuri banon ose punon, dhe një kopje e aktit afishohet edhe në këndin e njoftimeve të gjykatës. Kërkimi i të pandehurit që përmendet në dispozitën e parashikuar nga neni 141/1 të K.Pr.Penale, ka për qëllim gjetjen dhe njoftimin e tij për t'u paraqitur në seancë gjyqësore, në ditën dhe orën e caktuar, pra është për qëllime njoftimi dhe nuk presupozon marrjen e ndonjë mase sigurimi. Edhe kur i pandehuri pasi kërkohet e gjendet nga policia gjyqësore, ai vetëm sa njihet me aktin e njoftimit dhe nuk është i detyruar që të paraqitet domosdoshmërisht në gjykim. Por, konfirmimi se i pandehuri ka marrë dijeni për gjykimin, lejon më pas gjykatën të procedojë me deklarin e mungesës dhe të vazhdojë gjykimin. Pra, në rastet kur i pandehuri nuk provohet se ka marrë dijeni, gjykata kryen të gjitha veprimet e mësipërme, sipas radhës përkatëse. Pasi janë kryer të gjitha veprimet e mësipërme, janë kryer të gjitha kërkimet e mundshme për gjetjen dhe njoftimin e të pandehurit, gjykata vendos të nxjerrë vendimin e mosgjjetjes së të pandehurit. Vendimi i mosgjjetjes, është një vendim i ndërmjetëm i gjykatës, që dokumenton përpjekjet e kryera për njoftimin e të pandehurit dhe cakton mbrojtësin kryesisht i cili merr njoftimin për të pandehurin. Vendimi i mosgjjetjes, nuk është i njëjtë me vendimin e deklarin e mungesës së të pandehurit. Vendimi për deklarin e mungesës së të pandehurit në këtë rast, merret pasi mbrojtësi i caktuar me vendimin e mosgjjetjes, paraqitet në gjykim dhe njihet me aktin e njoftimit. Në këtë moment procedural, konsiderohet se procedura e njoftimit të të pandehurit është ezauruar dhe më pas gjykata merr vendimin për deklarin e mungesës së të pandehurit. E njëjta procedurë që kryhet në fazën e gjykimit të çështjes lidhur me njoftimin e të pandehurit, kryhet edhe në fazën e hetimeve paraprake. Veçse në fazën e hetimeve paraprake, procedurat kryhen nga prokurori dhe jo nga gjykata. Në këtë fazë, është prokurori autoriteti që vendos urdhërimin e kërkimit dhe më pas nxjerr vendimin e mosgjjetjes së të pandehurit duke i caktuar atij një mbrojtës. Pavarësisht se i pandehuri është hetuar në mungesë dhe prokurori ka nxjerrë për të pandehurin vendimin e mosgjjetjes, në fazën e gjykimit të çështjes, procedurat duhet që të fillojnë të përsëriten nga e para. Hetimi në mungesë nuk presupozon edhe gjykimin në

---

<sup>186</sup> Neni 140/1,4 të K.Pr.Penale.

mungesë. Në nenin 141/2 të K.Pr.Penale, është parashikuar që vendimi i mosgjetyes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake ose me dhënien e vendimit nga gjykata. Në praktikën gjyqësore të mëparshme, kanë qenë të shumta rastet kur gjykatat në fazën e gjykimit, nuk kryenin procedurën e njoftimit të të pandehurit sipas përshkrimit të mësipërm, por deklarorin drejtëpërdrejtë mungesën e të pandehurit, duke u bazuar në faktin se gjatë hetimeve paraprake i pandehuri ishte hetuar në mungesë dhe për të ishte nxjerrë nga prokurori vendimi i mosgjetyes. Kjo ka bërë që gjykatat më të larta, në shumë raste të vendosnin prishjen e vendimit të gjykatave të shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, vetëm për shkak të pavlefshmërisë së kryerjes së njoftimeve nga këto gjykata. Një çështje tjetër e diskutuar në praktikën gjyqësore, ka qenë edhe rasti kur për të pandehurit e larguar dhe që i fshihen drejtësisë, mbrojtësit e tyre i zgjedhin familjarët e tyre në bazë të nenit 48/3 të K.Pr.Penale. Në një rast të tillë, gjykata duhet që me paraqitjen e prokurës së zgjedhjes së mbrojtësit nga familjarët e të pandehurit, të vazhdojë gjykimin në mungesë apo pavarësisht zgjedhjes së mbrojtësit nga familjarët, gjykata duhet që të kryejë procedurën për njoftimin dhe kërkimin e të pandehurit? Në vendimin Nr.30, datë 17.06.2010, Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për shfuqizimin si në kundërshtim me Kushtetutën të nenit 48/3 të K.Pr.Penale<sup>187</sup>. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar procedurën që duhet të ndiqet nga gjykata në rastet e gjykimit në mungesë të të pandehurit, kur dhe njëkohësisht të afërmit e të pandehurit kanë zgjedhur mbrojtës të tij. Konkretisht, është arsyetuar se;

“Gjykata çmon se e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Po ashtu, parashikimi në nenin 48/3 për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehurit, nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë vetjake nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët. Në rastin e gjykimit në mungesë, GJEDNJ-ja përcakton qartë se është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Në këtë mënyrë duhet që autoritetet shtetërore të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar të pandehurin dhe vetëm nëse janë të sigurt se ai ka marrë njoftim në formën që parashikon ligji, atëherë mund të vazhdohet me procedimin në mungesë. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e

<sup>187</sup> Neni 48/3 i K.Pr.Penale.

të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse nuk kanë kontakte me të pandehurin, çka, sipas GJEDNJ-së është detyrë e organeve kompetente shtetërore. E njëjta situatë është edhe për sa i përket ankimit. Familjarët e të pandehurit mund të paraqesin ankim vetëm në rast se janë dukepërbushur vullnetin e të pandehurit dhe vetëm nëse i pandehuri ka dijeni se ndaj tij ka filluar e po zhvillohet një proces penal. Në këtë mënyrë është rigoroz zbatimi i procedurave të njoftimit. Duke këmbëngulur për domosdoshmërinë e njoftimit konform kërkesave ligjore dhe standardeve për këtë problem në çështjen Sejdivic kundër Italisë, GJEDNJ-ja u shpreh se nuk përbën provë për të vërtetuar se i pandehuri po i shmanget gjykimit nga vetë fakti se i pandehuri është larguar nga vendbanimi dhe nuk gjendet menjëherë pasi ka ndodhur vepra. Në këto kushte Gjykata duhet të pranojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provon se ato po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Po i njëjti arsyetim duhet të ndiqet edhe në rastin kur është një avokat i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit që kërkon rivendosjen në afat, për të ankimuar vendimin e një shkalle më të ulët. Në këtë rast gjykata duhet të hetojë nëse vërtet i pandehuri nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij dhe nëse mbrojtësi ligjor i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit është zgjedhur me dijeninë e këtij të fundit<sup>33</sup>. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.45 datë 10.10.2011 në një tjetër gjykim ka rikonfirmuar arsyetimin e mësipërm, duke arsyetuar se; “Në rastin objekt shqyrtimi kërkuesi pretendon se nuk ka pasur dijeni se ndaj tij ishte filluar një çështje penale pasi njoftimet e kryera nga gjykata janë bërë në adresa të gabuara dhe se adresa e tij ka qenë dhe është një banesë e ndryshme nga ajo në të cilën gjykatat kanë bërë njoftimet. Njoftimi i të pandehurit, në legjisllacionin shqiptar, rregullohet nga nenet 132 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtyre dispozitave, kur kopja e aktit nuk mund t’i dorëzohet personalisht të pandehurit, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ja dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të pandehurin, një fqinji, ose një personi që punon me të (neni 140 i Kodit të Procedurës Penale). Nga materialet bashkëngjitur dosjes gjyqësore vërehet se njoftimet janë bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm si në adresën (Lagjja nr.4, Rr. Skënderbeu, Durrës) e deklaruar nga bashkëshortja e kërkuesit në prokurën e posaçme me nr.566 Rep., nr.213 Kol., datë 15.12.2005, ashtu edhe në adresa të tjera të identifikuar nga verifikimet e bëra nga organet shtetërore të ngarkuara për kërkimin e kërkuesit. Gjithashtu rezulton se fletë-thirrjet e gjykatave, drejtuar kërkuesit, janë marrë ose nga avokati i tij (fletë-thirrja e datës 02.06.2006) ose nga vëllai i tij B.S (fletë-thirrja e datës 19.07.2006). Duke vlerësuar personat marrës të fletë-thirrjeve, si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale si dhe formën e përmbajtjen e fletë-thirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të Kodit të Procedurës Penale. Vlen gjithashtu të theksohet se nga korrespondenca ndërmjet gjykatave të të dyja niveleve dhe organeve të Policisë së Shtetit, rezulton se nga këta të fundit kërkuesi është kërkuar jo vetëm pranë adresave të lartpërmendura, por edhe në vende të tjera, në bazë të informacioneve dhe verifikimeve të kryera nga punonjësit e Policisë së Qarkut, gjithmonë pa sukses. Këto organe kanë njoftuar zyrtarisht Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe atë të Apelit Durrës, se nga kërkimet e kryera kanë informacion se kërkuesi është larguar familjarisht nga Republika e Shqipërisë (shih shkresën nr. 3194/1 prot., datë 13.07.2006 të Komisarariatit të Policisë Durrës). Sa më lart, Gjykata çmon se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjisllacioni procedural penal si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit. Gjykata vëren gjithashtu se nga dokumentet bashkëngjitur dosjes gjyqësore, rezulton se bashkëshortja e kërkuesit (F.S) me anë të prokurës së posaçme me nr.566 Rep., nr.213 Kol., datë 15.12.2005, ka autorizuar avokatin G.J.B. të përfaqësojë gjatë hetimit dhe gjykimit bashkëshortin e saj I.S, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Nga pyetjet drejtuar mbrojtësit të kërkuesit në seancë plenare, Gjykata krijoi bindjen se kërkuesi I.S ka pasur dhe vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me bashkëshortin dhe se kjo e fundit ka vepruar gjatë redaktimit të prokurës sipas porosisë të kërkuesit (shih proces-verbalin e seancës plenare datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe së bashku me bashkëshortin e tij, pas redaktimit të prokurës nga kjo e fundit, janë larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur gjithashtu me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me

qëllim për t'ju fshehur drejtësisë. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjkata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar<sup>188</sup>.

Gjithashtu me Vendim Nr.5 datë 25.02.2013, Gjkata Kushtetuese ka theksuar:

“Gjkata rikonfirmon qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij.”<sup>189</sup>

Në vijim të këtyre arsyetimeve dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjkata Kushtetuese, lidhur me procedurën e gjykimit në mungesë, respektimi i të cilës lidhet drejtëpëdrejtë me parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, arrijmë në përfundimin se gjykata duhet që të kryejë të gjitha veprimet procedurale për njoftimin e të pandehurit, dhe vetëm pasi të ketë ezauruar këto veprime procedurale, të mund të deklarojë mungesën e të pandehurit në gjykim, sipas nenit 351/1 të K.Pr.Penale, duke vazhduar më pas gjykimin me mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët. Vendimi i ndërmjetëm i gjykatës, që deklaroi mungesën e të pandehurit, është i revokueshëm nëse i pandehuri paraqitet më pas në gjykim. Veprimet procedurale që janë kryer në gjykim, para se i pandehuri të paraqitet në gjykim mbeten të vlefshme. Megjithatë nëse i pandehuri provon, se njoftimi është kryer me vonesë jo për fajin e tij, atëherë gjykata marrjen ose përsëritjen e veprimeve që çmohet se kanë rëndësi për marrjen e vendimit përfundimtar. Në nenin 352 të K.Pr.Penale, është parashikuar mungesa e vullnetshme e të pandehurit si dhe largimi i vullnetshëm i të pandehurit. Pjesëmarrja e të pandehurit nuk është një detyrim për të pandehurin por është një e drejtë e tij. Në bazë të kësaj dispozite, kur i pandehuri kërkon apo jep pëlqimin që gjykimi të vazhdojë në mungesë të tij, ose duke qenë edhe i paraburgosur por refuzon që të marrë pjesë, atëherë gjykimi vazhdon në mungesë të të pandehurit dhe në këtë rast i pandehuri përfaqësohet nga mbrojtësi i tij. E njëjta situatë është edhe rasti kur i pandehuri duke qenë i pranishëm në seancë gjyqësore, me vullnetin e tij të lire largohet nga salla. Në këtë rast i

---

<sup>188</sup> Vendimin Nr. 5, datë 25.02.2013, i Gjykatës Kushtetuese

<sup>189</sup> Po aty

pandehuri konsiderohet i pranishëm dhe përfaqësohet në gjykim nga mbrojtësi i tij. Rast tjetër i gjykimit në mungesë, është edhe rasti kur provohet se i pandehuri fshihet, por kjo është një rrethanë që duhet të provohet në gjykim, pra duhet të provohet se i pandehuri ka dijeni për gjykimin dhe që ai i fshihet drejtësisë. Kërkesa e të pandehurit për të vazhduar gjykimin në mungesë, mundet të bëhet verbalisht përpara gjykatës ose mundet të bëhet edhe me kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës, por duke vërtetuar nënshkrimin e tij para noterit. Ndërsa kur i pandehuri gjykohet me masë sigurimi “arrest në burg”, kërkesa mundet të vërtetohet edhe nga titullari i institucionit ku i pandehuri ndodhet i paraburgosur. Gjykimi në mungesë, parashikuar në nenin 352 të K.Pr.Penale, ndryshon nga deklarimi i mungesës së parashikuar nga neni 351/1 i K.Pr.Penale. Ndryshimi nuk qëndron në procedurën e mëpasëshme të gjykimit, e cila është e njëjtë, por qëndron në veprimet procedurale që duhet të bëjë gjykata para se të vendosë me vendim të ndërmjetëm, që të vazhdojë gjykimin në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 352 të K.Pr.Penale, zhvillohet duke qënë i njohur për gjykatën fakti se i pandehuri ka dijeni për gjykimin, por me vullnetin e tij të lirë ai nuk merr pjesë. Ndërsa vendimi i ndërmjetëm sipas nenit 351/1 të K.Pr.Penale, merret nga gjykata pasi ajo ka kryer një sërë veprimesh procedurale, me qëllim kryerjen e të gjitha përpjekjeve për njoftimin e të pandehurit, i cili mundet që edhe mos ketë dijeni se ndaj tij është duke u zhvilluar një gjykim. Gjatë gjykimit, në rast se i pandehuri nuk është paraqitur ose është deklaruar në mungesë, gjykata mundet të urdhërojë edhe shoqërimin e detyrueshëm të të pandehurit apo të personit ndaj të cilit është bërë kërkesa për gjykim. Por ky veprim procedural, nuk mundet të bëhet për pyetjen e të pandehurit, por kur paraqitja e të pandehurit është e domosdoshme për marrjen e një prove. Veprime të tilla mundet të jetë këqyrja e të pandehurit, marrja e kampionëve të gjakut, fijeve të flokut, zhvillimi i njohjes së personit, apo veprime të tjera të kësaj natyre që domosdoshmërisht kërkojnë praninë e të pandehurit. Veprimet paraprake të gjykimit në shkallë të parë, pasi gjykata sigurohet për prezencën e palëve, praninë e mbrojtësit, si dhe respektimin e procedurës për njoftimin e të pandehurit, vijnë më pas me fazën e kërkesave paraprake. Në këtë fazë mundet të bëhen kërkesat lidhur me juridiksionin, kompetencën, për bashkimin apo ndarjen e çështjes, mbi legjitimitimin e paditësit, nëse në procesin penal do të gjykohet edhe padia civile<sup>35</sup>. Nëse këto kërkesa nuk bëhen në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor, atëherë ato nuk mundet të ngrihen gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përrjashtim bën vetëm rasti kur mundësia për të ngritur këto lloj kërkesash, lind gjatë shqyrtimit gjyqësor, pra kur prokurori apo i pandehuri dhe

mbrojtësi vihen në dijeni për rrethana që lidhen me këto kërkesa gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në fazën e kërkesave paraprake ngrihen edhe kërkesat që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të akteve dhe të veprimeve procedurale. Në nenin 129/2 të K.Pr.Penale, është parashikuar që pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e provës, duhet të kundërshtohet para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor. Ngritja që në këtë fazë e pretendimeve, për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, detyron gjykatën që të marrë një vendim lidhur me aktet që kundërshtohen. Pranimi i kërkesave për pafshmërinë e akteve që në këtë moment procedural, bën që gjykata të përjashtojë nga lista e provave që do të shqyrtohet ato që janë deklaruar si të pavlefshme, të cilat nuk administrohen në gjykim dhe nuk bëhen pjesë e proces verbalit të seancës gjyqësore. Mosshqyrtimi i këtyre provave krijon mundësinë që gjykata të marrë vendimin përfundimtar, bazuar vetëm në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të vlerësuara si të vlefshme, dhe në këtë mënyrë gjykata nuk ndikohet në çmuarjen e provave dhe në vendimin përfundimtar nga rezultatet e provave që janë të pavlefshme. Në praktikën gjyqësore ka dhe raste, kur gjykata në mënyrë të gabuar në fazën e kërkesave paraprake, kur bëhen kërkesat për pavlefshmëri të akteve të hetimeve paraprake, nuk merr një vendim të ndërmjetëm lidhur me këto kërkesa, ku të vendosë nëse provat janë të vlefshme dhe që duhet ti nënshtrohen debatit gjyqësor apo janë të pavlefshme dhe nuk duhet të administrohen nga gjykata, dhe nuk duhet të bëhen pjesë e fashikullit të gjykimit. Në këto raste gjykata shprehet se “rezervon të drejtën që të shprehet lidhur me kërkesën në një fazë të mëvonshme apo në vendimin përfundimtar”, ndërkohë që neni 354/3 i K.Pr.Penale, parashikon në mënyrë taksative se “për kërkesat paraprake gjykata disponon me vendim”.<sup>190</sup> Madje ky vendim, megjithëse është një vendim i ndërmjetëm, duhet që detyrimisht të jetë i arsyetuar në proces verbalin e seancës gjyqësore. Mosmarrja e vendimit nga gjykata, lidhur me çmuarjen e pavlefshmërisë që në këtë fazë të gjykimit shton rrezikun që gjykata të ndikohet në marrjen e vendimit nga prova që mundet të jenë të pavlefshme, pavarësisht se ajo mundet ti deklarojë më pas të pavlefshme, por ndërkohë gjykata është njohur me rezultatet e tyre dhe i ka shqyrtuar ato. Në këtë fazë palët mund të bëjnë edhe kërkesë për gjykim të shkurtuar. Pasi kalon dhe faza e kërkesave paraprake dhe gjykata merr vendim lidhur me bazueshmërinë e tyre, procesi vijon më tej me deklarimin e hapur të

---

<sup>190</sup> K.Pr.Penale, neni 354/3 i tij



shqyrtimit gjyqësor si dhe përshkruan në mënyrë të detajuar në proces verbalin e seancës gjyqësore, gjeneralitetet e të pandehuri dhe akuzën në ngarkim të tij. Më pas gjykata fton prokurorin e seancës, që të parashtojë para gjykatës parashtrimin e tij hyrës, faktet objekt akuze si dhe provat që kërkohen të shqyrtohen në gjykim. Në vijim e merr fjalën mbrojtësi ose i pandehuri, të cilët në këtë moment procedural parashtrajnë qëndrimin e tyre lidhur me akuzën, tregojnë para gjykatës se cilat janë ato fakte dhe rrethana që synojnë të provojnë gjatë gjyqimit dhe njëkohësisht mundet të kërkojnë edhe marrjen e provave. Duke i'u referuar parashikimeve të nenit 356/3 të K.Pr.Penale, kërkesat për marrjen e provave si nga prokurori ashtu edhe nga mbrojtësi i të pandehurit, duhet që të bëhen që në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor.<sup>191</sup> Në të kundërt nëse kërkesat për prova bëhen pasi ka filluar marrja e provave, ato nuk mundet që të shqyrtohen. Megjithatë, e njëjta dispozitë ka parashikuar që “lejohe marrja e provave që nuk janë kërkuar paraprakisht kur pala që i kërkon pretendon se nuk ka pasur mundësi t’i kërkonte”. Kjo i jep mundësinë prokurorit dhe mbrojtësit, që të kërkojnë gjatë shqyrtimi gjyqësor edhe prova të tjera nëse ato janë të nevojshme për rrethanat dhe faktet objekt të gjyqimit. Gjykata pasi dëgjon prokurorin, të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, dëgjon dhe kërkesat e tyre për prova, merr një vendim të ndërmjetëm për marrjen e provave. Në këtë vendim, gjykata përshkruan me hollësi se cilat prova të prokurorit lejon që të administrohen dhe të shqyrtohen në gjykim, si dhe cilat prova të mbrojtjes do të lejojë që të shqyrtohen në gjykim. Në këtë mënyrë, gjykata verifikon në parim se provat e kërkuara të administrohen nga palët nuk janë të kundraligjshme dhe që shqyrtimi i tyre është i nevojshëm për çështjen në gjykim. Vendimi i ndërmjetëm i gjykatës për lejimin e marrjes së provave, nuk është i pandryshueshëm. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata mundet të revokojë marrjen e provave që janë haptazi të panevojshme, si dhe njëkohësisht mundet të pranojë marrjen e provave që kanë qënë refuzuar për t’u shqyrtuar më parë. Të gjitha veprimet gjyqësore për marrjen e provave, si pyetja e dëshmitarit dhe përmbajtja e dëshmisë së tyre, shpjegimet e ekspertëve, paralajmërimi i tyre për të thënë të vërtetën dhe përgjegjësitë penale në rast të dëshmisë së rreme apo për ekspektim të rreme shënohen në proces verbalin e seancës gjyqësore. Në proces verbal përshkruhen edhe provat e tjera shkresore të shqyrtuara dhe të lexuara nga gjykata. Në përfundim të marrjes së provave, proces verbalet e seancave gjyqësore, aktet që janë lexuar gjatë seancave

---

<sup>191</sup> K.Pr.Penale, neni 356/3 i tij

gjqësor, si dhe dokumentat e paraqitura nga palët gjatë gjykimit, i bashkëngjiten me vendim të ndërmjetëm të gjykatës fashikullit gjyqësor. Gjykata nuk mundet të bazojë vendimin e vet në një provë apo dokument i cili nuk i është bashkëngjitur apo nuk ndodhet në fashikullin gjyqësor. Po citojmë më poshtë një vendim gjyqësor, ku Gjykata e Lartë ka konstatuar në një rast shkelje procedurale të Gjykatës së Apelit për shkak se në vendimin e kësaj të fundit përmendet një akt shkresor, i cili nuk është gjendur në fashikullin e gjykimit dhe si pasojë nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Konkretisht, në vendimin Nr.123 datë 02.03.2005 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se;

“... akti prej 72 fletë që përmendet në vendimin e gjykatës së apelit dhe në process verbalet e këtij gjykimi nuk ndodhet në dosjen gjyqësore. Mospërfshirja e këtij akti në dosjen gjyqësore përbën shkelje të urdhërimit të nenit 371 të K.Pr.Penale, sipas të cilit dokumentat e paraqitura nga palët dhe të pranuar nga gjykata futen, bashke me process verbalin e seancës, në fshikullin e gjykatës. Mosfutja në fashikullin e gjykatës e akteve të administruara, të shqyrtuara dhe të verifikuara në seancë gjyqësore, bën që, për përmbajtjen që ato paraqesin, gjykata më e lartë të mos ketë mundësi të vlerësojë vërtetësinë dhe fuqinë provuese që ato paraqesin.”<sup>192</sup>

Lidhur me administrimin në gjykim të provave shkresore apo dhe të të deklarimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake, si dhe mbi vlerësimin e tyre për të provuar ekzistencën e veprës penale si dhe fajësinë e të pandehurit, nuk mungon as jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në jurisprudencën e saj kjo Gjykatë, ka mbajtur qëndrimin se leximi në gjykim i deklarimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake nga dëshmitrari apo një person i bashkëpandehur në të njëjtën çështje apo në një çështje të lidhur, nuk përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, por një vendim dënimi nuk mundet që të mbështetet vetëm apo në mënyrë përcaktuese në këto deklarime. Konkretisht, në çështjen Luca kundër Italisë arsyetohet nga kjo Gjykatë se:

“...Ashtu si Gjykata ka vendosur në një numër rastesh, mund të jetë e nevojshme në disa raste që të bëhet referim në deponimet dhe deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit, në vecanti kur një dëshmitar refuzon të përsërisë deponimin e tij në publik për shkak të frikës për sigurinë e tij. Si të tilla pranimi i këtyre deponimeve si prova nuk do të përbënte shkelje të nenit 6 të Konventës. Megjithatë në rastet kur një fajësim dhe dënim mbështetet vetëm ose kryesisht në deponimet që janë bërë nga një person të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësinë që ta pyesë direkt ose indirekt, qoftë gjatë fazës së hetimit qoftë gjatë fazës së procesit gjyqësor, atëherë të drejtat e mbrojtjes janë kufizuar në një masë që është e papajtueshme me garancitë e parashikuara nga neni 6 i Konventës”<sup>193</sup>.

Marrja e provave të reja është parashikuar në nenin 367 të K.Pr.Penale në të cilin thuhet:

“Pas marrjes së provave të kërkuara nga, gjykata, në qoftë se është e nevojshme, mund të bëjë pyetje shtesë dhe të disponojë, edhe kryesisht, marrjen e provave të reja. Kur nuk është e

<sup>192</sup> Vendim Nr.123 datë 02.03.2005 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

<sup>193</sup> Vendimi i GjEDrNJ në çështjen Luca kundër Italisë, Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Ledi Bianku, fq. 410

mundur të procedohet në njëjtën seancë, ndërpritet gjykimi dhe caktohet data e seancës së re”.<sup>194</sup>

Ky është një moment procedural që vjen gjykata ka shqyrtuar më parë të gjitha provat e kërkuara nga prokurori dhe nga pala mbrojtëse. Në këtë fazë, duke marrë në konsideratë mënyrën e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor deri në atë moment, debatin gjyqësor lidhur mbi provat, prokurori dhe mbrojtësi me të pandehurin, kanë përsëri mundësinë që të kërkojnë para gjykatës marrjen e provave të reja. Mëgjithatë, kërkesat e tyre janë të kushtëzuara nga parashikimit e nenit 356 të K.Pr.Penale, sipas të cilit kërkesat për prova bëhen vetëm në fillimit të shqyrtimit gjyqësor, dhe lejohet marrja e provave që nuk janë kërkuar paraprakisht, vetëmkur pala që kërkon marrjen e tyre, pretendon se nuk ka pasur mundësinë që ti kërkonte më parë. Sa sipër, kërkesat e prokurorit apo të mbrojtjes për marrjen e provave të reja, në fazën që po bëhet fjalë, duhet që detyrimisht të arsyetojnë edhe pamundësinë e kërimit të tyre në fazën e kërkesave për prova.

Në këtë fazë të gjykimit, gjykata mundet të marrë prova edhe kryesisht, pavarësisht nëse marrja e tyre nuk kërkohet nga prokurori dhe pala mbrojtëse. Kjo mundësi procedurale, i jep mundësinë gjykatës që të mos ketë rol tërësisht pasiv, në procesin e marrjes së provave. Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se gjykata, në çështjen objekt gjykimi, me provat e administruara nuk mundet që të arrinte në përfundime të sakta lidhur me ndodhjen e faktit. Për këtë shkak, gjykata duhet të kishte kryer kryesisht veprimin e eksperimentit hetimor dhe vetëm pasi të kryente këtë veprim, do të mund të arrinte në përfundime të sakta lidhur me ekzistencën e faktit. Moment i rëndësishëm që ndan qëndrimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nga Gjykata e Apelit, është nëse në kushtet e pretenduara prej mbrojtjes së të gjykuarit, a mund të ishte aksidentale ngjarja e ndodhur apo jo. Gjykatat i janë referuar vetëm aktit të ekspertimit mjeko ligjor, duke e konsideruar atë të mjaftueshëm dhe mbështetur në provat e tjera, të cilat njëra gjykatë i ka marrë në favor të pretendimit të mbrojtjes dhe tjetra në disfavor të saj. Ky moment i rëndësishëm, ka mbetur thjesht një vlerësim i gjykatës dhe një çmuarje e saj, pa u mbështetur në një proces të plotë të të provuarit. Kjo ka sjelle si rezultat që për të njëjtat rrethana dhe vetëm për shkaqe të vlerësimeve të ndryshme, por jo shkencore të gjykatave, të jenë dhënë vendime diametralisht të kundërta, pra në ekstremet e zgjidhjes së çështjes, nga fajësi në pafajësi. Në

---

<sup>194</sup> Neni 367 K.Pr.Penale

bazë të nenit 367 të K.Pr.Penale, gjykata, pas marrjes së provave të kërkuara nga palët, në qoftë se vlerëson të nevojshme, mund të marrë kryesisht prova të reja.<sup>195</sup> Kolegji çmon se ka qënë rasti, që për të arritur në një përfundim sa më të bazuar dhe sa më afër të vërtetës, gjykata duhej të urdhëronte kryerjen e eksperimentit hetimor, i cili minimalisht mund të ekskludonte mundësinë e kryerjes së mekanizmit të ndodhjes së faktit të pretenduar nga mbrojtja e të gjykuarit. Vetëm mbi këtë bazë, në vazhdimësi, gjykata në analizë tërësore të provave të administruara në gjykim, do të mund të arrijë në përfundime të sakta lidhur me ndodhjen e faktit<sup>196</sup>.

Duke qënë se në sistemin tonë procedural akuzator, me elementë inkuizitorë, provat krijohen dhe marrin vlerën provuese para gjykatës, pasi i nënshtrohen debatit dhe shqyrtimit gjyqësor, në praktikë nuk mundet të përjashtohen rastet kur, megjithë ekzistencën e burimeve të provave ndaj të pandehurit në fazën e hetimeve, provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk janë të një niveli të tillë saqë të provojnë tej çdo dyshimi se vepra penale ka ndodhur, dhe se ajo është kryer nga i pandehuri i akuzuar. Situata të tilla në praktikë mundet të shkaktohen për shkak të mangësive procedurale në kryerjen e veprimeve ose për shkaqe të tjera. Në një situatë të tillë prokurori nuk mundet ti kërkojë gjykatës deklarinimin fajtor për veprën penale për të cilën ai është akuzuar, pasi jo vetëm që do të ishte i pashmangshëm një vendim pafajësie i gjykatës që gjykon çështjen, por do të cënonte të drejtat dhe garancitë kushtetuese dhe të ligjshme të të pandehurit, si dhe veprimtarinë e rregullt dhe në përputhje ligjin të vetë funksionit të prokurorit. Instrumenti ligjor që shërben për të rikuperuar situata të tilla procedurale, është kalimi i akteve, parashikuar nga neni 377 i K.Pr.Penale. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 377 të K.Pr.Penale, kalimi i akteve mundet të vendoset nga gjykata vetëm në ato raste kur kërkohet nga prokurori, dhe jo kryesisht nga gjykata pa një kërkesë të prokurorit. Në përfundim të marrjes së provave të kërkuara nga palët, apo të provave të marra kryesisht nga ana e gjykatës, pasi zhvillohet debati gjyqësor lidhur me pranueshmërinë, vlefshmërinë, përdorshmërinë dhe vlerën e tyre provuese, zhvillohet diskutimi përfundimtar i palëve në procesin gjyqësor. Fillimisht diskutimi apo konkluzionet përfundimtare parashtrihen nga prokurori, dhe më pas me radhë nga mbrojtësi i të pandehurit apo vetë i pandehuri, si dhe palët private në procesin gjyqësor, nëse këto të fundit janë pjesë e një procesi gjyqësor. Gjatë fazës së diskutimeve

---

<sup>195</sup> K.Pr.Penale, neni 367 i tij

<sup>196</sup> Vendimi Nr.530, datë 03.11.2004 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

përfundimtare, prokurori dhe mbrojtës i të pandehurit, mundet të bëjnë replikë, por në çdo rast fjalën e fundit e ka i pandehuri, nëse ky kërkon që të bëjë replikë. Neni 378 i K.Pr.Penale, nuk ka parashikuar shprehimisht formën e paraqitjes së diskutimit përfundimtar, por në praktikën gjyqësore, ai paraqitet kryesisht me shkrim. Pas këtij momenti, Gjykata tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar. Vendimi gjyqësor përfundimtar, përfaqëson zgjidhjen në themel të çështjes gjyqësore, zgjidhje që jepet nga gjykata, duke u bazuar në provat e marra dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në vendimin e saj gjykata shpreh bindjen lidhur me ekzistencën ose jo të faktit penal, të veprës penale, për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, si dhe shkallën e fajit dhe rrezikshmërinë e tij shoqërore. Gjykata i jep vendimet në emër të Republikës, ashtu siç është parashikuar edhe në Kushtetutë<sup>197</sup>.

### **5.3. Ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së dhënë në mungesë të pandehurit**

E drejta e ankimit është një mjet procedural, i cili i jep mundësinë palëve realizojnë të drejtat e njohuar me ligj si dhe sistemit gjyqësor të ushtrij kontroll mbi vendimin e gjykatës<sup>198</sup>. Në sistemet bashkëkohore të drejtësisë penale, gjykatat e apelit luajnë një rol të rëndësishëm për ndreqjen e gabimeve të mundshme gjyqësore, si dhe kontribuojnë për zhvillimin e jurisprudencës së një vendi.<sup>199</sup> Vendimet e apelit janë mjetet parësore me anë të së cilave, përmes vlerësimit të gabimeve që kanë ndodhur gjatë gjykimit, zhvillohet e drejta penale materiale dhe ajo procedurale<sup>200</sup>. E drejta për të bërë ankim, sanksionohet edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga vendi ynë. Në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut<sup>201</sup>, si dhe në nenin 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, parashikohet e drejta e rekursit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Në nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, përcaktohet për shtetet detyrimi që të garantojnë nëpërmjet organeve kompetente gjyqësore, administrative ose legjislative të drejtën e individit për të ushtruar rekurs, si dhe krijimin e mundësive për gjykimin e këtij rekursi. Kjo e drejtë është rregulluar edhe në pikën 1 të nenit 2 të

<sup>197</sup> Neni 146 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

<sup>198</sup> Siracusanò,D.,Galati,A.&Tranchina,G.,Zappala,E.(2013)*Diritto Processuale Penale*,volume primo, Seconda Edizione, Milano: Giuffrè, fq.409

<sup>199</sup> Po aty

<sup>200</sup>OSCE, Maya Goldstein-Bolocan, “*Analiza e procedimeve të çështjeve penale në Republikën e Shqipërisë*”, fq.21

<sup>201</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 8

protokollit Nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>202</sup>. Gjatë gjykimit në Apel, nëse i pandehuri arrin të provojë se nuk ka marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë, sepse nuk ka pasur dijeni apo ka pasur shkaqe ligjore, atëherë gjykata vendos të përsërisë shqyrtimin gjyqësor (neni 427/4 i K.Pr.Penale). Në një vendim të sajën Gjykata e Lartë konstaton:

“... nuk rezulton që të jetë bërë njoftim për të gjykuarin A.H. ashtu siç përcakton neni 141 i K.Pr.Penale. Gjithashtu, nuk rezulton që të jetë bërë deklarimi i mungesës së tijkonform kërkesave të nenit 141 pika 1 dhe 2 të K.Pr.Penale. Për këtë shkak, i gjykuari A.H., gjatë shqyrtimit të çështjes në Apel, ka kërkuar që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor, sipas kërkesave të nenit 427 të K.Pr.Penale, por gjykata e ka rrëzuar këtë kërkesë. ...një kërkesëe tillë është e drejtë dhe ligjore. Në bazë të nenit 427 pika 4 të K.Pr.Penale, Gjykata e Apelit kishte detyrimin ligjor që, në kushtet kur i gjykuari A. H. nuk kishte marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë dhe për shkak të mosrespektimit nga ajo gjykatë të dispozitave procedurale mbi njoftimin e të pandehurit, kjo mospjesëmarrje do të konsiderohet pa dijeninë e të pandehurit, të pranonte kërkesën e të gjykuarit A.H. duke vendosur përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Shkelja e kësaj norme procedurale nga Gjykata e Apelit, ka sjellë si pasojë humbjen e së drejtës së ligjshme të të gjykuarit, përnjë proces të rregullt ligjor. Për këtë shkak, vendimi i Gjykatës së Apelit gjendet ipabazuar në ligj”<sup>203</sup>.

Pra nëse vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykimin që është zhvilluar ndaj tij në Shkallë të Parë, sepse nuk ka marrë dijeni apo për shkaqe ligjore, Gjykata e Apelit është edetyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Dispozita e përcaktuar në nenin 427/4 të K.Pr.Penale, përdor shprehjen “gjykata vendos” dhe jo “gjykata mund të vendosë”. Në këtë mënyrë i garantohet të pandehurit që është gjykuar në mungesë në Shkallë të Parë jo për faj të tij, një shqyrtim i ri i çështjes ku ai ka të drejtën të ngrëjë pretendime të faktit apo të ligjit, në lidhje me akuzat që i atribuohen. Urdhërimin për thirrjen dhe njoftimi i të pandehurit, për të marrë pjesë në gjykimin në apel, është një detyrim ligjor dhe jo fakultativ për gjykatën ( ashtu si edhe për gjykatën në shkallë të parë ), pjesëmarrja e të pandehurit të lirë apo të arrestuar në gjykim, dëgjimi dhe mbrojtja e tij është një drejtë kushtetuese. Në praktikën gjyqësore të Gjykatave të Apelit, pikërisht lidhur me thirrjen dhe njoftimin e të pandehurit në gjykim, efektivisht janë vërejtur qëndrime të ndryshme të kundërligjshme<sup>204</sup>, lidhur me mosurdhërimin e thirrjes dhe njoftimin e të pandehurit të lirë apo të arrestuar<sup>205</sup>; njoftimin vetëm të mbrojtësit të të pandehurit; rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga mbrojtësi për urdhërimin e thirrjes dhe njoftimin e të pandehurit; urdhërimin e thirrjes së të pandehurit, por mosrespektimin e kërkesave ligjor për njoftimin e të

<sup>202</sup> Protokollit Nr.7 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 2, pika 1

<sup>203</sup> Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues Nr. 2, datë 19.04.2001

<sup>204</sup> Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendim Unifikues Nr. 1, datë 15.02.2001

<sup>205</sup> Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.412, datë 18.04.2007

pandehurit të burgosur; Njoftimi i ankimit të bërë nga prokurori, pranë vendit të vuajtjes së dënimit ndërkohë që i pandehuri është liruar<sup>206</sup>.

Sigurimi të drejtës së pjesëmarrjes dhe dëgjimit të të pandehurit në gjykimin në apel, është një veprim i domodoshëm, jo vetëm në aspektin kushtetues e ligjor, por edhe për faktin se Gjykata e Apelit në dallim nga Gjykata e Lartë, gjykon edhe si gjykatë fakti.

Gjykata e Apelit duhet të tregohet e kujdesshme në bërjen e dallimit midis “njoftimit” të të pandehurit dhe “njoftimit” të mbrojtësit, moment i cili ngatërrohet në praktikë. Sikundër edhe u përmend, gjykatat jo rrallë njësojnë pozicionin e mbrojtësit me atë të të pandehurit, duke “barazuara” apo “njësuar” të drejtat dhe detyrimet e këtyre dy subjekteve të procesit penal. Por është i pandehuri, ai i cili përcakton, gjithnjë në kuadër të kërkesave ligjore, kufijtë e të drejtave të mbrojtësit të tij.

Garancitë apo të drejtat që i njihen të pandehurit nga neni 6/3 i Konventës, të cilat i trajtuam në të drejtat e tij gjatë fazës së hetimit të çështjes, është e kuptueshme se gjejnë zbatim gjatë gjithë procesit penal, deri në përfundimin e gjykimin në të tria shkallët e procesit gjyqësor.

Megjithatë, një tjetër kërkesë e rëndësishme “e procesit të rregullt ligjor” për të pandehurin, është e parashikuar në nenin 2 të protokollit 7 të KEDrNj sipas të cilit:

“Çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë, ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë, deklarimin e fajësisë ose të denimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, janë të përcaktuara me ligj »<sup>207</sup>.

Kushtetuta e R.Sh,sanksionon në nenin 43 të saj, të drejtën e ankimit ndaj çdo vendimi gjyqësor :“Kushdo ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.”<sup>208</sup>

Në kuptimin që i jep Konventa dhe Kushtetuta kësaj të drejte, është e qartë se procesi i rregullt ligjor, fillon me të drejtën për t’iu drejtuar një gjykate, dhe përfundon me dhënien e vendimit nga kjo gjykatë dhe ekzekutimin e tij. Pikërisht midis këtyre dy momenteve të fundit, pra nga dhënia e vendimit deri në ekzekutimin e tij, të pandehurit i njihet e drejta të kërkojë shqyrtimin dhe kontrollin e vendimit të kësaj gjykate, nga një gjykatë tjetër e një shkalle më të lartë. Kjo e drejtë përbën një garanci të nevojshme për të korigjuar apo pakësuar gabimet dhe dhënien e një vendimi të drejtë.

<sup>206</sup> Gjykata Kushtetuese, vendimet Nr. 9, datë 22.02.2001 dhe Nr. 17, datë 09.03.2001, Botimet Ilar, Tiranë

<sup>207</sup> KEDrNJ, Prot.7, neni 2

<sup>208</sup> Kushtetuta e RSh, neni 43

Megjithatë, kjo e drejtë nuk nënkupton që çdo çështje të kalojë detyrimisht nëpër të tri shkallët e gjyqësorit, por që për çdo vendim gjyqësor të ekzistojë një mundësi ankimi. Konventa e ka lidhur ushtrimin e kësaj të drejte dhe shkaqet e saj, me përcaktimet e bëra nga vetë legjislacioni i shtetit anëtar. Kështu, sipas Kushtetutës dhe K.Pr.Penale, sistemi ynë gjyqësor përbëhet nga tre shkallë gjykimi (neni 135 i Kushtetutës dhe neni 12 i K.Pr.Penale). Në nenin 410 të K.Pr.Penale, parashikohet shprehimisht se: “I pandehuri mund të bëjë ankim vetëm ose nëpërmjet mbrojtësit të tij”.<sup>209</sup> Në analizë të dispozitës së mësipërme, K.Pr.Penale, të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor i’a njeh të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, pra nuk ia rezervon shprehimisht vetëm të pandehurit si një e drejtë personale që s’mund të realizohet nga mbrojtësi i tij. Në vazhimesi, neni 410/2 K.Pr.Penale, sanksionon: “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar nga i pandehuri në format e parashikuara nga ligji”<sup>210</sup>. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se, kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, e drejta e ankimit ndaj vendimit mund të ushtrohet vetëm nga mbrojtësi i tij, i autorizuar shprehimisht me një akt përfaqësimi nga vetë i pandehuri.

Sipas përcaktimeve të këtij dispozitive të parashikuara në nenin 410 të K.Pr.Penale, mbrojtja e të pandehurit të gjykuar në mungesë mbetet “formale”, sepse realizimi i plotë i saj kërkon garantimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave procedurale të të pandehurit dhe interesave të tij, në çdo shkallë të gjyqimit, në mënyrë që pozita e të pandehurit në mungesë të mbrohet realisht, dhe të mos çenohet parimi i barazisë së armëve. Kjo për shkak se, shkelja e këtij parimi do të ishte e pashmangshme, nëse prokurori apo të pandehurit e tjerë që kanë qënë subjekte të pranishëm të gjyqimit në mungesë të të pandehurit në fjalë, duke realizuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqimit, i heqin atij mundësinë që të kërkojë qoftë edhe rivendosjen në afat të ankimit sipas nenit 147/2 të K.Pr.Penale. Për më tepër, nëse ankimi paraqitet nga prokurori, pozita e të pandehurit të gjykuar në mungesë, mund edhe të rëndohet në bazë të nenit 425/2 (a, b, c) të K.Pr.Penale, dhe me kalimin e çështjes në të gjitha shkallët e gjyqimit, vendimi do të marrë formë të prerë edhe për të pandehurin e gjykuar në mungesë.

Në analizë të dy dispozitiveve të nenit 410 të K.Pr.Penale, konstatohet një kontradiktë, e cila qëndron në faktin se, paragrafi i parë i njeh të drejtën e ankimit mbrojtësit të të pandehurit,

---

<sup>209</sup> K.Pr.Penale, neni 410

<sup>210</sup> K.Pr.Penale, neni 410/2



pavarsisht nëse është i zgjedhur apo i caktuar, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni, i kufizon këtë të drejtë të pandehurit të gjykuar në mungesë, duke parashikuar shprehimisht ushtrimin e kësaj të drejte vetëm nga mbrojtësi i autorizuar posaçërisht nga i pandehuri.

Sa sipër, kontradikta midis dy paragrafëve të nenit 410 ka ardhur si rezultat i ndryshimit të paragrafit të dytë të nenit 410 të K.Pr.Penale me Ligjin Nr.8813, dt.13.6.2002, duke u shtuar në këtë paragraf fjalët “nga i pandehuri”.<sup>211</sup> Dispozita e mëparshme sanksiononte se : “Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim, vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji”.<sup>212</sup>

Kjo dispozitë është interpretuar në mënyra të ndryshme nga Gjykatat e Apelit duke krijuar probleme në praktikën gjyqësore. Ky problem ka konsistuar në legjitimimin apo moslegjitimimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata, apo të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit që është gjykuar në mungesë, për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit.

Këtij problemi i janë dhënë zgjidhje të ndryshme nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Për zgjidhjen e këtij problemi në interpretimin e dispozitës së K.Pr.Penale dhe për unifikimin e praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues Nr.47, dt.28.01.1999, vendosën legjitimimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata për të përfaqësuar të pandehurin në të gjitha të drejtat e tij procedurale, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të dhënë në mungesë të tij, me arsyetimin se: “vendimi i marrë nga Gjykata është akt i përfaqësimit, i lëshuar në formën e parashikuar nga ligji” (neni 64 i K.Civil. dhe 410/2 i K.Pr.Penale.).<sup>213</sup>

Ndërsa me vendimin unifikues Nr. 354, dt.28.7.1999, Kolegjet e Bashkuara, e kanë çmuar jo të drejtë vendimin e mëparshëm unifikues dhe vendosën ndryshimin e praktikës gjyqësore me arsyetimin se, kjo praktikë mohon të drejtat e të pandehurit në procesin penal dhe, njohja e të drejtës së ankimit mbrojtësit të të pandehurit të caktuar kryesisht, e deformon dhe krijon anomali në procesin penal. Në këtë konkluzion Gjykata e Lartë ka arritur duke argumentuar se:

“Në gjykimin në Shkallë të Parë, për shkak të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal, mbrojtësi i caktuar kryesisht , merr të gjitha atributet e të pandehurit që gjykohet në mungesë dhe legjitimohet për bërjen e kërkesave dhe të kundërshtimeve që lidhen me atë

<sup>211</sup>Ligji Nr.8813, dt. 13.6.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” ,botuar në fletoren zyrtare Nr.29, dt. 26.6.2002

<sup>212</sup> K.Pr.Penale, miratuar me Ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995

<sup>213</sup> Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 47, dt. 28.02.1999

fazë gjykimi. Me dhënien e vendimit, mbrojtësi përfundon së qeni palë në gjykim, e për pasojë nuk gëzon në të drejtat që ligji iu njeherë në procesin penal.

Kjo për arsye se, sipas nenit 50/1 të K.Pr.P., mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njeherë të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen atij personalisht. Në rastin e gjykimit në mungesë, neni 40/2 ia njeherë këtë të drejtë vetëm mbrojtësit të autorizuar posaçërisht për ushtrimin e saj. Pra akti i përfaqësimit duhet të lëshohet personalisht nga vetë i pandehuri. Mbrojtja kryesisht presupozon garantimin e një procedimi dhe gjykimi të drejtë, por kurrsesi disponimin tërësor mbi të drejtat që atij i njeherë ligji.

Nga ana tjetër, të pandehurit të gjykuar në mungesë, nuk i mohohet e drejta për të ankimuar një vendim të dhënë ndaj tij, pasi bazuar në nenin 147/2 të K.Pr.P, ai ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur vërtetohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dhënë, dhe pasi t'i jetë njohur kjo e drejtë, ai mund të bëjë ankim kundër vendimit, sipas rastit në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë.<sup>214</sup>

Po të njëjtin qëndrim, Gjykata e Lartë ka mbajtur edhe për mbrojtësin e zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit, duke mos e legjitimuar të bëjë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë të të pandehurit.

Në këtë përfundim, Gjykata e Lartë ka arritur me vendimin unifikues Nr.386 dt.29.7.1999, duke theksuar edhe njëherë se:

“Edhe mbrojtja e zgjedhur nga familjarët e të pandehurit në mungesë, presupozon garantimin e një procesi të rregullt ligjor, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave procedurale të të pandehurit, por kurrsesi disponimin tërësor mbi të drejtat e tij.

Sipas nenit 410/2, autorizimi duhet të jetë akti i lëshuar në formën e kërkuar nga ligji, personalisht nga i pandehuri. Aplikimi i të drejtës së ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në mungesë të të pandehurit, nga mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e tij, mohon të drejtën e tyre për të ushtruar ose jo ankim kundër vendimit të gjykatës.<sup>215</sup>

Gjykata Kushtetuese e vënë në lëvizje nga mbrojtësit e të pandehurve të gjykuar në mungesë, të zgjedhur nga të afërmit e tyre, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës për shkelje të së drejtës kushtetuese të mbrojtjes dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, me vendimin Nr.17 dt.17.4.2000, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimit Nr.386 dt.29.7.1999, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqytrim prej tyre me këtë arsytim:

“Përcaktimi në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët e të pandehurve nuk legjitimohet në bërjen e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, çënon parimin kushtetues të mbrojtjes në procesin penal.

Sipas nenit 410/2 të K.Pr.P, kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji. Kurse në nenin 48 përcaktohet se zgjedhja e mbrojtësit për të pandehurin mund të behet nga një i afërm i tij.

Gjykata Kushtetuese çmon se në këtë rast, akti i përfaqësimit plotëson kërkesat e ligjit (neni 48, dhe neni 410/2 të K.Pr.P.). E drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, nuk është një e drejtë ekskluzive, që i takon vetëm të pandehurit, siç është e drejta për të pranuar ose jo veprën penale, por sipas ligjit (n.410/1) e drejta e ankimit i takon edhe mbrojtësit, si një nga kushtet për realizimin e plotë të mbrojtjes. T’i mohosh mbrojtësit ankimin, kur këtë të drejtë ia njeherë ligji,

<sup>214</sup> Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 354, dt. 28.7.1999

<sup>215</sup> Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 386, dt. 29.7.1999

do të thotë të mos sigurosh mbrojtjen e të pandehurit. E drejta e ankimit ndaj vendimit të fajësisë, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes është në favor të të pandehurit dhe jo në disfavor të tij, prandaj mosushtrimi i saj çënon të drejtat ligjore të të pandehurit.

Në arsyetimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara konfundohet e drejta e ankimit me të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afatin e humbur për të bërë ankim. Duhet të kemi parasysh se, i pandehuri që gjykohet në mungesë nuk e realizon dot vetë as të drejtën e ankimit e as atë të rivendosjes në afat, prandaj ligji në zbatim të parimeve kushtetuese, ngarkon me këtë detyrë dhe njëkohësisht i jep të drejtën mbrojtësit të caktuar në një nga format e parashikuara nga ligji.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara ka çënuar procesin e rregullt ligjor edhe për shkak se nga pranimi për shqyrtim i rekursit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë dhe moslegjitimiti i mbrojtësit të caktuar nga familjarët e të pandehurit, i vë palët në pozita të pabarabarta. Ky qëndrim vjen në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve n.6 i K.E.Dr.Nj. Në këtë rast, po të pranohej arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara se mbrojtësi i caktuar sipas ligjit nga familjarët e të pandehurit, nuk legjitimohet të bëjë apel kundërshtues dhe as të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në shkallët e tjera të gjykimin, kjo do të bënte që gjykimi në Apel dhe në Gjykatën e Lartë të zhvillohej vetëm me një palë, duke shkelur kështu parimin e rëndësishëm të kontradiktorialitetit në procesin penal, dhe njëkohësisht procesin e rregullt ligjor.

Ankimi që bëhet ndaj vendimit të fajësisë së gjykatës nga cilido mbrojtës i caktuar në kushtet e parashikuara nga ligji, ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të të pandehurit, dhe nuk mund të interpretohet si mohim i të drejtës së tij për të bërë vetë ankim. Përkundrazi, moslejimi i ankimit, çënon të drejtën e mbrojtjes dhe shqyrtimin e çështjes nga një instancë më e lartë gjykimi.

Caktimi i mbrojtësit, në mënyrat dhe kriteret e parashikuara nga ligji, përfshirë edhe mbrojtësin e caktuar kryesisht, dhe njëkohësisht e drejta e tyre për të bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës, ka për qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor në të gjitha shkallët e gjykimin.

Si konkluzion, mbrojtësi i të pandehurit që gjykohet në mungesë, i caktuar sipas kërkesave të ligjit, gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtësit në një mbrojtje të detyrueshme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës.<sup>216</sup>

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të vendimit të tyre, rishqyrtuan çështjen e mësipërme dhe me vendimin Nr.371, dt.27.10.2000 kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në interpretimin e normave procedurale që lidhen me çështjen duke sjellë argumenta shtesë si më poshtë:

“Përsa i përket realizimit të së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit në procesin penal, sipas nenit 31 të Kushtetutës, nenit 6/3 (ç) të K.E.Dr.Nj., nenit 6 të K.Pr.P. si dhe të nenit 351 të K.Pr.P, duke iu referuar rastit në shqyrtim, nuk konstatohen papajtueshmëri midis këtyre dispozitave ligjore e kushtetuese. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se mospërmbyshja e detyrimit për caktimin e mbrojtësit të pandehurit që gjykohet në mungesë, do të përbënte shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës.

Si konkluzion, në gjykimin në shkallë të parë, të pandehurve u janë garantuar të drejtat kushtetuese të mbrojtjes dhe të një procesi të rregullt ligjor.

Në lidhje me të drejtën kushtetuese të ankimit kundër vendimit gjyqësor, duke analizuar dispozitat e nenin 43 të Kushtetutës, nenin 2 të protokollit 7 të K.E.Dr.Nj. dhe neni 410 të K.Pr.P., konstatojmë se me ligj të pandehurve u njihet dhe u garantohet e drejta e ankimit, e cila është një e drejtë e ngushtësisht personale. Nuk konstatohet ndonjë kufizim i kësaj të drejte kushtetuese për të pandehurin që gjykohet në mungesë, por vetë gjykimi i tij në mungesë, përbën një kufizim të së drejtës kushtetuese të të pandehurit për t`u mbrojtur. Sipas vlerësimit të Kolegjeve të Bashkuara, ky kufizim nuk është antikushtetues, sepse është brenda parametrave të nenit 17 të Kushtetutës. Akti i përfaqësimit i lëshuar në format e parashikuara nga ligji, duhet të plotësojë elementët bazë të një prokure, d.m.th. i përfaqësuar nuk mund të jetë tjetër person veç i pandehuri i gjykuar në mungesë, ndërsa përfaqësuesi, mbrojtësi i caktuar prej tij.

<sup>216</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSh, Nr. 17, dt. 17.4.2000, Botimet Mihal Duri e Re, Tiranë

Mbrojtësi i caktuar kryesisht apo i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit, nuk përfaqëson vullnetin e tij, sepse nuk ka tagër përfaqësimi prej tij. Ai kryen vetëm një funksion publik që i është caktuar nga gjykata në interes të drejtësisë, për të ndihmuar në mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit në gjyq dhe për të garantuar një minimum standarti të një procesi të rregullt ligjor. Misioni i mbrojtësit mbaron me përfundimin që ka dhënë gjykata e shkallës së parë. Ndërsa mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit edhe sikur të ketë prokurë prej tyre për të bërë ankim kundër vendimit, kjo prokurë është e pavlefshme (s'është dhënë nga vetë I pandehuri).

Në thelb moslejimi i të drejtës së ankimit të mbrojtësit të caktuar kryesisht apo të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit, në rastet e gjykimit në mungesë, nuk i dëmton interesat e tij. Një mbrojtës i tillë, duke mos patur mundësi të kontaktojë me të pandehurin, e ka shumë të kufizuar mundësinë për të siguruar prova që do ta shfaqësonin të pandehurin ose do të lehtësonin pozitën e tij.

I pandehuri në mungesë, ndodhet në pozitë më të favorshme në qoftë se vendimi i shkallës së parë merr formë të prerë pa u ankimuar, sesa në qoftë se vendimi do të ankimohej në të gjitha shkallët dhe të lihej në fuqi. Kjo e fundit, do të çonte në një zgjidhje përfundimtare të çështjes dhe në ezaurimin e mjeteve mbrojtëse të të pandehurit. Përkundrazi, i pandehuri që është gjykuar në mungesë, me të marrë dijeni për vendimin e dhënë kundër tij, ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit të tij, duke pasur barrën e provës për të provuar se nuk ka marrë dijeni për vendimin (neni 147/2 i K.Pr.P).

Përsa u përket rasteve kur çështjen në Apel e çon prokurori ose të pandehurit e tjerë të pranishëm në gjykim, ato do të trajtohen njëjloj si rasti kur një i pandehur ka marrë dijeni rregullisht për vendimin e dhënë kundër tij dhe nuk e ka çmuar të leverdisshme për të bërë ankim.<sup>217</sup>

Krahas këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara ka patur edhe një mendim pakice, sipas të cilit interpretimi me karakter unifikues që bën Gjykata e Lartë nuk është përfundimtar, ai nuk ka fuqi detyruese sipas neni 132/1 të Kushtetutës. Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara ka karakter detyrues vetëm për gjykatat më të ulta (neni 141/2 i Kushtetutës).

Çdo organ kushtetues, dispozitat e Kushtetutës i zbaton drejtpërdrejt, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe (neni 4/3 i K.). Kjo dispozitë u jep të drejtë këtyre organeve të bëjnë interpretimin e këtyre normave kushtetuese sipas fushave të veprimtarisë së tyre. Por, nëse ky interpretim i bërë nga organet kushtetuese, ankimohet nga subjektet e parashikuara në neni 134 të Kushtetutës, është e drejtë e Gjykatës Kushtetuese të bëjë interpretimin përfundimtar. Në këtë rast, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, sipas neni 132/1 ka fuqi detyruese të përgjithshme (erga omnes), ndaj dhe është detyrues edhe për Gjykatën e Lartë.

Duke qënë se Kolegjet e Bashkuara në rigjykimin e çështjes mbajtën të njëjtin qëndrim, Gjykata Kushtetuese, e vënë në lëvizje nga avokatët e të pandehurve, sipas neni 131/f të Kushtetutës, me vendimin Nr.5 dt.7.02.2001 vendosi përsëri shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit Nr.371 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me arsyetimin se :

---

<sup>217</sup> Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë, Nr. 371, dt. 27.10.2000

“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë cënuar të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet:

- 1) mohimit të së drejtës për t'u mbrojtur dhe
- 2) të së drejtës për gjykim, të garantuara në nenin 31/c, 42 të Kushtetutës, nenin 6 të K.E.Dr.Nj. Pavarshisht nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ato kanë vazhduar t'i qëndrojnë mënyrës së mëparshme të interpretimit të normave procedurale-penale, dhe kanë arritur në përfundimin se procesi i gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është zhvilluar rregullisht. Kolegjet e Bashkuara e kanë zgjidhur çështjen në kundërshtim me interpretimin kushtetues të bërë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj. Gjykata Kushtetuese çmon se çështja e mësipërme është zgjidhur prej saj në mënyrë definitive me vendimin Nr.7, dt.17.4.2000, ndaj sipas parimit “res judicata”, ajo nuk mund të rishikohet përsëri në të ardhmen. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe kanë efektet e forcës së ligjit. Edhe vendimet e Kolegjeve të Bashkuara për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore duke qënë vendime unike dhe detyruese vetëm për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, i nënshtrohen kontrollit të kushtetueshmërisë së tyre nga Gjykata Kushtetuese. Ky kontroll realizohet në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, ndaj në këtë drejtim vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm edhe për Gjykatën e Lartë.”<sup>218</sup>

Nga zgjidhjet e ndryshme që kanë dhënë për çështjen e mësipërme Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, u pa si rrugëzgjidhje nga ana e ligjvënësit ndryshimi i nenit 410/2 të K.Pr.Penale, duke shtuar fjalët “nga i pandehuri”.

Megjithatë, në vijim të mendimit që është dhënë më lart, ndryshimi i kësaj dispozite ka krijuar më tepër kontradikta e paqartësi në kuptimin e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 410, si dhe ka çuar në sanksionimin nga vetë K.Pr.Peale, i kufizimit të së drejtës së mbrojtjes të pandehurit që gjykohet në mungesë, duke cënuar procesin e rregullt ligjor në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDrNj.

Të gjitha kriteret e mësipërme, duhet të udhëheqin procesin gjyqësor dhe janë premisa të domosdoshme për të patur një procedurë të drejtë në gjykatë, ashtu siç e kërkon Konventa.

#### **5.4 Gjykimi në mungesë i të pandehurit dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut**

Detyrimi për zhvillimin e nje procesi të rregullt gjyqësor përcaktohet ne nenin “6” të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Megjithëse nuk është qartësisht e shprehur në nenin 6/1 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, objekti dhe qëllimi i këtij neni i marrë si i tërë, nënkupton se një person “i akuzuar për një vepër penale” duhet të njohet në lidhje me procedimin ndaj tij. Më tej në nënparagrafët ‘c’, ‘d’ dhe ‘e’ të paragrafit 3, i

<sup>218</sup>Vendim i Gjykatës Kushtetuese, Nr.5 dt.7.02.2001,Botimet Mihal Duri e Re, Tiranë

garantojnë të drejtën e “çdonjërit të akuzuar për një vepër penale”, të mbrojnë veten, të dëgjojnë ose të dëgjojnë dëshmitarë dhe të ketë ndihmë falas nga një përkthyes nëse nuk kupton gjuhën e përdorur në gjykim. Nëse i pandehuri nuk do të merrte pjesë në gjykim, do ta kishte të pamundur të ushtronte këto të drejta që i sigurohen atij nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore<sup>219</sup>. Proçedimi në mungesë të të akuzuarit nuk është nëvetvete në papërputhshmëri me nenin 6 të Konventës. Megjithatë, do të ishte pa dyshim një mohim i drejtësisë, në rast se një person i dënuar në mungesë, nuk do të kishte më pas mundësi të dëgjohej nga një gjykatë e cila do të përcaktonte rishtas faktet e çështjes në respektim të ligjit dhe provave. Kjo do të ndodhte në rast se nuk është përcaktuar se i pandehuri, ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë dhe për tu mbrojtur në gjykim. Konventa u jep Shteteve Kontraktuese një liri veprimi të gjerë, për të përcaktuar mjetet në sistemin e tyre ligjor, që do të ishin në pajtim me kërkesat e nenit “6”. Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse qëllimi i përcaktuar nga Konventa është arritur. Në veçanti, mjetet procedurale të ofruara nga ligji vendas dhe praktika një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale, i cili nuk ka hequr dorë nga paraqitja dhe mbrojtja në gjykim dhe as ka kërkuar ti shpëtojë gjykimit, duhet të jenë efektive. Gjykata, më tej arsyeton se e drejta e të akuzuarit për të qenë pjesëmarrës në gjykim ose gjatë rigjykimit, është një nga kërkesat themelore të nenit 6 të Konventës. Si rrjedhim, refuzimi i kërkesës për rigjykim i të akuzuarit, procesi penal në ngarkim të të cilit është bërë në mungesë të tij dhe pa provuar se ai gjatë gjykimit kishte hequr dorë nga e drejta për t’u mbrojtur, është një shkelje flagrante e konventës. Neni 6 i Konventës nuk e ndalon të akuzuarin të heqë dorë, në mënyrë të shprehur ose me veprime konkludente, nga garancitë që i siguron neni 6 i Konventës për një gjykim të drejtë. Megjithatë, heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim, në mënyrë që të jetë në përputhje me Konventën, duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe duke respektuar minimumin e kërkesave ligjore në përpjestim me rëndësinë e saj. Për më tepër kjo heqje dorë, nuk duhet të vijë ndesh me interesin publik. Gjykata është shprehur se, në rast se një person i akuzuar për një vepër penale, nuk është njoftuar personalisht në lidhje me akuzat që rëndojnë ndaj tij, nuk mund të konkludohet vetëm nga fakti i statusit të tij si i arratisur, në rast se ky status është bazuar në prova të paplota, se ai ka hequr dorë nga e drejta për të mbrojtur veten. Gjithashtu, para se të konkludohet se me

---

<sup>219</sup>Colozza kundër Italisë, fq.26; FCB kundër Italisë, fq.33; Belzuik kundër Polonisë, fq. 37

sjelljen e tij, një i akuzuar ka hequr dorë nga një e drejtë e parashikuar në nenin 6 të Konventës, duhet të vërtetohet se ai ka pasur mundësi të parashikojë pasojat e sjelljes së tij. Për më tepër, nuk i takon të akuzuarit barra e proves. Neni 6, paragrafi 3 (a) i Konventës, përcakton se çdo njeri i akuzuar për kryerjen e një veprë penale ka të drejtë të informohet menjëherë, në një gjuhë që kupton dhe në mënyrë të detajuar për natyrën dhe shkaqet e akuzave që rëndojnë kundër tij. Ky parashikim, tregon për vëmendjen e veçantë që duhet të ketë njoftimi i akuzës për të pandehurin. Formulimi i akuzës, luan një rol kryesor në procesin penal, pasi që nga ky moment i akuzuari vihet formalisht në dijeni të provave dhe bazës ligjore që mbështesin akuzën e ngritur kundër tij. Qëllimi i parashikimit të cituar më lart, duhet të vlerësohet nën dritën e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, e garantuar nga neni 6/1 i Konventës. Është detyrë e Gjykatës për të siguruar një proces të rregullt gjyqësor dhe në përputhje me rrethanat, të sigurojë që mbrojtësi, i të akuzuarit që po gjykohet në mungesë, ka të gjithë ndihmën e nevojshme për të kryer detyrën e tij. Ndërsa sanksionon të drejtën e gjithësecilit, të akuzuar për një vepër penale, për të mbrojtur veten personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore, neni 6.3 (c) nuk përcakton shprehimisht mënyrat për ta ushtruar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë ju mbetet Shteteve kontraktuese, zgjedhja e mjeteve ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte. Gjithashtu është detyrë e Gjykatës, për të vlerësuar nëse metoda e zgjedhur është në përputhje me kërkesat e nenit 6 për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Në këtë aspekt, duhet të kihet parasysh se të drejtat e parashikuara nga Konventa garantojnë të drejta që nuk janë teorike ose abstrakte por efektive dhe praktike. Pra, në vijim të këtij arsyetimi, vetë momenti i caktimit të një mbrojtësi personit që akuzohet për një vepër penale, nuk siguron efektivitetin e Konventës. Megjithatë një Shtet nuk mund të jetë përgjegjës për çdo dështim ose problem nga ana e avokatit të caktuar kryesisht ose nga i akuzuari. Kjo është pjesë e pavarësisë, që sistemi gjyqësor e në këtë rast mbrojtësi ligjor ka nga Shteti, duke qenë se sjellja e përfaqësuesit, si ai i caktuar nga shteti dhe ai i zgjedhur nga i akuzuari, është çështje që i përket të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij ligjor. Nëse vihen në dijeni, autoritetet kompetente shtetërore kërkohet të ndërhyjnë për të siguruar një përfaqësim efektiv për të akuzuarin.

## 5.5 Gjykimi në mungesë në këndvështrimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare

### 5.5.1 Gjykimi në mungesë dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare

Kishte kohë që kërkohej nga Kombet e Bashkuara, ekzistenca e nje institucioni penal ndërkombëtar, me status të veçantë e të përhershëm, për të gjykuar krime që drejtoheshin kundër njerëzimit, krime të cilat bota i sheh të përsëriten gjithmonë: genocidi, krimet e luftës kundër civilëve, përfshirë vrasjen, torturën, përdhunimin, dëbimin dhe skllavërinë, si edhe krimet e agresionit. OKB-ja kishte filluar me anë të rezolutave, krijimin e bazës ligjore në rrugë diplomatike, për një gjykatë të përhershme penale ndërkombëtare. Më herët ishin ngritur Gjykata ndërkombëtare të përkohshme për të gjykuar krime, siç ishte rasti i Ruandës, kur OKB miratoi rezolutën Nr.955, dt.8 nëntor 1994. Por të tilla Gjykata nuk kishin një status të përhershëm. Ato pasi kryenin misionin e tyre për të cilat ishin ngritur, pushonin së ekzistuari. Pas masakrave të kryera në ish-Jugosllavi në fillim të viteve 1990 , OKB-ja vendosi në bazë të rezolutës Nr. 808, dt. 22 shkurt 1993, që të krijojë një gjykatë ndërkombëtare për të gjykuar personat përgjegjës të cilët kishin kryer krime të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-jugosllavisë që nga viti 1991<sup>220</sup>. Në datë 25 Maj 1993 Këshilli i Sigurimit, me anë të rezolutës Nr.827, i hapi rrugë miratimit të statusit ligjor ndërkombëtar që do të kishte kjo Gjykatë. Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, i miratuar nga Konferenca Diplomatike e të Plotëfuqishmëve në Kombet e Bashkuara për themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, më 17 korrik 1998 përcaktoi saktësisht që në nenin “1” se me këtë Statut themelohet Gjykata Ndërkombëtare Penale. Kjo Gjykate u krijua si një institucion i përhershëm, dhe ka autorizim të ushtrojë juridiksionin e vet ndaj personave përgjegjës për krimet më serioze ndërkombëtare, të përcaktuara qartësisht në objektin e gjykimit të Gjykatës. Gjykata Ndërkombëtare Penale, gjatë veprimtarisë së saj është parë edhe si ndihmë dhe plotësim i juridiksioneve penale kombëtare, duke ndihmuar shtetet anëtare dhe jo vetëm, në përmirësimin e sistemeve penale të brendshëm dhe duke unifikuar kështu për të gjitha shtetet anëtare, një qëndrim të njëjtë ndaj krimeve dhe veprave penale të kryera në territoret e tyre, ana objektive e të cilave bën pjesë në kompetencën dhe juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Gjykata Penale Ndërkombëtare, ka selinë e saj të

---

<sup>220</sup>Rezoluta Nr.955 dt. 8 nëntor 1994 (OKB)



përhershme në qytetin e Hagës në Shtetin e Hollandës, por ajo në raste të veçanta mund të punojë edhe në vend tjetër, kudo që e konsideron të arsyeshme, siç parashikohet në këtë Statut. Gjykata ka personalitet ligjor ndërkombëtar dhe aftësi ligjore të domosdoshme, për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj. Gjykata mund të ushtrojë funksionet dhe pushtetin e saj në territorin e cilitdo shtet palë, siç parashihet në këtë Statut dhe, përmes marrëveshjes së posaçme, edhe në territorin e cilitdo shteti tjetër, kur ky nuk është palë e nenshkrimit të statutit të Romës.

### ***5.5.2 Mënyra e procedimit gjatë gjykimit në GJNP për personin e akuzuar***

GJNP nuk e lejon absolutisht gjykimin në mungesë të një të pandehuri. Derisa sa personi për të cilin është nxjerrë një urdhër arresti të kapet apo të dorëzohet para GJNP, kryhen veprime hetimore nga Prokurori dhe veprime kërkimi nga oficerët e policisë së interpolit ose të policive të shteteve, që kanë detyrimin të dorëzojnë çdo person të akuzuar për të cilin ka një urdhër arresti ndërkombëtar. Statuti i Romës parashikon kryesisht për personin që akuzohet një sërë normash (statuti i Romës nenet 53-67), ku përshkruhen garancitë e personit të akuzuar, të drejtat dhe detyrimet e tij, të prokurorit dhe të Gjykatës. Në çdo kohë pas fillimit të hetimeve, Dhoma e Procedurës Paraprake, me kërkesë të Prokurorit, lëshon urdhër-arrestin për personin, nëse, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave ose ndonjë informacioni tjetër të dorëzuar nga Prokurori, plotësohen këto kushte: (a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për të besuar se ai person ka kryer krimin brenda juridiksionit të Gjykatës; dhe (b) arrestimi i personit paraqitet si i nevojshëm: (i) për të siguruar paraqitjen e personit në gjykim; (ii) për të siguruar se personi nuk do të pengojë ose rrezikojë hetimet ose procedurën gjyqësore, ose (iii) kur është e zbatueshme, për të ndaluar personin nga vazhdimi i kryerjes së atij krimi ose krimit të ngjashëm, që është brenda juridiksionit të Gjykatës dhe që del nga rrethanat e njëjta. Personi i arrestuar sillet pa vonesë para organit gjyqësor kompetent, në Shtetin që bën ndalimin, i cili përcakton, në pajtim me ligjet e atij Shteti, se: (a) urdhri për arrest është i zbatueshëm ndaj atij personi; (b) personi është arrestuar në përputhje me procedurat e rregullta; dhe (c) të drejtat e personit janë respektuar. 3. Personi i arrestuar ka të drejtë të kërkojë nga organi kompetent, në Shtetin që ka të drejtën e ndalimit, lirimin e përkohshëm në pritje të dorëzimit, të drejtat e tij. Me rastin e dorëzimit të personit në Gjykatë, ose paraqitjes së personit para Gjykatës në mënyrë vullnetare ose sipas fletëthirrjes, Dhoma e Procedurës Paraprake, krijon bindje nëse personi

është informuar për krimet të cilat ai ose ajo pohohet se i ka kryer, dhe për të drejtat e tij ose saj sipas këtij Statuti, përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar lirimin e përkohshëm në pritje të mbajtjes së gjyqimit. I akuzuari është i pranishëm gjatë gjyqimit.<sup>221</sup> Nëse i akuzuari, duke qenë i pranishëm para Gjykatës, vazhdon të pengojë gjyqimin, Dhoma e Gjyqimit mund ta largojë të akuzuarin dhe i krijon kushte, që të ndjekë gjyqimin dhe të këshillojë avokatin jashtë gjykatës, përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit, nëse kjo kërkohet. Masa të tilla ndërmerren vetëm në rrethana të posaçme, pasi të gjitha mundësitë e tjera të arsyeshme të jenë provuar si të papërshtatshme dhe vetëm për kohën e përcaktuar rreptësisht. Në përcaktimin e çfarëdo akuze, i akuzuari ka të drejtën e gjyqimit me dyer të hapura, duke iu referuar dispozitave të këtij Statuti, për një dëgjim të drejtë të zhvilluar në mënyrë të paanshme, dhe për garancitë minimale të mëposhtme, në barazi të plotë: (a) të njoftohet menjëherë dhe në hollësi rreth natyrës, shkakut dhe përmbajtjes së akuzës, në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet lirisht; (b) të ketë kohën dhe mjetet e duhura, për përgatitjen e mbrojtjes dhe për të komunikuar lirisht dhe në besim, me avokatin të cilin i akuzuari e ka zgjedhur vetë; (c) të gjykohet pa shtyrje të paarsyeshme; (d) kushtëzuar nga neni 63, paragrafi 2, të jetë i pranishëm në gjykim<sup>222</sup>, të bëjë mbrojtjen personalisht ose përmes ndihmës juridike sipas zgjedhjes së të akuzuarit, nëse i akuzuari nuk ka ndihmë juridike, të jetë i informuar për këtë të drejtë dhe të ketë ndihmën juridike të caktuar për të nga Gjykata, në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, dhe pa pagesë, në rast se të akuzuarit i mungojnë mjetet e mjaftueshme për të paguar atë; (e) të ekzaminojë ose të ketë ekzaminuar dëshmitarët kundër tij ose saj, dhe të sigurojë praninë dhe ekzaminimin e dëshmitarëve në dobi të tij ose saj, nën kushtet e njëjta, si edhe për dëshmitarët kundër tij ose saj. I akuzuari, po ashtu, ka të drejtë të paraqesë mbrojtjen dhe prova të tjera të lejueshme sipas këtij Statuti; (f) të ketë ndihmën e përkthyesit kompetent falas dhe përkthime të tilla, që janë të domosdoshme për të plotësuar kërkesat e drejtësisë, nëse cilado nga procedurat ose dokumentet, e paraqitura para Gjykatës nuk janë në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet lirisht; (g) të mos detyrohet të dëshmojë ose

---

<sup>221</sup>Belzuik kundër Polonisë, fq.37; Nëse i pandehuri nuk do të merrte pjesë në gjykim do ta kishte të pamundur të ushtronte këto të drejta që i sigurohen atij nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

<sup>222</sup>FCB kundër Italisë, fq.33; Në çështjen e F.C.B kundër Italisë<sup>181</sup>, gjykata italiane e riktheu çështjen për gjykim në mungesë të kërkuarit megjithëse ishte informuar nga këshilltari i tij ligjor se ai mbahej në paraburgim jashtë shtetit. Gjykata deklaroi se kërkuari nuk kishte shprehur dëshirën për të hequr dorë nga pjesëmarrja

të pranojë fajin dhe të heshtë, dhe një heshtje e tillë të mos merret në konsideratë gjatë përcaktimit të fajit ose pafajësisë; (h) të japë deklaratë me gojë ose me shkrim në mbrojtje të tij ose saj pa bërë betimin; dhe (i) të mos i nënshtrohet detyrimit për të vërtetuar pafajësinë e rastit ose barrës për të kundërshtuar provat. Përveç njoftimeve të tjera të parashikuara në këtë Statut, Prokurori i njofton mbrojtjes, sa më parë që të jetë e mundur, provat që i posedon Prokurori ose ka nën kontrollin e tij dhe për të cilat ai ose ajo beson që tregojnë ose kanë tendencën të tregojnë pafajësinë e të akuzuarit, ose të zbusin fajin e të akuzuarit, ose mund të ndikojnë në besueshmërinë e provave të ndjekjes penale. Gjykata vendos në çdo rast dyshimi, në lidhje me zbatimin e këtij paragrafi<sup>223</sup>.

---

<sup>223</sup> Colozza kundër Italisë, fq.26; Një gjyq penal në mungesë të të akuzuarit apo të një pale mund të lejohet në disa rrethana përjashtuese nëse autoritetet kanë vepruar me kujdes, por nuk kanë mundur të vënë në dijeni personin përkatës për ta marrë në seancë

## **KAPITULLI VI: VËSHTRIM KRAHASUES I TË DREJTËS PENALE SHQIPTARE MË ATË TË HUAJ NË KUADRIN E TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT**

### **HYRJE**

Vendet në tranzicion, të cilët kanë një sistem demokratik dhe shtet ligjor, kanë hartuar legjislacionin e tyre penal, duke respektuar zhvillimet në të drejtën ndërkombëtare, specifikat e brendshme të shtetit të tyre si dhe përpjekjet për t'u qasur me legjislacionin penal europian. Ligji penal shqiptar në dhjetëvjeçarin e fundit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime këto të cilat lindin nga zhvillimi i vullshëm i shoqërisë dhe evolimi i rendit shoqëror. Aspirata për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian, ka bërë që legjislacioni ynë të shkojë drejt përmirësimit, duke pasur si pikë referimi modelin e ligjit penal të vendeve të Europës, duke implementuar në këtë mënyrë një ligj penal sa më efikas dhe efektiv.

Në kuadrin e reformave institucionale në shtetin e ri demokratik shqiptar, ligjvënësi ishte i detyruar për të bërë ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ndryshime që u aprovuan me Ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995<sup>224</sup>. Kodi i ri i Procedurës Penale u ndërtua në bazë të modeleve bashkëkohore të Kodeve të shteteve demokratike si: Franca, Gjermania, Italia, etj dhe për kohën që u aprovua, i'u përgjigj standarteve ndërkombëtare. Ligji procedural penal nuk është statik dhe i pandryshuar, përkundrazi ai ka ndryshuar në varësi të kushteve sociale, ekonomike dhe politike të vendit dhe në përputhje me kërkesat objektive të praktikave gjyqësore. E drejta penale shqiptare, është në përpjekje të vazhdueshme në rrugën e saj drejt përqasjes së legjislacionit me atë të Bashkimit Europian. Ky fakt, pasqyrohet në ndryshimet e herëpashershme që kane karakterizuar ligjin penal e atë procedural penal në vazhdimësi, duke pasur përparësi zbatimin e parimeve bazë të së drejtës penale.

### **6.1 Vështrim krahasues i të drejtës sonë me të drejtën penale italiane**

Kodi ynë i Procedurës Penale i miratuar në vitin 1995, në kohën e miratimit të tij, si dhe në kontekstin historik të zhvillimit të legjislacionit penal në Shqipëri, përfaqëson një hap

---

<sup>224</sup>Kodi Procedurës Penale, miratuar me Ligjin Nr.7905, dt. 21.03.1995, dt.miratimi 05.04.1995, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.5, fq.159

përpara dhe me rëndësi në drejtim të demokratizimit të ligjit procedural penal, në garantimin e të drejtave dhe lirive të individit në procesin penal, në krijimin e themeleve të qëndrueshme të shtetit të së drejtës, si dhe në garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor, të personave që i nënshtroheshin procesit penal. Praktika gjyqësore aktuale, jo në pak raste, ka krijuar problematika të ndryshme në disa momente të procesit penal, për zgjidhjen e të cilave shpesh i referohemi legjislacionit procedural penal Italian, si dhe praktikës gjyqësore të këtij shteti, duke u munduar kështu për të gjetur zgjidhje të këtyre problematikave, të cilat jo në pak raste janë krijuar edhe për shkak të mos implementimit të saktë dhe të plotë të normave procedurale të legjislacionit në fjalë, por edhe për shkak të një praktike të pakonsoliduar dhe kryesisht të varfër gjyqësore.

Kodi aktual i Procedurës Penale në Itali ka hyrë në fuqi më datë 24.10.1989<sup>225</sup>. Deri në këtë datë në shtetin Italian zbatoheshin Kodi i Procedurës Penale të vitit 1930, i njohur me emrin “Kodi Rocco”, emërtim që lidhej me mbiemrin e Ministrit të Drejtësisë në Itali në kohën e miratimit të këtij Kodi. Kodi Rocco karakterizohej nga përshtatja e një skeme të tipit të përzier, ku ishin të pranishme pjesërisht tiparet dhe rregullat procedurale inkuizitore dhe pjesërisht ato akuzatore. Tiparet inkuizitore të procesit penal, konstatoheshin në fazën e hetimeve, i cili në vetvete ishte i ndarë në dy momente: hetimi i përgjithshëm, që i ishte besuar Prokurorit, si dhe hetimit formal, që i ishte besuar gjyqtarit hetues, i cili kishte si qëllim hulumtimin dhe formimin e provave, nëpërmjet iniciativës së lirë të gjyqtarit në kërkimin e tyre dhe që kryhej sipas parimit të fshehtësisë. Në këtë fazë prokurori ishte në fazë tërësisht të pabarabartë me të pandehurin dhe mbrojtësin, por ishte gjyqtari hetues ai që kryente një rol aktiv në procesin e kërkimit dhe marrjes së provave.<sup>226</sup> Ndërsa, tiparet e sistemit akuzator ishin të pranishme në fazën e debatit gjyqësor, i cili gjithsesi mbetej i kufizuar nga provat e siguruara nga organi akuzës që në fazën e hetimeve paraprake, sipas metodave inkuizitore. Kodi i Procedurës Penale i vitit 1989, në vënd të sistemit procedural penal të përzier që karakterizonte K.Pr.Penale të mëparshëm, krijoi një sistem procedural të tipit akuzator. Tiparet e këtij sistemi, bëjnë më mirë të mundur gërshetimin e garancisë me efikasitetin e procesit penal, dhe që shfaqen në dallimin e qartë midis rolit të prokurorit dhe të gjyqtarit, në eliminimin e fshehtësisë së akteve të gjyqtarit dhe në formimin e provës, në

---

<sup>225</sup> Alibrandi, L. & Coso, P. (2015) *Codice Penale e di Procedura Penale*, Itali: Editore : Tribuna

<sup>226</sup> Brazzi, M. (2012) *La difesa dell'indagato nella fase precautoire-L'arresto in flagrante e il fermo-*, Milano: Giuffrè

theksimin më tepër të të drejtave të palëve dhe në barazinë e tyre, në vlerësimin e rolit të debatit gjyqësor dhe të zhvillimit të debatit gjyqësor oral para gjyqtarit.<sup>227</sup>

Në Itali, efektshmëria e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, varet mbi të gjitha nga efektshmëria e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Por, kryesisht, ajo varet nga mundësia që i krijohet individit për të përdorur mjetet e caktuara ligjore në rastet e akteve apo praktikave që dhunojnë këto të drejta.

Kushtetuta italiane parashikon një garanci të plotë: kur një individ pretendon se i është dhunuar një e drejtë, duhet të ketë gjithmonë një gjyqtar kompetent që të dëgjojë pretendimin e tij. Në të vërtetë neni 24 i Kushtetutës (shih nenin 42/2 të Kushtetutës shqiptare) parashikon: “çdokush mund të ndërmarre veprime ligjore për të mbrojtur të drejtat individuale dhe interesat legjitime”; neni 13 deklaron: “mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave legjitime kundër dhunimeve shtetërore është gjithmonë e lejueshme para gjyqtarëve të zakonshëm apo administrative” dhe: “kjo mbrojtje gjyqësore mund të mos jetë e kufizuar vetëm për lloje të veçanta apelimi apo për kategori të veçanta veprimesh.”<sup>228</sup>

### **6.1.1 Gjyqtarët dhe gjykatat penale në Itali**

Në nenin 1 të K.Pr.Penale Italiane është parashikuar që, “juridiksioni penal ushtrohet nga gjyqtarët e parashikuar nga ligjet që rregullojnë sistemin gjyqësor”<sup>229</sup>. Mbi bazën e këtyre ligjeve që rregullojnë sistemin gjyqësor në Itali, detyra e gjyqtarëve penal në Itali, kryhet nga gjyqtarët profesionistë, të quajtur ndryshe “toga”, të cilët i përkasin sistemit gjyqësor, si magistratë karriere. Por, ushtrojnë detyrën e gjyqtarit edhe gjyqtarët honorarë, të quajtur ndryshe “laik”, me të gjitha funksionet që ka edhe gjyqtari i vetëm. Kemi të bëjmë edhe me subjekte që vetëm në mënyrë të përkohshme vishen me pushtet juridiksional, siç është rasti i gjyqtarëve të paqes, prania e të cilëve justifikohet me faktin se numëri i gjyqtarëve profesionistë është i pamjaftueshëm për të përballuar volimin e punës në zyrat gjyqësore. Në raste të tjera, elementë laikë marrin pjesë në formimin e trupave gjyqësore kolegjiale së bashku me gjyqtarët profesionistë. Duke iu referuar llojeve të juridiksionit dallojmë në sistemin gjyqësor në Itali disa lloje të gjyqtarëve penalë; Gjyqtarë të përgjithshëm dhe gjyqtarë të veçantë. Kriteri dallues midis këtyre dy kategorive, qëndron në faktin se disa gjyqtarë e ushtrojnë funksionin e tyre në rastet e përgjithshme të veprave penale dhe të pandehurve, ndërsa disa gjyqtarë të tjerë i ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore për një kategori të caktuar veprash penale dhe për një kategori të caktuar të pandehurish.<sup>230</sup> Kjo

<sup>227</sup> Grilli, L. (2014) *Il dibattito penale, guida pratica*, Milano: Giuffrè

<sup>228</sup> Gjykata Kushtetuese, Komisioni i Venecias, fq. 38

<sup>229</sup> *Codice di Procedura Penale e Leggi complementari*, (2014), Itali: botim Diritto & Diritti

<sup>230</sup> Spangher, G. (2012) *La pratica del processo penale*, Milano: Cedam

ndarje ekziston edhe në sistemin gjyqësor në Shqipëri, përmendim këtu gjyqtarët e Gjykatës për Krime të Rënda, që ushtrojnë funksionet e tyre për një kategori të caktuar të veprave penale që bëjnë pjesë në kompetencë e tyre lëndore, duke qënë kështu gjyqtarë të veçantë dhe jo të përgjithshëm që janë gjyqtarët e tjerë të juridiksionit të zakonshëm. Në sistemin procedural penal në fuqi në Itali, si gjyqtarë të përgjithshëm janë; a) Gjykata, që vepron në kuadrin e nëndarjeve administrative dhe që gjykon herë si organ monokratik, pra me një gjyqtar, që mundet të jetë edhe një gjyqtarë honorarë, dhe herë të tjera gjykon si organ kolegjal, me trupë gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë karriere. b) Gjykata e krimeve të rënda, që gjykon me trupë gjyqësore të përbërë nga tetë gjyqtarë, dy prej të cilëve janë gjyqtarë karriere, ndërsa gjashtë të tjerët janë gjyqtarë laikë. c) Gjyqtari i paqes, është organ monokratik honorar, që ushtron funksione gjyqësore për vepra penale të lehta apo për konflikte të vogla midis personave. Ndërsa, si gjykata të veçanta në sistemin procedural penal në Itali konsiderohen; a) Gjykata për të miturit, që ushtron funksionet gjyqësore me trup gjykues kolegjal, me dy gjyqtarë karriere dhe nga dy gjyqtarë laikë, një nga këta të fundit duhet të jetë mashkull dhe një femër, dhe që duhen të zgjidhen nga qytetarë të shquar në fushën e ndihmës sociale, kultivues të shkencës së biologjisë, psikiatrisë, antropologjisë kriminale, pedagogjisë, psikologjisë. b) Gjykatat ushtarake, që ushtrojnë funksione gjyqësore me trup gjykues të përbërë nga dy magjistratë, që i përkasin sistemit gjyqësor ushtarak dhe nga një ushtarak me funksionin e gjyqtarit. Të gjitha këto që përmendëm, janë gjykata që gjykojnë çështjet penale në shkallën e parë të gjykimit. Gjykojnë në shkallë të dytë, gjykata e apelit lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykata e zakonshme (pavarësisht nga përbërja e kësaj të fundit), gjykata e krimeve të rënda e apelit lidhur me vendimet e gjykatës së krimeve të rënda; ndërmjet gjyqtarëve të veçantë, gjykata e apelit për të miturit lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykata për të miturit, gjykata ushtarake e apelit lidhur me vendimet e gjykatës ushtarake. Gjithashtu, në sistemin gjyqësor Italian, ushtron funksionet gjyqësore Gjykata e Kasacionit, e cila sikurse edhe në sistemin gjyqësor në Shqipëri, është një gjykatë e shkallës së ligjshmërisë të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata e Kasacionit është një organ i vetëm, dhe në veprimtarinë e saj gjyqësore kufizohet me verifikimin, në këndvështrimin juridik, të procedimit dhe të vendimeve gjyqësore të nxjerra nga gjithë gjykatat e tjera, kontroll i cili kryhet për respektimin e ligjit. Në nenin 278 të Kodit të Procedurës sonë penale është parashikuar që, gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara në ligj, mbi kërkesën e prokurorit, të

pandehurit, të dëmtuarit dhe të palëve private, vendos gjykata. Dhe në zbatim të nenit 13/2, gërma (a) të K.Pr.Penale, në gjykatën e shkallës së parë, kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, gjykohen nga një gjyqtar, i cili në fakt është i njëjti gjyqtar që shqyrton të gjitha kërkesat e kryera gjatë hetimeve paraprake, lidhur më të njëjtën çështje penale.<sup>231</sup> Ky gjyqtar, është emërtuar me emrin gjyqtari i hetimeve paraprake. Gjatë fazës së hetimeve paraprake ai gjykon kërkesat e prokurorit për sekuestrime, në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji, kontrole, përgjime, kërkesat për vleftësimin e ndalimeve apo arrestimeve në flagrancë, kërkesat për sigurimin e provës, kërkesave për caktimin e masave të sigurimit, për zëvendësimin, shuarjen apo revokimin e tyre, ankimet e të pandehurit, mbrojtësit të tij apo të palëve private lidhur me vendime të ndryshme të prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në këtë pikë, ligji jonë procedural penal është i njëjtë me ligjin procedural Italian. Në Kodin e Procedurës Penale të Italisë, është parashikuar me të njëjtat karakteristika gjyqtari i hetimeve paraprake. Në ligjin Italian emërtimi si “gjyqtar për hetimet paraprake” në vend të “gjyqtari i hetimeve” – ka si qëllim për të sqaruar veçorinë e rolit: “një gjyqtar i veshur me kompetencat ad acta, të cilit, nuk i ngarkohet drejtimi i procedimit në tërësi, por vetëm për të marrë vendime, mbi kërkesat e veçanta që akuza dhe mbrojtja i paraqesin, në përmbushje të detyrimeve funksionale ndaj tezave të tyre respektive”. Gjithashtu, është një gjyqtar që gjatë zhvillimit të fazës hetimeve, kur nuk është formuluar akoma një akuzë dhe, si pasojë, nuk është vënë në lëvizje një veprim, nuk mund të marrë kompetencat dhe të shqiptojë vendime që i përkasin akuzës. Në Kodin e Procedurës sonë penale, në nenin 327/2 të tij është parashikuar që, prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë. Pra, pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, prokurori ka detyrimin në bazë të kësaj dispozitë, që të njohë me të gjitha aktet e procedimit penal të pandehurin ose mbrojtësin e tij, dhe vetëm më pas të vendosë pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë. Në Kodin e Procedurës Penale Italiane, përfundimi i hetimeve, dërgimi i çështjes për gjykim dhe fillimi i gjykimit të çështjes, bëhet në një mënyrë krejt të ndryshme nga ajo që parashikohet nga ligji procedural penal shqiptar. Në ndryshim nga K.Pr.Penale Shqiptare, në Kodin e Procedurës Penale Italiane, është parashikuar që vendimi i pushimit të çështjes nuk merret nga Prokurori, por

---

<sup>231</sup> Kodi Procedurës Penale të R.Sh, neni 278, 13/2 i tij



nëse Prokurori në përfundim të hetimeve, vlerëson se ndjekja penale nuk mundet që të vazhdojë dhe që çështja penale duhet të pushohet, atëherë prokurori i bën kërkesë gjykatës për pushimin e çështjes, dhe vendimi në këtë rast merret nga Gjykata. Kërkesa për pushimin e çështjes i dërgohet gjyqtarit për hetimet paraprake, së bashku më fashikullin që përmban njoftimin e veprës penale, dokumentacionin që ka të bëjë me investigimet e kryera dhe procesverbalet e akteve të kryera më parë para gjyqtarit. Gjyqtari, nëse pranon kërkesën për arkivim, shpall vendimin e arsyetuar dhe i kthen aktet prokurorit. Këtë vendim gjyqtari i hetimeve paraprake e merr në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e të pandehurit, mbrojtësit apo të palëve private, dhe pa kontradiktoritet, procedurë e njohur me emrin de plano.<sup>232</sup>

Seanca paraprake zhvillohet në dhomën e këshillimit, duke përjashtuar, pra, çfarëdo publiciteti. Zhvillohet me pjesëmarrjen e nevojshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit. Trupi gjykues duhet të verifikojë paraqitjen e rregullt të palëve, duke urdhëruar ripërsëritjen e njoftimeve, të fletë-thirrjeve, të komunikimeve, të cilat mund të sjellin pavlefshmëri. Mund të ndodh që mbrojtësi i të pandehurit të mos jetë i pranishëm dhe gjyqtari, në këtë rast, do të duhet të caktojë, si zëvendësues, një mbrojtës tjetër menjëherë, gjithmonë nëse mungesa nuk i detyrohet pamundësisë absolute për t'u paraqitur me pengesë të ligjshme. Nëse i pandehuri nuk paraqitet në seancën paraprake dhe rezulton se fletë thirret drejtuar të pandehurit dhe njoftimet që i përkasin e tij janë të rregullta, gjyqtari i seancës paraprake, me anë të një urdhëri deklaron mungesën e të pandehurit dhe vazhdon seancën paraprake në mungesë të të pandehurit, duke u përfaqësuar ky i fundit nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij apo i caktuar nga gjykata. I njëjti vendim merret nga gjyqtari edhe në rastet kur i pandehuri ka shprehur vullnetin dhe lejon që seanca paraprake të zhvillohet në mungesë të tij. Për të gjitha veprimet procedurale që kryhen gjatë seancës paraprake, duhet që të mbahet proces verbali përkatës, i cili si rregull mbahet në formë përmbledhëse.

Pasi është deklaruar i mbyllur diskutimi i palëve në seancën paraprake, gjyqtari duhet që të procedojë me marrjen e vendimit. Në këtë rast, sipas nenit 424 të K.Pr.Penale Italiane gjyqtari mundet që të vendosë ; a) vendimin për mosfillimin e procesit ose b) vendimin që

---

<sup>232</sup> Lattanzi,G.&Lupo,E.(2008) *Codice di procedura Penale. Rassenga di Giurisprudenza e di dottrina*, Milano: Editore Giuffrè, fq.461

urdhëron gjykimin. Nëse njoftimet drejtuar të pandehurit që nuk është paraqitur në gjykim janë të pavlefshme, nuk konfirmohet dijenia e të pandehurit, apo nëse ai ka dijeni por ka një pengesë të ligjshme për të mos u paraqitur në seancën gjyqësore, atëherë gjykata edhe kryesisht përsërit njoftimin dhe shtyn seancën gjyqësore në një datë tjetër. Edhe sipas ligjit procedural italian, mundet që të zhvillohet gjykimi në mungesë të të pandehurit. Nëse mungesa e të pandehurit në seancë gjyqësore nuk lidhet me ndonjë nga rastet e parashikuara në ligj, gjyqtari bën deklarimin e mungesës të të pandehurit dhe urdhëron të procedohet më tej me gjykimin. Po kështu, nëse konstatohet se mbrojtësi i zgjedhur i të pandehurit mungon në seancë, kryhet zëvendësimi i tij me një mbrojtës tjetër të caktuar kryesisht.

Lidhur me zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, jo vetëm lidhur me fazën e gjykimit, por edhe në fazën e seancës paraprake, janë të dallueshme disa situata:<sup>233</sup>

a) Situata e parë ka të bëjë me pengesën për t'u paraqitur. Mungesa e të pandehurit apo e mbrojtësit nuk lejon në fakt fillimin apo vazhdimin e debatit gjyqësor. Pengesa duhet të mbartë pamundësinë absolute për t'u paraqitur dhe, sipas rrethanave, duhet të varet nga një rast faktor apo nga forca madhore, ose nga një pengesë tjetër e ligjshme, që vjen si për rastet e mungesës të të pandehurit po ashtu edhe për rastin e mungesës të mbrojtësit. Pasi të jetë vërtetuar pengesa, gjyqtari e shtyn edhe kryesisht debatin gjyqësor. Procedon, pra, me caktimin e një date për seancën e re, duke disponuar njëkohësisht me përsëritjen e njoftimit për të pandehurin dhe mbrojtësin e tij.

b) Situata e dytë ka të bëjë me rastin kur i pandehuri i njoftuar rregullisht për tu paraqitur në seancë gjyqësore, nuk paraqitet pa ndonjë pengesë të ligjshme. Në këtë rast gjykata me vendim, procedon me deklarimin e mungesës së të pandehurit. Deklarimi i mungesës së të pandehurit shënon fillimin e debatit gjyqësor, i cili në fakt karakterizohet nga disa specifika të veçanta në një rast të tillë. Vendimi për deklarimin e mungesës, është i pavlefshëm nëse i pandehuri nuk ka pasur dijeni për t'u paraqitur në gjykimin që zhvillohet në ngarkim të tij. Vendimi i deklarimit të mungesës është gjithashtu i pavlefshëm, nëse në momentin e shpalljes së mungesës, provohet që mungesa e të pandehurit i detyrohej pamundësisë absolute për t'u paraqitur për shkak të rastit faktor, forcës madhore apo ndonjë pengese tjetër të ligjshme. Vendimi i deklarimit në mungesë është i revokueshëm, nëse i pandehuri

---

<sup>233</sup> Geronimo,P.(2009) *Teoria e practica del diritto.IL contributo dell imputato all'acertamento del fatto*, Milano:Editore Giuffrè, fq. 93

paraqitet “me vonesë” ose dalin prova rreth padijenisë së thirrjes apo pamundësisë absolute për t’u paraqitur.

c) Situata e tretë lidhet me mungesën e vullnetshme të të pandehurit në gjykim. Mungesa e vullnetshme e të pandehurit, është e barazvlefshme me heqjen dorë nga një garanci për procesin e rregullt ligjor, e cila realizohet nëpërmjet mbrojtjes apo pjesëmarrjes në gjykim.

Pra, nëse i pandehuri gëzon të drejtën për t’u mbrojtur, dhe për të marrë pjesë efektivisht në debatin gjyqësor, kjo nuk duhet të kuptohet se i pandehuri e ka detyrim pjesëmarrjen e tij në gjykim, gjithmonë vetëm nëse vullneti për të munguar është i qartë apo është ligjërisht i prezumuar. Ky vullnet është i qartë kur i pandehuri, e shfaq shprehimisht dëshirën për të mos marrë pjesë në gjykim, duke kërkuar apo duke lejuar që debati gjyqësor të zhvillohet në mungesë të tij (nëse bëhet fjalë për të pandehurin e lirë), ose duke refuzuar praninë (nëse bëhet fjalë për të pandehurin e burgosur).

Lidhur me të treja këto situata, si dhe lidhur me zhvillimin e gjykimit në mungesë në tërësi, rregullat procedurale të zbatueshme sipas K.Pr.Penale italiane janë të ngjashme me rregullat procedurale të parashikuara lidhur me zhvillimin e gjykimit në mungesë nga Kodi ynë i Procedurës Penale. Në këtë moment midis këtyre dy legjislacioneve nuk kemi ndonjë dallim sepse për gjykimin në mungesë kodi ynë është mbështetur tërësisht duke përshtatur ose më mirë të themi kopjuar Kodin Italian<sup>234</sup>.

## **6.2 Vështrim krahasues me të drejtën penale franceze**

Kodi i Procedures Penale franceze, është në fuqi që nga viti 1958. Disa vite më vonë dy ngjarje të rëndësishme orientuan ndryshimet në kwtw Kod : konstitucionalizimi i ligjit dhe i së drejtës penale në vecanti dhe ndërkombëtarizimi i ndjekur nga ratifikimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe i Konventave të Kombeve të Bashkuara. Si rezultat i këtyre konventave, sistemi i tanishëm procedural penal është i ndryshëm nga ai i vitit 1958<sup>235</sup>.

Në vitin 1989, Komisioni i Drejtësisë Penale dhe të Drejtave të Njeriut, propozoi një listë me parime themelore që duhet të vendoseshin në hyrjen e Kodit të ri të Procedurës Penale.

---

<sup>234</sup> Shameti, M. (2014) *Sistemi gjyqësor penal shqiptar i parë në planin krahasues me atë italian*, Tiranë: Instituti i Studimeve Europiane

<sup>235</sup> Marty, M.D. & Spencer, J.R (2002) *European Criminal Procedures*, Kembrixh: Cambridge University Press, fq. 218.

Ky propozim nuk u pranua në atw periudhë dhe ndryshimet që i'u bënë Kodit të Procedurës Penale në vitin 2000, vendosën në hyrje të Kodit të Procedurës Penale disa parime referuese<sup>236</sup>. Disa nga këto parime kanë lidhje me të drejtat e të pandehurit. Parimet që gjenden në Kodine Procedurës Penale janë:

a-Procedura penale duhet të jetë e drejtë dhe akuzatore dhe të ruaj një ekuilibër midis të drejtave të palëve. Ajo duhet të garantojë një ndarje midis autoriteteve përgjegjëse për ndjekjen penale dhe atyre që janë përgjegjëse për gjykimin. Personat të cilët e gjejnë veten në një situatë të ngjashme dhe që ndiqen penalisht për të njëjtat vepra penale, duhet të gjykohen sipas rregullave të njëjta.

b-Çdo person i dyshuar për kryerjen e ndonjë vepre penale ose që ndiqet penalisht, prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia i tij nuk është e përcaktuar. Sulmet ndaj prezumimit të pafajësisë janë të ndaluara dhe dënohen sipas rregulla të përcaktuara nga Kodi. I pandehuri ka të drejtë të informohet për akuzat e ngritura kundër tij dhe të mbrohet ligjërisht.

c-Masat shtrënguese, të cilat mund t'i aplikohen një personi të tillë janë marrë ose janë nën kontrollin e një autoriteti gjyqësor. Ato duhet të jenë të kufizuara për nevojat e procesit, në mënyrë proporcionale me rrezikshmërinë e veprës për të cilën akuzohet personi dhe jo të çënojë dinjitetin njerëzor.

Akuza që i bëhet një personi, duhet të lihet në fuqi me një vendim të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm. Çdo person i dënuar ka të drejtë që vendimin e dënimit ta paraqesi për shqyrtim përpara një gjykate të shkallës së dytë.

### ***6.2.1 Pozita e të pandehurit gjatë hetimit në të drejtën penale franceze***

Një person i dyshuar për kryerjen e një vepre penale, mund të ndalohej nga policia gjyqësore fillim për një periudhë kohore prej 24 orësh, që mund të zgjatet me autorizim të prokurorit deri në 48 orë. Gjatë kësaj periudhe, i dyshuari mund të merret në pyetje nga policia. Policia nuk kishte e detyrimin të vinte në dijeni të dyshuarin, se ai nuk ishte i detyruar t'u përgjigjej pyetjeve të tyre, derisa u bënë ndryshimet e duhura në nenin 63 të Kodit të Procedurës Penale me Ligjin 2000-516, të datës 16 qershor të vitit 2000, i cili

---

<sup>236</sup> Po aty, fq. 221

parashikon detyrim e organeve të policisë, të vënë në dijeni personin se nuk është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të tyre<sup>237</sup>.

Ky ndryshim synon forcimin e prezumimit të pafajësisë në sistemin francez. Çdo pyetje duhet të rregjistrohet me shkrim dhe të jetë e nënshkruar nga i dyshuari dhe personi që e merr në pyetje. Procesverbali i marrjes në pyetje vendoset në dosje<sup>238</sup>.

Sistemi procedural penal francez, parashikon më shumë garanci sesa sistemi procedural penal shqiptar, lidhur me personat që nuk janë në gjendje të qëndrojnë në paraburgim për arsye shëndetësore. Është parashikuar në mënyrë eksplicite në Kodin e Procedurës Penale franceze, që personat e ndaluar, kanë të drejtë të ekzaminohen nga një mjek për të parë nëse ai person është i aftë për të qëndruar në dhomën e paraburgimit<sup>239</sup>. Personi i ndaluar, ka të drejtë të telefonojë partnerin, një të afërm, punëdhënësin dhe duhet të jetë i informuar për këto të drejta.

Nëse mund të bëjmë një krahasim për hetimin, sipas sistemit procedural penal shqiptar dhe atij francez, do të vëmë re se në sistemin procedural penal shqiptar, kërkesat e prokurorit për miratimin nga gjykata, të akteve më të rëndësishme dhe shqyrtimi i ankimeve në gjykatë kundër akteve të prokurorit, bëhen në gjykatën që ka kompetencën lëndore dhe tokësore, për gjykimin e çështjeve penale në të cilat përfshihen këto akte<sup>240</sup>. Në Francë, ato shqyrtohen nga një gjyqtar i caktuar vetëm me këtë detyrë, që ndryshe quhet “gjyqtari hetues”, i cili ka të drejtë të vendosë për kërkesat e palëve (duke përfshire edhe të pandehurin) gjatë hetimeve paraprake, si dhe për pushimin apo dërgimin e çështjeve në gjykatë<sup>241</sup>. Në doktrinën shqiptare<sup>242</sup> është mbajtur qëndrimi që pozicioni i një gjyqtari të tillë është i diskutueshëm, dhe përgjithësisht kritikohet sepse ai bëhet pjesë e ndjekjes penale dhe është i interesuar për mënyrën e përfundimit të hetimeve.

Jam e mendimit që zgjidhja e gjetur në Kodin e Procedurës Penale franceze, është më e mirë se sa ajo e sistemit tonë procedural penal, sepse gjyqtari hetues ushtron kontroll në hetimin e realizuar nga prokurori, ai mund të vendosi edhe pushimin e çështjes ose mosdërgimin e saj në gjykatë. Kompetencat e gjyqtarit hetues në Francë, janë më të gjera se

---

<sup>237</sup> Mckillop, B. (2003) *The position of accused persons under the common law system in the Australia (more particularly in New South Wales) and the Civil Law System in France*, vol. 26, Nr. 2, France : UNSW Law Journal, fq. 521

<sup>238</sup> Po aty

<sup>239</sup> Neni 63-3 i Kodit të Procedurës Penale franceze

<sup>240</sup> Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I. (2007) *Procedura penale*, Tiranë: Botimet Morava, fq. 394

<sup>241</sup> Po aty, fq. 394

<sup>242</sup> Po aty, fq. 394

sa kontrolli që ushtron gjykata në aktet e prokurorit, sipas sistemit procedural penal shqiptar.

Statistikat franceze evidentojnë të kundërtën e asaj që shprehet në doktrinën tonë, në lidhje me interesin e pushimit të çështjes nga gjyqtari hetues, sepse për më tepër se 97 % të rasteve të hetimeve të zhvilluara nga prokuroria, gjytari hetues ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim. Nëse gjyqtarit hetues i kërkohet nga prokurori, të hetojë një vepër penale, gjyqtari mund të kërkojë nga i pandehuri që të paraqitet në zyrën tij, që të merret në pyetje. Kjo mund të ndodhi shumë herë gjatë hetimit, sidomos kur është administruar një provë e re dhe është kërkuar përgjigja e të pandehurit. I pandehuri duhet të njoftohet për paraqitjen e tij përpara gjyqtarit hetues dhe marrja në pyetje mund të vazhdojë vetëm me pëlqimin e të pandehurit, pëlqim i cili jepet në prani të avokatit. Sipas ndryshimeve të bëra me Ligjin 2000-516, të datës 16 qershor të vitit 2000, gjykatësi hetues është i detyruar të njoftojë të pandehurin se ai mund të japi deklaratë, mund të merret në pyetje ose të heshti<sup>243</sup>. Duhet theksuar fakti se e drejta për të heshtur zbatohet në të gjitha etapat e procesit penal<sup>244</sup>.

Në lidhje me të drejtën e të pandehurit për të heshtur, Gjykata e të Drejtave të Njeriut në çështjen John Murray kundër Britanisë së Madhe e vitit 1996<sup>245</sup>, është shprehur se e drejta për të heshtur nuk është absolute, por kur organi i akuzës ka prova bindëse, i pandehuri duhet të japi disa shpjegime<sup>246</sup>.

Personi i cili është i pandehur, mund të heshti por mund edhe të japi deklaratë nëse dëshiron. Në rast se ai jep deklaratë, ato do të jenë pjesë e provave dhe do të vendosen në dosjen hetimore<sup>247</sup>.

## **6.2.2 Ndhimja ligjore për të pandehurin në të drejtën penale franceze**

---

<sup>243</sup> Mckillop, B. (2003) *The position of accused persons under the common law system in the Australia (more particularly in New South Wales) and the Civil Law System in France*, vol. 26, Nr. 2, France: UNSW Law Journal, fq. 521

<sup>243</sup> Po aty, fq. 521-522

<sup>244</sup> Hocking, B.A. & Manville, L.L. (2001) *What of the right to silence: still supporting the presumption of innocence, or a growing legal fiction?* Vol.1, Nr.1, Australia: Macquarie Law Journal, fq.66

<sup>245</sup> John Murray kundër UK, 8 Shkurt 1996, fq. 66. E drejta për përfaqësim ligjor aplikohet në të gjitha fazat e procedurës penale dhe me rëndësi të veçantë është kur personit të paraburgosur ti sigurohet që parimet e korrektësisë dhe barazisë së armëve (mjeteve ligjore) të respektohen

<sup>246</sup> Pulice, E.B. (2010) *The right to silence at risk: neuroscience-based lie detection in the United Kingdom, India and the United States*, The George Washington International Law Review, vol. 42, Nr.4, fq. 889

<sup>247</sup> Dammer, H.R. & Albanese, S.Y. (2014) *Comparative criminal justice systems*, Belmont: Wadsworth, fq. 136

I pandehuri që është ndaluar nga policia, ka të drejtë të përfitojë shërbimet e një avokati. Që nga viti 1993, të pandehurit i lindi kjo e drejtë, që mbas 20 orëve nga momenti që është i ndaluar nga policia dhe mbas 36 orësh nëse masa e ndalimit është zgjatuar. Kishte të drejtë të qëndronte me mbrojtësin e tij jo më tepër se 30 minuta në kushte konfidencialiteti<sup>248</sup>. Avokati gjithësesi nuk kishte të drejtë të ishte i pranishëm kur i pandehuri merrej në pyetje dhe nuk kishte të drejtë të shikonte procesverbalin e veprimeve hetimore deri në atë moment, por ai kishte të drejtë të informohej për akuzën ndaj klientit të tij<sup>249</sup>.

Ndalimi i të pandehurit nga policia, ka qenë një çështje shumë e nxehtë vitet e shkuara në Francë dhe është diskutuar shumë nga doktrina, legjislatori dhe praktika gjyqësore. Në vitin 2011, mbas vendimit Salduz kundër Turqisë të GjEDrNj<sup>250</sup>, në Francë u realizuan reforma të rëndësishme në lidhje me rregullat e ndalimit të të pandehurve nga policia<sup>251</sup>.

Deri para qershorit të vitit 2011, i pandehuri kishte të drejtë të qëndronte me avokatin për një periudhë kohe prej 30 minutash, që nga fillimi i ndalimit të tij nga policia, por pas ndryshimeve të K.Pr.Penale, avokati mund të jetë i pranishëm gjatë periudhës së ndalimit të personit nga policia duke përfshirë edhe momentin kur ai merret në pyetje<sup>252</sup>.

Në vitin 2011, ligjvënësi francez, i njohi drejtën avokatëve që përfaqësojnë personat e ndaluar nga policia, të konsultojnë disa dokumente të çështjes si: urdhërin e ndalimit dhe njoftimin e të drejtave, certifikatën mjekësore dhe traskriptimin e marrjes në pyetje të klientit të përfaqësuar. Ky akses i kufizuar është i debatueshëm: në radhë të parë, aktet e lejuara nga ligjvënësi, nuk të japin mundësinë të kesh një tablo të qartë të çështjes dhe të provave të prokurorisë; në radhë të dytë, mundësia e kufizuar për të marrë dijeni për aktet e dosjes, devijon nga kriteret e vendosura nga GjEDrNj, për të respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.<sup>253</sup>

Gjykata Kushtetuese e Francës, e ka pozicionuar të drejtën për të pasur avokat tek të drejtat e mbrojtjes dhe ka deklaruar shprehimisht : “e drejta e personit për të komunikuar me

---

<sup>248</sup> Pradel, J. (2002) *Manual de procédure pénale*, Paris : Cujas, fq. 509

<sup>249</sup> Po aty, fq. 509

<sup>250</sup> Salduz kundër Turqisë, 27 Nëntor 2008

<sup>251</sup> Charret-Del Bove, M. & Murlon, F. (2014) *Pre-trial detention in 20<sup>th</sup> and 21<sup>st</sup> Century Common Law and Civil Law System*, Kembrixh: Cambridge Scholars Publishing, fq. 93

<sup>252</sup> Dammer, R.H. & Albanese, S.Y. (2015) *Comparative criminal justice systems*, Belmont : Wadsworth, fq. 136

<sup>253</sup> Gogorza, A. (2015) *The influence and false influence of European Union Law on French criminal procedure, Nr.1.*, Australia: Montesquieu Law Review, fq. 4

avokatin, ushtrohet që në fazën e anketës procedurale penale dhe përbën një të drejtë të mbrojtjes”<sup>254</sup>.

Kur ndërhyrja e avokatit bëhet ab initio, ai jep një ndihmë morale dhe juridike, informon personin në lidhje me hapat që do të ndiqen, ndërsa nëse ndërhyrja e avokatit do të bëhej mbas 20 orësh ose mbas 36 orësh, nuk mund të kontrolloheshin a posteriori veprimet që ishin kryer.<sup>255</sup>

Nëse i pandehuri nuk ka mundësi të ketë një avokat, atij do t’i caktohet një avokat nga kryetari i dhomës së avokatëve dhe shpenzimet për avokatin, do të mbuloohen nga shteti. Ai mund të bëjë vërejtje të shkruara të cilat vendosen në dosjen hetimore<sup>256</sup>.

Neni 114 i K.Pr.Penale, parashikon të drejtën e palës, që gjatë hetimit dhe në momentin që merret në pyetje nga gjyqtari hetues, të përfaqësohet me avokat. Avokati ka të drejtë të studiojë dosjen hetimore dhe të bëjë kopje të akteve të dosjes<sup>257</sup>. Neni 114 i K.Pr.Penale, parashikon procedurën që ndiqet për marrjen e informacionit që ka dosja hetimore dhe marrjen e kopjeve të akteve që ka dosja hetimore. Për të mos shkelur parimin e barazisë, ligjvënësi francez këto të drejta ia njuh jo vetëm palës që përfaqësohet me avokat por edhe palës që nuk dëshiron të ketë një mbrojtës ligjor, por dëshiron të mbrohet vetë gjatë procesit penal.

Gjatë gjykimit që zhvillohet përpara “cour d’assises” ose “tribunal correctionnel”, i akuzuari ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat i zgjedhur prej tij, ose në rast se nuk ka mundësi, i caktohet një avokat kryesisht nga kryetari i trupit gjykues<sup>258</sup>. Ndërsa në gjykimin e zhvilluar përpara “tribunal de police”, i pandehuri ka të drejtë të ketë një avokat, të cilin mund ta zgjedhi ai vetë, por ai nuk ka të drejtë të ketë një avokat të caktuar nga shteti<sup>259</sup>.

Avokatët edhe pse kanë të drejtë të bëjnë mbrojtjen ligjore sepse kjo rrjedh nga natyra e profesionit të tyre, ata realizojnë një mbrojtje ligjore më pak të efektshme se sa në një sistem akuzator sepse kyetari i trupit gjykues i bën vete pothuajse të gjitha pyetjet dëshmitarëve në seancat gjyqësore. Roli i avokatëve është reduktuar sepse ata i sugjerojnë

---

<sup>254</sup>Pradel,J.(1995) *La protection de la personne en France depuis les réformes de procédure penale en 1993*, vol. 29, Nr.1, France: Thémis, fq. 7

<sup>255</sup>Po aty

<sup>256</sup> Elliott,C.(2001) *French Criminal Law*, New York : Eillan Publishing, fq. 22

<sup>257</sup>Pradel,J.(1995) *La protection de la personne en France depuis les réformes de procédure penale en 1993*, vol. 29, Nr.1, France: Thémis, fq. 8

<sup>258</sup> Nenet 274 dhe 417 të Kodit të Procedurës Penale Franceze

<sup>259</sup> Neni 536 i Kodit të Procedurës Penale Franceze



gjqtarit të bëj pyetje shtesë. Në përgjithësi avokatët përpiqen për zbutjen e dënimit se sa për pafajësinë e klientit.

### ***6.2.3 Të drejtat e të pandehurit gjatë gjykimit në të drejtën penale franceze***

I pandehuri gjatë gjykimit pyetet nga kryetari i trupit gjykues. Marrja në pyetje mbështetet tek procesverbalet ose deklaratimet e bëra nga dëshmitarët, të ndodhura në dosje. Në gjykimin e zhvilluar në “cour d’assises”, marrja në pyetje mund të jetë shumë e zgjatur. Objekti i marrjes në pyetje, ngjason me paraqitjen e akuzës së prokurorit. I pandehuri do të pyetet në mënyrë të detajuarnëse se ka kontradita midis deklaratave të tij dhe të dëshmitarëve. Interesant është fakti që i pandehuri pyetet jo vetëm për rrethanat e çështjes, por edhe për personalitetin e tij<sup>260</sup>. Gjyqtari është i detyruar të hetojë personalitetin e të pandehurit<sup>261</sup>. Personaliteti i të pandehurit ka lidhje me historikun familjar, edukimin, punët që ka bërë, situatën materiale, rrethin shoqëror, nëse ka qenë apo jo i dënuar. Kërkimet për personalitetin e të pandehurit, zakonisht kryhen nga policia gjyqësore ose nga një grup gjyqtarësh dhe rezultatet vendosen në dosje<sup>262</sup>.

Kodi Procedurës Penalefranceze, si gjithë legjisllacioni penal në mbarë botën (përjashto këtu pak shtete), parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ky parim, përfshin “barazinë e armëve”, që do të thotë barazia procedurale midis të pandehurit, organit të prokurorisë dhe palëve civile. Sipas këtij parimi, palët në proces, kanë të drejtë të marin dijeni për aktet që ka dosja dhe të paraqesin vërejtjet e tyre, përpara një gjyqtari të paanshëm<sup>263</sup>. I pandehuri ka të drejtë të njihet me të gjitha provat, si ato që e ngarkojnë me përgjegjësi por dhe edhe me ato që e shfajësojnë.

Personi i akuzuar për kryerjen e një vepre penale, ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm. Për të llogaritur afatin e arsyeshëm, janë disa rrethana që merren në konsideratë si p.sh: kompleksiteti i çështjes, sjellja e të pandehurit, sjellja e autoriteteve gjyqësore, etj.

---

<sup>260</sup> Mckillop, B. (2003) *The position of accused persons under the common law system in the Australia (more particularly in New South Wales) and the Civil Law System in France*, vol.26, Nr.2, France: UNSW Law Journal, fq. 527

<sup>261</sup> Neni 81 i Kodit të Procedurës Penale Franceze

<sup>262</sup> Mckillop, B. (2003) *The position of accused persons under the common law system in the Australia (more particularly in New South Wales) and the Civil Law System in France*, vol.26, Nr.2, France: UNSW Law Journal, fq. 534

<sup>263</sup> Kutyl, F. (2002) *Chronique de jurisprudence: Le droit à un procès penal équitable au sens de la jurisprudence strabourgeoise en 2001*, Nr.14, France: JLMB, fq. 585

I pandehuri ka të drejtë të gjykohet nga një gjykatës i pavarur dhe i paanshëm. Në K.Pr.Penale dhe në ligje të tjera të posaçme, janë parashikuar rregullat për pavarësinë e gjyqtarëve, kurse në K.Pr.Penale për të ruajtur paanshmërinë e gjyqtarëve, ligjvënësi ka parashikuar rastet e papajtueshmërisë së tyre.

Prezumimi i pafajësisë është parashikuar që në momentin kur u adoptua Deklarata e Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, e cila në nenin 9 te saj parashikonte se :

“Çdo njeri presumohet i pafajshëm deri në momentin që është deklaruar fajtor; nëse shihet e nevojshme të arrestohet, cdo lloj akti që nuk është i nevojshëm për ndalimin e tij duhet të ndëshkohet ashpër nga ligji”<sup>264</sup>.

Prezumimi i pafajësisë gjeneron disa pasoja juridike: prokurori duhet demostrojë fajësinë e personit, barra e provës i përket organit të akuzës.

Neni 3 i K.P.Penale parashikon që çdo person është i pafajshëm, derisa fajësia e tij nuk është vendosur nga një vendim i formës së prerë.

Në rast se një personi i shkelet prezumimi i pafajësisë, ai mund të kërkojë shpërblimin e dëmit. Neni 9-1 i Kodit Civil e lejon gjyqtarin të marrë të gjitha masat për të eliminuar shkeljen e prezumimit të pafajësisë. Këto masa janë: korigjimi apo nxjerrja e një njoftimi në media për t’i dhënë fund shkeljes së prezumimit të pafajësisë<sup>265</sup>.

I pandehuri ka të drejtë për të pasur kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij<sup>266</sup>. Ai ka të drejtë të thërrasi dhe pyesi dëshmitarë. Në rast se i pandehuri është i huaj dhe nuk e kupton frëngjishten ai ka të drejtë të ketë një përkthyes.

### **6.3 Vështrim krahasues me të drejtën penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ofrojnë të pandehurit garanci që ai të trajtohet në mënyrë të drejtë. Ligji amerikan përshkruhet në mënyrë të përgjithshme edhe si ligji i të pandehurit, në kontrast me sisteme të tjera ligjore, që vendosin prokurorin në krye dhe i japin prioritet interesit të shoqërisë dhe dënimit të kriminelëve.<sup>267</sup>

<sup>264</sup>Pouit,M. (2013) *Les atteintes à la présomption d’innocence en droit pénal de fond*, fq. 9. <https://docassas.u-paris2.fr/nuxeo/site/esupversions/ec87b75c-7498-4a6f-a32e-468606f5556d>

<sup>265</sup>Pouit,M.(2013) *Les atteintes à la présomption d’innocence en droit pénal de fond* fq. 12. <https://docassas.u-paris2.fr/nuxeo/site/esupversions/ec87b75c-7498-4a6f-a32e-468606f5556d>

<sup>266</sup>*L’accès au dossier au stade de l’instruction*, fq.2  
[https://ww.courdecassation.fr/publications\\_26/rapport\\_annuel\\_36/rapport\\_2010\\_3866/etude\\_droit\\_3872/e\\_dr\\_oit\\_3873/obligation\\_information\\_3874/obligation\\_information\\_droit\\_processuel\\_19401.html#1.1.3.1.2](https://ww.courdecassation.fr/publications_26/rapport_annuel_36/rapport_2010_3866/etude_droit_3872/e_dr_oit_3873/obligation_information_3874/obligation_information_droit_processuel_19401.html#1.1.3.1.2).

<sup>267</sup> Fellman,D. (1976) *The defendant’s rights today*, Wisconsin: Wisconsin Press, fq.3

Të drejtat e të pandehurit zënë një vend të rëndësishëm në sistemin ligjor amerikan. Origjina e tyre e ka prejardhjen nga Magna Carta, që u firmos nga Mbreti Xhon në vitin 1215. Magna Carta përmbledh gjashtëdhjetë e tre parime, që kanë lidhje me veprat penale dhe me hetimin<sup>268</sup>. Merita e Magna Carta është se vendosi limite për ushtrimin e pushtetit nga mbreti. Për herë të parë, baronët e detyruan të pranonte faktin që veprimet e tij janë të kufizuara me ligj. Magna Carta ishte një dokument i shkruar dhe për këtë mbreti e pati të vështirë të mohonte efektet e saj juridike<sup>269</sup>.

Parimet themelore që garantojnë të drejtat e të pandehurit, i kanë rrënjët në doktrinën e vjetër të sistemit Common Law ku mund të përmendim: i pandehuri prezumohet i pafajshëm dhe barra për të provuar fajësinë është e prokurorit. Fajësia duhet të përcaktohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm<sup>270</sup>.

Të drejtat e të pandehurit garantohen nga Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto të drejta parashikohen nga amendamentet katër, pesë, gjashtë dhe tetë të Kushtetutës Amerikane<sup>271</sup>. Këto amendamente janë interpretuar nga gjykatat amerikane si standarte minimale për një proces penal ligjor për të pandehurin<sup>272</sup>.

Në SHBA personave që ndiqen penalisht, mund t'u aplikohet ligji i shteteve ose ligji federal. Nëse vepra penale është parashikuar nga ligji federal, atëherë i pandehuri do të hetohet dhe gjykohet duke iu aplikuar ligji federal. Nëse i pandehuri ka kryer një vepër penale që parashikohet nga kodet penale të shteteve, atëherë shteti përkatës do të ushtroje ndjekjen penale. Prandaj me të drejtë është shprehur mendimi që sistemi gjyqësor është dual<sup>273</sup>.

Sistemi procedural penal është i natyrës akuzatore, që do të thotë se të dy palët kundërshtarë, mbrojtja dhe prokurori do të prezantojnë provat e ndryshme përpara një jurie të paanshme në një proces gjyqësor të drejtuar nga një gjykatës i paanshëm. Të dy palët kanë të drejtë të kundërshtojnë argumentet e njëri-tjetrit dhe provat, me qëllim që gjatë zhvillimit të procesit, të arrihet të përcaktohet qartë fajësia ose pafajësia e të akuzuarit<sup>274</sup>.

---

<sup>268</sup> Kusha, R.H.( 2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni : ABC-CLIO, Inc, fq. 1

<sup>269</sup> Banaszak, A.R.( 2002) *Fair trial rights of the accused: a documentary history*, Westport: Greenwood Press, fq. 13

<sup>270</sup> Fellman,D.(1976) *The defendant's rights today*, Winsconsin: Wisconsin Press, fq.3

<sup>271</sup> Kusha, R.H.( 2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni : ABC-CLIO, Inc, fq. 1

<sup>272</sup> Scheb,M.J.& Scheb,M.J II. (2011) *Criminal law and procedure*, Belmont: Wadsworth, fq. 431

<sup>273</sup> Kusha, R.H.( 2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni : ABC-CLIO, Inc, fq. 1

<sup>274</sup> Barkan,S.E., Bryjak,J.G.( 2011) *Fundamental of criminal justice: a sociological view*, Ontario: Jones & Bardett Learning. LLC. fq. 21

Amendamenti katër, mbron të pandehurin nga kontrollet dhe konfiskimet e policisë dhe agjensive qeveritare. Qëllimi i amendamentit katër është të mbrojë privatësinë e banesës, sendet, dokumentet që ndodhen në banesë nga kontrollet dhe konfiskimet e pajustificuara. Vendimi i gjykatës duhet të përcaktojë vendin që duhet të kontrollohet, personat që duhen ndaluar dhe objektet që duhen mbajtur.

Referuar amendamentit të pestë, i pandehuri ka të drejtë të refuzojë t'i përgjigjet pyetjeve ose të mos bëjë deklaratë që mund ta fajësojnë. Këto garanci aplikohen në çdo etapë të procesit penal.

Amendamenti i pestë përfshin edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Interpretimi gjyqësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor ka evoluar gjatë kohës, ajo është e ndarë në dy pjesë: garancitë materiale të procesit të rregullt ligjor dhe garancitë procedurale. Garancitë materiale i'u referohen të drejtave që lidhen me lirinë e të shprehurit, votimin. Garancitë procedurale ndihmojnë që procesi i gjykimit të jetë i drejtë dhe i paanshëm<sup>275</sup>.

Amendamenti i gjashtë përcakton të drejta të posaçme për të pandehurin ku përfshihen:

E drejta për gjykim nga juria, e drejta për gjykim në kohën e duhur, e drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e të gjitha akuzave, e drejta për t'u përballur me dëshmitarët, e drejta për të pasur një këshilltar ligjor në dispozicion, e drejta për të detyruar dëshmitarët për të dëshmuar.

Amendamenti tetë ndalon kushtet tepër të ashpra të dënimit edhe pse nuk është përcaktuar një afat kohor. Në një zgjerim të të drejtave të përcaktuara në Kushtetutë, Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në çështjen Miranda kundër Arizonës të vitit 1966, u shpreh se kushdo që vendoset në paraburgim duhet të vihet në dijeni për të drejtat e mëposhtme: Personi ka të drejtë të heshtë, çdo gjë që personi thotë mund të përdoret kundër tij gjatë zhvillimit të gjykimit, personi ka të drejtë të përfaqesohet nga avokati, nëse personi i ndaluar nuk ka mundësi të përballojë shpenzimet për të zgjedhur një avokat, atij do t'i caktohet një avokat nga shteti.

Amendamenti i tetë parashikon që nuk do të vendosen garanci pasurore të tepërta, nuk do të vendosen gjopa të tepërta dhe nuk do të vendosen dënime mizore ose të jashtëzakonshme.

---

<sup>275</sup> Dimitrakopoulos, G.I. (2007) *Individual rights and liberties under the U.S. Constitution: The Case Law of the U.S. Supreme Court*, Leiden : Martinus Nijhoff Publishers, fq. 1033

### **6.3.1 Amendamenti i katërt**

Amendamenti katër i vendos organeve shtetërore kufizime për të zhvilluar kontrolle dhe konfiskime<sup>276</sup>.

Ndryshe nga amendamenti 5 dhe 6 që mbrojnë të drejtat e të akuzuarit, amendamentin 4 më tepër parashikon të drejtën e “njerëzve” se sa të drejtën e një individi të veçantë ose të akuzuari<sup>277</sup>.

Shumë vite që nga momenti kur amendamenti katër u miratua, rregullat kanë përcaktuar në mënyrë të kujdesshme mbikqyrjen se kur dhe ku vazhdojnë kontrolli dhe konfiskimi. Disa individë argumentojnë se këto rregulla janë bërë shumë të vështira për policinë dhe për organet e tjera ligjzbatuese të kapin keqbërësit, ndërsa të tjerë individë argumentojnë të kundërtën<sup>278</sup>.

Nga analiza e jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, arrijmë në konkluzionin se në vende të caktuara amendamenti i katërt nuk i shtrin efektet e tij juridike. Këtu mund të përmendim rastin e personave që janë duke vuajtur dënimin në burgje.

Në çështjen Hudson kundër Palmer, Gjykata Supreme e SHBA, vendosi për herë të parë që amendamenti i katërt nuk i mbron të burgosurit nga kontrolli i objekteve personale që realizohet nga oficerët e policisë së burgjeve. Pavarësisht se disa gjykata të shkallëve të ulta, i’u njohën të burgosurve disa të drejta të kufizuara për privatësinë e qelive të burgut që mbrohen nga amendamenti i katërt, me vendimin Hudson i’u eliminua të burgosurve çdo mundësi që të përfitojnë nga amendamenti i katërt<sup>279</sup>.

### **6.3.2 Amendamenti i pestë**

Amendamenti i pestë përmbledh pesë klauzola që kanë në fokusin e tyre të drejtat e individëve kundër abuzimeve të qeverisë.<sup>280</sup> Katër nga pesë klauzolat kanë lidhje me procesin penal, kurse një klauzolë ka lidhje me procesin civil.

Klauzolat që parashikon amendamenti i pestë janë:

---

<sup>276</sup> Smith,R. (2008) *Fourth Amendment: The right to privacy*, Edina: ABDO Publishing, fq. 7

<sup>277</sup> Urbina,G.M. ( 2012) *Hispanics in the U.S. Criminal justice system: the new American demography*, Illinois: Charles Thomas Publishier, fq. 149

<sup>278</sup> Smith,R. (2008) *Fourth Amendment: The right to privacy*, Edina: ABDO Publishing, fq. 8

<sup>279</sup> Goring,D.C.( 1984) *Fourth Amendment-Prison Cells: Is there a Right to Privacy*, Louisiana State:Journal of criminal Law and Criminology, vol.75, Nr. 3fq. 609

<sup>280</sup> Brezina,C. (2011) *The fifth Amendment: double jeopardy, self-incrimination and due process of law*, New York: Rosen Publishing Group, fq. 6

- 1) Personi mund të përgjigjet për kryerjen e një vepre penale, vetëm në bazë të një deklarate ose akuze e ngritur nga juria, përveç rastit kur veprat penale janë kryer nga i akuzuari në periudhën kur ishte në forcat ushtarake tokësore, detare ose të policisë, në kohe lufte ose rreziku publik. (Përgjegjësia për veprat penale sipas një deklarate ose akuze të ngritur nga juria).
2. Asnjë personi nuk mund t'i kërcënohet jeta ose integriteti trupor, dy herë për të njëjtën vepër penale. (Ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtën vepër).
3. Asnjë person nuk mundet që në një proces penal të detyrohet të dëshmojë kundër tij. (Vetinkriminimi).
4. Asnjë person nuk mund të privohet nga jeta, liria ose prona pa ndjekur rrjedhën normale të ligjit procedural.(E drejta për një proces të rregullt ligjor).
5. Asnjë pronë private nuk do të merret për interes publik pa një kompensim të drejtë. (E drejta e kompensimit në rast shpronësimit).

Nga këto pesë klauzola që janë të inkorporuara në amendamentin e pestë, do të trajtojmë vetëm katër klauzolat e para që kanë lidhje me të pandehurin dhe procesin penal.

**1) Juria është supozuar të funksionojë si trup i afërt, që ndihmon shtetin në vënien përpara drejtësisë të autorëve, që kryejnë vepra penale dhe duke mbrojtur të pafajshmit nga akuzat e padrejta<sup>281</sup>.**

Njëri funksion i jurisë është të veprojë si hetues dhe akuzues dhe mbrojtës i publikut. Kurse funksioni tjetër i jurisë, është të veprojë si mbrojtëse e individëve nga akuzat e padrejta, duke vendosur anëtarë të komunitetit ndërmjet prokurorisë dhe të akuzuarit<sup>282</sup>.

E drejta për t'u akuzuar për një krim, nga një juri e cila është e parashikuar në amendamentin e pestë, nuk është inkorporuar nga shtetet dhe në këtë mënyrë nuk aplikohet për ndjekjet penale shtetërore. Praktikrat e jurive ndryshojnë nga juridiksionet shtetërore dhe ato federale<sup>283</sup>.

---

<sup>281</sup> Alexander,P.R., Portman,Sh. (1974) *Grand jury indictment versus prosecution by information- an equal protection due process issue*, Standfort: The Hastings Law Journal, vol .254, fq. 998

<sup>282</sup> Goldstein,W.H (2015) *Grand jury practice*, New York : ALM Media, fq. 2

<sup>283</sup> Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)

Fakti që e drejta për t'u gjykuar nga një juri nuk është aplikuar nga të gjitha shtetet, ka lidhje me vendimin e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që vendosi se shqyrtimi i çështjes nga juria nuk është një e drejtë themelore<sup>284</sup>.

Gati gjysma e shteteve parashikojnë në ligjet e tyre që akuza për krimet të grihet nga juria. Ndërsa në shtetet që nuk parashikojnë ngritjen e akuzës nga juria, procedimi vazhdon në bazë të informacioneve të paraqitura nga prokurori, këto përbëjnë edhe akuzën<sup>285</sup>.

Rregullat dhe procedurat e jurisë, ndryshojnë nga një juridiksion në tjetrin. Juria është e përbërë nga 12-23 anëtarë<sup>286</sup>. Juria nuk duhet gjithmonë që të jetë unanime në dhënien e vendimit, p.sh në Misuri 9 nga 12 anëtarët mund të kthejnë një akuzë<sup>287</sup>.

Në procedurat përpara jurisë, publiku nuk ka akses dhe media nuk lejohet të jetë e pranishme. Në përgjithësi, personat e vetëm që marrin pjesë janë prokurori për të drejtuar procesin pa një gjyqtar në dhomën e jurisë. Prokurori zakonisht udhëzon jurinë për ligjin,<sup>288</sup> ndërsa juria nuk është nën kontrollin e tij<sup>289</sup>.

Në lidhje me standartin e akuzës së ngritur nga juria, Gjykata e Supreme e SHBA, është shprehur se kërkon vetëm një “probabilitet të drejtë”, i cili të jetë arsyeshëm dhe i kujdesshëm dhe nuk kërkohen njohës ligjesh<sup>290</sup>.

2) Vitet e fundit, gjykatat, juristët dhe doktrina kanë shprehur mendimin se e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën veprë penale, është një e drejtë themelore. Në çështjen Benton kundër Maryland (1969), Gjykata Supreme e SHBA u shpreh se “natyra themelore e garancisë kundër mos gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale vështirë se mund të vihet në dyshim”. Disa dekada më vonë, gjyqtari i Gjykatës Supreme të SHBA, Felix

---

<sup>284</sup> Hall, E.D. (2015) *Criminal law and procedure*, Stamford: CENGAGE Learning, fq. 535

<sup>285</sup> Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)

<sup>286</sup> *Fifth amendment*: an overview, [https://www.law.cornell.edu/wex/fifth\\_amendment](https://www.law.cornell.edu/wex/fifth_amendment)

<sup>287</sup> Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)

<sup>288</sup> Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)

<sup>289</sup> *Fifth amendment*. Rights of persons, fq. 1464. <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-REV-2014/pdf/GPO-CONAN-REV-2014-10-6.pdf>

<sup>290</sup> Kaley kundër SHBA, 2014, marrë nga Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)

Frankfurtes e quajti këtë të drejtë “një kërkesë të nevojshme për një procedurë penale të qytetëruar”<sup>291</sup>.

E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, e mbron të pandehurin nga një akuzë e dytë për të njëjtën vepër penale, pasi ka marrë pafajësi. Kjo klauzolë e mbron të pandehurin nga procedim i dytë për të njëjtën vepër mbasi është dënuar një herë dhe kundër ndëshkimeve të shumta për të njëjtën vepër<sup>292</sup>.

Ndalimi gjyqimit dy herë për të njëjtën vepër, është një vetëmbrojtje e pashmangshme në çdo sistem ligjor. Asnjë sistem ligjor nuk mund të mbijetojë duke vazhduar t’i përsërisë çështjet në vazhdimësi. Në momentin që një gjykatë, ka përcaktuar faktet dhe ligjin, nuk ka kuptim që të mendosh se një gjykim i dytë do të ketë më shumë mundësi për të vendosur “drejt”<sup>293</sup>.

Në rast se dy gjykata, japin vendime të ndryshme në të njëjtën çështje, nuk ka asnjë arsye për të preferuar njërin në krahasim me tjetrin dhe nuk ka arsye për të preferuar një gjykim të dytë kundër të parit<sup>294</sup>. E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër aplikohet për ligjet federale dhe ato të shteteve<sup>295</sup>.

Nuk konsiderohet si shkelje e këtij parimi, rasti kur juria nuk arrin të marrë një vendim për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit ose nuk ka qenë unanime në vendimin e saj, në juridiksionet që kërkojnë unanimitet dhe rasti kur gjykimi është deklaruar i pavlefshëm nga gjyqtari për arsye të ndryshme. Ky parim nuk konsiderohet që është shkelur edhe në rastin kur gjykata e apelit e prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e kthen çështjen në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të gabimeve procedurale që janë bërë në çështjen përkatëse<sup>296</sup>.

Mund të ndodhi që i pandehuri me veprimin ose mosveprimin tij, të shkelë ligjin federal dhe ligjin e shtetit. Në këtë rast me të drejtë shtrojmë pyetjen: Do të gjykohet i pandehuri vetëm për shkelje të ligjit federal ose shtetëror apo do të gjykohet për shkelje të të dy ligjeve pa u shkelur parimi për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër?

---

<sup>291</sup>Rudstein,S.D.( 2004) *Double Jeopardy: a reference guide to the United States Constitution*, Westport: Praeger Publishers, fq. 1

<sup>292</sup>Broyles,S. (2011) *Criminal law in the USA*, Leiden: Wolters Kluwer, fq. 135

<sup>293</sup>Thomas,C.G.( 1998) *Double Jeopardy: the history, the law*, New York: University Press, fq. 1

<sup>294</sup> Po aty

<sup>295</sup>Crist kundër Bretz, 1987, fq. 1472, *Fifth amendment*. Rights of persons,

<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-REV-2014/pdf/GPO-CONAN-REV-2014-10-6.pdf>

<sup>296</sup> Kusha,R.H. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc,fq. 12



Duke analizuar jurisprudencën e Gjykatës Supreme të SHBA, vëmë re se në çështjen SHBA kundër Lanza (1922), gjykata u shpreh se i pandehuri që ka shkelur të dy ligjet, atë federal dhe atë shtetëror do të procedohet sipas të dy ligjeve, pa shkelur parimin për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër penale sipas amendamentit të pestë.<sup>297</sup>

3) Po të hedhim një vështrim historik për të drejtën për të mos inkriminuar veten, do të vëmë re se kjo çështje, është diskutuar që në vitin 1537 në të drejtën angleze Common Law, nga ku amendamenti i pestë i ka rrënjët<sup>298</sup>.

E drejta kundër vetinkriminimit, mbron çdo person nga detyrimi për të dëshmuar kundër vetes së tij. Kjo e drejtë aplikohet për çdo person që ndalohet nga policia, për çdo person që thirret të dëshmojë përpara një gjykate shtetërore, një gjykate federale, përpara jurisë ose çdo agjensie qeveritare e çfarëdo niveli qoftë ajo. Në këtë situatë, çdo person mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, që mund t'a fajësojnë atë në kryerjen e veprimeve të paligjshme<sup>299</sup>.

Është vënë re se çështjet që kishin të bënin me marrjen në pyetje nga policia dhe pohimet e marra me dhunë, u anashkaluan nga gjykata deri kur amendamenti i pestë u aplikua në çështjen Malloy kundër Hogan (1964). Deri para se të gjykohej kjo çështje, gjykata aplikonte amendamentin e katërbëdhjetë, që parashikon ndalimin e një personi të japi deklarata vetinkriminuese në procedimin e filluar nga shtetet<sup>300</sup>. Deri përpara aplikimit të amendamentit të pestë ndaj shteteve, Gjykata Supreme përdorte testin e “tërësisë së rrethanave”, për të përcaktuar nëse policia kishte shkelur të drejtat e të pandehurit të parashikuara nga amendamenti i katërbëdhjetë. Kjo do të thoshte që nëse “rrethanat” nuk ishin shtrënguese, amendamenti i pestë nuk aplikohet<sup>301</sup>.

Përpara se të aplikohet amendamenti i pestë, për të drejtën e të pandehurit për të mos inkriminuar veten (çështja Miranda kundër Arizona, viti 1966), të pandehurit që ishin të ndaluar nga policia vazhdimisht nuk trajtoheshin në mënyrë dinjitoze. Kishte raste kur përdorej tortura, siç ishte çështja Brown kundër Shteteve të Bashkuara. Aplikimi i amendamentit të pestë në lidhje me amendamentin e gjashtë, i detyroi shtetet që të hiqnin

---

<sup>297</sup> Vile, R.J. (2010) *Essential Supreme Court decisions: summaries of leading cases in U.S.*, Maryland: Rowman & Littlefield Publishers, Inc. fq. 339

<sup>298</sup> Woods, D.G. (2002) *A history of criminal law in New South Wales: The Colonial Period, 1788-1900*, Sidni: Federation Press, fq. 172

<sup>299</sup> Kusha, R.H. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc, fq. 13

<sup>300</sup> Cloud, J. (2002) *Criminal law*, New York: Aspen Publishers, fq. 127

<sup>301</sup> Kusha, R.H. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc, fq. 15

dorë nga shumë metoda marrjesh në pyetje nga policia, që përdoreshin sipas testit të“ tërësisë së rrethanave”<sup>302</sup>.

Deri përpara çështjes Miranda kundër Arizona (1966), oficerët e policisë bënëin çfarë kishin mundësi për të marre pohimin nga i pandehuri. Ata përpiqeshin të thyenin rezistencën e të pandehurve me pyetjet e tyre. Në disa raste ata bënëin lojën “polici i mirë, polici i keq”. Duke përdorur këtë strategji, një oficer policie mund të bërtiste ose të godiste të pandehurin, kurse një “polic i mirë”, përpiquej të bindte të pandehurin që ai ishte aty për ta ndihmuar. Në disa raste oficerët e policisë përdornin dhunë fizike ose psikologjike për të marrë pohimin që donin<sup>303</sup>.

Çështja Miranda kundër Arizona, do të jetë një nga më të famshmet në historinë e SHBA. Mbas vendimit të dhënë në çështjen Miranda, çdo person që arrestohet nga policia ose akuzohet për një krim duhet të marri dijëni që në fillim se cilat janë të drejtat e tij<sup>304</sup>.

Vendimi Miranda vendosi disa kushte, që oficerët e policisë duhet t’i përmbushin për të informuar të pandehurit për të drejtat e tyre. Të drejtat që duhet t’u vihen në dijëni të pandehurit janë<sup>305</sup>:

-Ka të drejtë të heshti gjatë gjithë periudhës që është i arrestuar dhe merret në pyetje derisa i pandehuri të heqi dorë vullnetarisht.

-Ka të drejtë të informohet përpara se të merret në pyetje se ka të drejtë të heshti nëse dëshiron dhe çfarëdo që ai të thotë do të përdoret kundër tij në gjykatë.

-Ka të drejtë të këshillohet me një avokat dhe të ketë një avokat të pranishëm gjatë gjithë procesit të marrjes në pyetje.

-Ka të drejtë t’i caktohet një avokat nga shteti në rast se nuk ka mundësi financiare të paguajë një avokat.

Të drejtat e të pandehurit që u vendosën në çështjen Miranda nga Gjykata Supreme e SHBA, mbahen në një karton të vogël nga oficerët e policisë në shumë shtete<sup>306</sup>.

Vendimi Miranda i jep të drejtë të pandehurit që ndodhet i arrestuar në ambjentet e policisë, të pretendojë të drejtat e tij që rrjedhin nga amendamenti i pestë, në çdo moment gjatë kohës që merret në pyetje. Në rast se i pandehuri i përgjigjet si fillim pyetjes së

---

<sup>302</sup>Po aty

<sup>303</sup>Burgan, M. (2007) *Miranda v. Arizona: the rights of the accused*, Minneapolis: White-Thomson Publishing, fq. 12

<sup>304</sup>Po aty, fq. 15

<sup>305</sup> Ruschmann J.D.P. (2007) *Miranda Rights*, New York: Infobase Publishing, fq. 11

<sup>306</sup> Po aty

oficerit të policisë, dhe më vonë i pandehuri vendosë të heshtë, duke përmendur të drejtat e tij, oficerët e policisë duhet menjëherë të ndërpresin procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit. Nëse vendoset në gjyq, që të drejtat e të pandehurit që rrjedhin nga çështja Miranda janë shkelur nga oficerët e policisë, mbrojtja mund të bëjë kërkesë për prishjen e çështjes. I pandehuri mund t'i kërkojë gjykatës, që të mos merret në konsiderate prova që është marrë në kundërshtim me vendimin Miranda<sup>307</sup>.

Një pjesë e doktrinës amerikane, ka kritikuar të drejtat që rrjedhin nga vendimi Miranda, sepse i japin shumë të drejta procedurale të pandehurit dhe është shumë e vështirë për oficerët e policisë dhe prokurorët të ushtrojnë në mënyrë efektive detyrën e tyre<sup>308</sup>.

**4)** E drejta për proces të rregullt, është një parim historik që i ka rrënjët në kapitullin 39 të Magna Carta, ku Mbreti Xhon premtoi se asnjë njeri i lirë nuk do të burgoset ose të internohet përveçse me një vendim gjyqësor të drejtë<sup>309</sup>.

Personat e të gjithë spektrove politike, janë dakort se e drejta për një proces të rregullt është e rëndësishme. E drejta për një proces të rregullt, do të thotë se të pandehurit nuk do t'i shkelen të drejtat themelore që janë parashikuar në Kushtetutën e SHBA. Kushtetuta ka përcaktuar si të drejta themelore, të drejtën e jetës, lirinë dhe pronësinë. E drejta për një proces të rregullt, nënkupton se asnjë të pandehuri nuk mund t'i mohohen këto të drejta themelore, derisa të gjitha lehtësimet procedurale të njohura nga Bill of Rights, janë vënë re gjatë procedimit. Në rast se oficerët e policisë, nuk kanë administruar prova sipas mënyrave të ligjshme, por kanë përdorur torturën, kërcënimin, në këtë rast pavarisht sesa e rëndësishme mund të jetë prova, ajo nuk do të merret në konsideratë<sup>310</sup>.

Në çështjen *Twining kundër New Jersey* (1908), Gjykata Supreme e SHBA afirmoi që e drejta për një proces të rregullt, presupozon faktin që palët duhet të marrin njoftim dhe të kenë mundësi të dëgjohen. Në vendimin *Powell kundër Alabama* (1932), Gjykata Supreme e SHBA, nuk e ka konsideruar praktikën historike as si një kusht të mjaftueshëm. Me pak fjalë, edhe një praktikë që është e pranuar nga Common Law, mund të çenojë të drejtën për një proces të rregullt, nëse shkelen parimet themelore të lirisë dhe drejtësisë, që janë themeli i institucioneve civile dhe politike. Gjykata vendosi se e drejta për një proces të

<sup>307</sup> Kusha, R.H. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc, fq. 17

<sup>308</sup> Freeman, M., Smith, F. (2013) *Law and language*, Oksford: Oxford University Press, fq. 381

<sup>309</sup> Fifth amendament. *Rights of persons*, fq. 1541. <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-REV-2014/pdf/GPO-CONAN-REV-2014-10-6.pdf>

<sup>310</sup> Allen, J.R., Hoffmann, L.J. (2005) *Criminal Procedure, In vestigation and Rights to Counsel*, New York: Aspen Publishers

rregullt, i garanton të pandehurve aksesin për t'u takuar me avokatin, sepse e drejta për t'u dëgjuar do të jetë më pak e vlefshme, nëse nuk përfshin edhe të drejtën për t'u dëgjuar nga avokati<sup>311</sup>.

### **6.3.3 Amendamenti i gjashtë**

Amendamenti i gjashtë përcakton të drejta të posaçme për të pandehurin, të cilat përfshijnë:

- 1) E drejta për një gjykim të shpejtë dhe publik;
- 2) E drejta për një gjykim nga një juri;
- 3) E drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e të gjitha akuzave;
- 4) E drejta për t'u përballur me dëshmitarët;
- 5) E drejta për të pasur një këshilltar ligjor në dispozicion;
- 6) E drejta për të detyruar dëshmitarët për të dëshmuar;

1) Edrejta për një gjykim të shpejte dhe publik e ka prejardhjen nga Magna Carta. Kjo e drejtë, parashikohet në Deklaratën e të Drejtave të Virxhinias e vitit 1776 dhe me vonë në amendamentin e gjashtë. Gjykata është shprehur në çështjen Shtetet e Bashkuara kundër Ewell (1966) se dispozita, është :

“një garanci e rëndësishme për të parandaluar arrestimet e panevojshme përpara fillimit të gjyqit, për të zvogëluar ankthin dhe shqetësimin që shoqërojnë një akuzë publike dhe për të kufizuar mundësinë që vonesa e gjatë të dëmtojë aftësinë e të akuzuarit për të mbrojtur veten”<sup>312</sup>.

E drejta për një gjykim të shpejtë është një nga të drejtat më themelore të ruajtura në Kushtetutën amerikane.

Në sistemin Anglo-Amerikan, ekziston mendimi se një drejtësi e vonuar është një drejtësi e mohuar. Shpejtësia e gjykimeve në çështjet penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, preket nga nevoja për të vërejtur në mënyre të detajuar procedurat që garantojnë të drejtat e të pandehurit. Hapat që merren nga autoritetet ligjore, për të përgatitur një çështje penale, mund të përmbliidhen si më poshtë<sup>313</sup>:

- veprime përpara nisjes së gjykimit;
- zgjedhja e juries;

<sup>311</sup> Wasserman,R. (2004) *Procedural Due process: a reference guide to the United States Constitution*, Westport : Prager Publishers, fq. 14

<sup>312</sup> *When the right is denied. Right to a speedy and public trial*

<http://law.justia.com/constitution/us/amendment-06/02-speedy-trial.html>

<sup>313</sup> Kusha,H.R. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc, fq. 18

- hapja e deklaratave, që fillon me prokurorin dhe mbaron me mbrojtjen;
- paraqitja e provave në fillim nga prokurori dhe mbas tij mbrojtja;
- konkluzionet përfundimtare;
- vënia në dijeni e jurisë nga gjyqtari, e ligjit të aplikuar në çështjen përkatëse;
- marrja e vendimit nga juria;
- vendimi.

E drejta për një proces të shpejtë është relative. Ajo është në përputhje me vonesat që varen nga rrethanat e arsyeshme. Kjo e drejtë nuk përjashton të drejtat e drejtësisë publike<sup>314</sup>.

Ndërsa në lidhje me gjykimin publik, mund të themi se ai i ka rrënjët nga sistemi britanik Common Law. E drejta e të pandehurit për një proces publik, është sanksionuar në fillim në Kushtetutën e shtetit në vitin 1776, e ndjekur nga ratifikimi i Kushtetutës Federale në vitin 1791. Qëllimi i këtij detyrimi është i shumëanshëm: ndihmon në sigurinë e të pandehurit për gjykim të drejtë, në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, prezanton në mënyrë publike drejtësinë, dekurajon dëshmitë e rreme. Gjykatat realizon edhe një lloj terapie me vlerë për komunitetin, me gjyqet e hapura që publiku të ketë mundësi të shikojë që realizohet drejtësia<sup>315</sup>.

**2)** Garancitë e një gjykimi me juri në Kushtetutën Federale dhe Kushtetutat shtetërore, pasqyrojnë një gjykim të thellë, për mënyrën se si ligji duhet të zbatohet dhe drejtësia të administrohet. E drejta për gjykimin me juri, i jepet të pandehurit për të parandaluar shtypjen nga qeveria. Hartuesit e kushtetutave u përpoqën për të krijuar një gjyqësor të pavarur, por insistuan në mbrojtje të mëtejshme kundër veprimeve arbitrare<sup>316</sup>.

**3)** E drejta për t'u informuar për akuzën, i jep të drejtë të pandehurit që të përgatisi mbrojtjen dhe të mbrohet gjatë gjyimit. Informimi për akuzën, konsiderohet i mjaftueshëm nëse vepra është komunikuar e plotë. Ndërsa, kur elementët e veprës penale referojnë tek Common Law ose tek statute të tjera, akuzat në këtë rast nuk është komunikuar siç duhet<sup>317</sup>. Njoftimi për llojin dhe shkakun e akuzës, është detyrim për organet e drejtësisë, që i pandehuri të përgatisi mbrojtjen ndaj akuzës së bërë ndaj tij. Njoftimi për efekt të

<sup>314</sup> Killian, H.J., Costello, A.G., Thomas, K.R., Ackerman, M.D., Cohen, H., Meltz, R. (2002) *The Constitution of the United States of America. Analysis and Interpretation*, Uashington: Library of Congress, fq. 1496

<sup>315</sup> Po aty, fq. 1498

<sup>316</sup> Jury trial, <http://law.justia.com/constitution/us/amendment-06/04-jury-trial.html>

<sup>317</sup> Sixth amendment. *Rights of accused in criminal prosecutions*, fq. 1420

<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-1992/pdf/GPO-CONAN-1992-10-7.pdf>

amendamentit te gjashtë, zakonisht është në formë informacioni që përmbledh të dhëna të shkruara për kryerjen e një veprë penale<sup>318</sup>.

4) E drejta për t'u përballur me dëshmitarët, ka për qëllim që i akuzuari të ketë mundësi jo vetëm për të testuar ndërgjegjen e dëshmitarit, por edhe për t'u vendosur ballë për ballë me dëshmitarët, ku juria të ketë mundësi të shikojë të pandehurin dhe t'i gjykojë sjelljen dhe mënyrën se si ai jep dëshminë e tij. E drejta për t'u përballur me dëshmitarët, është një nga garancitë themelore të jetës dhe lirisë, e parashikuar në Kushtetutën e SHBA dhe pothuajse në të gjitha Kushtetutat e Shteteve të Bashkuara<sup>319</sup>.

E drejta për t'u përballur me dëshmitarët, e parashikuar nga amendamenti i gjashtë, përfshin të drejtën për t'u përballur me dëshmitarët e palës kundërshtare, gjatë momentit kur japin dëshmitë e tyre në gjykim.

5) Në çështjet penale, avokatët luajnë një rol shumë të rëndësishëm për gjetjen e strategjive për të pandehurit, që të përfitojnë shërbimet e tyre juridike. Avokatët analizojnë akuzat kundër klientit të tyre, përgatisin çështjen duke i'u referuar legjislacionit të shtetit ose legjislacionit federal<sup>320</sup>.

Pavarësisht se e drejta për të pasur avokat njihet që herët (në vitin 1789), ndërsa në rastin e personave që nuk kishin mundësi financiare, e drejta për t'u caktuar një avokat nga shteti në çështjen Powell v. Alabama që në vitin 1932, gjykata njohu të drejtën e të pandehurit për t'u caktuar një avokat nga shteti, vetëm në disa raste kur bëhej fjalë për vepra penale të rënda, ku i pandehuri mund të dënohej me dënimin me vdekje dhe vetëm në rast se, i pandehuri nuk kishte mundësi të lidhte kontratën e shërbimit me një avokat. Ndërsa në çështjen Johnson kundër Zerbst (1938), gjykata vendosi se gjykatat federale duhet të garantojnë të drejtën e caktimit të një avokati në çështjet penale. Vetëm në rast se i akuzuari refuzon, është e mundur që gjykata të refuzojë të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur me avokat. Në çështjen Gideon kundër Wainwright (1963), gjykata u shpreh se e drejta për të pasur avokat, është një aspekt themelor i parimeve të procesit të rregullt, të njohur nga amendamenti gjashtë. Nuk ka rëndësi nëse i pandehuri mund të dënohet ose jo me dënimin me vdekje në gjykatat e shteteve ose federale, që t'i caktohet një avokat nga shteti. Nëse i

---

<sup>318</sup> Cartan, P., Nored, L. & Downey, R. (2011) *An Introduction to Criminal Law*, Sudbry: Jones & Bartlett Learning, fq. 24

<sup>319</sup> Sixth amendment. *Rights of accused in criminal prosecutions*, fq. 1421

<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-1992/pdf/GPO-CONAN-1992-10-7.pdf>

<sup>320</sup> Kusha, R.H. (2004) *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni: ABC-CLIO, Inc, fq. 34

pandehuri nuk ka mundësi ekonomike të lidhë kontratën e shërbimit me një avokat, gjykata është e detyruar të emërojë një avokat dhe shpenzimet mbulohen nga shteti. Në rast se i pandehuri refuzon qëllimisht, gjykata nuk e ka më këtë detyrim<sup>321</sup>.

E drejta për të pasur avokat, nuk do të thotë që avokati mjafton vetëm të jetë i pranishëm gjatë etapave të ndryshme procedurale, por mbrojtja me avokat duhet të jetë edhe efektive, (Shtetet e Bashkuara kundër Morrison, 1981). Shteti nuk duhet të ndërhyjë dhe të kufizojë mundësinë e takimit të avokatit me klientin e tij, sepse do të pengojë mundësinë e realizimit të mbrojtjes.<sup>322</sup>

Në çështjen Strickland kundër Washington (1984), gjykata realizoi një test të përgjithshëm se çfarë kuptohet me ndihmë ligjore joadekuate. Dy ishin komponentët e testit: performanca me mangësi e avokatit dhe paragjykimi në mbrojtje.

6) E drejta për të ofruar dëshminë e një dëshmitari dhe të detyrimit të paraqitjes së tij në rast nevoje, bëjnë pjesë tek të drejtat e mbrojtjes. I pandehuri ka të drejtë të përballet me dëshmitarët e prokurorisë, për të kundërshtuar dëshmitë e tyre e tyre, si dhe ka të drejtë të paraqesi dëshmitarët e tij për të përcaktuar drejtimin e mbrojtjes<sup>323</sup>. I pandehuri mund të kërkojë që dëshmitari të dëshmojë për karakterin e tij, alibinë e ngritur ose të kundërshtojë faktet e çështjes<sup>324</sup>.

#### **6.3.4 Amendamenti tetë**

Amendamenti i tetë parashikon që nuk do të vendosen garanci pasurore të tepërta, nuk do të vendosen gjopa të tepërta dhe nuk do të vendosen dënime mizore ose të jashtëzakonshme.

Amendamenti tetë ndalon kushtet tepër të ashpra të dënimit.

---

<sup>321</sup> Banaszak, R. (2002) *A documentary history: Fair Trial Right of the Accused*, Connecticut: Greenwood Press, fq. 122

<sup>322</sup> Është e zakonshme, në SHBA, t'i referohesh avokatëve, por edhe aktorëve të tjerë si përmbartesit, ekspertët, me termin "officer of the court" i cili shërben për të përkufizuar të gjithë ata që, ndonëse nuk janë punonjës të gjykatës, kanë një rol ligjor (pozitiv procedural) në procese gjyqësore, por edhe detyrime profesionale e etike që lidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor si një i tërë. Në këtë rol të tyre, avokatët kanë detyrimin të promovojnë drejtësinë dhe funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor dhe detyrimin etik absolut për të thënë të vërtetën përpara gjykatës, për të shmangur pandershmërinë, mosparaqitjen pa arsye, si dhe për t'i ardhur në ndihmë mirëfunksionimit të gjykatës dhe zgjidhjes së proceseve gjyqësore

<sup>323</sup> Sixth amendment. *Rights of accused in criminal prosecutions*, fq. 1429

<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-1992/pdf/GPO-CONAN-1992-10-7.pdf>

<sup>324</sup> Cartan, P., Nored, L. & Downey, R. (2011) *An Introduction to Criminal Law*, Sudbry: Jones & Bartlett Learning, fq. 24

Garancia pasurore është e tepërt, kur është caktuar një garanci pasurore shumë e lartë, sesa një shumë e llogaritur në mënyrë të arsyeshme për të siguruar interesin qeveritar. Në rast se interesi i vetëm është që i pandehuri, do të jetë i pranishëm gjatë zhvillimit të gjyqit dhe të zbatojë vendimin e gjykatës, në rast se shpallet fajtor, atëherë garancia pasurore duhet të caktohet nga gjykata që të mbylli këtë boshllëk dhe jo më tepër. Në rast se i pandehuri nuk është dakort me shumën e caktuar si garanci pasurore, ai duhet të një kërkesë për të kërkuar uljen e shumës së vendosur si garanci pasurore, dhe nëse kjo kërkesë refuzohet, mund të depozitojë ankim në gjykatën e apelit. Nëse edhe kjo kërkesë refuzohet, mund të bëjë kërkesë në Gjykatën Supreme që përfshin atë qark<sup>325</sup>.

Në lidhje me aplikimin e gjobave të tepërta, gjykata përdorte si kriter atë të mundësisë për të paguar<sup>326</sup>.

Në çështjen Shtetet e Bashkuara kundër Bajakajian (1998), gjykata në përcaktimin e proporcionalitetit, nuk e kufizoi vendimmarrjen vetëm në gjobën e vendosur për veprën e kryer, por mori në konsideratë dhe rrethanat e veçanta të çështjes, sjelljen e te pandehurit, dëmin e shkaktuar nga vepra penale.<sup>327</sup>

Nisur nga çështja Bajakajian, gjykata vendosi të ndryshojë jurisprudencën e saj në lidhje me interpretimin e shprehjes “gjoba të tepërta”, duke vendosur si kriter parimin e proporcionalitetit.

Qëllimi i amendamentit të tetë është për të ndaluar aplikimin e dënimit penal në mënyrë arbitrare ose diskriminuese<sup>328</sup>.

Në vitin 1825, në Karolinën e Jugut një të pandehuri për krimin që kreu, i'u caktua dënimi me djegie deri në vdekje. Ajo ishte hera e fundit kur një të dënuari i'u caktua ai lloj dënimi sepse shkelte amendamentin e tetë.

Çfarë do të kuptojmë me dënime mizore?

Kësaj pyetje i ka dhënë përgjigje në vitin 1972, Gjykata Supreme e SHBA në çështjen Furman kundër Georgia. Gjykata hartoi një listë se çfarë e bën një dënim mizor dhe të jashtëzakonshëm. Së pari, dënimi duhet të shkeli dinjitetin njerëzor të personit që i caktohet

---

<sup>325</sup> Eighth amendment. *Further guarantees in criminal cases*, fq. 1568 <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-2002/pdf/GPO-CONAN-2002-9-9.pdf>

<sup>326</sup> Po aty, fq. 1569. <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-2002/pdf/GPO-CONAN-2002-9-9.pdf>

<sup>327</sup> Gurule, J. (2013) *Complex criminal litigation: prosecuting drug enterprises and organized crime*, New York: Juris Publishing, fq. 444-445.

<sup>328</sup> Claus, L. (2008) *Methodology, proportionality, equality: which moral question does the eighth amendment pose?*, Harvard : Journal of Law & Public Policy, vol. 31. Nr.1, fq. 37-38.



dënimi. Së dyti, dënimi duhet të duket si diçka, që pjesës më të madhe të njerëzve do t'u dukej çmenduri edhe sikur të mendonin diçka të tillë. Së treti, dënimi duhet të jetë i panevojshëm për krimin që bëhet fjalë<sup>329</sup>. Së katërti, shteti nuk mund të vendosi në mënyrë arbitrare një dënim të ashpër<sup>330</sup>.

Po në këtë çështje, gjykata u shpreh se dënimi me vdekje mund të jetë në kundërshtim me amendamentin e tetë për mënyrën se si ai aplikohet<sup>331</sup>.

Në çështjen Coker kundër Georgia, gjykata rrëzoi një vendim që kishte caktuar dënimin me vdekje për veprën penale të "Përdhunimit", sepse asnjë jetë nuk është marre. Në një tjetër vendim, në çështjen Kennedy kundër Louisiana (2008), gjykata nuk la në fuqi një dënim me vdekje për përdhunimin e një fëmije nën moshën 12 vjec, me argumentin se dënimi me vdekje për një krim kundër individit, që nuk ka pasur si rezultat vdekjen, shkel amendamentin tetë<sup>332</sup>.

Duke analizuar jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin e dënimit me vdekje, vëmë re se gjykata mbas çështjes Coker kundër Georgia, ka filluar të aplikojë parimin e proporcionalitetit. Në rast së kemi shkelje të parimit të proporcionalitetit kemi shkelje të amendamentit të tetë.

## **6.4 Vështrim krahasues me të drejtën penale të Republikës së Kosovës**

### ***6.4.1 Kodi Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe parimet bazë të tij***

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Ky kod është hartuar me ndihmën e ndërkombëtarëve dhe përmban parime demokratike, në përputhje me standartet ndërkombëtare. Këtu gjejmë një ndërthurje të sistemit Civil Law me institutin e sistemit Common Law, siç është marrëveshja e njohjes së fajësisë.<sup>333</sup>

---

<sup>329</sup> Smith,R. (2008) Eighth amendment: *the right to mercy*,Minneapolis: ABDO Publishing Company, fq 7

<sup>330</sup> Palmer,J.L.& JR. (1998) *The death penalty: an american citizen's guide to understanding federal and state laws*, Karolina e Veriut : McFarland Company, Inc., Publishers, fq. 13

<sup>331</sup> Eighth amendment. *Further guarantees in criminal cases*, fq. 1575.<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-2002/pdf/GPO-CONAN-2002-9-9.pdf>

<sup>332</sup> Novak,A. (2014) *The global decline of the mandatory death penalty: constitutional jurisprudence and legislative reform in Africa, Asia and the Caribben*, USA : Ashgate Publishing Limited, fq. 17

<sup>333</sup> Sijerçia-Çoliq,H.,Haliloviq,H. (2007) *E drejta e Procedurës Penale me vështrim të posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës*, Prishtinë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka parashikuar në nenin 53 të saj se: “Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”<sup>334</sup>

Kosova edhe pse nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, ka parashikuar në Kushtetutën e saj që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, interpretohen në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo dispozitë është vendosur në Kushtetutën e Kosovës për dy arsye: e para, sepse Kosova do të anëtarësohet në një moment të caktuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe e dyta, për të vendosur standartet evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në nenin 3 të K.Pr.Penale të Republikës së Kosovës, është parashikuar prezumimi i pafajësisë dhe se çdo dyshim interpretohet në favor të të pandehurit. Në analizë të kësaj dispozite, çdo person i dyshuar që akuzohet se ka kryer një vepër penale, konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.<sup>335</sup> Dyshimet lidhur me ekzistencën e fakteve të rëndësishme, për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas K.P.Penale dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në nenin 4 të K.Pr.Penale, është parashikuar një tjetër parim i rëndësishëm që ka të bëjë me të pandehurin, ai i mosgjyqimit dy herë për të njëjtën vepër penale. Kjo dispozitë parashikon garancinë për të pandehurin, që mos të ndiqet penalisht dhe të dënohet për një vepër penale, nëse është shpallur i pafajshëm ose është dënuar me vendim të formës së prerë, ose nëse çështja penale është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, ose akuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.<sup>336</sup> Me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në K.Pr.Penale, vendimi i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike vetëm në favor të personit të dënuar.

Në nenin 9 të K.Pr.Penale, është parashikuar barazia e palëve. Kjo është një karakteristikë e sistemit akuzator, ku prokuri dhe i pandehuri janë në pozita të barabarta. Kjo dispozitë parashikon që në rast se nuk parashikohet ndryshe në K.Pr.Penale, i pandehuri dhe prokurori në procesin penal kanë pozitë të barabartë.<sup>337</sup> Paragrafi 2 i nenit 9 parashikon që i

---

<sup>334</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, fq . 6

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf)

<sup>335</sup> K.Pr.Penale të R.Kosovës, neni 3 i tij

<sup>336</sup> K.Pr.Penale të R.Kosovës, neni 4

<sup>337</sup> Po aty, neni 9

pandehuri, ka të drejtë të deklarojë dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi, për të gjitha faktet dhe provat që akuzohet dhe të paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori, që të thërrasi dëshmitarë në emër të tij dhe të marri në pyetje dëshmitarët kundër tij, si dhe të kërkojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejné për dëshmitarët kundër tij.<sup>338</sup>

Neni 10 i K.Pr.Penale parashikon tre garanci për të pandehurin, njëra lidhet me njoftimin e akuzës dhe dy të tjerat kanë lidhje me fajësinë. Konkretisht, ky nen parashikon njoftimin e akuzës. I pandehuri nuk është i detyruar të pranojë akuzën dhe atij nuk i imponohet akuza. Në mënyrë më të detajuar, neni 10 parashikon që gjatë arrestimit dhe marrjes në pyetje për herë të parë, i pandehuri njoftohet me hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzes kundër tij në gjuhën që ai e kupton. I pandehuri nuk ka detyrimin të paraqesë mbrojtjen e vet ose t'i përgjigjet pyetjeve, dhe nëse ai dëshiron të mbrohet nuk është i detyruar të fajësojë veten ose të afërmit e tij dhe as të pranojë fajësinë. Nga kjo e drejtë bën përjashtim rasti kur i pandehuri, zgjedh të hyjë vullnetarisht në marrëveshje për të bashkëpunuar me prokurorin. Ndaj të pandehurit ndalohet dhe dënohet imponimi i pranimit të fajësisë ose ndonjë deklarim tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme.<sup>339</sup>

Ligjvënësi ka parashikuar ndalimin e torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme, për arsye se çënojnë zbardhjen e së vërtetës, dhe lejimi i tyre do të shkelte të drejtat e të pandehurit dhe do të çënonte një sërë konventash ndërkombëtare që ndalojnë të tilla praktika.

#### ***6.4.2 Procesi penal hetimor në Republikën e Kosovës***

Në proceset penale në Kosovë përdoret gjuha shqipe dhe serbe, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj. Të pandehurit që mbahet në paraburgim dhe personit që vuan dënimin, i sigurohet përkthimi i njoftimeve gjyqësore, vendimeve dhe kërkesave në gjuhën të cilën ai e përdor në procesin penal<sup>340</sup>.

Në fillim të marrjes në pyetje në procesin hetimor, prokurori i lexon të pandehurit këtë paralajmërim:

---

<sup>338</sup> Smibert, J. (2013) *Udhëzues për K.Pr.Penale të Kosovës dhe K.Pr.Penale të Kosovës*, Prishtinë: Ambasada e SHBA

<sup>339</sup> Neni 10 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>340</sup> Neni 14 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

"Ky është një hetim penal i veprave që ju mund të keni kryer. Ju keni të drejtë të jepni deklaratë, mirëpo po ashtu keni të drejtë të heshtni dhe të mos përgjigjeni në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin tuaj. Ju keni të drejtë të mos e fajësoni veten tuaj. Nëse ju zgjedhni të jepni deklaratë apo të përgjigjeni në pyetje, ju do të jeni nën betim. Informatat e dhëna mund të përdoren si dëshmi në gjykatë. Nëse keni nevojë për përkthyes, do t'iu sigurohet falas. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten apo të afërmin tuaj si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Ju keni të drejtë të keni mbrojtës dhe të konsultoheni me të para dhe gjatë marrjes në pyetje. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonit që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonit atë. Nëse nuk i kuptoni këto të drejta, konsultohuni me mbrojtësin tuaj".<sup>341</sup>

Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më përpara të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata gjatë hetimit. Mospjesëmarrja për shkaqe të pajustificuara të të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimave në datën për marrjen e deklaratës gjatë hetimit, pasi të ketë pranuar njoftimin, ia mohon të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit apo mbrojtësit të viktimës që të kundërshtojë pranueshmërinë e dëshmisë në një fazë të mëvonshme të procedurës penale<sup>342</sup>.

Në nenin 133 të K.Pr.Penale, ligjvënësi kosovar ka përcaktuar procedurën e marrjes në pyetje gjatë hetimit, të dëshmitarëve.

Prokurori, së pari merr në pyetje dëshmitarët që i ka caktuar vetë. Nëse mbrojtja ka kërkuar që të merren deklarata gjatë hetimit nga dëshmitarë, atëherë së pari mbrojtja merr në pyetje ata dëshmitarë që ajo ka kërkuar të pyeten. Secilës palë duhet t'i jepet mundësia që t'i bejë pyetje dëshmitarit të pyetur nga pala tjetër<sup>343</sup>.

I pandehuri mund të kërkojë nga prokurori i shtetit, që të paraqese kërkesë për ekspertizë, që është relevante për mbrojtjen e tij. Nëse prokurori i shtetit refuzon, i pandehuri mund të kundërshtojë këtë vendim tek gjyqtari i procedurës paraprake. I pandehuri ka të drejtë të kërkojë bërjen e ekspertizës nga ekspertë të zgjedhur nga vetë ai<sup>344</sup>.

Përpara se i pandehuri të merret në pyetje, atij i lexohet paralajmërimi i nenit 125, paragrafi 3 i K.Pr.Penale. Para çdo marrjeje në pyetje, i pandehuri informohet për<sup>345</sup>:

a) Veprën penale për të cilën akuzohet.

<sup>341</sup> Neni 125 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>342</sup> Neni 134 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>343</sup> Neni 133 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>344</sup> Neni 141 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>345</sup> Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

b) Faktin se ai mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij. Kur i pandehuri është në paraburgim, para çdo marrjeje në pyetje ai gjithashtu informohet për të drejtën e tij për të pasur mbrojtës.

c) Të drejtën për të heshtur dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveçse të japë informacion në lidhje me identitetin e tij / të saj.

I pandehuri ka të drejtë të këshillohet me mbrojtësin e tij para dhe gjatë marrjes në pyetje. Si rregull, procesi i marrjes në pyetje i të pandehurit nga policia ose prokuri, incizohet audio ose video. Në rast se kjo është e pamundur, atëherë proces verbali me shkrim realizohet sipas rregullave të parashikuara në Kapitullin XI të K.Pr.Penale dhe në proces verbal shënohet arsyeja pse marrja në pyetje nuk u realizua audio ose video.

Personi i arrestuar gëzon këto të drejta<sup>346</sup>:

1. të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
2. të heshtë dhe të mos i përgjigjet asnjë pyetjeje, përveç dhënies së informacioneve mbi identitetin e tij;
3. t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e punonjësit të policisë;
4. të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike;
5. për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij;
6. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

Në rastin e shtetasve të huaj, për të mbajtur lidhjet e tyre me vendin e origjinës por edhe për t'i vënë në dijeni përfaqësuesit të shtetit të huaj që po zhvillohet një proces ndaj një shtetasi të tyre, është parashikuar e drejta e personit të arrestuar për të njoftuar ambasadën e shtetit të tij. Të njëjtën garanci K.Pr.Penale, ofron edhe për personat që janë refugjatë, por në këtë rast ata kanë të drejtë të njoftojnë organizat ndërkombëtare.

Personi i ndaluar ka këto të drejta<sup>347</sup>:

1. Personi i ndaluar veçohet nga personat e dënuar ose nga personat e paraburgosur.
2. Personat e ndaluar të gjinive të ndryshme nuk mbahen në të njëjtën dhomë.

---

<sup>346</sup> Neni 167 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>347</sup> Neni 170 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

3. Personit të ndaluar për më shumë se dymbëdhjetë orë i sigurohen tre racione ushqimi në ditë.

4. Brenda njëzet e katër orëve, personi i ndaluar ka të drejtë të bëjë të paktën tetë orë pushim pa ndërprerje, dhe gjatë kësaj kohe nuk merret në pyetje e as nuk trazohet nga policia lidhur me hetimin.

Gjatë marrjes në pyetje nga punonjësit e policisë, personi i arrestuar ka të drejtë të ketë mbrojtës. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet brenda 2 orëve pas informimit për arrestimin, policia i cakton mbrojtës tjetër. Më tutje, nëse mbrojtësi tjetër nuk paraqitet brenda një ore pas informimit nga policia, personi i arrestuar mund të merret në pyetje vetëm nëse prokurori i shtetit ose policia, çmon se shtyrja e mëtejshme do të rrezikonte seriozisht zhvillimin e hetimit. Gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, bëhen pushime të shkurtra në intervale kohore përafërsisht 2 orëshe. Pushimi mund të shtyhet, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se shtyrja do të shkaktonte rrezik për dëmtimin e shëndetit të personave, ose humbje apo dëmtim të rëndë të pasurisë. Gjatë marrjes në pyetje, nuk kërkohet nga personi i arrestuar të qëndrojë në këmbë dhe nuk i mohohet ushqimi, uji dhe kujdesi i nevojshëm mjekësor<sup>348</sup>.

I pandehuri ka të drejtë të njihet me aktet e dosjes hetimore. Procedurën që zbatohet për njohjen me aktet e dosjes hetimore e parashikon neni 213 i K.Pr.Penale.

Me fillimin e hetimit, prokurori është i detyruar që t'i sigurojë cilido të pandehur apo mbrojtësve të tyre akses në shkresat e dosjes, përveç përjashtimeve të parashikuara në ligj.

Në asnjë fazë të hetimit, mbrojtjes nuk mund t'i mohohet njohja me aktet lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, njohja me materialet e marra nga i pandehuri apo materialet që i përkasin atij, njohja me materialet lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose duhej të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit ose njohja me aktet e ekspertimit.

Mbas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata.

Mbrojtjes i lejohet nga prokurori i shtetit që të shikojë, të kopjojë ose të fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të

---

<sup>348</sup> Neni 170 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij. Prokurori mund t'i refuzojë mbrojtjes, shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit është përfundimtar<sup>349</sup>.

I pandehuri mund të kërkojë edhe sigurimin e proë<sup>350</sup>. Gjatë hetimit i pandehuri mund të kërkojë nga prokurori marrjen e ndonjë prove konkrete. Prokurori administron provën apo merr dëshminë nëse plotësohen dy kushte: 1) nëse është e rëndësishme për procedurë; 2) kur ekziston rreziku për humbjen e provës apo dëshmisë ose kur ka gjasa që të mos jetë e mundshme në shqyrtim gjyqësor. Nëse prokurori refuzon kërkesën për marrjen e provës, ai merr vendim të arsyetuar dhe njofton të pandehurin. I pandehuri mund të ankohej te gjyqtari i procedurës paraprake ndaj një vendimi të tillë.

Prokurori me pëlqimin e të dëmtuarit mund të pezullojë ndjekjen për vepra penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet, duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe karakterin e veprës penale dhe të autorit, nëse i pandehuri zotohet se do të sillet siç është udhëzuar nga prokurori i shtetit dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara, që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale, duke përfshirë: eliminimin ose kompensimin e dëmit, pagesën e një kontributi ndaj një institucioni publik ose humanitar apo të fondeve për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale ose kryerjen e punës në interes publik.

Nëse brenda një afati prej jo më shumë se 6 muajsh, i pandehuri i përmbush detyrimet, hetimi pushohet. Kur i pandehuri nuk përmbush detyrimet, prokurori mund të rifillojë ndjekjen e veprës penale<sup>351</sup>.

Në rastet e dhunës në familje ose dhunës seksuale nuk zbatohet pezullimi i hetimeve.

Kur autori i veprës penale të dënueshme me gjobë ose burgim deri në 1 vit, sinqerisht pendohet për veprën penale dhe ndalon pasojat e dëmshme ose bën kompensimin e dëmit,

---

<sup>349</sup> Neni 213 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>350</sup> Neni 216 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

<sup>351</sup> Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

prokurori çmon se nga aspekti i rrethanave të çështjes sanksioni penal nuk do të ishte i arsyeshëm<sup>352</sup>.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 233 të tij, ka parashikuar institutin e njohjes së fajësisë, i cili e ka prejardhjen nga sistemi Common Law. Kjo dispozitë parashikon procedurën që ndiqet për njohjen e fajësisë nga i pandehuri. Si rregull sanksioni nuk mund të ulet nën minimumin që parashikon dispozita përkatëse. Kjo marrëveshje mund të lidhet si në fazën e hetimeve ashtu edhe gjatë gjykimit ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit.

---

<sup>352</sup> Neni 231 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës



## KAPITULLI VII: PROBLEMATIKAT NË RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË TË PANDEHURIT NË PRAKTIKË

### 7.1- Shkelja e të drejtave të të pandehurit si shkak i pavlefshmërisë së akteve procedurale

Do të ndalemi në trajtimin e këtij instituti tepër të rëndësishëm të K.Pr.Penale, për faktin se gjatë studimit të rasteve të praktikës gjyqësore, janë evidentuar shumë raste të akteve të pavlefshme në procesin penal, si rrjedhojë e shkeljes apo mosrespektimit të të drejtave të të pandehurit në këtë proces. Aktet procedurale pasqyrojnë dhe vërtetojnë veprimtarinë e subjekteve të procedimit penal, dhe si të tilla ato duhet të përpilohen në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat përcaktohen nga karakteri dhe rëndësia e aktit. Morespektimi i këtyre kërkesave, sjell pavlefshmërinë e aktit, e cila mund të jetë absolute ose relative. K.Pr.Penale nuk parashikon të gjitha shkaqet që sjellin pavlefshmërinë e aktit, megjithatë nga interpretimi i dispozitave të kodit, rezulton se akti procedural duhet të përmbajë disa elementë, mungesa e të cilëve çon në pavlefshmërinë e tij. Të tilla janë: forma, përmbajtja e aktit (arsyetimi, qëllimi, afati) procedura për përpilimin e aktit, kompetenca e organit.

Për efekt të temës që po trajtojmë, do të analizojmë jo të gjitha shkaqet e pavlefshmërisë së aktit, por do t'i referohemi, veçanërisht nenit 128 të K.Pr.Penale, i cili sanksionon shkaqet kryesore të pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale.

Është e kuptueshme se një akt absolutisht i pavlefshëm nuk krijon pasoja juridike, është “nul” dhe si i tillë nuk ka fuqi juridike ndaj subjekteve që iu drejtohet.

Në bazë të nenit 128/1 (a) të K.Pr.Penale:

“Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me kushtet për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete, dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuar në këtë kod”.<sup>353</sup>

Mosrespektimi i kësaj dispozite passjell shkeljen e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDrNj, sepse cënon të drejtat e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor. Kjo për faktin se, kushtet për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete, kanë të bëjnë me ndalimet e parashikuara në nenin 15, 16, 17, 18 të K.Pr.P, të cilat përcaktojnë rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim. Ligjvënësi, me të drejtë, për të shmangur njëanshmërinë e mundshme të gjyqtarit në çështjen konkrete, i ka parashikuar këto raste,

<sup>353</sup> Neni 128/1 K.Pr.Penale të R.Sh

duke i njohur të pandehurit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nëse ekziston një prej rasteve të mësipërme.

Parimi i paanshmërisë, i afimuar në Kushtetutë (neni 42) dhe në K.E.D.Nj. (neni 6), është shumë i rëndësishëm për vetë ekzistencën e procesit të rregullt gjyqësor, për të pandehurin si subjekt kryesor i tij.

Gjykata Europiane, në çështjen De Cubber kundër Belgjikës (vendim i dt.24.10.1984), pranoi pretendimin e kërkuarit për shkelje të nenit 6 të KEDrNj. Sipas këtij pretendimi, një gjyqtar kishte marrë pjesë në të dy shkallët e procedimit dhe kërkuari pjesëmarrjen e këtij gjyqtari në proces, pavarsisht nga vendimi i tij, e quante “njëanshmëri të prezumuar”. Gjykata e pranoi këtë pretendim, duke e konsideruar si të prezumuar njëanshmërinë e gjyqtarit në këtë rast, dhe theksoi se shteti ishte i detyruar të vërtetonte të kundërtën (paanshmërinë), por duke qënë se nga shteti nuk u soll asnjë provë e kundërt që të fliste për paanshmërinë e gjyqtarit, ky prezumim nuk u rrëzua.

Gjykata e pranoi argumentimin e shtetit se gjyqtari në këtë çështje ishte i paanshëm, por vetë i akuzuari mund të kishte dyshime lidhur me paanshmërinë e gjykatës dhe për pasojë kishte shkelje të nenit 6 të KEDrNj.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin Nr.473, dt.29.10.2001 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Kurbin në ngarkim të të pandehurit K.N., A.M., me arsyetimin se:

“në gjykimin e çështjes ndaj këtyre të pandehurve ka marrë pjesë në trup gjykues edhe gjyqtari D.M. Nga aktet e administruara në dosje, rezultojnë se ky gjyqtar ka gjykuar kërkesën e Prokurorisë Kurbin për vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi ndaj A.M. dhe K.N. Gjyqtari D.M. ka shkelur edhe n.18 të K.Pr.P, pasi gjatë ushtrimit të funksionit ka shfaqur mendimin mbi faktet dhe rrethanat objekt procedimi... dhe në bazë të n.128/1 të K.Pr.P. vendimi i Gjykatës Kurbin është absolutisht i pavlefshëm, sepse gjyqtari D.M. nuk ka respektuar kushtet ligjore për të qënë gjyqtar në çështjen konkrete.”<sup>354</sup>

Nga vendimi i mësipërm, del qartë se ndodhemi para një “procesi të parregullt gjyqësor” për të pandehurin që ka qënë subjekt i këtij procesi. Para një procesi të tillë do të ndodheshim, edhe në rastin e mosrespektimit të dispozitave që lidhen me numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara.

Neni 128/1 (b): “Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me:

---

<sup>354</sup> Vendim Nr. 473, dt. 29.10.2001 Gjykata e Apelit Tiranë

- a) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim”.<sup>355</sup>

Sipas nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24 të K.Pr.P, del qartë se prokurori kryen dy funksione të rëndësishme:

1. Është i vetmi organ shtetëror që ushtron ndjekjen penale
2. Pjesëmarrja e prokurorit në çdo shkallë të gjykimit është e detyrueshme, sepse është subjekti i procedimit penal që përfaqëson akuzën publike.

Në praktikën gjyqësore, janë evidentuar raste kur gjykatat kanë marrë rolin e prokurorit (akuzës). Kryerja e një funksioni të tillë nga gjykata, jo vetëm nuk pajtohet me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të K.E.Dr.Nj, por e pozicionon atë si një subjekt me funksion të dyfishtë, atë të dhënies së drejtësisë dhe akuzës.

Është e kuptueshme se në një rast të tillë nuk mund të bëhet fjalë për “proces të rregullt gjyqësor e ligjor”, e aq më pak për garantimin e të drejtave të të pandehurit në këtë proces.

Prokuroria e Rrethit Elbasan, ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A.P. me akuzën e “Vrasjes me paramendim” e mbetur në tentative, (neni 78 dhe 22 i K.P.) dhe “Armëmbajtje pa leje”, (neni 278/2 i K.P). Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Elbasanit e ka deklaruar fajtor të pandehurin A.P. për veprat e mësipërme. Gjithashtu, po me këtë vendim penal, kjo Gjykatë ka deklaruar fajtor dhe i ka dënuar me gjobë I.Z., H.D. e A.Sh. për veprën penale të ”Dëshmisë së rreme” (neni 306 i K.P).

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e dt.26.12.1996, vendosi lënien në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga apeli i prokurorit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për shkelje të rëndë procedurale, për faktin se, në gjykimin e shkallës së parë, prokurorit i është mohuar e drejta e ushtrimit të ndjekjes penale, duke e marrë përsipër vetë gjykata këtë funksion.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e tij pranoi rekursin e prokurorit, duke prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, me arsyetimin se: vendimet e mësipërme janë akte procedurale absolutisht të pavlefshme, pasi ato i kanë mohuar prokurorit të drejtën e ushtrimit të ndjekjes penale në hetim dhe gjykim të parashikuara nga neni 24 dhe 25 i K.Pr.P, dhe në bazë të nenit 128/1(b) të K.Pr.P. ai duhet të priset.

---

<sup>355</sup> Neni 128/1/b K.Pr.Penale të R.Sh

Nga rasti që trajtuam më lart, në një seancë gjyqësore u morën të pandehur dhe u gjykuan me vendim përfundimtar dy persona, pa u respektuar dispozitat e K.Pr.Penale, në lidhje me të drejtat e tyre dhe të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale.

Pjesëmarrja e prokurorit në procesin gjyqësor është një e drejtë kushtetuese, mosrespektimi i së cilës do të shkelte parimin e kontradiktorialitetit, që përbën dhe thelbin e procesit të rregullt ligjor. Kjo për arsye se, ligji i nje vetëm prokurorit të drejtën e mbrojtjes së akuzës në gjyq dhe mungesa e tij do të pengonte zbatimin e parimit të mësipërm, pasi i pandehuri nuk do të mund ta kundërshtonte këtë akuzë, në mungesë të debatit midis dy palëve dhe, gjykata nuk mund të krijojë bindjen e saj në dhënien e vendimit.

Prokurori ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të paraqesë provat për vërtetimin e akuzës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij në këtë mënyrë realizojnë të drejtën e kundërshtimit të kësaj akuze nëpërmjet provave që paraqesin, dhe është debati ai që krijon bazën mbi të cilën mbështetet bindja e gjyqtarit në dhënien e vendimit përfundimtar.

Neni 128/1(ç) referon se:“Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme”.<sup>356</sup>

Së pari, duhet të theksojmë se mbi 1/3 e akteve procedurale që janë konstatuar absolutisht të pavlefshme, janë pasojë e mosrespektimit të dispozitës së mësipërme, lidhur me thirrjen e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kjo për shkak se, dispozita në fjalë garanton parimin e “barazisë së palëve”, ku të pandehurit i lejohet të përdorë të njëjtat mjete që përdor edhe akuza, për të mbrojtur vetveten. Në bazë të këtij parimi, të cilin e kemi trajtuar tek kapitulli paraardhës, secilës prej palëve duhet t’i ofrohen mundësi dhe mjete të barabarta për të paraqitur çështjen, dhe asnjëra të mos gëzojë ndonjë avantazh ndaj tjetrës.

Siç del nga vetë dispozita e mësipërme, shkelja e të drejtës së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për të qënë të pranishëm në proces, kur ligji e parashikon në mënyrë të detyrueshme praninë e tyre, bëhet shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit procedural. Rastet e pjesëmarrjes së detyrueshme të mbrojtësit në proces, janë parashikuar në dispozita të veçanta të K.Pr.Penale, si në nenin 35/2, nenin 309/2, nenin 259, nenin 321 etj.

---

<sup>356</sup> K.Pr.Penale të R.Sh, neni 128/1/c

Duke e analizuar këtë dispozitë konstatojmë dy rrethana që duhet të jenë prezente : E para lidhet me thirrjen e të pandehurit kur ajo është e detyrueshme, ndërsa e dyta lidhet me praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.

Lidhur me pikën e parë, theksojmë se pjesëmarrja e të pandehurit në procesin penal, është jo vetëm detyrim për organet e drejtësisë, por edhe një e drejtë e pamohueshme e vetë të pandehurit, e parashikuar kjo në nenin 33 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet”.<sup>357</sup>

Mosrespektimi i kësaj të drejte, përbën shkelje të rëndë procedurale dhe mbi të gjitha shkelje të vetë Kushtetutës, duke çuar në pavlefshmërinë absolute të vendimit të dhënë nga organi procedues. Praktika ka treguar se këto shkelje janë të shumta, dhe vijnë për shkak të moszbatimit të rregullt të dispozitave të kodit që lidhen me njoftimet. Janë evidentuar në praktikën gjyqësore, raste kur organi procedues ka nxjerrë vendimin e mosgjetyjes së të pandehurit, pa u kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme, ose është deklaruar ikja e të pandehurit, bazuar në të dhëna të marra jo në rrugë ligjore, është bërë deklarimi i mungesës në gjykim, në një kohë kur i pandehuri nuk ka marrë fare njoftim mbi datën e seancës gjyqësore.

Disa raste të praktikës gjyqësore, pasqyrohen më poshtë :

### **Rasti I**

Gjykata e Apelit Tiranë me vendim Nr.57, dt.13.02.2002 ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë pasi është shkelur neni 141/2 i K.Pr.Penale, me arsyetimin se:

“organi i Prokurorisë ka vendosur deklarimin e mosgjetyjes së të pandehurit, por ky deklarim është konstatuar i pavlefshëm pasi nuk janë respektuar rregullat e parashikuara në nenin 141 për njoftimin e të pandehurit kur nuk gjendet ».<sup>358</sup>

Gjykata duke u bazuar në vendimin e mosgjetyjes të nxjerrë nga prokurori, ka vendosur në seancë gjyqësore deklarimin e mungesës së të pandehurit duke shkelur nenin 141/2 të K.Pr.Penale, sipas të cilit “vendimi i mosgjetyjes i pushon efektet, kur përfundojnë hetimet paraprake”.<sup>359</sup> Ndaj në bazë të të nenit 128/1(c), shkelja e të drejtës së të pandehurit për t’u thirrur në gjykim, çon në pavlefshmërinë e këtij vendimi të gjykatës dhe të gjithë akteve të tjera procedurale të marra në gjykim.

<sup>357</sup> Neni 33 i Kushtetutës së R.Sh

<sup>358</sup> Vendim Nr.57, dt. 12.02.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>359</sup> Neni 141/2 K.Pr.Penale

Në këtë rast, mosnjohimi i rregullt i të pandehurit, ka çuar në shkeljen e të drejtës së tij për të qënë i pranishëm në gjykim dhe është bërë shkak për prishjen e vendimit të gjykatës, si akt procedural absolutisht i pavlefshëm, i marrë në kundërshtim me kërkesat e K.Pr.Penale. Në lidhje me praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme, i referohemi nenit 259, nenit 310, nenit 351, nenit 352 (gjykimi në mungesë) etj. Mungesa e mbrojtësit në këto veprime procedurale, e bën aktin procedural që i evidenton ato, të pavlefshëm. Roli i mbrojtësit në një procedim penal ka shumë rëndësi, duke u parashikuar ky institut edhe në nenin 30/ç të Kushtetutës. Në praktikë ka mjaft raste të shkeljes së këtyre dispozitave, duke u cënuar kështu procesi i rregullt ligjor për të pandehurin, dhe veçanërisht në gjykimet në Apel këto raste janë të shumta.

## **Rasti II**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr.176 dt.4.03.2002 ka vendosur prishjen e vendimit Nr.256 dt.23.10.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për shkak të shkeljes së ligjit, lidhur me garancitë e mbrojtjes së të gjykuarit në procesin penal.Gjykata referon në vendimin e saj se :

« Nga materialet e dosjes, rezulton se i pandehuri Sh.P. duke qënë në gjendje të lirë, nuk është njoftuar për ditën e gjyimit të çështjes në Gjykatën e Apelit për datën 5.10.2001. Për mosnjohim të të pandehurit është vendosur shtyrja e seancës për datën 16.10.2001, në të cilën është paraqitur i pandehuri Sh.P. duke kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për arsye se avokati i tij ishte me raport mjekësor. Për t'i dhënë mundësi të pandehurit të mbrohej në gjykim nga avokati i tij, me të drejtë, Gjykata e Apelit vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore për datën 23.10.2001. Në gjykimin e zhvilluar në këtë datë i pandehuri megjithëse kishte dijeni nuk u paraqit, ndërsa avokati i tij ka vënë në dijeni gjykatën se ai nuk mund të mbronte te pandehurin, për arsye se i pandehuri e ka përjashtuar nga kjo e drejtë.Gjykata e Apelit ka vazhduar gjykimin në mungesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit ka lejuar shkeljen e dispozitave procedurale që garantojnë të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit, ndaj bazuar në nenin 128/c të K.Pr.P, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm prandaj dhe duhet të priset».<sup>360</sup>

## **Rasti III**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr.341 dt.23.05.2002 ka vendosur prishjen e vendimit Nr.245 të Gjykatës së Apelit Vlorë me arsyetimin se:

“nga aktet e ndodhura në dosje del se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit nuk janë respektuar rregullat e përcaktuara në K.Pr.P për njoftimin e të pandehurve L.Gj. dhe B.I. për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në gjykim.

Sipas procesverbalit gjyqësor të datës 23.10.2001, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur gjykimin e çështjes në mungesë të të pandehurve B.I dhe L.Gj. me arsyetimin se ata nuk janë paraqitur në gjykim ndonëse kishin dijeni për ditën dhe orën e zhvillimit të tij. Por nga fletëthirrjet e ndodhura në dosje, vërehet se ato nuk iu janë dorëzuar personalisht të dy të pandehurve. Gjithashtu Kolegji Penal çmon se të dy fletëthirrjet, duke qënë se janë të

<sup>360</sup> Vendim Nr.176, dt. 04.3.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

panëshkruara si nga ai që ka bërë njoftimin ashtu edhe nga ia që ka marrë përsipër njoftimin, janë të pavlefshme.

Duke u ndodhur në kushtet e mosrespektimit të dispozitave që lidhen me thirrjen e dy të pandehurve në gjykim në Gjykatën e Apelit kur ajo ka qënë e detyrueshme, Kolegji Penal çmon se, në bazë të nenit 128/1(c) të K.Pr.P, të gjitha aktet proceduriale të bëra në këtë gjykatë, janë absolutisht të pavlefshme. Përveç sa më sipër, nga procesverbali gjyqësor del se i pandehuri L.Gj është gjykuar në mungesë pa patur mbrojtës. Lidhur me këtë fakt, Kolegji Penal çmon se Gjykata e Apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 351/1 të K.Pr.P., sipas të cilit për çdo rast që gjykata deklaron mungesën e të pandehurit, ajo është e detyruar që gjykimin në ngarkim të tij ta vazhdojë në prani të mbrojtjesit. Edhe për këtë shkak vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të priset.”<sup>361</sup>

Përveç rasteve të mësipërme, në shumë raste të tjera në Gjykatën e Apelit, është zhvilluar gjykimi vetëm me praninë e mbrojtjesit dhe të prokurorit.

Vetë këto gjykata, në vendimet e tyre arsyetojnë se neni 426 i K.Pr.Penale, i cili përmban urdhrin për thirrjen e palëve në proces për gjykimin në Apel, nuk parashikon thirrjen e mbrojtjesit apo praninë e tij dhe të pandehurit në seancë në mënyrë të detyrueshme.

Për këtë problem Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dalë me vendimin unifikues Nr.1 dt.15.02.2001, ku theksojnë se:

“Urdhërimi për thirrjen dhe njoftimi i të pandehurit për të marrë pjesë në gjykimin në Apel, është një detyrim ligjor dhe jo fakultativ për gjykatën. Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor përbën shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës). Gjykatat duhet të bëjnë dallimin midis njoftimit të të pandehurit dhe njoftimit të mbrojtjesit, sepse edhe nga këndvështrimi i nenit 426/1 i K.Pr.P, nuk mundet kurrsesi “të barazohet” thirrja e njoftimi i të pandehurit me mbrojtjesin e tij. Gjithashtu, gjykatat e apelit duhet të bëjnë dallimin midis “urdhërimit për thirrje” dhe “njoftimit të të pandehurit”, dhe duhet të kenë parasysh detyrimin tjetër ligjor, që ky urdhërim nuk mund të kuptohet pa realizimin e njoftimit të të pandehurit.

Në këtë kuadër, gjykatat e apelit duhet të zbatojnë e të respektojnë kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me njoftimin e të pandehurit. Mosrespektimi i kërkesave ligjore të parashikuara nga neni 426/1 dhe 139 të K.Pr.P, i bën të gjitha aktet e Gjykatës së Apelit në këtë gjykim, absolutisht të pavlefshme sipas nenit 128/1(c) të K.Pr.P.”<sup>362</sup>

Pas rregullimit që iu bë problemit të mësipërm nga Gjykata e Lartë, në praktikë ka një tendencë pozitive në lidhje me njoftimet, sidomos në Gjykatën e Apelit. Edhe në ato raste, kur mbrojtësi deklaron se i pandehuri ka shprehur dëshirën që të mos marrë pjesë në gjykim, por për këtë nuk ka ndonjë konfirmim nga gjykata, procesi gjyqësor është çmuar nga Gjykata e Lartë i parregullt, dhe gjykimi është konstatuar i pavlefshëm sipas nenit 128/1(c). (vendim Nr.570, dt.23.10.2002<sup>363</sup>).

<sup>361</sup> Vendim Nr.341 dt.23.05.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

<sup>362</sup> Vendim Nr.1 dt.15.02.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

<sup>363</sup> Vendim Nr.570, dt. 23.10.2002 i Gjykatës së Lartë

Gjykimi i zhvilluar pa njoftuar të pandehurin dhe mbrojtësin e tij sipas dispozitave të K.Pr.Penale, e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja ligjore dhe, në bazë të nenit 131/f e legjitimon të pandehurinc të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese pasi ka ezauruar të tria shkallët e gjykimit për rivendosjen e të drejtave të tij për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në gjykim, në bazë të nenit 33 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese me vendimin Nr.9, dt.22.2.2000, ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve penale Nr.97 dhe Nr.670, përkatësisht të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë arsyetim:

“Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Rrethit në rigjykim kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës. Në radhë të parë, gjykimet janë zhvilluar pa njoftuar të pandehurin ose mbrojtësin e tij sipas rregullave të K.Pr.P. Kështu, ndërsa prokurori ka paraqitur një ankim ndaj vendimit të gjykatës së rrethit, kopja e këtij ankimi nuk i është dërguar kërkuarit sipas nenit 140 të K.Pr.P.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykimi i çështjes në gjykatën e Apelit është bërë pa e njoftuar të pandehurin. Njoftimi i tij nuk është bërë as në rigjykim, në Gjykatën e rrethit, aq më tepër që nga kjo gjykatë u dënua për një vepër penale shumë më të rëndë se e mëparshmeja.

Është e vërtetë, që Gjykata e Rrethit në rigjykim i ka caktuar mbrojtës dhe i ka dhënë kohë atij të përgatitet, por kjo nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se gjykata ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues e ligjor për realizimin e të drejtës së mbrojtjes. Është detyrë e Gjykatës së Rrethit dhe e Gjykatës së Apelit të kryejnë të gjitha veprimet procedurale për njoftimin e të pandehurit, dhe vetëm kur ky nuk paraqitet të caktojnë mbrojtës kryesisht.

Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk ka caktuar as mbrojtës kryesisht por ka dëgjuar vetëm prokurorin duke mos respektuar parimet e rëndësishme të mbrojtjes dhe të kontradiktorialitetit në gjykim. Të gjitha këto e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin e nenit 42/1 të Kushtetutës”.<sup>364</sup>

Në analizë të nenit 128/2 të K.Pr.Penale, i cili referon se : “Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm, nuk mund të bëhet i vlefshëm”<sup>365</sup>, paragrafi 2 i këtij neni lejon të kuptohet se, përveç rasteve të pavlefshmërisë absolute të parashikuara nga paragrafi 1, dispozitat e K.Pr.P, parashikojnë edhe raste të tjera të akteve absolutisht të pavlefshme.

Kështu, e drejta e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor, shkelet edhe në rastin e mosrespektimit të nenit 112/3 të K.Pr.Penale, sipas të cilit: “Vendimet e gjykatës duhet të arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshme” (neni 142/1 i Kushtetutës). Shkelja e kësaj dispozite e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja ligjore (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDrNj).

Gjithashtu neni 323 i K.Pr.Penale, përcakton shprehimisht afatin e hetimeve paraprake. Çdo veprim hetimor i prokurorit tej këtij afati, cënon procesin e rregullt ligjor, të drejtat e të

<sup>364</sup> Vendim Nr.9 dt.22.02.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

<sup>365</sup> Neni 128/2 i K.Pr.Penale



pandehurit në këtë fazë të procedimit, ndaj edhe çdo akt procedural i përpiluar tej këtij afati, është absolutisht i pavlefshëm në kuptimin e nenit 128/2 të K.Pr.Penale.

Si përfundim, theksojmë se trajtimi i nenit 128 të K.pr.Penale, është rezultat i rëndësisë thelbësore që ka respektimi i kërkesave të këtij neni për të garantuar të drejtat themelore procedurale të të pandehurit në procesin penal dhe veçanërisht të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.

## **7.2. Problematikat e hasura në praktikë në procesin e mbrojtjes së të pandehurit**

Referuar nenit 38 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri edhe kur është me masë sigurimi izoluese, ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkak tjetër, merret në pyetje i lirë. Është e nevojshme të theksohet se i pandehuri, si rregull, nuk merret në pyetje me qëllim që të fitohet pohimi i tij se është autor i veprës penale, por me qëllim që të njoftohet mbi bazat e akuzës dhe t'i mundësohet mbrojtja. Megjithë këtë fakt, i pandehuri nuk ka obligim që të deklarojë, ç'ka do të thotë se ai ka të drejtë të heshtë. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjatë marrjes në pyetje, duhet të respektohet plotësisht dinjiteti i të pandehurit. Në këtë drejtim, gjatë çdo marrje në pyetje të tij, K.Pr.Penale ndalon keqtrajimin, shkaktimin e lodhjes, ndërhyrjet fizike, përdorimin e drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit, kanosjen, dhunën, premtimet në kundërshtim me ligjin dhe veprimet që dëmtojnë kujtesën e tij. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në disa vendime të saj, vlerëson rëndësinë e veçantë të lirisë gjatë marrjes në pyetje. Por në fakt, janë të panumërta rastet kur personat e ndaluar apo të arrestuar, në momentet e para pyeten nga oficerë të policisë gjyqësore pa praninë e mbrojtësit, duke dhënë deklarime sipas orientimeve të punonjësve të policisë, duke deklaruar emra bashkëautorësh fiktivë apo duke dhënë shpjegime, të cilat në fakt nuk kanë lidhje me faktin, i cili i atribuohet personit nën hetim, por i shërbejnë çështjeve të tjera penale, për të cilat kanë interes punonjësit e policisë. Personat nën hetim, në momentet e para të ndalimit të tyre, nuk informohen rreth faktit të ndalimit të tyre apo arrestimit. Ata pyeten disa herë nga punonjësit e policisë, duke mos pasqyruar çdo detaj të pyetjes në proces verbalet përkatëse, dhe deklarimi merret vetëm atëherë, kur personi nën hetim jep variantin “ e kënaqshëm” për punonjësin e policisë.

Referuar nenit 53 të Kodit të Procedurës Penale, personi i arrestuar në flagrancë, ose i ndaluar, ka të drejtë të flasë me mbrojtësin menjëherë pas arrestimit ose ndalimit. I

pandehuri i paraburgosur, ka të drejtë të flasë me mbrojtësin që në momentin e ekzekutimit të masës së sigurimit.<sup>366</sup> Pra, në zbatim të kësaj dispozite, personi i arrestuar apo ndaluar, menjëhere pas arrestit apo ndalimit, duhet të kontaktojë me mbrojtësin e zgjedhur. Në fakt, nga praktika jonë e përditshme, rezulton se mbrojtësi mund të kontaktojë me personin e arrestuar apo të ndaluar, vetëm kur çështja i kalon prokurorisë, dhe mbrojtësi bashkë me prokurorin përkatës, shkojnë në ambjentet e paraburgimit për të marrë deklaratime nga personi i dyshuar. Pra, në shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtësi nuk lejohet nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë që të kontaktojnë me personin e arrestuar apo të dyshuar që në momentet e para, fakt ky që i jep mundësinë këtyre punonjësve të marrin shpjegimet që dëshirojnë nga këta shtetas. Për të mos përmendur pastaj rastet, kur mbrojtësi dhe klienti shihen dhe konsultohen në sallën e gjyqit, para seancës së masës së sigurimit. Gjithashtu, në referim të nenit 7 të Ligjit 9109, dt. 17/7/2003 të ndryshuar,<sup>367</sup> avokati ka të drejtë të takojë personin e mbrojtur prej tij në mënyrë private dhe pa kufizim kohor. Organi i prokurorisë, gjykata, administrata e burgjeve dhe Policia e Shtetit, janë të detyruar të sigurojnë praninë e avokatit, kur këtë e kërkon personi i mbrojtur prej tij, i ndaluar, i arrestuar, ose që është duke vuajtur dënimin. Në të gjitha rastet, prania e avokatit duhet të sigurohet menjëherë. Vlen për tu theksuar se mosrespektimi i këtyre dispozitave nga aktorët e drejtësisë, sjell pavlefshmëri dhe veprimeve të kryera në shkelje të ligjit dhe cënon në këtë mënyrë procesin e rregullt ligjor.

Para se të merren në pyetje të pandehurit, është e domosdoshme konsultimi me mbrojtësin e kërkuar nga vetë ata, ç'ka passjell një proces të drejtë e legjitim.

Avokati në këtë rast, ka rolin e vëzhguesit gjatë një procesi hetimi e më pas gjykimi, rol i cili zgjat në vazhdimësi deri në fazën e ekzekutimit të dënimit penal. Çështja e të drejtave themelore dhe garantimi i tyre, është detyrë së pari e mbrojtësve, me qëllim që të garantojnë respektimin e këtyre të drejtave gjatë procedurave hetimore e gjyqësore. Respektimi i së drejtës së mbrojtjes, nënkupton një proces të drejtë dhe të paanshëm. Realizimi i së drejtës së mbrojtjes, s'mund të bëhet veçse nëpërmjet një procesi të tillë. Në të njëjtën kohë s'mund të kemi një proces të drejtë dhe të paanshëm, nëse e drejta e mbrojtjes nuk respektohet.

---

<sup>366</sup>Neni 53 i K.Pr.Penale të RSh

<sup>367</sup> Ligji Nr. 9109, dt. 17.7.2003” *Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë*”, ndryshuar me ligjin Nr. 1047, dt. 24.12.2008

## KAPITULLI VIII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

### 8.1 Konkluzione

Në Shqipëri procedimi penal ka ndjekur rrugën e përgjithshme të zhvillimit politiko-shoqëror, me ndryshimet dhe veçoritë përkatëse të çdo periudhe. Si rezultat i zhvillimeve politiko-juridike të pas viteve '90, kuadri kushtetues dhe legjislacioni, pësuan ndryshime rrënjësore konceptuale dhe procedurale. Në themel të dispozitave kushtetuese u vendos individi dhe të drejtat themelore të njeriut. Miratimi i Kushtetutës, në vitin 1998, rikonfirmoi të drejtat themelore të njeriut dhe ndër të tjera sanksionoi parimet kryesore dhe elementet bazë të procesit të rregullt penal si dhe të drejtat e palëve në këtë proces. Kjo ndodhi për shkak të karakterit delikat që mbart në vetvete gjykimi penal, për arsye se në të, vendoset përfundimisht mbi kufizimin ose jo të lirisë individuale. Kushtetuta Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, i ka renditur në mënyrë të hollësishme të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke marrë si bazë tekstin e Konventës Evropiane. Për më tepër, ajo i dha prioritet të drejtës ndërkombëtare, duke pranuar në nenin 5, se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke u plotësuar në nenin 122/1, se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Gjithashtu, Kushtetuta jonë ka njohur në nenin 116/1 dhe 122/2 të saj, epërsinë e marrëveshjes ndaj ligjeve të vendit. Rëndësi paraqet edhe neni 17/2 i Kushtetutës, në të cilin flitet për shkallën e kufizimit të të drejtave themelore, duke parashikuar se, në asnjë rast këto kufizime nuk mund t'i tejkalojnë standartet e vendosura dhe të parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo bën që KEDrNj, si pjesë e së drejtës ndërkombëtare që vepron në R.Sh, jo vetëm që qëndron mbi ligjin e brendshëm por orienton legjislacionin tonë drejt Bashkimit Europian.

Analiza e punimit, provon plotësisht hipotezën e ngitur se legjislacioni shqiptar, për sa i përket të drejtave të të pandehurëve, është në përputhje me aktet ndërkombëtare.

Në punim pasqyrohet evolucioni historik që ka bërë e drejta jonë penale, parimet bazë të saj dhe mënyrën si është trajtuar figura e të pandehurit në periudha të ndryshme kohore dhe në legjislacione të ndryshme.

Ajo që konstatohet, është përmirësimi i dukshëm i legjislacionit procedural penal, pasqyruar dhe në Kushtetutë, duke ndikuar fuqishëm në të parimet ndërkombëtare të së drejtës.

Nga gjithë analiza që i bëhet kornizës ligjore përsa i përket të drejtave të të pandehurit në procesin penal, arrihet në konkluzionin se legjislacioni procedural penal shqiptar, është në përgjithësi i plotë, përshkruhet nga parimet bazë të së drejtës penale ndërkombëtare dhe sanksionon më së miri të drejtat e të pandehurit në procesin penal.

Nga ana tjetër, këto të drejta gjejnë pasqyrim të plotë në Kushtetutën e R.Sh, ligjin themelor të Shtetit. Nga analiza që i bëhet parashikimeve ligjore në Kushtetutën e R.Sh, përsa i përket kuadrin ligjor të të drejtave dhe lirive të individit, vihet re se Kushtetuta jonë e përmend procesin e rregullt ligjor, por nuk jep një përkufizim të tij ose nuk përcakton kriteret bazë, që do të duheshin për të përcaktuar një proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Në nenin 42/1 të Kushtetutës, citohet se "liria, prona dhe të drejtat e njohura në kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çenohet pa një proces të rregullt ligjor", duke nënkuptuar se, një kërkesë e tillë shtrohet në radhë të parë për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndonëse jo vetëm për ato.<sup>368</sup>

Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, përmes jurisprudencës së saj, ka arritur me mjaft kujdes e maturi, të konsolidojë një praktikë relativisht të qëndrueshme lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kërkesave për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues. Në këtë drejtim, ajo ka ditur të harmonizojë mjaft mirë kërkesat e Kushtetutës sonë, me dispozitat respektive që parashikohen kryesisht në Kodet e Procedurës Penale, me kërkesat e nenit 6 të K.E.D.Nj dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata jonë Kushtetuese ka arritur që, përmes jurisprudencës së saj, të përcaktojë elementët kryesorë të këtij procesi, përmes të cilëve mund të veçohen: 1) e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, 2) gjykimi nga një gjykatë e pavarur e paanshme, 2) nocioni i vendimit dhe arsyetimi i tij, 3) barazia e armëve, 4) e drejta e mbrojtjes vetë ose me avokat, 5) e drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, etj<sup>369</sup>

Në analizë të praktikës gjyqësore të parashtruar në punim, konstatohet se të pandehurit të cilët kanë patur pretendim për çënim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, kanë vënë në lëvizje mjetet e mbrojtjes ligjore, duke i'u drejtuar Gjykatave më të Larta. Ky tregues hedh dritë mbi faktin se individi shqiptar është ndërgjegjsuar lidhur me mjetet ligjore të vëna në dispozicion nga Kushtetuta dhe aktet e tjera normative.

---

<sup>368</sup>Citim.Prof.As.Dr.Xhezair Zaganjori. *Koncepti kushtetuese mbi ankimin individual*. Jeta Juridike Nr.1 Gusht 2003

<sup>369</sup> Po aty

Një risi që vlen për t'u theksuar, është dhe deklarata që nënshkruan personi i marrë në pyetje nga punonjësit e policisë, ku ai deklaron nëse ndaj tij është ushtruar dhunë fizike apo psikologjike dhe se deklaramet janë dhënë me vullnet të plotë të personit.

E rëndësishme është që kjo deklaratë, të jetë nënshkruar me vullnetin e lirë të shtetasit që merret në pyetje dhe jo nën ndikimin e kanosjes apo dhunës fizike dhe psikologjike.

Dukshëm ka ardhur nevoja për një Kod të Ri të Procedurës Penale që t'i përgjigjet zhvillimit shoqëror, emancipimit të tij, zhvillimit teknologjik, zhvillimit të mentalitetit të njerëzve në përgjithësi dhe të personave me precedent penal në veçanti. Kodi i Procedurës Penale që ne kemi sot është miratuar në vitin 1995 dhe që nga ajo kohë është bërë përpjekje për ta "arnuar" me shtesa e paragrafe, që hera herës e ndërlikojnë aq shumë procesin, duke u bërë pengesë, në vënd që të bëhet zgjidhje e problemeve të ndërlikuara të procedimit penal. Ndryshimet e herëpashershme në kuadrin ligjor penal e atë procedural penal, shpesh herë mund të sjellin dhe amulli në zbatimin e drejtësisë në praktikën gjyqësore. Legjislativi duhet të ketë në konsideratë faktin se ndryshime në ligjet penale materiale dhe procedurale, duhet të jenë rrënjësore, të kenë si bazë të tyre efektivitetin, korrektësinë dhe frymën humaniste. Vihet re se sanksionet e reja dhe aktet në zbatim të tyre, nuk janë plotësisht specifike dhe të mjaftueshme. Në këto kushte, herë pas here lind si nevojë krijimi i një sistemi vlerësues për të analizuar efektivitetin e legjislacionit. Ndryshimet në legjislacionin procedural penal shqiptar, të clat kanë për qëllim përqasjen me Bashkimin Europian, duhet të kenë si objektiv të tyre dhe krijimin e Institucioneve të reja, të cilat do të kenë si detyrë zbatimin në praktikë të legjislacionit.

Inisiativat ligjore të ndërmarra së fundmi nga ligjvënësi nuk po japin rezultatin e duhur, edhe pse në fushën penale nuk ka asnjë studim të mirëfilltë nga juristë të shquar e me përvojë për t'ia përshtatur kushteve të Shqipërisë. Kodi ynë i Procedurës Penale ka shumë të meta, në disa raste për shkak të kopjimit nga legjislacionet e huaja, kryesisht ai Italian. Siç përmendëm në konkluzionet e arritura, megjithëse kuadri ligjor procedural penal është pothuaj i plotë, praktika ka vërtetuar se është e nevojshme të bëhet reforma ligjore edhe në Kodin e Procedurës Penale.

## 8.2 Rekomandime

Referuar analizës më lart, rekomandimet do të konkludonin si më poshtë:

a-Referuar dispozitave të K.Pr.Penale, lidhur me njoftimet konstatohet se neni 139/4 i K.Pr.Penale, nuk hedh dritë qartësisht se si do të bëhet njoftimi në banesën e deklaruar apo të zgjedhur nga i pandehuri. Nuk bëhet një analizë e qartë nëse do të kryhen të gjitha procedurat e njoftimit, në respektim të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 140 dhe 141 të K.Pr.Penale, duke specifikuar në dispozitë hollësisht procedurën e njoftimit të të pandehurit.

Rekomandoj që dispozita të përcaktojë nëse njoftimet do të bëhen në respektim të nenit 140 e 141 të K.Pr.Penale, duke e barazuar të pandehurin me masë sigurimi të ndryshme nga ajo e “Arrestit në burg “ me të pandehurin e lirë, apo për këtë kategori të pandehurish do të zbatohet një procedurë tjetër njoftimi.

b-Një konstatim tjetër lidhet me rastet e gjykimit në mungesë dhe rivendosjes në afat të të pandehurit, për të bërë ankim ndaj vendimit gjyqësor të dhënë në mungesë. Dispozita e parashikuar nënenin 147/1 të K.Pr.Penale, parashikon vetëm dy raste kur subjekti mund të rivendoset në afat. Një parashikim i tillë është shumë kufizues dhe lë hapësira për ndryshime, pasi duhet krijuar më shumë mundësi për rivendosje në afat, subjektit që jo për faj të tij ka humbur afatin për të bërë ankim. Mendoj se duhet të ndërhyhet në këtë dispozitë, duke parashikuar dhe raste të tjera të rivendosjes në afat.

Neni 147/2 i K.Pr.Penale, nuk është në përputhje me kërkesat e GjEDrNj, pasi Gjykata Europiane analizon dhe përcakton se barra e provës që rëndon mbi të pandehurin, përbën një pengesë ligjore objektive dhe pengon realizimin e të drejtave të garantuara nga konventa. Në këtë rast, duke pasur parasysh rekomandimet e ekspertëve të huaj ligjor, i pandehuri duhet të çlirohet nga detyrimi për të provuar se nuk ka pasur dijeni për vendimin dhe të gjëndet një zgjidhje tjetër që të mos rëndojë të pandehurin, duke ndërhyrë në dispozitë.

c-Nga ana tjetër, neni 147/3 i K.Pr.Penale, parashikon afatin 10 ditor brenda të cilit duhet të bëhet kërkesa për rivendosje në afat. Ky afat është relativisht i shkurtër, duke pasur këtu parasysh faktin që personi brenda 10 ditëve duhet të përgatisë një mbrojtje efektive për një vendim për të cilin nuk kishte as dijeni. Mendoj se kjo dispozitë duhet të ndryshoj duke parashikuar një afat ligjor më të gjatë për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat.

Në vazhden e rivendosjes në afat, rezulton se neni 148/1 i K.Pr.Penale, bëhet pothuajse i pazbatueshëm. Kjo për shkak se me interpretimin që i'u bë nga Gjykata e Lartë nenit 147/4 të K.Pr.Penale, u pranua që kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat do të konsiderohet gjykata e shkallës së parë. Për këtë arsye, qoftë me ndërhyrje nga ana e legjislatorit apo me interpretim nga Gjykata e Lartë, duhet t'i jepet një zgjidhje ngërçit të krijuar, duke konkretizur në nenin 147/4 të K.Pr.Penale, gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat.

d-Rezulton se dispozitat ligjore të parashikuara në nenet 350/1, 351/1 dhe 427/4 të K.Pr.Penale, përdorin terminologji të ndryshme për të identifikuar pamundësinë absolute të të pandehurit për t'u paraqitur në gjykim, duke lënë në këtë mënyrë shteg për interpretime të ndryshme juridike. Në këto kushte këto dispozita duhet të unifikohen, në mënyrë që të evitohen keqinterpretimet, duke përcaktuar shprehimisht “shkakun ligjor”, që passjell pamundësinë absolute të të pandehurit për t'u paraqitur në gjykim.

e-Efektiviteti i kërkesës për rivendosje në afat, është fakti që personi nuk i nënshtrohet ekzekutimit të një vendim i gjyqësor për dënimin e tij. Por, realisht personi i dënuar, nuk gëzon asnjë mjet ligjor që bashkë me kërkesën për rivendosje në afat, të kërkojë që të pezullohet edhe ekzekutimi i vendimit të dënimit. Rekomandoj që të ndërhyhet në këtë dispozitë dhe t'i jepet e drejta shtetasit të dënuar në mungesë, të kërkojë bashkë me rivendosjen në afat dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit.

Në punim janë trajtuar problematikat në rastet e mbrojtjes së të pandehurit. Në këtë kuadër, vlen për tu theksuar se praktika e vendosur nga prokuroria, se avokatit mbrojtës të të pandehurit, ndonëse është në përshtatje të plotë me vullnetin e këtij të fundit dhe konform Kodit të Procedurës Penale, përpara se të realizohet marrja e takimit me të pandehurin, i duhet leje paraprake nga ana e prokurorisë, jo vetëm që nuk ka asnjë bazë ligjore, por ndërkohë cënon rëndë interesat e të pandehurit. Marrja e kësaj leje paraprake bie ndesh me realizimin real të të drejtave që gëzon i pandehuri. Nuk është organi i prokurorisë ai që ia jep këtë të drejtë avokatit mbrojtës për t'u takuar me klientin e tij, të pandehurin, por është ligji që e vesh me një tagër të tillë. Pa folur këtu për praktikën e përditshme, ku evidentohen raste që avokatit mbrojtës i janë vënë pengesa artificiale, si psh, ai duhet të presë sa të merret firma nga titullari i prokurorisë, t'i jepet leja nga prokurori që drejton hetimet, që ti vuloset autorizimi nga sekretaria, etj. Një praktikë e tillë, e karakterit teknik nuk gjen

mbështetje në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, prandaj ajo nuk ka përse të ekzistojë më.<sup>370</sup> Në të kundërtën, ekzistenca e saj indirekt le të kuptohet që marrja e takimit me të pandehurin, mbetet në dëshirën e organit të akuzës dhe jo një detyrim i këtij organi për të mos penguar takime të tilla. Kur organi i akuzës dhe i pandehuri konsiderohen palë në raport me njëri-tjetrin, të drejtat dhe detyrimet e secilës s'janë produkt i marrëveshjes midis tyre, por të përcaktuara nga ligji. Prandaj, si të tilla, të dyja palët janë të detyruara t'i nënshtrohen ligjit.

Siç shihet, megjithëse doktrina penale e procedurale penale kanë bërë hapa përpara për interpretimin doktrinar të ligjeve penale e procedurale penale, ende nuk është shkëputur nga disa lidhje të së kaluarës dhe nuk ka arritur ende t'i paraprijë me rekomandimet e saj përmirësimit të ligjit penal e atij procedural penal. Ky është një ndër shkaqet kryesore se përse në Kodin tonë Penal e atë Procedural Penal, që nga viti 1995 e deri ditët e sotme, janë bërë shtesa e ndryshime të shumta. Në këtë kuadër, duhet të kemi në vëmendje citimin e kriminologut gjerman dhe autorit të politikës kriminale, Heinz Zipf, i cili thotë se: “Fusha e së drejtës penale nuk toleron ndërhyrje të shpejtuara, të pakonsultuara e të vlefshme vetëm për një kohë të shkurtër. Politika kriminale kërkon perspektiva afatmesme e afatgjata.”<sup>371</sup> Orientimet kryesore për politikën kriminale përmbahen në rekomandimin Nr. 96/8 “Për politikën kriminale në një Europë në transformim” të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës. Në këto rekomandime thuhet se: “Politika kriminale duhet të udhëhiqet nga parimet themelore të shteteve demokratike”.<sup>372</sup> Çdo shtet duhet të adaptojë një politikë kriminale koherente dhe racionale, të mbështetur në parimet bazë të të drejtave të njeriut.

Sa sipër, rekomandohet se doktrina e së drejtës procedurale penale, ka nevojë të azhurnohet me teoritë bashkëkohore, por konkludohet se mungojnë studimet e thelluara në këtë fushë. Pavarësisht se ky studim në aspektin e të drejtave të të pandehurit, është përpjekur të jetë gjithpërfshirës, janë lënë pa përmendur mjaft aspekte të rëndësishme të së drejtës. Për këtë arsye, rekomandoj se duhet të kryhen studime të tjera, të cilat në trajtimin e tyre të kenë parasysh parimet kushtetuese, të drejtën penale ndërkombëtare, aktet juridike

---

<sup>370</sup> Dhrami, J. (2010) *Të drejtat e të pandehurit në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, Tiranë: Revista Jeta Juridike, fq.

<sup>371</sup> Zipf, H. (1989) *Criminologia, Politica criminale, diritto penale, traduzione in italiano da Adriano Barzoni*, Milano: Giuffrè Editor, fq.320.

<sup>372</sup> Aktet juridike ndërkombëtare, botim i vitit 1999.



ndërkombëtare, vërejtjet e propozimet e botuara në shtypin e vendit dhe të huaj si dhe jurisprudencën shqiptare të deritanishme. Institucionet që bëjnë pjesë në sistemin e drejtësisë penale (pushteti gjyqësor, prokuroria, policia gjyqësore, sistemi i burgjeve) kanë sfidat e tyre të mëdha, të cilat mund të kapërcehen me realizimin e plotë të reformës në drejtësi që ndodhet në proces. Në themel të reformës, qëndron pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe e krejt këtyre institucioneve, nga ndërhyrja e politikës, lufta kundër korrupsionit dhe binomi ndershëmëri – ngritje e nivelit profesional, të personave që angazhohen në këto institucione. Vetëm me një sistem të drejtësisë penale, me kulturë juridike dhe respekt për ligjin mund të funksionojë shteti i së drejtës, të sigurohen liritë e të drejtat e njeriut dhe mund të integrohemi në Bashkimin Evropian.

## LISTA E REFERENCAVE/ BIBLIOGRAFIA

### Literaturë

- Alibrandi,L. & Coso,P. (2015), *Codice Penale e di Procedura Penale*, Itali: Editore Tribuna
- Allen,J.R & Stunz,J.W, ( 2015) *Comprehensive Criminal Procedure*, New York: Woltres Kluver
- Allen,J.R, Hoffmann,L.J. (2005), *Criminal Procedure, In vestigation and Rights to Council*,New York: Aspen Publishers
- Alsula,A. ( 2006), Përmbledhje vendimesh unifikuese të Gjykatës së Lartë, Tiranë: QPZ
- Anastasi,A. (1998), *Institucionet Politike dhe e drejta Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë: Luarasi
- Anastasi,A. & Omari,L. ( 2010 ), *E drejta Kushtetuese*, Tiranë: ABC
- Antoni,M. (2003), *Rreth Konventës Europiane*, Tiranë: Morava
- Antolisei,F. (2008), *Manuale di diritto penale, Parte generale*, Milano: Giuffre
- Banaszak,A.R. (2002), *Fair trial rights of the accused: a documentary history*, Westport: Greenwood Press
- Barkan,S.E. & Bryjak,J.G. (2011), *Fundamental of criminal justice: a sociological view*, Ontario: Jones & Bardett Learning. LLC
- Bergman,P. & Berman,S. (2015) *The criminal law Handbook, know your rights, survive the system ( Fundamental trial rights of the defense)*, USA
- Brazzi,M. (2012), *La difesa dell'indogato nella fase precauteore-L'arresto in flagrance e il fermo-*, Milano: Giuffre
- Brezina,C. (2011), *The fifth Amendament: double jeopardy, self-incrimination and due process of law*, New York: Rosen Publishing Group
- Broyles,S. (2011), *Criminal laë in the USA*, Leiden: Wolters Kluwer
- Burgan,M. (2007), *Miranda v. Arizona: the rights of the accused*, Minneapolis: White-Thomson Publishing

- Cartan,P., Nored,L. & Doëney,R. (2011), *An Introduction to Criminal Law*, Sudbry: Jones & Bartiett Learning
- Charret-Del Bove,M. & Mourlon,F. (2014), *Pre-trial detention in 20<sup>th</sup> and 21<sup>st</sup> Century Common Law and Civil Law System*, Kembrixh: Cambridge Scholars Publishing
- Chemerinsky,E&,Levenson,L.L. (2015), *Criminal Procedure.Case and statutory supplement, Chapter 12*, New York: Wolters Kluwer
- Cicchini,D.M & Kushner,B.A. (2010), *But they didn't read me my rights:Myths, Oddities and Lies about aur legal System, Problems ëith the Police*, New York : Prometheus Books
- Cicchini,D.M. (2012), *Tried Convicted:How Police Prosecutors and Judges destroy aur constitutional rights*, Maryland: Rowman&Littlefield Publishers
- Cloud,J. (2002), *Criminal law*, New York: Aspen Publishers
- Cordero,F. (1995), *Procedura Penale*, Terca Edizione, Milano: Giuffre
- Dammer,H.R. & Albanese,S.Y. (2014), *Comparative criminal justice systems*, Belmont: Wadsworth
- Dimitrakopoulos,G.I. (2007), *Individual rights and liberties under the U.S. Constitution: The Case Law of the U.S. Supreme Court*, Leiden : Martinus Nijhoff Publishers
- Elezi,I. (1983), *E drejta penale e R.P.S.SH. Pjesa e posaçme*, Tiranë: 8 Nëntori
- Elezi,I.,Çela,A.,Gjika,D.,Dumi,D. & Peza,N. (1982), *E drejta penale e R.P.S.Sh. Pjesa e përgjithshme*, Tiranë: 8 Nëntori
- Elezi,I.,Çela,K. & Peza,N. (1987), *E drejta penale e R.P.S.Sh. Pjesa e përgjithshme*, Tiranë: 8 Nëntori
- Elezi,I. (1998), *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, Tiranë: Albin
- Elezi,I. (1999 ), *E Drejta Penale (pjesa e posaçme )*, Tiranë: Albin
- Elezi,I. (2002), *E drejta zakonore e labërisë*, Tiranë: Toena
- Elezi,I. (2009), *E drejta penale (Pjesa e posaçme)*, Tiranë: ERIK
- Elezi,I.(2001), *Komentar i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal me ligjin Nr.23, dt.01.03.2012*, Tiranë : Erik

- Elezi,I.(2012), *Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal me ligjin Nr.8733, dt.24.01.2001*, Tiranë : Albin
- Elezi,I., Kaçupi,S. & Haxhia,M. (2006), *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë,Pjesa e Përgjithshme*, Tiranë : Geer
- Elezi,I., Kaçupi,S. & Haxhia,M. (2009), *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, Shblu Tiranë
- Elliott,C.(2001), *French Criminal Law*, New York : Eillan Publishing
- Elshani,Xh. & Dehari,M. (2008), *Kodi Procedurës Penale i Kosovës*, Prishtinë: Insituti Gjyqësor i Kosovës
- Ferrari,G. (2014), *Codice Penale*, Milano: Editore Ulrico Hoepli
- Ferrajoli, (2000), *Diritto e ragione. Teoria del garantismo penale*,Roma: Laterza
- Fiandaca,M. & Musco,E. (1997), *Diritto Penale, Parte Generale*, Bologna: Zanichelli
- Geronimo,P. (2009), *Teoria e pratica del diritto.IL contributo dell imputato all'acertamento del fatto*, Milano:Editore Giuffre
- Goldstein,W.H. (2015), *Grand jury practice*, New York : ALM Media
- Grilli,L. (2014), *Il dibattito penale, guida pratica*,Milano: Giuffre
- Gurule,J. (2013), *Complex criminal litigation: prosecuting drug enterprises and organized crime*, New York: Juris Publishing
- Hall,E.D. ( 2015), *Criminal law and procedure*, Stamford: CENGAGE Learning
- Islami, H., Hoxha, A. & Panda, I. (2003), *Komentari i Kodit të Procedurës Penale të RSh*, Tiranë: Botimet Morava
- Islami, H., Hoxha,A. & Panda,I. ( 2012 ), *Procedura Penale*, Tiranë: Morava
- Islami,H. & Hoxha,A., Panda I. (2007), *Komentari i Procedurës Penale*, Tiranë: Botimet Morava
- Islami,H., Hoxha,A.& Panda,I. (2007), *Procedura Penale*, Tiranë: Morava
- Kambovski,V. ( 2010), *E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme*,Shkup : Furkan
- Killian,H.J., Costello,A.G., Thomas,K.R., Ackerman,M.D., Cohen,H., Meltz,R., (2002), *The Constitution of the United States of America.Analysis and Interpretation*,Uashington: Library of Congress

- Kodifikim i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore të Shqipërisë (1945-1957), Vëllimi III – Botim i Kryeministrit, Tiranë 1958
- Komentari i Kodit Penal, Pjesa e posaçme, 1960, botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës
- Konomi (Perolla),R. (2013), *Rendi etnojuridik nga statutet tek kanunet*, Tiranë :Kristalina - KH
- Kusha,R.H. (2004), *Defendant rights: a reference handbook*, Kaliforni : ABC-CLIO
- Lattanzi,G. & Lupo,E. (2008), *Codice di procedura Penale. Rassenga di Giurisprudenza e di dottrina*, Milano: Editore Giuffrè
- Luarasi,A. (2001), *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Tiranë:SHBLU
- Luarasi,A. (2007), *Historia e Shtetit dhe të Drejtës në Shqipëri*, Tiranë : Luarasi Press
- Luarasi,P.K. (1929), Aktet juridike ndërkombëtare, botim i vitit 1999 Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare, Tiranë: Shtypshkronja “ Mbrothësija”
- Muçi, Sh. (2012), *E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Tiranë: Dudaj
- Muci,Sh. (2007), *E Drejta Penale (pjesa e përgjithshme)*, Tiranë : Dudaj
- Novak,A. (2014), *The global decline of the mandatory death penalty: constitutional jurisprudence and legislative reform in Africa, Asia and the Caribben*, USA : Ashgate Publishing Limited
- Nowicki M,A. ( 2002), Gurët udhërrefyes, Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Tiranë: Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- Pagliaro, (1998 ), *Principi di diritto penale*, Milano: Giuffrè
- Palmer,J.L.& JR. (1998), *The death penalty: an american citizen's guide to understanding federal and state laws*, Karolina e Veriut: McFarland Company, Inc., Publishers
- Përmbledhës i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1945-1985) Vëllimi II ,Tiranë 1986, botim i Byrosë juridike në aparatit e Këshillit të Ministrave
- Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë, (2006), Tiranë: QPZ

- Përmbledhje të Akteve Ndërkombëtare, (2010), botim i Qendrës Publikimeve Zyrtare
- Përmbledhje vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, Tiranë : Botimet Ilar
- Pouit,M. (2013), *Les atteintes à la présomption d'innocence en droit pénal de fond*, Paris: Editions Universitaires Europeennes
- Pradel,J. (2002), *Manual de procédure pénale*, Paris: Cujas
- Pradel,J., Corstens,G. & Vermeulen,G. (2009), *E Drejta Penale Evropiane*, Tiranë: Papyrus
- Gruda,Z. (2001), *Mbrojtja ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*, Prishtinë:Universiteti i Prishtinës
- Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë, botim i QPZ
- Përmbledhje Legjislacioni për sistemin e drejtësisë, botim i QPZ
- Përmbledhje vendimesh unifikuese të Gjykatës së Lartë, 2012, botim i QPZ
- Puto,A. (2002), *Konventa Europiane për të Drejtat e njeriut në përqasje me Kushtetutën Shqiptare*, Tiranë: Albin
- River,Ch. (2015), *Criminal law procedure. A background on the elements of crimes and the rights of defendants*,USA: CreateSpace Independent Publishing
- Rudstein,S.D. (2004), *Double Jeopardy: a reference guide to the United States Constitution*, Westport: Praeger Publishers
- Ruschmann J.D.P. (2007), *Miranda Rights*, New York: Infobase Publishing
- Salihu,I. (2008), *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Prishtinë, Fakulteti Juridik
- Sahiti,E. (2005), *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë: Fakulteti Juridik
- Samaha,J. (2014), *Criminal Procedure ( self – incrimination)*, Stamford: Library of Congress
- Scheb,M.J. & Scheb,M.JII. (2011), *Criminal law and procedure*, Belmont: Wadsworth
- Shegani,A. (2007), *E Drejta penale e krahasuar*, Tiranë :
- Shegani,A.,Haxhi,P. & Cela,K. (2013), *E Drejta Penale e Krahasuar*, Tiranë:Albpaper

- Siegel,J.,L& Worrall,L.J. (2014) *Essentials of Criminal Justice*,Stamford,USA: Library of Congress
- Sijerçia-Çolliq. & H.Haliloviq,H. (2007), *E drejta e Procedurës Penale me vështrim të posaçëm në Procedurën Penale të Kosovës*, Prishtinë
- Siracusano,D., Galati,A. & Tranchina,G., Zappala,E. (2013), *Diritto Processuale Penale*,volume primo, Seconda Edizione, Milano: Giuffrè
- Smith,R. (2008), *Eighth amendment: the right to mercy*,Minneapolis: ABDO Publishing Company
- Smith,R. (2008), *Fourth Amendment: The right to privacy*, Edina: ABDO Publishing
- Spangher Shameti,M. (2014), *Sistemi gjyqësor penal shqiptar i parë në planin krahasues me atë italian*, Tiranë: Instituti i Studimeve Europiane
- Spangher, G. (2014), *Codice di Procedura Penale e Leggi complementari*, Itali: botim Diritto & Diritti
- Spangher,G. (2012), *La pratica del processo penale*, Milano: Cedam
- Steiner-Alston, (1999), *Të drejtat Ndërkombëtare të njeriut në kontekstin e ligjit,politikës dhe moralit*, Oxford
- Summers,J.S. (2007), *Fair trials: the European Criminal Procedural Tradition and the European court of Human Rights ( Criminal law)The Rights of the defence*, North America: Hart Publishing
- Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në një proces gjyqësor, Mars 2013, Tiranë : botim i USAID
- Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH, përmbledhje e viteve 1967, 1968, 1969 dhe 1970, Shtëpia botuese « 8 Nëntori »
- Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH, përmbledhje e viteve 1974, 1975, 1976 dhe 1977, Shtëpia botuese « 8 Nëntori »
- Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH, përmbledhje e viteve 1974, 1975, 1976 dhe 1977, Shtëpia botuese « 8 Nëntori »
- Uka,Nj. & Brati, J. ( 2012), *Magjistratura & Avokatia*, Tiranë : Ilari
- Urbina,G.M. ( 2012), *Hispanics in the U.S. Criminal justice system: the need American demography*, Illinois: Charles Thomas Publisher

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2011, botim i Gjykatës Kushtetuese
- Vile, R.J. (2010), *Essential Supreme Court decisions: summaries of leading cases in U.S.*, Maryland: Roëman & Littlefield Publishers
- Wasserman, R. (2004), *Procedural Due process: a reference guide to the United States Constitution*, Westport : Prager Publishers
- Woods, D.G. (2002), *A history of criminal law in New South Wales: The Colonial Period, 1788-1900*, Sidni: Federation Press
- Zaganjori, Xh., Anastasi, A. & Çani, E. (2011), *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë: Adelprint
- Zipf, H. (1989), *Criminologia, Politica criminale, diritto penale, traduzione in italiano da Adriano Barzoni*, Milano: Giuffrè Editor

### **Burime parësore**

- Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1946
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, "*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*", shpallur me Dekretin Nr. 2260, datë 28.11.1998, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, miratuar nga populli me referendumin e datës 22 nëntor 1998.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve të saj shtesë, nënshkruar në Romë 1950, hyrë në fuqi 1953, ratifikuar me Ligjin Nr. 8137, dt. 31.7.1996, Tiranë: QPZ
- Konventa kundër Torturës dhe Akteve Ç'njerëzore dhe Degraduese, ratifikuar nga RSH në vitin 1994 nga Asambleja e Përgjithshme, me Rezolutën 39/46, dt. 10.12.1984
- Protokollin Nr.12 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Romë, dt. 4.11.2000
- Protokollin Nr.7 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive hemelore, amenduar me protokollin Nr.11, Strasburg, dt. 22.11.1984



- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, shpallur më 10.12.1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, (aderuar më 1991)
- Rezoluta Nr.955 dt. 8 Nëntor 1994
- Ligj Nr. 9675, datë 13.1.2007 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë””, shpallur me Dekretin Nr.5191, datë 14.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- Ligj Nr.88/2012 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, shpallur me dekretin Nr.7779, datë 9.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- Ligj Nr.9904, datë 21.04.2008 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, shpallur me Dekretin Nr.5700, datë 6.5.2008 të Presidentit të Republikës
- Ligj, Nr. 8175, Dt. Aktit: 23.12.1996, dt.Miratimit: 27.12.1996 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare Nr.29, Tiranë
- Ligji Nr. 10023, Dt.Aktit: 27.11.2008, Dt.Miratimit: 27.11.2008 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare Nr.190, Tiranë
- Ligji Nr. 4406, dt. 24.6.1968 “ *Për organizmin gjyqësor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatin e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986
- Ligji Nr. 6298, dt. 27.3.1981 “ *Për Prokurorinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatin e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986
- Ligji Nr. 6800, dt. 29.6.1983 “ *Për hetuesinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, botim i Byrosë juridike në aparatin e Këshllit të Ministrave, Tiranë, 1986
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren zyrtare Nr.5, Tiranë

- Ligji Nr. 8498, datë 10.06.1999 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës ‘Për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale’ dhe Protokollin e Saj Shtesë”, botuar në fletoren zyrtare Nr.21, dt. 22.7.1999
- Ligji Nr. 8733, dt.Aktit: 24.01.2001, dt.Miratimit: 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare Nr.4, Tiranë
- Ligji Nr. 8883, datë 18.04.2002 “Për Ratifikimin e Protokollit të Dytë Shtesë të ‘Konventës së Këshillit të Europës për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale”, botuar ne fletoren zyrtare Nr. 17, 27.4.2001
- Ligji Nr. 9109, dt. 17.7.2003, ” *Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë*”, botuar në Fletoren zyrtare Nr.66, Tiranë, ndryshuar me Ligjin Nr. 9795, datë 23.7.2007, botuar në Fletoren zyrtare Nr. 104, ndryshuar me ligjin Nr. 10047, datë 24.12.2008, botuar në Fletoren zyrtare Nr. 202, ndryshuar me ligjin Nr. 91/2012, datë 27.9.2012, botuar në Fletoren zyrtare Nr.135
- Ligji Nr. 9275, Dt.Aktit: 16.09.2004, Dt.Miratimit: 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Fletore zyrtare Nr.69, Tiranë
- Ligji Nr. 9590, datë 27.7.2006, ”Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare”,botuar në Fletoren zyrtare Nr. 87, dt. 14.8.2006, Tiranë
- Ligji Nr. 9686, dt.Aktit: 26.02.2007, dt.Miratimit: 26.02.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare Nr.27, Tiranë
- Ligji Nr.23/2012, Dt.Aktit: 01.03.2012, Dt.Miratimit: 01.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Fletore zyrtare Nr.26, Tiranë
- Ligji Nr.7, Fruer 1929, “*Mbi Organizimin e Drejtësisë*”,Tiranë: Ministria e Drejtësisë, (Mbretëria Shqiptare), Përmban Dekretin e mbretit Ahmet Zogu për aprovimin dhe zbatimin e ligjit, Shtypshkroja Nikaj
- Ligji Nr.7541, datë 18.12.1991, ”*Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë*”, botuar në Gazetën Zyrtare Nr.10, Dhjetor 1991

- Ligji Nr.7561,dt.29/04/1992, “Dispozitat Kushtetuese për organizimin e drejtësisë”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.5, Prill 1993
- Ligji Nr.7574, datë 24.6.1992, ”Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.3, Korrik 1992
- Ligji Nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese", botuar në Fletoren Zyrtare Nr.5, Prill 1993
- Ligj Nr.7717, datë 6.2.1993. Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.- Fletorja Zyrtare 9, Korrik 1993
- Ligji Nr.7895, dt.Aktit: 27.01.1995, dt.miratimi: 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Fletore zyrtare Nr.2, Tiranë
- Ligji Nr.8737, datë 12.2.2001, ndryshuar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese Nr. 25, datë 13.02.2002,ndryshuar me ligjin Nr. 9102, datë 10.07.2003, ndryshuar me ligjin Nr. 10051, datë 29.12.2008,i azhurnuar “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr.8813, dt. 13.6.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" ,botuar në fletoren zyrtare Nr.29, dt. 26.6.2002
- Ligjin Nr. 7386, datë 08.05.1990 “ Për disa ndryshime në Kodin Penal të R.Sh”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.3, dt. 14.5.1990
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Prill 2009
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i vitit 1953, ndryshuar me ligjin Nr. 1776, datë 03.12.1953 dhe me ligjin Nr. 2805, datë 04.12.1958
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 6069, datë 25.12.1979
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Prill 2009
- Kodi Penal i vitit 1928. Libri i Parë, Tiranë; Botim i Këshillit të Shtetit

## Burime dytësore

- Alexander,P.R. & Portman,Sh. (1974), *Grand jury indictment versus prosecution by information- an equal protection due process issue*, Standfort: The Hastings Law Journal, vol .254
- Berhami,I. (2009), *Disa aspekte të përgjithshme të së drejtës zakonore shqiptare*, Tiranë: Buletin Shkencor : Seria e shkencave ekonomiko-juridike, Nr. 3
- Biba,D. & Zaganjori,Xh. (2010), *Zbatimi i sundimit të ligjit në Shqipëri*, Shkup: Revista "Mendimi politik", Nr. 32
- Buletin i posacëm “ 10 vjet Gjykatë Kushtetuese “, 2003, Tiranë: botim i Gjykatës Kushtetuese dhe Komisionit të Venecias
- Claus,L. (2008), *Methodology, proportionality, equality: which moral question does the eighth amendment pose*, Harvard : Journal of Law&Public Policy, Vol. 31. Nr.1
- Dhrami,J. (2010), *Raportet e prokurorit me të pandehurin dhe të dëmtuarin akuzues*, Tiranë: Jeta juridike, Shkolla e Magjistraturës
- Dhrami,J. (2010), *Të drejtat e të pandehurit në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, Tiranë: Revista Jeta Juridike
- Dobjani,E. (2008), *Parimi i sigurisë juridike*, Në: Jeta juridike Nr.4, Dhjetor 2008, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë
- Elezi,I. (2009), *Vështrim i shkurtër historik i drejtësisë penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, Revistë Shkencore «Justiniani I», Tiranë: Albin
- Fellman,D. (1976), *The defendant’s rights today*, Wisconsin: Wisconsin Press
- Freeman,M. & Smith,F. (2013), *Law and language*, Oksford: Oxford University Press
- Gjonaj(Saliu),E. (2014), *Rigjykimi i çështjes në zbatim të vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut*, Tiranë: Revista Avokatia Nr. 8, botimi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare
- Gogorza,A. (2015), *The influence and false influence of European Union Law on French criminal procedure, Nr.1*, Australia: Montesquieu Law Review
- Goring,D.C. (1984), *Fourth Amendment-Prison Cells: Is there a Right to Privacy*, Louisiana State: Journal of criminal Laë and Criminology, vol.75, Nr. 3

- Hocking,B.A. & Manville,L.L. (2001), *What of the right to silence: still supporting the presumption of innocence, or a growing legal fiction?* Vol.1, Nr.1, Australia: Macquarie Law Journal
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit,(2006), *Raporti i të drejtave të njeriut në Shqipëri (1997-2003)*
- Krisafi,K. (1979), *Shteti dhe e drejta në Iliri*, Revista Drejtësia Popullore, Nr.1, Tiranë
- Kutu,F. (2002), *Chronique de jurisprudence: Le droit à un procès penal équitable au sens de la jurisprudence strabourgeoise en 2001*, Nr.14, France: JLMB
- Marty,M.D. & Spencer,J.R. (2002), *European Criminal Procedures*, Kembrixh: Cambridge University Press
- MCKillop,B. (2003),*Position of Accused Persons under the Common Law System in Australia (More Particularly in New South Wales) and the Civil Law System in France*, The Legal Systems, France : UNSW Law Journal, Vol.26, Nr.2
- Mckillop,B. (2003), *The position of accused persons under the common law system in the Australia (more particulary in New South Wales) and the Civil Law System in France*, vol. 26,Nr.2, France: UNSW Law Journal
- Mole,N. & Harby,C. (2006), *The right to a fair trial [E drejta për një proces të drejtë gjyqësor]*, Udhëzuesi Nr. 3 i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut, Këshilli Europës
- Myrtja,Y. (2005), *Funksioni i Prokurorisë dhe garancitë kushtetuese dhe ligjore të prokurorëve në detyrë* , Revista Juridike Nr. 2, (Studime Juridike), Universiteti i Tiranës
- Nicholls,C. & Montgomery,C. & Knowles,J. (2007), *The laë of extradition and mutual assistance*, Oxford: Oxford University Press
- Omari,L. (1990), *E drejta zakonore dhe e drejta zyrtare në Shqipëri*, Revista Drejtësia Popullore, Korrik-Shtator, Tiranë: SHBLU
- Omari,L. (2002), *Shteti i së Drejtës*, Akademia e Shkencave, Shtëpia botuese Lilo
- OSCE, Maya Goldstein-Bolocan, (2007), *Analiza e procedimeve të çështjeve penale në apel në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë: Albpaper

- Paskali,F. (2001), *Gjykimi në mungesë i të pandehurit*, Tiranë: Tribuna Juridike, Nr.30
- Pradel,J. (1995), *La protection de la personne en France depuis les réformes de procédure penale en 1993, vol. 29, Nr.1*, France: Thémis
- Pulice,E.B. (2010), *The right to silence at risk: neuroscience-based lie detection in the United Kingdom, India and the United States*, The George Washington International Law Review, Vol. 42, Nr.4
- Puto,A., Kondi,Th., Zaka,T. & Kalo,P., Kumbaro,M. (2001), *Për një rend publik Europian*, Vëllimi I, Tiranë: Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- Raporti i ECRI për Shqipërinë ( cikli i katërt monitorues), miratuar më 15.12.2009, publikuar më 02.3.2010
- Raporti i ECRI për Shqipërinë ( cikli i pestë monitorues), miratuar më 19 mars 2015, botuar më 9 qershor 2015
- Raste të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, botim i Komitetit Suedez të Heksinkit për të Drejtat e Njeriut
- Revista “ Avokatia”, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë
- Revista “ Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës
- Revista “ Studime sociale”, vol 7, Nr.3, 2013, botim i Albanian Insitute of Sociology
- Revista “ Të drejtat e Njeriut “, Botimi 49-50, viti 2007, botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- Revista “ Të drejtat e Njeriut “, Vëllimi 3 i vitit 1997, vëllimi 4 i vitit 1998, vëllimi 5 i vitit 1998, botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut
- Selmani,A. (2007), *Manual për prokurorët dhe gjyqtarët*
- Smibert,J. (2013), *Udhëzues për K.Pr.Penale të Kosovës dhe K.Pr.Penale të Kosovës*, Prishtinë: Ambasada e SHBA
- Spiro,S. (2010), *Leksione mbi të Drejtën Penale*, Tiranë : Universiteti Europian i Tiranës (UET)
- Thomas,C.G. (1998), *Double Jeopardy: the history, the laë*, Neë York: University Press

- Zaganjori,Xh. (2003),*Koncepti kushtetuese mbi ankimin individual*, Tiranë:Jeta Juridike Nr.1, Gusht 2003
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K.Gjeçovi, përgatitur dhe pajisur me shënime nga Koço Nova
- Kanuni i Zhurisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, korrik 2009

### **Praktikë gjyqësore**

- Colozza kundër Italisë,GjEDNj, 9024/80, aktgjykimi i datës 12 shkurt 1985
- Salduz kundër Turqisë, 27 Nëntor 2008
- Axen kundër Republikës Federale të Gjermanisë, dt. 8.12.1983
- Allenet de Ribemont kundër Francës, dt.10.02.1995
- John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.08.02.1996
- Van Mechelen dhe të tjerë kundër Hollandës, dt.23.04.1997
- Krcmar dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, dt. 03.03. 2000
- Sutter kundër Zvicrës datë 22.02.1984
- Belzuik kundër Polonisë, 25.3.1998
- FCB kundër Italisë, 28.8.1991
- Puzelt kundër Republikës Çeke, 25 Prill 2000
- Engel dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulta, 8 Qershor 1976
- Van Den Leer kundër Vendeve të Ulta, gjykimi i 21 Shkurt 1990
- Berhani kundër Shqipërisë, gjykimi i 27 Maj 2010
- Kamasinski kundër Austrisë, 9783/82,19 Dhjetor 1989
- Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, Aplikim Nr. 123451/04 dhe 17605/04, dt. 20 prill 2010
- Gjonbocari e të tjerë kundër Shqipërisë, GjEDrNj, 23 tetor 2007
- Sejdivic kundër Italisë, Nr. 56581/00, GjEDrNj 2006
- Luca kundër Italisë, Nr.33354/96, dt.27.5.2001
- Kurt kundër Turqisë, gjykimi i 28 Majit 1998
- Vendim dt. 22.09.1970 i Gjykatës së Lartë, Drejtësia Popullore Nr.6 e vitit 1970
- Vendim dt. 18.01.1974 i Gjykatës së Lartë,
- Vendim dt. 02.08.1977 i Gjykatës së Lartë

- Vendim dt. 14.03.1979 i Gjykatës së Lartë
- Vendim dt. 23.08.1980 i Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr. 13, datë 29.05.1997 i Gjykatës Kushtetuese të RSh
- Vendime të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 31, dt. 14.7.1998
- Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 47, dt. 28.02.1999
- Vendim Nr.28, dt.19.03.1999 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 354, dt. 28.7.1999
- Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 386, dt. 29.7.1999
- Vendim Nr.9 dt.22.02.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr. 17, dt. 17.4.2000 i Gjykatës Kushtetuese të RSh
- Vendim Nr.33, dt.24.05.2000 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendimi Nr.156 dt. 25.5.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim unifikues i Gjykatës së Lartë, Nr. 371, dt. 27.10.2000
- Vendim gjyqësor Nr.310, dt. 21.11.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër
- Vendim Nr.3, dt.29.01.2001 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr.1, dt.15.02.2001 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr. 9, dt. 22.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr. 17, dt. 09.03.2001, i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr. 88, dt.28.02.2001 i Gjykatës së Apelit Tiranë
- Vendim unifikues Nr.2, dt.19.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr.24, dt.24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr. 21, dt. 14.5.2001 i Gjykatës së Apelit Durrës
- Vendim Nr.5 dt.7.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr.96 dt.27.07.2001 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr. 473, dt. 29.10.2001 Gjykata e Apelit Tiranë
- Vendim Nr.176, dt. 04.3.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr.102, dt.18.04.2002 i Gjykatës së Apelit Durrës
- Vendim Nr.341 dt.23.05.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr.3, dt. 27.9.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr. 258, dt. 21.10.2002 i Gjykatës së Apelit Durrës



- Vendim Nr.570, dt. 23.10.2002 i Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr.568, dt.23.10.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr.57, dt. 12.02.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë
- Vendim Nr.123 datë 02.03.2005 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendim Nr. 21, dt. 24.07.2006 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr. 27, dt. 11.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr.412, dt. 18.04.2007 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë
- Vendimi Unifikues Nr.4.dt. 24.06.2009 i Gjykatës së Lartë
- Vendimi Unifikues Nr.1, dt 08.01.2009 i Gjykatës së Lartë
- Vendim unifikues Nr.7 dt. 14.10.2011 i Gjykatës së Lartë
- Vendimin Nr. 5, dt. 25.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese
- Vendim Nr.410, datë 18.04.2007 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

### **Burime nga interneti**

- Elezi, I. (2001), *Vështrim i Shkurtër Historik i Drejtësisë Penale në Shqipëri dhe sfidat para saj*, <http://drejtësiashqiptare.com>
- L'accès au dossier au stade de l'instruction  
[https://www.courdecassation.fr/publications\\_26/rapport\\_annuel\\_36/rapport\\_2010\\_3\\_866/etude\\_droit\\_3872/e\\_droit\\_3873/obligation\\_information\\_3874/obligation\\_information\\_droit\\_processuel\\_19401.html#1.1.3.1.2](https://www.courdecassation.fr/publications_26/rapport_annuel_36/rapport_2010_3_866/etude_droit_3872/e_droit_3873/obligation_information_3874/obligation_information_droit_processuel_19401.html#1.1.3.1.2)
- Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia laë school students about grand juries*  
[http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)
- *Fifth amendment: an overview*  
[https://www.law.cornell.edu/wex/fifth\\_amendment](https://www.law.cornell.edu/wex/fifth_amendment)
- Fifth amendment. *Rights of persons*,  
<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-REV-2014/pdf/GPO-CONAN-REV-2014-10-6.pdf>

- Kaley kundër SHBA, 2014, marrë nga Jeffrey Fagan, Bernard E. Hacıourt, *Fact sheet: questions and answers for Columbia law school students about grand juries*, [http://www.law.columbia.edu/media\\_inquiries/news\\_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury](http://www.law.columbia.edu/media_inquiries/news_events/2014/november2014/Facts-on-Ferguson-Grand-Jury)
- Crist kundër Bretz, 1987, *Fifth amendment. Rights of persons*, <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-REV-2014/pdf/GPO-CONAN-REV-2014-10-6.pdf>
- Eighth amendment. *Further guarantees in criminal cases* <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-2002/pdf/GPO-CONAN-2002-9-9.pdf>

## Websites

- [www.gjykataelartë.gov.al](http://www.gjykataelartë.gov.al)
- <http://www1.fint.gov.al/al/>
- [http://www.Laundryman.u\\_net.com/pag.1hist.html](http://www.Laundryman.u_net.com/pag.1hist.html)
- <http://www.fatf-gafi.org/>
- <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GPO-CONAN-1992/pdf/GPO-CONAN-1992-10-7.pdf>
- <http://law.justia.com/constitution/us/amendment-06/02-speedy-trial.html>
- Jury trial, <http://law.justia.com/constitution/us/amendment-06/04-jury-trial.html>
- [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës  
[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta\\_sh.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf)
- [www.parlament.al](http://www.parlament.al)
- <http://www.bibliotecavolumi.giuffre.it>
- Gjykata e Lartë  
<http://www.gjykataelartë.gov.al/>
- Gjykata Kushtetuese  
<http://www.gjk.gov.al/>  
<http://www.dirttweb.org>

- GJEDNJ  
[http:// www.coe.int](http://www.coe.int)
- <https://docassas.u-paris2.fr/nuxeo/site/esupversions/ec87b75c-7498-4a6f-a32e-468606f5556d>
- <http://hudoc.echr.coe.int/>